



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURAS  
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK  
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE  
MARS 2023

# REVISTA USHTARAKE

(edicioni i parë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2023



Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura  
Miratuar me vendim nr. 1, datë 01. 03. 2023  
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

**Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake**

**Kryetari i Bordit**

Gjeneral Brigade **Bilbil Bitri**

**Anëtarët e Bordit**

Kolonel Msc. **Ulsi Rexhaj**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Kolonel Msc. **Hysni Gjergji**

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Dr. **Etleva Smaçi**

Kolonel Msc. **David Rroku**

Msc. **Blerina Vorpsi**

Kryeredaktor

**Pano Hallko**

Art design

**Engjellushe Llulla**

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2023 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Copyright © 2023 by the Military Scientific Research Institute of the Academy of Albanian Forces.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në “Revista Ushtarake” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura  
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak  
**Shtypur: mars 2023**

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                                                           |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>USHTARAKËT, NË QENDËR TË VËMENDJES SË SHTETIT.....</b>                                                                                                                 | <b>9</b>  |
| <i>Intervistë e ministrit të Mbrojtjes zoti Niko Peleshi</i>                                                                                                              |           |
| <b>TESTOJMË KAPACITETET, PËRKRAH FORCAVE TË NATO-s.....</b>                                                                                                               | <b>13</b> |
| <i>Gjeneral Brigade Arben Kingji</i><br><i>Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura</i>                                                                    |           |
| <b>RUBRIKA E PARË: Arsimimi dhe stërvitja.....</b>                                                                                                                        | <b>17</b> |
| <b>STËRVITJA, ÇELËS I AFTËSIMIT LUFTARAK DHE BAZË E SUKSESIT.....</b>                                                                                                     | <b>21</b> |
| <i>Gjeneral Brigade Bilbil Bitri</i><br><i>Komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura</i><br><i>Nënkolonel Dritor Papa</i><br><i>Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë</i> |           |
| <b>STËRVITJET, PËR RRITJEN E GATISHMËRISË SË FORCËS TOKËSORE.....</b>                                                                                                     | <b>33</b> |
| <i>Kolonel Beqir Tafili</i><br><i>Shef i Shtabit të Forcës Tokësore</i>                                                                                                   |           |
| <b>ARSIMIMI SIPAS MODELIT “WEST POINT”, GARANCI PËR SUKSES.....</b>                                                                                                       | <b>45</b> |
| <i>Dr. Glevin Dervishi</i><br><i>FMS, AFA</i>                                                                                                                             |           |
| <b>ARSIMIMI NË FUSHËN E SIGURISË, ECURIA DHE SFIDAT.....</b>                                                                                                              | <b>53</b> |
| <i>Prof. Dr. Kristaq Xharo</i><br><i>Lektor në Universitetin Europian të Tiranës</i>                                                                                      |           |
| <b>RUBRIKA E DYTË: Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimet inovative.....</b>                                                                                                 | <b>65</b> |
| <b>ROLI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHOQËRINË MODERNE.....</b>                                                                                                     | <b>69</b> |
| <i>Prof. Dr. Ethem Ruka</i><br><i>Rektor i Universitetit “Luarasi”, Tiranë</i>                                                                                            |           |

|                                                                                                                  |            |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>INOVACIONI DHE PROJEKTI INOVATIV, KËRKESË E KOHËS.....</b>                                                    | <b>81</b>  |
| <i>Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj</i>                                                                                  |            |
| <i>Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA</i>                                                      |            |
| <b>SIGURIA KIBERNETIKE NË FORCAT E ARMATOSURA .....</b>                                                          | <b>99</b>  |
| <i>Nënkolonel Dritan Merdani</i>                                                                                 |            |
| <i>Drejtor i Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike</i>                                                       |            |
| <b>RUBRIKA E TRETË: Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen.....</b>                                    | <b>109</b> |
| <b>ANËTARËSIMI NË NATO-BE I SHTETEVE TË “EUROPËS SË RE”,<br/>E VETMJA PËRGJIGJE E KËRCËNIMIT HIBRID RUS.....</b> | <b>111</b> |
| <i>Kolonel Msc. Hysni Gjergji,</i>                                                                               |            |
| <i>Kolonel Msc. David Rroku</i>                                                                                  |            |
| <i>Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA</i>                                                                 |            |
| <b>RUSIA MIDIS TË KALUARËS DHE TË ARDHMES – NATO-s,<br/>ZGJERIMI DHE VAZHDIMËSIA.....</b>                        | <b>125</b> |
| <i>Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj</i>                                                                           |            |
| <i>Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA</i>                                                                 |            |
| <b>RUBRIKA E KATËRT: Shkrime historike.....</b>                                                                  | <b>139</b> |
| <b>QËNDRIMI AMERIKAN NË KONFLIKTIN SHQIPTARO-SOVJETIK.....</b>                                                   | <b>145</b> |
| <i>Prof. Dr. Paskal Milo</i>                                                                                     |            |
| <b>MARRËDHËNIET SHQIPTARO-AMERIKANE PARA 28 KORRIKUT 1922.....</b>                                               | <b>159</b> |
| <i>Prof. Dr. Ksenofon Krisafi</i>                                                                                |            |
| <i>Dekan i SDSHH në Universitetin Mesdhetar, Tiranë</i>                                                          |            |
| <b>BETEJA E ALEKSANDRIT TË MADH NË PELION TË ILIRISË MË 335 p.e.s.....</b>                                       | <b>179</b> |
| <i>Prof. Dr. Neritan Ceka</i>                                                                                    |            |
| <b>TELEGRAMI I PARË I DEKRIPTUAR SHQIPTAR, I VITIT 1914.....</b>                                                 | <b>195</b> |
| <i>Dr. Ulsi Meta</i>                                                                                             |            |



## SPECIALE

Në këtë edicion të “Revista Ushtarake”, organ teoriko-shkencor i AFA, për shkak të dinamikave që Forcat e Armatosura kanë për vitin 2023, ku një vend të rëndësishëm zë stërvitja “Defender 23”, ministri i Mbrojtjes zoti Niko Peleshi jep një mesazh, ku thekson se:

...“Defender 2023” është një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik, sa i përket sigurisë, paqes dhe garancisë për qytetarët tanë, vendet e rajonit dhe për mbarë Europën.

...Prania e një Aleance kaq të gjerë në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor, pikë së pari jep sinjale të forta sigurie...

Vijnë këto sinjale në një kohë që situata mbetet delikate në raportet mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe në vende të tjera të rajonit.

Bota sot po përjeton një situatë komplekse të mbushur me sfida, kërcënime e rreziqe, të cilët kanë efekte mbi të gjitha shtetet dhe natyrisht, kërkojnë një përgjigje të përbashkët.

Ndaj bashkimi i të gjitha forcave në një stërvitje si “Defender 2023”, nuk është thjesht një bashkim forcash përballë një agresori. Ky bashkim është më shumë një mesazh bashkimi fuqish për të transmetuar dhe garantuar siguri, e doemos mbështetje për më të dobët.

Forcat tona të Armatosura janë syri dhe siguria e qytetarëve të këtij vendi, janë forca që kanë më shumë besueshmëri në popull. Ministria e Mbrojtjes, qeveria shqiptare i vlerëson FA si një trupë që përfaqëson edhe dinjitetin e Shqipërisë, përkrah aleatëve të NATO-s”...

Një tjetër mesazh i rëndësishëm për stërvitjen “Defender 2023” vjen në Revistë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneral brigade Arben Kingji. Ndër të tjera, ai nënvizon:

“Brigada Shumëkombëshe e “Task Force South” do të drejtohet nga një oficer shqiptar me gradë madhore (gjeneral). Ky fakt përbën një tregues shumë të rëndësishëm të aftësive tona për të kryer testimin e kapaciteteve dislokuese dhe të vendosjes së forcave të luftimit në terren, si dhe për të drejtuar e manovruar forca shumëkombëshe në Europë.

Angazhimi me trupa dhe oficerë shtabi në të gjitha nivelet, do të shërbejë më së miri në rritjen e aftësive operacionale të forcave tona, si dhe do të përmirësojë

shkallën e ndërveprimit midis forcave alete dhe atyre nga vendet partnere, që do të marrin pjesë në stërvitje.

Situata e sigurisë në Europë është bërë gjithnjë e më komplekse, sidomos pas agresionit ushtarak të Rusisë dhe luftës së padrejtë që po merr përditë jetë njerëzish në Ukrainë.

Ndaj dhe stërvitje të tilla i shërbejnë më së miri përgatitjes së kapaciteteve tona mbrojtëse dhe rritjes së shkallës së vigjilencës.

Tashmë mund të themi se vendi ynë ka një eksperiencë të vyer në drejtim të stërvitjeve të përbashkëta e sidomos me të tilla përmasa, mbas “Defender Europe-21”...



## USHTARAKËT, NË QENDËR TË VËMENDJES SË SHTETIT...

### Intervistë me ministrin e Mbrojtjes zotin Niko PELESHI

Marrë nga kryeredaktori i Revistës.

*Zoti Ministër, Ju sapo keni prezantuar arritjet për vitin 2022 dhe projektet për vitin 2023, një prej të cilave është edhe mikpritja e stërvitjes “Defender 2023”. Cilat janë qëllimet e kësaj stërvitjeje?*

- Kjo stërvitje, veç përmasave ushtarake të saj, konfirmon rëndësinë strategjike të politikës së zgjeruar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për NATO-n dhe partnerët e saj europianë, një prej të cilëve është edhe Shqipëria.

Stërvitja rithekson angazhimin e fortë që Aleanca dhe në veçanti Shtetet e Bashkuara, i kushtojnë rajonit tonë.

“Defender 2023” është një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik, sa i përket sigurisë, paqes dhe garancisë për qytetarët tanë, vendet e rajonit dhe për mbarë Europën.

Shqipëria do të jetë një vend pritës i trupave aleate, të cilët janë pjesë e stërvitjes së madhe “Defender 2023”.

Në këtë stërvitje do të organizohen veprimtari të shumta ushtarake, duke përforcuar rëndësinë strategjike gjeografike të Shqipërisë në rajon.

Prandaj qeveria jonë, institucionet tona kanë gatishmërinë për të ndihmuar dhe lehtësuar të gjitha kërkesat specifike dhe të përgjithshme që kërkon një stërvitje e tillë, e cila pritët të realizohet për herë të dytë në Shqipëri dhe jo vetëm.

Kjo stërvitje është edhe një mundësi e jashtëzakonshme e trupave tona për t’u ballafaquar me forca të ushtrive të tjera, për t’u integruar me ta, për të rritur ndërveprueshmërinë, por kryesisht për të përforcuar besimin se, edhe një vend i vogël si Shqipëria, mund të luajë një rol të madh.

Shqipëria e vlerëson aleancën me NATO-n, duke qenë jo vetëm përfitues, por edhe kontributor. Prandaj kemi rritur dhe do të vazhdojmë të rrisim buxhetin për mbrojtjen. Për vitin 2023, duhet të jemi 1,85% të GDP-së dhe do të jemi pak më tepër.

Në vitin 2024, do të shkojmë në 2% të GDP-së, pa dyshim.

*A mund të na thoni konkretisht, cili është roli i “Defender 2023” në sigurinë rajonale?*

- Prania e një Aleance kaq të gjerë në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor, pikë së pari jep sinjale të forta sigurie.

Vijnë këto sinjale në një kohë që situata mbetet delikate në raportet mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe në vende të tjera të rajonit.

Shqipëria vlerësohet nga NATO si një aleate e vendosur dhe një partnere që kontribuon në stabilitet, në nivel rajonal dhe global.

Krahas Shqipërisë, pjesë e stërvitjes janë edhe vendet e tjera të Ballkanit perëndimor, anëtarë të NATO-s; Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Madje një pjesë e stërvitjes do të zhvillohet në Kosovë, ku trupat e forcave aleate do të stërviten dhe do të ndërveprojnë me forcat e FSK.

Kjo do të thotë se nuk do të jetë thjesht një shkëmbim në planin ushtarak, por do të jepet mesazhi i bashkimit, përballë një bote të trazuar edhe më shumë, pas 24 shkurtit të vitit të kaluar, kur nisi agresioni rus.

*Çfarë ndikimi do të ketë kjo stërvitje, parë në kuadrin e luftës në Ukrainë dhe pozicionit të Rusisë ndaj perëndimit?*

- Bota sot po përjeton një situatë komplekse të mbushur me sfida, kërcënime e rreziqe, të cilët kanë efekte mbi të gjithë shtetet dhe natyrisht, kërkojnë një përgjigje të përbashkët.

Gjatë pothuajse një viti, të gjithë aleatët e NATO-s kanë treguar se janë rreshtuar në anën e drejtë të historisë, atë të paqes.

Shqipëria iu bashkua që në fillim qëndrimit të aleatit strategjik SHBA-së dhe partnerëve të tjerë të NATO-s, duke dënuar agresionin rus.

Ndaj bashkimi i të gjitha forcave në një stërvitje si “Defender 2023”, nuk është thjesht një bashkim forcash përballë një agresori.

Ky bashkim është më shumë një mesazh bashkimi fuqish për të transmetuar dhe garantuar siguri, e doemos mbështetje për më të dobët.

Rusia prej muajsh tashmë ndodhet në anën e kundërt të këtij blloku, i cili përçon çdo ditë qetësi për qytetarët e mbarë botës.

Ajo që Aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi European duan të tregojnë, edhe përmes sanksioneve që janë vendosur ndaj Moskës, është se zhvillimi i vendeve duhet të ecë paralelisht me garantimin e lirive, demokracisë dhe sigurisë për të gjithë qytetarët.

Bazuar edhe në mesazhin që na dha Samiti i Brukselit kërkohet që “Aleanca jonë duhet të jetë gati sot, për t’u përballur me sfidat e së nesërme”.

*Zoti Ministër, cili është mesazhi Juaj për Forcat tona të Armatosura, në këtë fillim viti?*

- Forcat tona të Armatosura janë syri dhe siguria e qytetarëve të këtij vendi, janë forca që kanë më shumë besueshmëri në popull. Ministria e Mbrojtjes, qeveria shqiptare i vlerëson FA-të si një trupë që përfaqëson edhe dinjitetin e Shqipërisë, përkrah aleatëve të NATO-s.

Ndaj e ka vlerësuar dhe e vlerëson shumë të rëndësishme, rritjen e dinjitetit të çdo efektivit përmes një trajtimi më të mirë financiar, përmirësimit të kushteve të stërvitjes, kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre, si dhe integrimin e tyre në shoqëri pas daljes në rezervë.

Një pikë e rëndësishme, për të cilën nisëm mjaft projekte që prej vitit të kaluar dhe do të vijojmë edhe në 2023, është modernizimi i FA-ve.

Kjo realizohet përmes pajisjes së Forcave të Armatosura me kapacitetet e nevojshme për t’u përballur me sfidat e ardhshme. Në 2023, personeli ushtarak mori një tjetër shtesë mbi pagën prej 7%, që e çon gati në 40% rritjen, krahasuar me një vit më parë.

Në projektet për këtë vit është edhe zbatimi i Paketës Sociale për ushtarakët. Është një risi kjo, që përfshin mbështetje në akomodim, trajtim, kompensimin ushqimor, kujdesin shëndetësor, transportin, si dhe kartën e ushtarakut.

Të gjithë efektivët e Forcave të Armatosura kanë dhe do të kenë mbështetjen e pakursyer të qeverisë shqiptare.

*Ju falënderoj shumë zoti Ministër dhe Ju uroj sukesese në detyrën tuaj të lartë!*

- Edhe unë ju falënderoj, duke ju uruar suksese.



## **TESTOJMË KAPACITETET, PËRKRAH FORCAVE TË NATO-s**

**Gjeneral Brigade Arben KINGJI**  
**Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura**

Stërvitja “Defender Europë-23” është një stërvitje e përbashkët shumëkom-bëshe, drejtuar nga forcat tokësore të SHBA-ve.

Stërvitja ka në qendër konsolidimin e elementeve të gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave të Armatosura të SHBA-ve, vendeve të NATO-s dhe atyre partnere. Kjo është një stërvitje me natyrë mbrojtëse dhe përqendrohet në përgatitjen e përbashkët, në përgjigje të krizave në një zonë të gjerë operacionesh, duke demonstruar aftësinë për të ofruar stabilitet dhe siguri në rajonin e Europës dhe më gjerë.

“Defender Europë 23” do të zhvillojë aktivitetin e saj në disa vende të Europës në periudhën 7 maj deri në 9 qershor 2023. Ajo do të demonstrojë aftësitë e trupave të Aleancës për t’u dislokuar, për të shtuar kapacitetet luftarake, unifikuar gatishmërinë e njësisë në një mjedis të përbashkët, si edhe për të ushtruar aftësitë dhe potencialet e vendeve pritëse.

Kjo stërvitje e rëndësishme do të shërbejë gjithashtu për të testuar aftësitë dhe kapacitetet e NATO-s, për të ushtruar një qëndrim frenues të konflikteve në Europë.

Stërvitja përbëhet në vetvete nga disa stërvitje të tjera më të vogla, me skenarë të detajuar në tokë, det dhe ajër. Konkretisht, “Defender Europë 23” përfshin tre stërvitje në teatrin tokësor, përkatësisht “Immediate Response”, “Saber Guardian” dhe “Swift Response”. Ashtu siç janë një stërvitje detare “Formidable Shield”, një stërvitje ajrore “Astral Knight”, por edhe dy stërvitje të forcave speciale “Jackal Stone” dhe “Triglav”.

Nëse flasim me shifra, “Defender Europe-23” do të sjellë gjithsej rreth 25 mijë trupa nga 29 vende anëtare të NATO-s, por edhe nga vende aleate. Në kuadër të këtij angazhimi stërvitor gjithëpërfshirës, në datat 15 maj - 9 qershor 2023, vendi ynë do të mikpresë dhe do të zhvillojë stërvitjet “Immediate Response”

dhe “Astral Knight”. Stërvitja “Immediate Response”, e cila do të ketë një numër të madh trupash dhe mjetesh tokësore, është organizuar me tre “Task Force” shumëkombëshe në nivel brigade, respektivisht “Multinational Task Force North” me qendër në Kroaci, “Multinational Task Force South” me qendër në vendin tonë, në Zall-Herr dhe “Multinational Task Force Black Sea” me qendër në Koren, në Bullgari.

Brigada “Task-Force South”, që varet nga Divizioni i 34-t i SHBA-ve do të ketë në përbërje një regjiment në rajonin stërvitor të Babaj-Bokes në Kosovë, një batalion këmbësorie në rajonin stërvitor të Bizës, si dhe dy batalione këmbësorie në Krivolak të Maqedonisë së Veriut.

Brigada Shumëkombëshe e “Task Force South” do të drejtohet nga një oficer shqiptar me gradë madhore (gjeneral), ndërkohë që në përbërje të shtabit të Brigadës do të ketë oficerë dhe nënoficerë nga Shqipëria, Kosova, SHBA-të, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Mali i Zi. Ky fakt përbën një tregues shumë të rëndësishëm të aftësive tona për të kryer testimin e kapaciteteve dislokuese dhe të vendosjes së forcave të luftimit në terren, si dhe për të drejtuar e manovruar forca shumëkombëshe në Europë.

Krahas operacioneve tokësore, Forca Ajrore në bashkëpunim me Regjimentin e Operacioneve Speciale, do të zhvillojë stërvitjen ajrore “Astral Knight”, gjatë së cilës do të kryejë detyra të përbashkëta me forcat amerikane, të specializuara kryesisht në operacione “Personel Recovery”.

Forcat tona të Armatosura janë angazhuar maksimalisht në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që kanë të bëjnë me fazën përgatitore, planëzuese dhe atë të pjesëmarrjes e zhvillimit të stërvitjes “Defender Europe-23”.

Angazhimi me trupa dhe oficerë shtabi në të gjitha nivelet do të shërbejë më së miri në rritjen e aftësive operacionale të forcave tona, si dhe do të përmirësojë shkallën e ndërveprimit midis forcave alete dhe atyre nga vendet partnere, që do të marrin pjesë në stërvitje.

Këto stërvitje do të shërbejnë për të demonstruar dhe testuar aftësitë e forcave tona, për të qenë të gatshme për të vepruar në teatrin e operacioneve, kudo dhe kurdo që të kërkohet.

Stërvitjet ushtarake si “Defender Europe-23”, demonstrojnë qartazi angazhimin e SHBA-ve dhe NATO-s si garantuese të paqes, sigurisë dhe stabilitetit. Kjo stërvitje është një shembull konkret i përkushtimit për të qenë promovues të sigurisë, si dhe për të treguar se aleatët dhe partnerët e NATO-s do të jenë më të fortë së bashku, duke bashkëpunuar dhe kontribuar, nëpërmjet aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse kolektive.

Dëshiroj të theksoj faktin se stërvitja “Defender Europe-23” nuk zhvillohet

në përgjigje të ndonjë kërcënimi specifik, ose të ndonjë kundërshtari konkret. Ajo dhe stërvitje të tjera ushtarake që zhvillohen rregullisht nga NATO, janë manovra të drejtuara nga SHBA dhe komandat e NATO-s, të dizenuara për të rritur gatishmërinë dhe ndërveprimin e forcave të Armatosura të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere.

Situata e sigurisë në Europë është bërë gjithnjë e më komplekse, sidomos pas agresionit ushtarak të Rusisë dhe luftës së padrejtë që po merr përditë jetë njerëzish në Ukrainë. Pas rreth tre dekadash me konflikte ushtarake të luftuara jashtë territoreve të veta, Aleanca e Atlantikut të Veriut po tregon më së miri se mund t'i përgjigjet kërcënimit kudo, përgjatë kufijve të saj. Ndaj dhe stërvitje të tilla i shërbejnë më së miri përgatitjes së kapaciteteve tona mbrojtëse dhe rritjes së shkallës së vigjilencës.

Në kuadër të masave përgatitore për zhvillimin me sukses të “DE-23”, janë zhvilluar disa konferenca paraprake planëzuese, të drejtuara nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane në Europë (USAREUR) dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve ushtarakë nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Gjatë këtyre konferencave është diskutuar mbi planet stërvitore të zhvillimit të paketës së stërvitjes “DE-23”, janë identifikuar dhe konfirmuar strukturat që do të angazhohen në stërvitje, rajonet e mundshme stërvitore, mbështetja logjistike dhe shëndetësore, konsolidimi i strukturave organizative, strukturës së kontrollit të stërvitjes, si dhe objektivat e trajnimit për secilën strukturë që do të angazhohet në stërvitje.

Tashmë mund të themi se vendi ynë ka një eksperiencë të vyer në drejtim të stërvitjeve të përbashkëta e sidomos me të tilla përmasa: “Defender Europe-21”, e cila u zhvillua në vendin tonë gjatë vitit 2021. Ajo dëshmoi aftësitë e Forcave tona të Armatosura, për të qenë të ndërveprueshme me simotrat e veta të Aleancës. Padyshim që edhe këtë vit, do të synojmë që të zhvillojmë stërvitje të suksesshme, për të konfirmuar edhe një herë se së bashku, do të jemi në gjendje të mbrojmë stabilitetin dhe sigurinë e zonës euroatlantike.

Në përmbyllje, dëshiroj që të citoj një mesazh të gjeneralit amerikan Tod D. Wolters, ish-komandanti i Komandës Supreme të Forcave Aleate në Europë (SACEUR), i cili në përfundim të stërvitjes “Defender Europe 21” u shpreh se: “Nga pranimi në NATO na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, një pjesë perëndimore më të sigurt. Ne përmirësohemi ditë pas dite dhe jemi më të fortë, të gjithë së bashku”.

Shpreh bindjen se kjo stërvitje do të shërbejë si një garanci e fortë që Shqipëria do të vazhdojë të kontribuojë në mbrojtjen e vlerave të demokracisë në Europë dhe në të gjithë hapësirën euroatlantike. “Defender Europe” mbetet një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik të paqes, sigurisë, stabilitetit dhe garancisë për vendet e rajonit dhe mbarë Europën.





## RUBRIKA E PARË

### Arsimimi dhe stërvitja

Komandanti shqiptar i stërvitjes “Defender 23”, Gjeneral Brigade Bilbil Bitri, në punimin e tij me titull “*Stërvitja, çelës i aftësimit luftarak dhe bazë e suksesit*”, shtjellon shumë elemente të rëndësishme dhe thekson:

...“Duke qenë pjesë e Aleancës, është domosdoshmëri që gjatë procesit të stërvitjes individuale apo kolektive të trupës, rëndësi e veçantë t’i jepet integritetit dhe ndërveprimit të sistemeve e pajisjeve, brenda vetë forcës, si dhe atë të ndërveprimit me vendet e tjera.

...Stërvitjet ushtarake në shkallë të lartë, duke angazhuar forca të shërbimeve të ndryshme nga vende të ndryshme, janë ndër demonstrimet më të dukshme të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe shpesh shihen si mjete gjeopolitike, që përdoren për të ruajtur stabilitetin dhe për të shkurajuar aktorët potencialisht të aftë, që mund të krijojnë destabilitet. Qëllimi i stërvitjes ushtarake nuk është vetëm të përgatitë njerëzit për betejë, por t’i bëjë ata, ta dëshirojnë atë.

Në këndvështrimin gjeopolitik, shkurajimi kërkon një strategji kombëtare që integron fuqi diplomatike, informative, ushtarake dhe ekonomike. Shkurajimi nëpërmjet komponentit ushtarak, si instrument i fuqisë kombëtare, realizohet edhe përmes planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjeve, të cilat demonstrojnë aftësinë për të kryer e përballuar spektrin e plotë të operacioneve”...

Shefi i Shtabit të Forcës Tokësore Kolonel Beqir Tafili vjen në faqet e kësaj rubrike me punimin me titull “*Stërvitjet, për rritjen e gatishmërisë së Forcës Tokësore*”. Ndër të gjitha angazhimet që Forca Tokësore ka për vitin 2023 e në vazhdim, Kolonel Tafili nënvizon: ... “Nga pikëpamja ushtarake, për të qenë të

gatshëm të përballemi me realitetin e ri, për ruajtjen e stabilitetit dhe të sigurisë, është domosdoshmëri rritja e gatishmërisë luftarake dhe ndërveprueshmërisë, nëpërmjet përgatitjes intensive luftarake dhe stërvitjeve kombëtare e ndërkombëtare, të trupës, shtabeve dhe komandave. Kjo, e programuar dhe e konceptuar duke përdorur mjedise trajnuese, 360°, me skenarë operacionale realë, ku kërcënimet “hibride”, “kibernetike” dhe “asimetrike”, janë prezent dhe që zhvillohen me intensitet të lartë.

Në këtë këndvështrim, edhe Forca Tokësore në kuadër të detyrimeve të Forcave të Armatosura, për të qenë të gatshëm për realizimin e misionit kushtetues, programon aktivitete dhe kryen trajnime dhe ushtrime stërvitore, në interes të përgatitjes së saj për t’u aftësuar, në spektrin e plotë të operacioneve”.

Para pak kohësh përfundoi procesi i miratimit të programit të Akademisë “West Point” në Shqipëri.

Kjo është një temë që do të ketë vendin e saj në Revistë, për shumë kohë. Por në këtë numër, janë dy shkrime.

Prof. Dr. Kristaq Xharo ish-komandant i Akademisë sonë ushtarake, vjen me punimin e tij me titull “*Arsimimi në fushën e sigurisë, ecuria dhe sfida*”.

Profesor Xharo nënvizon: “Siguria është substanca e jetës njerëzore. Të jesh i sigurtë, do të thotë të jesh i pa shqetësuar nga rreziqet apo frika. Ekonomia dhe siguria vazhdojnë të dominojnë zhvillimin e shoqërisë në çdo kohë dhe në çdo sistem. Nga ky ndikim nuk ka “shpëtuar” as epoka jonë.

Siguria vazhdon të mbetet një nga dilemat më të mëdha të shoqërisë. Globi nuk fitoi më shumë siguri edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, kohë kur pritej nga të gjithë të besonin për një epokë paqësore.

Ngjarjet në Ukrainë, jo vetëm për nga distanca, e cila është 1300 km, por edhe nga konteksti i brendisë dhe i formatit, e më parë konflikti në Siri-Irak, vetëm 1000 km, na ka afruar shumë pranë krizave rajonale me pasoja të drejtpërdrejta. Në përmasat gjeografike, por tashmë edhe gjeopolitike, këto zhvillime “mbërthejnë” edhe vendin tonë në zonat e krizave.

Në vlerësim gjeopolitik, mjedisi ynë i sigurisë ndikohet drejtpërdrejt nga këto zhvillime në nivel të mjaftueshëm për të reflektuar.

Qysh nga viti 1974, në Akademinë tonë Ushtarake filluan kualifikimet pasuniversitare, të cilat fokusoheshin kryesisht në studime kërkimore në fushën e mbrojtjes. Kujtojmë gjithashtu se kandidatë nga struktura të tjera, si nga Policia e shtetit, Garda, Shërbimi Informativ deri edhe nga Ministria e Jashtme ndiqnin kurse kualifikimi në këtë institucion. Kjo periudhë korrespondon me kohën kur edhe në vende të tjera (perëndim apo lindje)

studimet e mbrojtjes identifikoheshin me studimet e sigurisë. Akademia e Mbrojtjes kishte njëkohësisht edhe atributin në dhënien e titujve dhe gradave shkencore.

Kurse Doktorit i Shkencave Gledin Dervishi vjen në këtë Rubrikë me shkrimin me titull “*Arsimimi sipas modelit të West Point, garanci për sukses*”.

Zoti Dervishi me cilësinë e shefit të marrëdhënieve dhe komunikimit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, ndër të tjera nënvizon: “Shërbimi në Forcat e Armatosura është më shumë sesa mision, ai është mishërimi i detyrës së vështirë, sakrificës por në të njëjtën kohë është sfida e të qenurit i pari aty ku e kërkon kombi dhe detyra. Arsimimi dhe trajnimi ushtarak është procesi që synon të krijojë dhe përmirësojë aftësitë e personelit ushtarak në detyrat e tyre respektive, ndaj AFA përbën vetëm themelin në këtë proces të gjatë e të pandalshëm edukues të Forcave të Armatosura.

AFA, në partneritet të plotë me Akademinë Ushtarake të SHBA-ve “West Point”, është përfshirë në një proces dinamik të zhvillimit substancial të kurrikulave dhe programeve sipas këtij modeli, si dhe në përputhje me arsimimin e lartë publik kombëtar. Asistenca amerikane për AFA-në është e përqendruar në tre komponentë të rëndësishëm të programeve të reja që do të çelen si: Formimi i karakterit, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Shkencat e komunikimit.

Në vazhden e këtij angazhimi, AFA synon që të çelë për vitin akademik 2023-2024 programet mësimore “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” si dhe “Shkencat e Komunikimit në Fushën e Mbrojtjes”. Këto janë programe studimesh universitare të ciklit të parë të ofruar nga AFA, të organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)”.



# STËRVITJA, ÇELËS I AFTËSIMIT LUFTARAK DHE BAZË E SUKSESIT

**Gjeneral Brigade Bilbil BITRI**

*Komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura*

**Nënkolonel Dritor PAPA**

*Student në Kursin e Lartë të Oficerit,*

*Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Gatishmëria luftarake është aftësia e forcave të armatosura për t'u angazhuar në operacione të një spektri të gjerë dhe përmbushur me sukses kërkesat e detyrave, ose misioneve të caktuara. Për të siguruar gatishmërinë luftarake, është e rëndësishme të vlerësohen elementet themelore që ndihmojnë në ndërtimin e saj dhe një nga këto elemente është stërvitja, çka do të jetë dhe fokus i këtij shkrimi. Në këtë drejtim, do të sjellim pranë lexuesit një ndër shumë përkufizime të stërvitjes, rolin dhe rëndësinë e saj në përgatitjen e personelit të Forcave tona të Armatosura, si dhe këndvështrimin e NATO-s rreth qëllimit dhe rëndësisë së stërvitjeve.*

*Duke qenë pjesë e Aleancës, është domosdoshmëri që gjatë procesit të stërvitjes individuale apo kolektive të trupës, rëndësi e veçantë t'i jepet integritetit dhe ndërveprimit të sistemeve e pajisjeve, brenda vetë forcës, si dhe atë të ndërveprimit me vendet e tjera.*

*Stërvitjet ushtarake në shkallë të lartë, duke angazhuar forca të shërbimeve të ndryshme nga vende të ndryshme, janë ndër demonstrimet më të dukshme të*

*bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe shpesh shihen si mjete gjeopolitike, që përdoren për të ruajtur stabilitetin dhe për të shkurajuar aktorët potencialisht të aftë, që mund të krijojnë destabilitet.*

*Tjetër element i rëndësishëm në të cilin jemi fokusuar, është trajtimi i stërvitjes si element i treguesit të kapacitetit dhe vlerësimit të gatishmërisë, por edhe stërvitja si një ndër mësimet e nxjerra nga lufta në Ukrainë, për ta mbyllur me një panoramë të stërvitjes “Defender Europe 21” dhe pritshmëritë e Forcave tona të Armatosura për stërvitjen e radhës, “Defender Europe 23”.*

*“Romakët ia detyrojnë pushtimin e botës, jo gjëje tjetër, përveçse stërvitjes ushtarake të vazhdueshme, zbatimit me përpikmëri të disiplinës në kazernat/kampet e tyre dhe mësimet në mënyrë të palodhur, të artit të luftës së kundërshtarit”.*

Publius Vegetius Renatus<sup>1</sup>

## STËRVITJA, DISIPLINA E PËRGATITJES INDIVIDUALE DHE KOLEKTIVE

Është e provuar se stërvitjet janë “mjete” më i rëndësishëm, e ndoshta i vetmi, përmes të cilave formacionet ushtarake, më vete ose së bashku me formacione të tjera kombëtare, apo ndërkombëtare, testojnë dhe “certifikojnë” konceptet, teknikat, taktikat dhe procedurat. Një gjë e tillë është e vërtetë sot, po aq sa ishte 40 vjet më parë, kur në raportin e shefit të Shtabeve të Bashkuara të SHBA-ve për Kongresin amerikan shkruhej: “Stërvitjet janë mjete më i mirë, përvec luftës, për të testuar aftësinë e forcave tona, për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive”<sup>2</sup>.

Stërvitjet janë një proces i të mësuarit dhe të përmirësuarit të përhershëm. “Përmes tyre njësitë dhe formacionet e të gjitha niveleve, kanë mundësinë që përveçse të testojnë, edhe të identifikojnë gjithçka funksionon në funksion të misionit dhe detyrave apo natyrës së operacionit, për të cilin kryhet stërvitja dhe çfarë nuk funksionon, e që duhet të përmirësohet në të ardhmen”<sup>3</sup>.

Përgatitja për operacione “të përbashkëta dhe të kombinuara” i bën stërvitjet “kontribuuesin” më të mirë sa i takon ndërveprueshmërisë, e cila është “çelësi” i suksesit, jo vetëm për ndërveprim në nivel kombëtar, doemos më shumë, në kuadër të Aleancës. Në kuadër të Aleancës, stërvitjet i kontribuojnë edhe

<sup>1</sup> Publius Vegetius Renatus, i njohur si Vegetius, shkrimtar i Perandorisë Romake të vonë (v. 450-BC)

<sup>2</sup> <https://apps.dtic.mil/sti/pdfs/AD1122026.pdf>; Improving The Effectiveness Of Joint Military Exercises--An Important Tool For Military Readiness, Raport to US Congress, December 11, 1979

<sup>3</sup> [https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics\\_49285.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49285.htm), aksesuar më 12.02.2023

situatës së sigurisë në hapësirën euroatlantike<sup>4</sup>.

Në Forcat e Armatosura, stërvitja është njëri prej treguesve të gatishmërisë dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura. Në përputhje me misionin dhe detyrat e secilit prej formacioneve operacionale, ndërtohet programi gjithëvjeter i përgatitjes, trajnimit dhe stërvitjes së tyre. Arkitektura e stërvitjes së FA-ve është në funksion të nivelit të ambicies, duke qenë se qëllimi është... *“Rritja dhe shfaqja e kapaciteteve ushtarake të FARSH, për të gjithë spektrin e operacioneve, si dhe për të zbatuar strukturën aktuale të Komandimit dhe Kontrollit”*<sup>5</sup>.

Edhe për Aleancën qëllimi i stërvitjeve është... *“Të krijojnë, zgjerojnë dhe tregojnë/demonstrojnë kapacitetet ushtarake të NATO-s, në të gjithë spektrin e misionit të Aleancës dhe të sigurojnë integrimin efektiv e të ndërveprueshëm të forcave partnere, në operacionet në përgjigje të krizave (CRO) dhe misionet e drejtuara nga NATO”*<sup>6</sup>.

Edukimi dhe trajnimi i personelit në Forcat e Armatosura është një proces i vazhdueshëm dhe ciklik, njëherësh sfidues, qëllimi i pandryshueshëm i të cilit është të pajisë atë (personelin) me njohuri, aftësi dhe ekspertizë të qëndrueshme në një mjedis në ndryshim të përhershëm, e në të gjitha drejtimet.

Stërvitja ushtarake nga ana tjetër, është procesi përmes të cilit mundësohet integrimi i aftësive individuale të personelit në funksionet dhe detyrat përkatëse, kompaktësimi i veprimeve brenda formacioneve duke filluar nga grupi dhe skuadra, e ndërveprimi mes strukturave në rastin e stërvitjeve kombëtare, si dhe ndërveprimin me aleatë dhe partnerë, në rastin e stërvitjeve ndërkombëtare.

Stërvitje ushtarake do të thotë një tërësi veprimesh dhe masash të caktuara, por të ndryshme, për funksione e poste të ndryshme.

Për komandantin e një njësie ushtarake do të thotë dislokim të trupave, mjeteve e sistemeve në terren, ose marinarët në det, në mënyrë që ata të ushtrohen dhe të veprojnë si një njësi e integruar, e sinkronizuar dhe e koordinuar.

Gjithashtu do të thotë përgatitjen dhe certifikimin e individëve në një spektër të plotë specialitetesh, që mund të jenë pjesë e kapaciteteve të luftimit, mbështetjes së luftimit, apo mbështetjes me shërbime të luftimit. Për cilindo tjetër, jashtë Forcave të Armatosura dhe me dëshirën për t’iu bashkuar, do të thotë transformim i tyre, në ushtarak profesionist.

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Direktiva e Stërvitjes së FARSH, DS-7, 2011.

<sup>6</sup> BI-SC Collective training and exercise directive (CT&ED) 075-003, [https://www.act.nato.int/images/stories/structure/jft/bi-sc-75-3\\_final.pdf](https://www.act.nato.int/images/stories/structure/jft/bi-sc-75-3_final.pdf)

Stërvitja ushtarake duhet t'i përgatitë individët dhe formacionet, të përballen me rrezikun dhe të kryejnë detyra të vështira fizike dhe mendore, në nivelet më të larta të mundshme të aftësisë, pasi gjithnjë e më shumë ato po marrin e do të marrin pjesë, në...*“Misionë që karakteristike kanë rrezikun, natyrën e ndryshueshme të detyrave dhe mjedis operacional në shumë nivele, kompleks dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Në këtë kuptim, “ndryshimi” është e vetmja gjë konstante”*<sup>7</sup>.

Kjo kërkesë mund të jetë karakteristika përcaktuese e stërvitjes ushtarake. Mund të nënkuptojë ndryshimin midis jetës dhe vdekjes. Një vëzhgim i përbashkët i analistëve taktikë dhe historianëve ushtarakë, përfundon se “dëmi më i madh pësohet nga personeli ushtarak që braktis detyrën, e nuk përballon ngarkesën fizike dhe mendore të luftës”<sup>8</sup>. Për këtë arsye, komandantë ushtarakë e shohin stërvitjen si disiplinë të ndarë.

Ndonëse stërvitja ushtarake mund të ketë ekzistuar edhe përpara kësaj kohe, një shembull i stërvitjes ushtarake është i evidentuar në fushatat persiane të viteve 480-479 p.e.s. në Greqi<sup>9</sup>. Në ato fushata, grekët u mbështetën në falangën e këmbësores, e cila ishte një trupë e stërvitur ushtarakësh të renditur në rreshta të gjata, që varionin në thellësi nga rreth 8 deri në 16 burra.

Stërvitja fokusohej në punën në grup dhe përmirësimin e gjendjes fizike. Anëtarëve të këtyre falangave u mësohej se si të koordinonin lëvizjet për të mundësuar manovra të sakta të falangave. Po kështu atyre u mësohej përdorimi me mjeshtëri i armëve, qëndrimi dhe luftimi pa i ekspozuar shokët e tij ndaj sulmit në krah, duke mbyllur radhët shpejt, kur të tjerët binin.

Ky trajnim dha rezultat. Persianët luftuan me një numër më të madh trupash dhe shfaqën aftësi të goditjes së rrufeshme me moral të lartë, e megjithatë ata u penguan vazhdimisht nga disiplina dhe trajnimi kokëfortë, i falangave greke. Në betejën e Plateas, persianët shkatërruan forcat e tyre tokësore kundër falangave greke, duke humbur rreth 50,000 ushtarë nga 1.500 humbje të grekëve. Ky fakt vë në dukje se beteja e Plateas ishte e para e fituar nga epërsia teknike, në shembullin e parë të qartë të vlerës së disiplinës dhe stërvitjes superiore.

<sup>7</sup> Soili Paananen & Antti-Tuomas Pulkka (eds.), Processes and practices in military training and education. National Defense University Department of Military Leadership and Pedagogy, Helsinki 2019.

<sup>8</sup> Ardant du Picq 1821-1870 Battle studies (J.N. Greely and R.C. Cotton, Trans.). Harrisburg, PA: Military Service Publishing. (Original work published 1880).

<sup>9</sup> Dupuy, R.E., and Dupuy, T.N. (1977). The encyclopedia of military history. New York, NY: Harper and Row.



## STËRVITJET, SI MEKANIZËM NDËRVEPRIMI DHE...

Natyrë e luftës mbetet e pandryshuar, ndërsa karakterin e saj e përcaktojnë armët, sistemet, pajisjet dhe mënyrat e përdorimit të tyre<sup>10</sup>. Pikërisht se armët, sistemet, pajisjet dhe mënyrat e përdorimit të tyre kanë evoluar në mënyrë të vazhdueshme, madje në dekadat e fundit me ritme përtej asaj që ishte menduar. Forcat e Armatosura, aleatët e partnerët duhet të adresojnë njëherësh sfidën e integritit dhe ndërveprimit të sistemeve e pajisjeve brenda vetë forcës, si dhe atë të ndërveprimit me njëri-tjetrit. Fushëbeteja e të sotmes dhe në mënyrë të padiskutueshme ajo e të nesërmes, kërkon që ndërveprueshmëria midis aleatëve dhe partnerëve, të jetë në shkallën më të lartë.

Stërvitjet në nivel batalioni dhe grup-batalioni, me pjesëmarrjen e të gjithë elementëve mbështetës nga strukturat e FA-ve, stërvitjet e përbashkëta me aleatë dhe partnerë, por edhe stërvitjet në kuadër të Aleancës, synojnë mes të tjerash, edhe ndërveprueshmërinë. Stërvitjet mbeten mënyra e vetme për të “testuar” nëse personeli, pajisjet dhe procedurat ndërveprojnë, për të krijuar bashkëveprimin e nevojshëm në operacion. Pikërisht për këtë arsye, *“STANAG-ët e NATO-s janë një mjet i rëndësishëm, për të rritur ndërveprueshmërinë me vetë NATO-n dhe partnerët”*<sup>11</sup>.

NATO e përkufizon “ndërveprueshmërinë” si aftësinë e aleatëve për të vepruar së bashku në mënyrë koherente, efektive dhe efikase për të arritur objektivat taktikë, operacionale dhe strategjike<sup>12</sup>.

Në mënyrë të veçantë, ndërveprueshmëria u mundëson forcave, njërive dhe sistemeve të veprojnë së bashku, duke i lejuar ato të komunikojnë e të ndajnë doktrinën dhe procedurat e përbashkëta, së bashku me infrastrukturën dhe bazat e njëri-tjetrit. Ndërveprueshmëria redukton dyfishimin, mundëson bashkimin e burimeve dhe prodhon bashkëveprim midis të gjithë aleatëve, doemos edhe kur është e mundur, me vendet partnere.

Me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe zhdërvjelltësisë së përdorimit të fuqisë luftarake, forcat e NATO-s kanë kryer stërvitje të përbashkëta për të forcuar aftësinë e tyre, për të praktikuar mbrojtjen kolektive që nga viti 1949. Shpërthimi i Luftës Koreane i ndihmoi aleatët të kuptojnë shpejt rëndësinë e një force të integruar, nën komandën e centralizuar.

Me kalimin e kohës, stërvitja është zgjeruar si gjeografikisht, ashtu edhe institucionalisht për t’u bërë pjesë integrale e aftësisë së NATO-s, për të

<sup>10</sup> Clausewitz, On War, eds. and trans. Michael Howard and Peter Paret (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1976)

<sup>11</sup> [https://armypubs.army.mil/epubs/DR\\_pubs/DR\\_a/pdf/web/ARN19606\\_AR34-1\\_FINAL.pdf](https://armypubs.army.mil/epubs/DR_pubs/DR_a/pdf/web/ARN19606_AR34-1_FINAL.pdf), Army Regulations 34-1, Interoperability, Department of the Army, April 2020.

<sup>12</sup> [https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics\\_84112.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_84112.htm)

ofruar siguri. Si prioritet, NATO siguron që komandat e saj dhe forcat shumëkombëshe të mbeten të gatshme, të përgjegjshme, të adaptueshme dhe të ndërveprueshme, pavarësisht dallimeve në taktika, doktrinë, stërvitje, struktura dhe gjuhë.

Ndërveprueshmëria nuk kërkon domosdoshmërisht pajisje të përbashkëta ushtarake. Ajo që ka rëndësi, është fakti që pajisjet mund të përdoren në mjedis të njëjtë operacional, e të jenë në gjendje të ndërveprojnë, të lidhen dhe të komunikojnë, të shkëmbejnë të dhëna dhe shërbime, me pajisje të tjera. Ndërsa për personelin që deklarohet për të qenë pjesë e këtyre strukturave, është domosdoshmëri stërvitja individuale dhe kolektive sipas standardeve, njohja dhe përdorimi me zhdërvjelltësi i armatimit dhe teknikës, si dhe arritja e mbajtja e një gjendjeje të mirë fizike.

### ...MEKANIZËM SHKURAJIMI

*“Qëllimi i stërvitjes ushtarake nuk është vetëm të përgatitë njerëzit për betejë, por t’i bëjë ata ta dëshirojnë atë.”*

*Louis Simpson*

Gatishmëria e një ushtrie për t’u mbrojtur ndaj një agresioni, varet nga stërvitja në mënyrë të vazhdueshme<sup>13</sup>. Deterrenca, -sipas fjalorit të Oksford-it, është shkurajimi për të bërë diçka nga frika e pasojave. E thënë ndryshe, është një gjendje shpirtërore e shkaktuar nga ekzistenca e një kërcënimi të besueshëm, të kundërveprimit të papranueshëm.

Në këndvështrimin gjeopolitik, shkurajimi kërkon një strategji kombëtare që integron fuqi diplomatike, informative, ushtarake dhe ekonomike. Shkurajimi nëpërmjet komponentit ushtarak, si instrument i fuqisë kombëtare, realizohet edhe përmes planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjeve, të cilat demonstrojnë aftësinë për të kryer e përballuar spektrin e plotë të operacioneve.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në kuadër të Aleancës, stërvitjet ushtarake shpesh shihen si mjete gjeopolitike, që përdoren për të ruajtur stabilitetin dhe për të shkurajuar aktorët potencialisht të aftë, për të krijuar destabilitet. Masat shkurajuese jo të “balancuara”, mund edhe të krijojnë efekt të kundërt: të shtojnë mundësinë për keqlllogaritje-“miscalculation”, si dhe mund të kontribuojnë në përshkallëzim të situatës, ose atë që quhet “kurthi i Tukididit” (Thucydides trap)<sup>14</sup>.

<sup>13</sup> Elisabeth Braw, Ukraine’s Victory in the Information Space Is No Reason for Complacency; <https://foreignpolicy.com/2023/01/05/russia-ukraine-next-war-lessons-china-taiwan-strategy-technology-deterrence/>

<sup>14</sup> Tukididi i referohet luftës midis Athinës dhe Spartës, luftë e cila filloi për faktin se Sparta u frikësua nga fuqia në rritje e Athinës.

Deklaratat zyrtare rreth këtyre stërvitjeve ushtarake, zakonisht theksojnë qëllimin e tyre të specifikuar për përmirësimin e stërvitjes, gatishmërisë dhe ndërveprimit midis shërbimeve dhe forcave shumëkombëshe. Por stërvitjet ushtarake përcjellin gjithashtu mesazhe të fuqishme gjeopolitike, që synojnë të demonstrojnë se si aftësitë e shfaqura, rritin stabilitetin rajonal, pengojnë agresionin dhe përforcojnë qëllimet e politikës së jashtme.

Si një shembull konkret mund të përdorim këtu stërvitjen “Trident Juncture 2018 (TRJE-18)”, e cila ishte një ndër stërvitjet më të mëdha të NATO-s, qysh nga fundi i Luftës së Ftohtë, me një skenar të Artikullit 5 të NATO-s. Mbi 50.000 forca, 10.000 mjete, 250 avionë dhe 65 anije nga 31 vende të NATO-s e atyre partnere, u stërvitën së bashku duke testuar Forcën e Reagimit të NATO-s dhe kapacitetet mbrojtëse të Aleancës.

Por, përveç përmbushjes me sukses të objektivave stërvitorë, “TRJE-18” përmbushi maksimalisht efektin e shkurajimit, duke u komunikuar audiencave të interesuara se Aleanca ishte në gjendje që brenda një kohe të shkurtër, të projektonte dhe të angazhonte fuqi të madhe luftarake, edhe në skajet më të largëta të saj, siç ishte rasti i kësaj stërvitjeje në Norvegji.

Shqetësimeve në lidhje me nivelin e madh të forcave dhe kapaciteteve të angazhuara në stërvitjen “Trident Juncture 2018”, admiral James G. Foggo, i cili komandoi këtë stërvitje, iu përgjigj: -“NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne nuk po kërkojmë një luftë, por jemi të përkushtuar ndaj mbrojtjes dhe parandalimit. Kjo është ajo që ka të bëjë ky ushtrim: stërvitje për t’u mbrojtur dhe sigurimi i një efekti parandalues, i gatshëm për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi nga çdo drejtim, e në çdo kohë.”<sup>15</sup>

Stërvitjet vijojnë të jenë në qendër të vëmendjes të autoriteteve ushtarake të NATO-s, jo vetëm për efekt të shkurajimit, por dhe për të rritur efektivitetin, ndërveprueshmërinë, gatishmërinë, për të pasur mentalitet dhe aftësi operacionale. Për t’u përmendur në këtë drejtim është dhe stërvitja “Defender Europe 21”, e cila integroi afërsisht 28000 efektivë nga 26 vende të ndryshme, të cilët kryen veprime ushtarake thuajse të njëhershme në 30 zona trajnimi, të shpërndara në 12 shtete.

Në kuadër të kësaj stërvitjeje, vendi ynë u angazhua në mënyrë aktive si vend mikpritës dhe pjesëmarrës, duke demonstruar aftësi organizimi e ndërveprimi të Forcave të Armatosura me institucione dhe agjensi qendrore, me njësitë e qeverisjes vendore, si dhe me trupat e vendeve aleate dhe partnere.

“DOTMLPF” është shembulli që Aleanca përdor prej dhjetëvjeçarësh për

<sup>15</sup> NATO, “Exercise Trident Juncture 18 to Demonstrate NATO’s ability to Defend Itself,” news release, June 11, 2018, [https://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_155866.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_155866.htm).

të ndërtuar kapacitetet dhe njëherazi dhe si “njësi matëse” (metrics), për të vlerësuar gatishmërinë e kapaciteteve. Me termin “analizë”, në NATO kuptohet studimi i një tërësie duke ekzaminuar pjesët e saj dhe ndërveprimet e tyre.<sup>16</sup> “DOTMLPF” siguron një kornizë për të analizuar të gjithë përbërësit e një kapaciteti, apo të kapaciteteve, gatishmërinë e tyre në raport me nivelin e pritshmërive, apo nevojës operationale.

Vlerësimi (vetëvlerësimi) i kapaciteteve është domososhmëri, pasi mundëson njohjen e ‘Forcës’ në raport me standardin por edhe me kundërshtarin potencial. *“Nëse nje kundërshtarin dhe nje veten, nuk është nevoja të kesh frikën për rezultatin e 100 betejave”*<sup>17</sup>. Vlerësimet periodike të aftësive luftarake të komponentëve (tokësor, ajror dhe detar) përmes proceseve respektive dhe në mënyrë të vecantë përmes procesit të vlerësimit të Alenacës (në rastin e komponentit tokësor sipas AFS. Vol 7) ndihmojnë për të përcaktuar nivelin real të gatishmërisë për betejë (Combat Ready).

## MËSIMET QË DALIN NGA LUFTA NË UKRAINË

Luftën nuk e fitojnë armët. Njerëzit po. Rusia shpenzoi rreth 65 bilion dollarë për mbrojtjen në vitin 2021, ose dhjetë herë më shumë sesa Ukraina. Nëse armatimi dhe pajisjet do të ishin faktori përcaktues, Rusia do të kishte arritur fitoren e shpejtë që kërkoi e synoi, në fillim të luftës. Por në këtë luftë, Ukraina ka treguar se lidërshtipi i mirë dhe stërvitja, -të cilat i ka me shumicë, por që Rusia ka shumë pak,-bëjnë diferencën.<sup>18</sup>

Ndërkohë që po i afrohem një viti nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë, përherë e më shumë ky konflikt po bëhet i paparashikueshëm. Ka një mori mësimesh strategjike dhe operationale, por ato zbehin për nga rëndësia, pasi shërbejnë si provë empirike, se e pa mendueshmja është e mundur.

Mësimi më i rëndësishëm nga ky konflikt, është se lufta e madhe konvencionale midis vendeve të zhvilluara është e mundur,-madje edhe nën hijen e armëve bërthamore, e se është po aq brutale, sa ka qenë gjithmonë. Për dekada të tëra, shumë vëzhgues perëndimorë i kanë parë luftërat e mëdha konvencionale si anakronizma, për arsye të drejta (shkurajim bërthamor, aleanca të forta, ndërvarësi ekonomike, ndalime ndërkombëtare për agresionin ushtarak), etj.

Nëse kemi parasysh rezistencën heroike të forcave ukrainase, duhet ta pranojmë si mësim të nxjerrë, faktin se lufta në shkallë të plotë, është ende shumë më pak

<sup>16</sup> AAP-6, NATO Glossary of Terms and Definitions

<sup>17</sup> Sun Tzu, The Art of War.

<sup>18</sup> Colonel John “Buss” Barranco, *The Atlantic Council*, <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/six-months-twenty-three-lessons-what-the-world-has-learned-from-russias-war-in-ukraine/>,

e parashikueshme, sesa mund të kemi supozuar nga përlogaritjet, supozimet, lojërat e luftës, apo simulimet tona. Roli i moralit, lidhshimit kombëtar, iniciativës, imagjinatës dhe disiplinës, pra të gjitha ato gjëra të paprekshme, që nuk i nënshtrohen sasisë së lehtë dhe që mund të shihen brenda natës, kanë treguar se luajnë një rol vendimtar, në fushat e betejës së Ukrainës.

Sipas gjenerallejtënant Ben Hodges<sup>19</sup>, ndër mësimet kryesore të nxjerra nga ky konflikt, është fakti se udhëheqja pozitive, galvanizuese dhe ushtarët e trajnuar mirë e të disiplinuar, pra faktori njerëzor, janë të pazëvendësueshme. Po kështu, “hard power” është kthyer. Nuk zëvendëson fuqinë e butë, por e mundëson dhe e mbështet atë.

E parë në aspektin e stërvitjes dhe përgatitjes së forcave pjesëmarrëse, nuk mund të thuhet se ka mësim të nxjerrë por thjesht konstatim i faktit, që futja në luftim e forcave të pastërvitura dhe papërgatitura, siç ishte rasti rus, nuk është gjë tjetër veçse recetë për dështim.

## PËRFUNDIME

Periudha maj-qershor e vitit 2021, ishte një periudhë intensive stërvitjesh ushtarake, gjatë së cilave mijëra ushtarakë të vendeve aleate dhe atyre partnere përmirësuan aftësitë e tyre, duke rritur ndjeshëm ndërveprueshmërinë dhe zhdërvjelltësinë nëpërmjet angazhimit në një sërë stërvitjesh, si pjesë përbërëse e stërvitjes së përvitshme, “Defender Europe”.

“Defender Europe 21” (DE21) kishte si fokus rritjen e gatishmërisë strategjike, sigurinë e Aleancës dhe aftësi të tjera, që aleatët e NATO-s kanë nevojë për të parandaluar konfliktin, për të ruajtur paqen dhe për të mbajtur kombet tona të sigurta.

Duke përfshirë stërvitjet e saj të ndërlidhura, “DE21” ishte stërvitja më e madhe e kryer në Europë në vitin 2021. Ajo përfundoi më 13 qershor me një stërvitje të komando-shtabi me 2.000 personel. “DE21”, e udhëhequr nga forcat amerikane, përfshinte 28.000 forca të SHBA-ve, aleate dhe partnere nga 27 vende dhe ofroi trajnime në të gjitha domenet; ajrore, detare, tokësore dhe kibernetike, në më shumë se një duzinë kombe. Ky trajnim shfaqti aftësinë e ushtrisë amerikane në Europë dhe Afrikë për të komanduar forcat tokësore shumëkombëshe, duke mbajtur operacione të botës reale në 104 vende.

Nëse nuk do të ekzistonin “seritë” e stërvitjeve “Defender Europe”, është e sigurtë se ato do të ishin gjëja e parë që do të bëhej pas agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës, rreth një vit më parë. Por siç edhe është përmendur më lart, seritë e stërvitjeve “Defender Europe” janë një realitet që nën drejtimin e “US

---

<sup>19</sup> Ish-komandant i forcave të ushtrisë amerikane në Europë.

ARMY Europe”, bashkon në terrene stërvitore e zona operacioni të Aleancës personell, armatim, pajisje dhe sisteme nga Aleatë e Partnerë, për të rritur më tej gatishmërinë, për të përsosur ndërveprueshmërinë midis Shteteve të Bashkuara, NATO-s dhe vendeve partnere.

Në lidhje me këtë stërvitje, duhet theksuar edhe rolin mjaft aktiv të vendit tonë, jo vetëm si vend pritës i disa prej aktiviteteve stërvitore, por dhe si vend pjesëmarrës me struktura të Forcave të Armatosura. “Defender 2021” ishte një histori suksesi për Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura, sukses të cilin do të kemi mundësinë ta përsërisim. Mësimet e identifikuar dhe të nxjerra gjatë “DE-21”, eksperiencia e fituar nga personeli i angazhuar, si dhe përgatitja e bërë gjatë fazës së planëzimit të saj, “nuk lenë hapësirë për të gabuar”. Megjithatë stërvitjet në fakt, ndër të tjera kanë edhe qëllimin të identifikojnë, se çfarë duhet përmirësuar apo ndryshuar.

“Defender Europe 23” e vendos Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura edhe në “hartën” e vendeve pjesëmarrëse që do të kenë Shtabin dhe do të drejtojnë një prej Forcave Shumëkombëshe të Bashkuara për Detyrë (Multinational Task Force South), në përbërje të së cilës përveç trupave të FARSH (rrreth një batalion), do të jenë edhe formacione në nivel batalioni nga SHBA, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Republika e Kosovës.

“DE-23”, përveçse për të ripërsëritur suksesin e “DE-21” në mundësimin e RSOM (Reception-Staging-Onward-Movement), është një mundësi e mirë për të testuar aftësinë e FARSH, për të planëzuar dhe drejtuar një strukturë shumëkombëshe në nivel “brigade”, proceset dhe procedurat që lidhen me gatishmërinë dhe aftësinë e formacioneve pjesëmarrëse në stërvitje, ndërveprueshmërinë dhe kapacitetet e komandim-kontrollit.

## **Burime të shfrytëzuara**

1. Publius Vegetius Renatus, (v. 450-BC)
2. Improving The Effectiveness Of Joint Military Exercises--An Important Tool For Military Readiness, Raport to US Congress, December 11, 1979, <https://apps.dtic.mil/sti/pdfs/AD1122026.pdf>.
3. Direktiva e Stërvitjes së FARSH, DS-7, 2011.
4. BI-SC Collective training and exercise directive (CT&ED) 075-003, [https://www.act.nato.int/images/stories/structure/jft/bi-sc-75-3\\_final.pdf](https://www.act.nato.int/images/stories/structure/jft/bi-sc-75-3_final.pdf)
5. Soili Paananen & Antti-Tuomas Pulkka (eds.), Helsinki 2019.
6. Ardant du Picq 1821-1870 Battle studies (Military Service Publishing. (Original work published 1880).

7. Dupuy, R.E., and Dupuy, T.N. (1977).
8. Clausewitz, On War, eds. and trans.
9. [https://armypubs.army.mil/epubs/DR\\_pubs/DR\\_a/pdf/web/ARN19606\\_AR34-1\\_FINAL.pdf](https://armypubs.army.mil/epubs/DR_pubs/DR_a/pdf/web/ARN19606_AR34-1_FINAL.pdf),
10. [https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics\\_84112.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_84112.htm)
11. <https://foreignpolicy.com/2023/01/05/russia-ukraine-next-war-lessons-china-taiwan-strategy-technology-deterrence/>
12. NATO, “Exercise Trident Juncture 18 to Demonstrate NATO”s.
13. AAP-6, NATO Glossary.
14. Sun Tzu, “The Art of War”.
15. Colonel John “Buss” Barranco, *The Atlantic Council*.





# STËRVITJET, PËR RRRITJEN E GATISHMËRISË SË FORCËS TOKËSORE

**Kolonel Beqir TAFILI**

*Shef i Shtabit të Forcës Tokësore*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Gjatë vitit 2022, ndodhën dhe u dokumentuan mjaft ngjarje të rëndësishme politike dhe ushtarake vecanërisht në kuadër të mbështetjes së pa lëkundur të Aleancës për Ukrainën pas sulmit të paprecedent të Rusisë, rritjes së gatishmërisë operacionale dhe prezencës së kapaciteteve tokësore, detare dhe ajrore të NATO-s, për parandalimin dhe rritjen e aftësive mbrojtëse, përgjatë krahut lindor të aleancës dhe më gjerë, si dhe në kuadër të masave të NATO-s, “DDA/Shkurajimit dhe Mbrojtjes së Zonës Euroatlantike të Aleancës”.*

*Në këtë kontekst, duke filluar nga muaji shkurt 2022 e në vijim, në mjedisin e ri të sigurisë, të krijuar nga agresioni i Rusisë kundër Ukrainës, NATO dhe të gjitha organizatat ndërkombëtare të sigurisë, rritën bashkëpunimin midis tyre në të gjitha fushat, vecanërisht në fushën diplomatike, ekonomike dhe fushën ushtarake. U intensifikua bashkëpunimi ushtarak midis aleatëve, të cilët, në mënyrë tepër të unifikuar, morën dhe vazhdojnë të marrin masat e nevojshme, duke organizuar mjaft aktivitete, trajnime dhe stërvitje ushtarake të përbashkëta, të organizuara nga komandat e NATO-s, komandat amerikane, si dhe nga vendet anëtare të aleancës.*

*Qëndrimet dhe aktivitetet e përbashkëta të NATO-s dhe vendet aleate, gjatë kësaj periudhe krize të paprecedent, kanë dëshmuar se aleatët janë në gjendje të menaxhojnë krizën e krijuar dhe se po i përgjigjen sfidave dhe kërcënimeve, në mënyrë të shpejtë dhe të unifikuar.*

*Nga pikëpamja ushtarake, për të qenë të gatshëm për t'u përballuar me realitetin e ri, për ruajtjen e stabilitetit dhe të sigurisë, është domosdoshmëri rritja e gatishmërisë luftarake dhe ndërveprueshmërisë, nëpërmjet përgatitjes intensive luftarake dhe stërvitjeve kombëtare e ndërkombëtare, të trupës, shtabeve dhe komandave. Kjo, e programuar dhe e konceptuar duke përdorur mjedise trajnuese, 360°, me skenarë operacionalë realë, ku kërcënimet “hibride”, “kibernetike” dhe “asimetrike”, janë prezent dhe që zhvillohen me intensitet të lartë.*

*Në këtë këndvështrim, edhe Forca Tokësore në kuadër të detyrimeve të Forcave të Armatosura, për të qenë të gatshëm për realizimin e misionit kushtetues, programon aktivitete dhe kryen trajnime dhe ushtrime stërvitore, në interes të përgatitjes së saj për t'u aftësuar, në kryerjen e spektrit të plotë të operacioneve, duke filluar nga operacionet luftarake tokësore, ato të mbështetjes së paqes, e deri tek operacionet në mbështetje të Autoriteteve Civile për menaxhimin e Emergjencave Civile, të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose katastrofat industriale.*

*Trajnimet dhe stërvitjet e Forcës Tokësore, në interes të rritjes së aftësive operacionale dhe ndërveprueshmërisë, janë programuar, zhvilluar dhe do të zhvillohen në terrenet dhe poligonet tona kombëtare, por edhe në ambientet trajnuese e poligonet stërvitore të vendeve aleate dhe partnere.*

**Fjalët kyçe:** Përgatitje operacionale, programe trajnuese, trajnime, stërvitje, edukim, ushtrime stërvitore, kapacitete operacionale, poligone stërvitore, NATO, ndërveprueshmëri.

## PLANËZIMI

Procesi i planëzimit dhe përgatitjes operacionale të Forcës Tokësore bazohet në doktrinat ushtarake, direktivat strategjike, taktikat, teknikat, procedurat dhe standardet e NATO-s. Njohja, trajnimi dhe stërvitja sipas tyre, garanton gatishmërinë operacionale të forcës si dhe ndërveprueshmërinë me komandat e tjera dhe me aleatët, për kryerjen e spektrit të plotë të operacioneve tokësore.

Metodologjia e hartimit dhe menaxhimit të procesit stërvitor, përdorimi i simulatorëve të cilët do të jenë shumë shpejt pjesë e organikës së Forcës Tokësore, përdorimi i simulimit për të trajnuar individët dhe kompaktësuar formacionet dhe njësitë ushtarake tokësore, si dhe procesi për kryerjen e “After Action Review”, janë pjesë integrale e ciklit vjetor dhe afatmesëm të programit të edukimit, trajnimit dhe stërvitjes.

Në mjedisin e ri të sigurisë, të krijuar mbas sulmit të paprecedent të Rusisë ndaj Ukrainës si dhe në mbështetje të masave të ndërmarra nga aleanca, përgatitja operacionale e Forcës Tokësore, me qëllim rritjen e aftësive operacionale dhe

të ndërveprueshmërisë, vijon në kohezion të plotë me programet dhe planet kombëtare të SHPPFA, programet trajnuese të NATO-s, të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, si dhe me programet trajnuese dhe stërvitore të Komandës Amerikane në Europë-Afrikë (USAREUR-AF).

Në këtë prizëm, programi trajnues vjetor i komponentit tokësor për vitin 2023, është një konceptim dhe gërshtim i programit të trajnimit individual me programin e trajnimit kolektiv, i cili kulmon me stërvitjet kompaktësuese në nivele të ndryshme, të cilat për trupën dhe për shtabet zhvillohen në poligonet stërvitore ose me simulim, brenda dhe jashtë vendit.

Eksperiencat e fituara ndër vite nga strukturat e Forcës Tokësore, me pjesëmarrjen në stërvitjet kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, e kanë rritur profesionalisht trupën dhe shtabet dhe kanë konsoliduar më tej aftësinë e tyre për të planëzuar, për lëvizje taktike dhe zhvendosje strategjike dhe për t'u stërvitur në mjedise operacionale komplekse dhe dinamike.

Pa përmendur listën e gjatë të stërvitjeve të shumta që Forca Tokësore ka organizuar dhe ka marrë pjesë, në vitet e fundit, mund të veçohet pjesëmarrja në stërvitjen “Defender Europe 21” dhe stërvitja certifikuese “Biza 22”, stërvitje të cilat dëshmuar profesionalizëm dhe përgatitje të lartë profesionale dhe taktike, aftësi operacionale të admirueshme, si dhe ndërveprueshmëri të lartë në zbatimin e detyrave të përbashkëta në mjediset shumëkombëshe të krijuara sipas skenarëve.

## **PËRVOJA E FORCËS TOKËSORE**

### **Stërvitja “Defender Europe 21”.**

Organizimi i Stërvitjes “Defender Europe 21” në Shqipëri dhe pjesëmarrja aktive e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje, forcoi më tej bashkëpunimin ushtarak me partnerin strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe transmetoi mesazhe strategjike për rolin e Shqipërisë si anëtar i NATO-s në kuadër të konceptit të “*Shkurajimit dhe Mbrojtjes së Zonës Euroatlantike të Aleancës*”.

“Defender Europe 21” demonstroi gjithashtu, aftësitë tona kombëtare për të pritur dhe për të mbështetur një forcë të madhe ushtarake ndërkombëtare për të realizuar objektivat strategjike në kuadër të mbrojtjes kolektive.

Pjesëmarrja e Forcës Tokësore në stërvitjen “*Defender Europe 21*”, e cila ishte stërvitja shumëkombëshe më e madhe e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rritjes së aftësive operacionale, duke u stërvitur me një skenar real në një ambient “*Combined-Joint*”, ngriti në një nivel më të lartë ndërveprueshmërinë midis forcave ushtarake ndërkombëtare pjesëmarrëse.

Ndërkohë, në vijim të suksesit që Forca Tokësore pati me pjesëmarrjen në stërvitjen “Defender Europe 21”, bazuar në detyrimet kombëtare në kuadër të NATO-s, gjatë vitit 2022, u përgatit dhe u zhvillua në vendin tonë, stërvitja certifikuese e Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësores/GBKL.

### **Stërvitja certifikuese “Biza 22”.**

Në muajin shtator 2022, Grup-Batalioni i Lehtë i Këmbësores (GBKL), i cili është kapacitet operacional kombëtar i deklaruar në NATO, strukturë operationale e organizuar për detyrë, me bërthamë batalionin e dytë të këmbësores (b2k), i mbështetur nga strukturat e zbulimit, mbështetjes me luftim, mbështetjes logjistike të Forcës Tokësore, nënreparte të Komandës Mbështetëse, Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit dhe të Njësisë Mjekësore Ushtarake, iu nënshtrua vlerësimit operacional, sipas sistemit “*Combat Readiness Evaluation*” (CREVAL) të NATO-s në stërvitjen certifikuese “Biza 22”.

NATO, në mënyrë të vazhdueshme, bazuar në kriteret dhe standardet e gatishmërisë operationale dhe në Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes, si dhe bazuar në ciklin vlerësues 4-vjeçar, monitoron, teston dhe vlerëson “*Statusin e Gatishmërisë Operacionale*” të kapaciteteve operationale të vendeve anëtare, të cilat vihen në dispozicion të saj, për t’u përdorur për mbrojtjen e kufijve të aleancës dhe për kryerjen e operationeve ndërkombëtare jashtë artikullit V, nëse nevojitet.

Përveç certifikimit të Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, i cili ishte objektiv ushtarak me përmasa kombëtare, stërvitja “Biza 22” mundësoi edhe realizimin e disa objektivave të tjerë trajnues si: aftësimin dhe rritjen e nivelit operacional të njërive pjesëmarrëse në stërvitje; kryerjen e procesit të planëzimit sipas standardeve të NATO-s; testimin e komandim-kontrollit; testimin e procedurave të vendimmarrjes ushtarake dhe procedurave të drejtimit të trupave; kompaktësimin kolektiv dhe familjarizimin e plotë me Taktikat, Teknikat dhe Procedurat Standarde, etj.

Në këtë stërvitje certifikuese, për herë të parë në historikun e “*stërvitjeve certifikuese të GBKL*”, morën pjesë mbi 1200 trupa, mbi 200 automjete dhe teknika luftarake, mbi 80 automjete të blinduara, sistemet luftarake organike, armatimi i lehtë dhe armët artilerisë, si dhe rreth 40 monitorues e vëzhgues nga Komanda e Komponentit Tokësor të NATO-s, Komanda e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, Forca e Sigurisë së Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe personel nga struktura amerikane trajnuese “*Special Force Assistance Brigade/SFAB*”.

Për arritjen e suksesit të Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, përveç aktorëve kombëtarë, kontribut dhe mbështetje sinjifikante dhanë edhe Komanda e Komponentit Tokësor të NATO-s, Izmir, strukturat e ndryshme

ushtarake të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, si dhe ekipi special amerikan, “*Special Force Assistance Brigade*” (SFAB), i cili qysh nga muaji prill 2022 e në vazhdim, vijon asistencën ushtarake, i atashuar pranë Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësisë.

## VITI STËRVITOR 2023

Planëzimi i aktiviteteve kryesore stërvitore dhe trajnuese të Forcës Tokësore për vitin 2023, është konceptuar sipas ciklit vjetor të trajnimit duke analizuar dhe vlerësuar suksesin e stërvitjes ndërkombëtare “*Defender Europe 21*”, suksesin e Forcës Tokësore në certifikimin nga NATO të “Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësisë” në stërvitjen “Biza 22”, si dhe duke analizuar përvojat dhe mësimet e nxjerra nga të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë këndvështrim, plani stërvitor i Forcës Tokësore 2023, është gjithëpërfshirë dhe i integruar, ku bazuar në objektivat dhe prioritetet kryesore, ndërthuren programet e trajnimit individual me programet e stërvitjes kolektive. Programet e trajnimit dhe stërvitjeve tokësore kombëtare, janë gjithashtu të integruar me programet trajnuese dhe stërvitore të komandës tokësore të NATO-s, Komandës së Bashkuar Operacionale të NATO-s në Napoli, komandës Amerikane në Europë-Afrikë, Gardës Kombëtare të New Jersey-it etj.

Në kuadër të detyrimeve trajnuese ndaj NATO-s, vendet anëtare janë përgjegjëse për edukimin dhe trajnimin e personelit të tyre, si dhe të forcave ushtarake të alokuara për NATO-n. Aleatët duhet të sigurojnë që personeli i caktuar në strukturat dhe misionet e NATO-s, duhet të plotësojnë kualifikimet thelbësore, si dhe të kenë aftësitë e kërkuara operacionale, për të ndërvepruar në kryerjen e detyrave operacionale. Koordinimi, ndarja e përgjegjësisë, integrimi i programeve trajnuese dhe stërvitore, realizohet nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak, si dhe pjesëmarrjes në aktivitete, forume stërvitore dhe konferencat kryesore të organizuara nga komandat strategjike të NATO-s në përgjithësi dhe pjesëmarrjes në Konferencën e Kombinuar të Trajnimit dhe Stërvitjes në veçanti.

Konferenca e Kombinuar e Trajnimit dhe e Stërvitjes, e organizuar dhe drejtuar nga Komanda Tokësore e NATO-s dhe Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë, e cila zhvillohet dy herë në vit, me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s, si dhe pjesëmarrjen e komandave kryesore ushtarake amerikane dhe të NATO-s, është platforma më e mirë e koordinimit dhe e integritetit të programeve trajnuese dhe stërvitore 4 - 5-vjeçare.

Bazuar në mundësitë të cilat të ofrojnë “*forumet ndërkombëtare të komunitetit të drejtuesve dhe planëzuesve të stërvitjes*”, në të cilat marrin pjesë planëzuesit dhe drejtuesit e lartë, nga komandat e NATO-s, Komandat Amerikane dhe shtabet e vendeve anëtare dhe aleate të NATO-s, bazuar në objektivat

kombëtarë të trajnimit dhe stërvitjes, Forca Tokësore si një ndër forcat kryesore të Forcave të Armatosura, në koordinim edhe me komandat e tjera, planëzon dhe menaxhon ciklin trajnues dhe stërvitor, brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë frymë, Komanda e Forcës Tokësore, me qëllim shkëmbimin e hershëm të informacionit të stërvitjes, për t'u dhënë mundësi komandave dhe aleatëve për t'u stërvitur së bashku, por edhe për mbështetje reciproke, ka programuar dhe ka pasqyruar në platformat kryesore të NATO-s dhe të Komandës Amerikane në Europë, stërvitjet kryesore për periudhën 2023-2026, si dhe programin e trajnimit individual, për periudhën 2023-2024.

Po ashtu, në vijim të modernizimit të Forcës Tokësore, trajnimi dhe stërvitja për këtë vit kalendarik, i paraprin përgatitjes dhe trajnimit të burimeve njerëzore dhe strukturave, të cilat do të kompletohen dhe do të përdorin sistemet, pajisjet dhe armatimin e ri, me qëllim përdorimin sa më efikas të tyre, shfrytëzimin e efikasitetit të teknologjisë si dhe mirëmbajtjen e tyre.

### **Stërvitjet dimërore kryesore.**

Këto stërvitje janë të përvitshme dhe programohen e konceptohen duke vlerësuar, analizuar dhe përgjigjur disa pyetjeve: Çfarë nevojitet për të mbrojtur, luftuar dhe mbijetuar në një mjedis të ftohtë? Çfarë duhet bërë, nëse kryeni operacione luftarake ditën dhe natën, në kushte të vështira moti, ndërsa keni mbi 20 kilogramë veshje dhe pajime ushtarake, si dhe pyetjeve të tjera, të cilat u referohen aftësive dhe veprimeve operaconale, në kushte ekstreme moti.

Këto stërvitje përgatiten pas një planëzimi të përbashkët midis Forcës Tokësore dhe njësisë vartëse (*Regjimentit të Operacioneve Speciale, reparteve të manovrës dhe atij të mbështetjes me luftim*), të cilat realizohen në periudhën shkurt-mars 2023. Janë stërvitje që unifikojnë procedurat e komandim-kontrollit, si dhe veprimet komplekse të trupave të këmbësorisë, trupave speciale, Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, trupave të mbështetjes me luftim, duke testuar aftësinë e tyre për të punuar dhe operuar së bashku në kushtet e motit të ftohtë, në një zonë operaconale të caktuar.

Në këtë kontekst, gjatë javëve të ardhshme, strukturat e Forcës Tokësore do të dislokohen nëpër poligone të ndryshme dhe do të trajnojnë aftësitë jetike dhe aftësitë operaconale, duke siguruar përgatitje të lartë, për t'iu përgjigjur çdo kërcënimi ose krize.

### **“DEFENDER EUROPE 23”**

Stërvitja “Defender Europe” është një stërvitje vjetore shumëkombëshe, e përbashkët në shkallë të gjerë, e udhëhequr nga SHBA, e krijuar për të rritur gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë midis Shteteve të Bashkuara, NATO-s dhe vendeve partnere. Stërvitja “Defender Europe 2023” do të zhvillohet në

periudhën maj-qershor 2023, në disa terrene, në të gjithë Europën.

Përgatitja e kësaj stërvitjeje e filloi udhëtimin e saj pikërisht në Tiranë, ku në fund të muajit tetor 2021, u mbajt konferenca e parë e kësaj stërvitjeje me pjesëmarrjen e më shumë se 400 pjesëmarrëseve nga rreth 30 vende të ndryshme të botës, pjesëmarrjen e autoriteteve të larta politike dhe ushtarake të FA-ve, pjesëmarrjen e ambasadores së SHBA-ve në vendin tone, si dhe me pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë ushtarakë amerikanë.

Në fjalën e tij, Ministri i Mbrojtjes do të theksonte: *“Kjo stërvitje shkon përtej dimensionit ushtarak dhe konfirmon gatishmërinë e plotë të qeverisë për të mbështetur dhe mundësuar ekzekutimin e saj në vendin tonë. Stërvitje të tilla me vizibilitet të lartë, demonstrojnë rëndësinë strategjike të Politikës së SHBA-ve për NATO-n, aleatët dhe partnerët e saj evropianë dhe riafirmojnë angazhimin e fortë që Aleanca, dhe në veçanti Shtetet e Bashkuara, kanë në rajonin tonë. “Defender Europe 23” për ne, theksoi më tej Ministri i Mbrojtjes, mbetet një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik për pagën, sigurinë, stabilitetin dhe garancinë për qytetarët tanë, vendet e rajonit dhe në mbarë Europën”.*

Bazuar në konceptin “DE 23/IR 23”, stërvitja që do zhvillohet në territorin e Ballkanit, organizohet me “2 Multinational Task Force” dhe respektivisht “Multinational Task Force North”, me qendër në Kroaci dhe “Multinational Task Force South”, me qendër në Shqipëri.

Struktura organizative e Shtabit të Brigadës Shumëkombëshe, në përbërje të “Multinational Task Force South”, si dhe strukturat operacionale, do të plotësohen me personel nga vendet anëtare të Kartës “Adriatik 5”: Shqipëria, Kosova, SHBA, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Mali i Zi.

Angazhimet e Forcave të Armatosura në këtë stërvitje po planëzohen nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ku në ekzekutimin e saj, do të marrin pjesë personel nga SHPFA, Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda Mbështetëse, Policia Ushtarake etj.

Forca Tokësore, në paketën e stërvitjes “Defender Europe 23”, e cila përbëhet nga stërvitjet, “Immediate Response 23”, “Saber Guardian 23”, “Swift Response 23”, si dhe stërvitjet e bashkëlidhura me të, si “Astral Knight 23”, stërvitja “Laufer” që zhvillohet në Kroaci. Po kështu, stërvitja “Triglav Star 23” që zhvillohet në Sloveni, do të angazhojë personel nga Shtabi i Forcës Tokësore, struktura operacionale nga batalioni i dytë i këmbësisë, struktura të xhenios, kimisë, forcave speciale, forcave komando, zbulimit, batalionit të parë të këmbësisë dhe batalionit të tretë të këmbësisë, të mbështetura nga strukturat e mbështetjes logjistike.

Për zhvillimin në vendin tonë të stërvitjes, do të vihen në dispozicion të saj,



hapësira ajrore e RSH, hapësirat detare, 5 poligone stërvitore dhe ambiente akomoduese, të cilat do të garantojnë mbështetjen logjistike, administrative dhe stërvitjen e përbashkët, me forcat amerikane dhe aleate për rreth dy javë, ndërkohë që do të dislokojmë edhe disa struktura tokësore në 4 poligone stërvitore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë: Poligonin Kombëtar Bizë; Poligonin Feken; Garnizonin Zall Herr; Bazën Ajrore Farkë; Poligonin “Mnelës”, Shkodër; Poligonin “Krivolak” në Maqedoninë e Veriut; Poligonin “Babaj i Bokës” në Kosovë; Poligonin “Slunjë” në Kroaci; Poligonin “Bohinjska Bela” në Slloveni.

### **Stërvitja “Stong Balkan” (BCHOD 9).**

Në vitin 2007, shefat e Shtabeve të Përgjithshme të Forcave të Armatosura të 9 vendeve të Ballkanit, gjatë një konference të mbajtur në Selanik, konfirmuan vullnetin e tyre për të përmirësuar bashkëpunimin ushtarak shumëpalësh ndërmjet vendeve të tyre, me qëllim përballimin koherent të sfidave të sigurisë rajonale.

Në kuadër të Iniciativës së Shefave të Shtabit, të nëntë vendet ballkanike, Shqipëria, Bullgaria, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Rumania, Greqia, Turqia, Serbia dhe Bosnje Hercegovina, përveç aktiviteteve vjetore të programuara, çdo vit, zhvillojnë stërvitje të përbashkëta, në vendet respektive me sistem rotacioni. Historia e këtyre stërvitjeve të përbashkëta, ka qenë ndër vite shembull i bashkëpunimit ushtarak shumëkombësh, me objektiv strategjik, promovimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan.

Vitin që kaloi, në kuadër të kësaj iniciative u zhvillua në Greqi, stërvitja “*Balkan Shield 22*” me pjesëmarrjen e forcave speciale nga Shqipëria, Bullgaria, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Rumania dhe Bosnjë-Hercegovina.

Gjatë këtij viti, Shqipëria si vend pritës i aktiviteteve në kuadër të Iniciativës së Shefave të Shtabit të nëntë vendeve Ballkanike, do të mikpresë stërvitjen e radhës. Stërvitja, e cila kodohet “*Strong Balkan 23*”, që do të zhvillohet në disa poligone stërvitore, brenda territorit të vendit tonë, në periudhën 31 tetor deri më 12 nëntor 2023, do të garantojë një platformë dhe mjedis kompleks trajnimi, për zhvillimin e suksesshëm të stërvitjes së përbashkët të trupave speciale, nga nëntë vendet e Ballkanit.

Forca Tokësore dhe Regjimenti i Operacioneve Speciale, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e me forcat speciale të vendeve pjesëmarrëse, po e projektojnë këtë stërvitje shumëkombëshe në formën “LIVEX”, me skenar të tillë operacional që të realizohen objektivat e stërvitjes dhe objektivat e trajnimit të secilës strukturë të forcave speciale pjesëmarrëse, në frymën e bashkëpunimit rajonal të iniciativës dhe të ndërveprimit.




Qëllimi i stërvitjes është që të rritë aftësitë operacionale dhe nivelin e ndërveprimit midis Forcave Speciale për të planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar operacione speciale të bashkuara, të kombinuara, në një mjedis shumëkombësh, duke zbatuar procedurat standarde dhe qasjen gjithëpërfshirëse, si dhe për të promovuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me operimin e përbashkët, ndaj kërcënimeve të sigurisë, në kuadrin e një krizë rajonale.

Në stërvitje do të integrohen skenarë realistë dhe kompleksë, për të testuar përdorimin e armatimit, aseteve teknologjike, si dhe përdorimin e taktikave e teknikave moderne të forcave speciale, duke përfshirë në strukturën organizative edhe stafet me strukturat operacionale. Këto stafe do të vlerësojnë dhe anlizojnë situatat luftarake, do të planifikojnë, si dhe do të sikronizojnë ekzekutimin e operacioneve, duke koordinuar ndërmjet nivelit taktik e atij operacional.

### “Fekeni 23”, e hapur për aleatët dhe partnerët.

“Fekeni 23” është një stërvitje kombëtare në nivel batalion +, e deklaruar në “*NATO MTEP*”, e hapur për pjesëmarrje të strukturave ushtarake nga vendet aleate dhe partnere të NATO-s.



Duke u nisur nga fakti se kjo stërvitje do të jetë Shumëkombëshe, planëzimi i saj ka filluar me përgatitjen e konceptit të stërvitjes në gjuhën angleze.

Qëllimi i stërvitjes është aftësimi i trupave komando, në kryerjen e operacioneve në prapavija të kundërshtarit, duke zbatuar taktikat, teknikat dhe procedurat standarde të NATO-s, në kushte ekstreme moti. Nëpërmjet kësaj stërvitjeje komplekse, do të synohet unifikimi i procedurave të komandim-kontrollit, rritja e aftësive operacionale të trupave komando duke zhvilluar operacione

në prapavijat e kundërshtarit, si dhe rritja e ndërveprimit me strukturat e tjera shumëkombëshe, të cilat mund të marrin pjesë.

Kjo stërvitje do të përgatitet dhe planëzohet nga ana Komanda e Forcës Tokësore, duke bashkëpunuar me Shtabin e Përgjithshëm të FA-ve, Regjimentin e Operacioneve Speciale, por edhe me planëzuesit e vendeve të tjera, të cilat mund të marrin pjesë.

### **Angazhime të Forcës Tokësore, jashtë vendit.**

Ashtu siç u përmend më sipër, Komanda e Forcës Tokësore, e cila merr pjesë periodikisht në Konferencën e Kombinuar të Trajnimit dhe Stërvitjes, të organizuar dhe drejtuar nga Komanda Tokësore e NATO-s dhe Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë, ka zhvilluar konceptin e pjesëmarrjes me disa struktura tokësore, në stërvitjet ndërkombëtare dhe në poligonet stërvitore jashtë vendit.

Në konferencën e fundit që u zhvillua në fund të vitit të kaluar, FT koordinoi aktivitetet e programit të trajnimit individual të FT-së, me programin e trajnimit individual të Komandës Amerikane në Europë-Afrikë (USAREUR-AF) për periudhën 2023-2024. Forca Tokësore koordinoi dhe konfirmoi pjesëmarrjen e strukturave të saj në stërvitjet e përbashkëta, jashtë vendit me USAREUR-AF dhe NATO-n, për periudhën 2023-2026. FT informoi dhe përditësoi aleatët tanë për mundësinë e pjesëmarrjes së tyre në stërvitjet tona kombëtare, të pasqyruar në NATO dhe MTEP, të cilat janë të hapura për aleatët dhe partnerët.

Për këtë vit kalendarik, janë disa struktura të FT-së, të cilat bazuar në plan-kalendarin e miratuar, do të trajnohen në disa poligone të ndryshme të Europës, në stërvitjen “*KFOR Rotation*”, në Hoenfels Gjermani; në stërvitjen “*Saber Junction*”, e në Hoenfels Gjermani. Po kështu në stërvitjen “*Combined Resolve*”, në Hoenfels Gjermani; në stërvitjen “*Immediate Response 23*”, në Krivolak, Maqedonia e Veriut; në stërvitjen “*Immediate Response 23*”, në Poligonin “Babaj i Bokës”, Kosovë; në stërvitjen “*Immediate Response 23/Laufer*”, në Poligonin “Slunjë” Kroaci, në stërvitjen “*Immediate Response 23/Triglav Star 23*” dhe Poligoni “Bohinjska Bela” në Slloveni, etj.

### **PËRFUNDIME**

Integrimi i stërvitjes dhe trajnimit individual me atë kolektiv, i strukturave të Forcës Tokësore, rrit aftësitë personale, si dhe aftësitë operacionale të strukturave operacionale.

Në situatën aktuale të sigurisë, pjesëmarrja e Forcës Tokësore në stërvitjet ndërkombëtare, përveç përfitimeve të rritjes së aftësive operacionale të forcave

pjesëmarrëse, përcjell mesazhe strategjike të bashkëpunimit, kohezionit dhe unitetit të Aleancës.

Stërvitjet ndërkombëtare janë një vlerë kontribuuese për rritjen e gatishmërisë operacionale dhe ndërveprueshmërinë e forcave, pajisjeve dhe procedurave.

Forca Tokësore, në kuadër të misionit të Forcave të Armatosura, demonstroi aftësitë për të mbështetur dhe për t'u integruar në strukturat operacionale të NATO-s dhe ato amerikane për realizimin e objektivave strategjike, në kuadër të mbrojtjes kolektive.

Zhvillimi në vendin tonë i stërvitjes “Defender Europe 23”, ashtu si edhe stërvitja “Defender Europe 21”, do të përcjellë mesazhe strategjike të unifikuara me NATO-n dhe me komandën amerikane në Europë, për:

1. Rolin dhe angazhimin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s, në kuadër të masave të NATO-s për *“Shkurajimin dhe Mbrojtjen e zonës euroatlantike/ DDA”*.
2. Rritjen e partneritetit strategjik në fushën e mbrojtjes, partneritet i cili është konsoliduar dhe rritur në vijimësi.
3. Rritjen e rolit të lidershit politik dhe ushtarak, në përgatitjen për menaxhimin e krizave të mundshme.
4. Rritjen e aftësive operacionale dhe ndërveprueshmërisë së forcave, të cilat do të angazhohen në stërvitje.

## **Burime të shfrytëzuara**

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH.
2. Strategjia Ushtarake.
3. Doktrina e Stërvitjes e FARSH.
4. Doktrina e Përbashkët e FARSH.
5. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile të RSH.
6. Manuali i Standardizimit i FA.
7. AJP-1, Doktrina e Përbashkët e Aleancës.
8. ACO Security Directive AD 70-1, e ndryshuar.
9. AJP-3.2 Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Operacionet Tokësore.
10. MC 0458, NATO TRAINING EXERCISE AND EVALUATION POLICY.
11. Bi-SC 75-7, Education and Individual Training Directive (E&ITD).
12. BI-SC 075-002, Education and Training (E&T) Directive.

13. BI-SC Directive 075-003 Collective Training and Exercises.
14. Balkan Countries CHODs Forum.
15. Balkan CHOD Conference Joint Statement.
16. ETESWG Annual Report.
17. Bi-SCD 080-006, Lessons Learned.
18. NATO Military Training and Exercise Programme (MTEP).
19. Politikat e NATO-s për Standardizimin.
20. Command and Control of Allied Land Forces, February 2009.

# ARSIMIMI SIPAS MODELIT “WEST POINT”, GARANCI PËR SUKSES

**Dr. Glevin DERVISHI**

Shefi i Departamentit të Marrëdhënieve  
Ndërkombëtare dhe Shkencave të  
Komunikimit, FMS, AFA

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Ky artikull informues ndalet në rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e arsimimit ushtarak, mes Akadaemisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Akademisë Ushtarake West Point të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe çeljen e programeve të reja të studimit. Akademia e Forcave të Armatosura, në bashkëpunim të plotë me Akademinë Ushtarake të SHBA-ve “West Point” është përfshirë në një proces dinamik të zhvillimit substancial të korrikulave dhe programeve sipas këtij modeli, si dhe në përputhje me arsimin e lartë publik kombëtar. Asistenca amerikane është e përqendruar në tre komponentë të rëndësishëm të programeve të reja që do të çelen si: formimi i karakterit, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe shkencat e komunikimit. Në kontekstin e realitetit të ri që po jetojmë, veprimtaria e Forcave të Armatosura është rivendosur në fokusin kryesor të të gjitha shoqërive europiane, por zhvillimet dinamike në fushën e zhvillimit ushtarak nuk mund të shihen të shkëputura nga arsimimi ushtarak. Akademia e Forcave të Armatosura, si një prej institucioneve lider dhe unik në formësimin e kapaciteteve akademike dhe institucionale në fushën e mbrojtjes, me një traditë rreth 65-vjeçare, ka hyrë tashmë në një rrugë transformimi të qendrueshëm, për ta shndërruar atë në një prej institucioneve të arsimit të lartë, më me ndikim në fushën e sigurisë në vend.*

**S**hërbimi në Forcat e Armatosura është më shumë sesa mision, ai është mishërimi i detyrës së vështirë, sakrificës por në të njëjtën kohë është sfida e të qenurit i pari aty ku e kërkon kombi dhe detyra. Ecuria e proceseve zhvillimore shoqërore brenda vendit, por edhe dimensionet e reja teknologjike që hasim, na imponojnë nevojën për të zhvilluar kapacitete që mbështesin detyrat në Forcat e Armatosura dhe shenjtërinë e këtij misioni fisnik si në aspektin akademik, të standardeve dhe kërkimit shkencor. Arsimimi dhe trajnimi ushtarak është procesi që synon të krijojë dhe përmirësojë aftësitë e personelit ushtarak në detyrat e tyre respektive, ndaj AFA përbën vetëm themelin në këtë proces të gjatë e të pandalshëm edukues të Forcave të Armatosura. Arsimimi ushtarak ndihmon në krijimin e kushteve për sukses ushtarak, duke krijuar arkitekturën konceptuale dhe intelektuale, për t'i bërë operacionet ushtarake më efektive dhe për ta bërë këtë në mënyrë të vazhdueshme.

Akademia e Forcave të Armatosura,<sup>1</sup> si një prej institucioneve lider dhe unik në formësimin e kapaciteteve akademike ushtarake dhe institucionale me një traditë rreth 65-vjeçare, ka hyrë tashmë në një transformim të qendrueshëm për ta shndërruar atë, në njërin prej institucioneve të arsimit të lartë më me ndikim në fushën e sigurisë në vend. Në funksion të arritjes së këtij objekti, AFA ka përqafuar vizionin për t'u kthyer në një qendër moderne të arsimit të lartë ushtarak dhe të kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare<sup>2</sup>. Ky transformim synon që ta kthejë këtë akademi në një “laborator” të formimit të gjeneratës së re të oficerit të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar.

Në kuadër të këtij formatimi dhe konsolidimit të plotë institucional, AFA, në partneritet të plotë me Akademinë Ushtarake të SHBA-ve “West Point”, është përfshirë në një proces dinamik të zhvillimit substancial të korrikulave dhe programeve sipas këtij modeli, si dhe në përputhje me arsimimin e lartë publik kombëtar. Asistenca amerikane për AFA-në është e përqendruar në tre komponentë të rëndësishëm të programeve të reja që do të çelen si: Formimi i karakterit<sup>3</sup>, Marrëdhëniet ndërkombëtare<sup>4</sup> dhe Shkencat e komunikimit<sup>5</sup>.

Ky bashkëpunim në fushën e arsimimit ushtarak ofron një arkitekturë intelektuale për suksesin në fushën e operacionalitetit dhe trajnimit, ku gjithashtu kontribuon në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme civilo-ushtarake, në stimulimin

<sup>1</sup> <https://www.tradoc.mil.al/rreth-kds/vizioni-misioni>

<sup>2</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-156-dt.-19.2.2020-AFA.pdf>

<sup>3</sup> <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/behavioral-sciences-and-leadership>

<sup>4</sup> <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/social-sciences/international-affairs>

<sup>5</sup> <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/social-sciences>

e kulturës së reflektimit dhe ngritjen e kapaciteteve për analizë kritike.

Në vazhden e këtij angazhimi AFA synon që të çelë për vitin akademik 2023-2024 Programet mësimore “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” si dhe “Shkenca e Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes”. Këto dy programe janë programe studimesh universitare të ciklit të parë të ofruar nga AFA, të organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programi “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” synon që të pajisë studentin me njohuri të domosdoshme dhe të konsoliduara për marrëdhënie ndërkombëtare, diplomacinë dhe disiplinat mbështetëse të saj. Këto janë ndër detyrat themelore të Forcave të Armatosura në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat ofrohen në programet ekzistuese si njohuri të përgjithshme dhe bazë. Ndërsa programi “Shkenca Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes” synon që t’u ofrojë një formim intelektual e profesional studentëve, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe prespektive në fushën e komunikimit e të mediave, përfshirë këtu mediat tradicionale dhe të hapësirës virtuale, rezultat i drejtpërdrejtë i zhvillimeve teknologjike në këtë fushë.

Veprimtari të tjera formuese të lidhura ngushtë me profesionin të tilla si: përgatitja e kuadrove të aftë dhe të pajisur me njohuritë bashkëkohore të gazetarisë dhe komunikimit në fusha të ndryshme të mbrojtjes; përvetësimi i aftësive për të vjelë, analizuar dhe më pas raportimin profesional të informacionit; njohja me çështje të etikës në raportim dhe çështjeve që kanë të bëjnë me median dhe shkencat e komunikimit; integrimi i teorisë dhe praktikës në mënyrë që studentët të përjetojnë aspekte që lidhen me fushën e studimit.

Ekspertiza amerikane përveçse po i shërben rritjeve të kapaciteteve akademike, modernizimit, avancimit të mëtejshëm në procesin e edukimit, gjithashtu mbart edhe një potencial të lartë në ndërtimin e një praktike të re në bashkëpunimin akademik dypalësh, atë të shkëmbimeve të studentëve dhe trupës akademike mes Akademisë së Forcave të Armatosura dhe West Point. Gjatë dy takimeve të zhvilluara me ekspertët e Akademisë “West Point”, janë marrë në analizë objektivat akademike të programeve të reja që do të ofrohen, strukturimi i *sylabuseve* dhe pasurimi i tyre me literaturën më koherente, që reflekton zhvillimet akademike më cilësore në këtë fushë<sup>6</sup>.

Në hartimin e këtyre programeve janë marrë në konsideratë specifikat kombëtare të vendit tonë, konteksti historik, mjedisi i sigurisë ku operojmë, kapacitetet dhe synimet tona për të ofruar një model akademik ushtarak, lider në rajon.

<sup>6</sup><https://www.tradoc.mil.al/lajme/550-nje-ekip-nga-akademia-ushtarake-e-west-point-shba-zhvilloi-nje-vizite-pune-ne-akademine-e-forcave-te-armatosura>

## TRANSFORMIMI I AKADEMISË

Ambicia jonë është që arsimimi ushtarak të vijojë të zhvillohet dhe të konsolidohet më tej në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë, misionin dhe përgjegjësitë kushtetuese të FARSH, politikën e arsimit të ministrit të Mbrojtjes, kërkesat dhe standardet e NATO-s, si dhe vizioni i shefit të Shtabit të Përgjithshëm për periudhën 2022-2025<sup>7</sup>, i cili parasheh: *“Transformimi dhe funksionimi i plotë i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), si i vetmi institucion ushtarak i arsimit të lartë që do të përgatitë oficerët e ardhshëm të Forcave të Armatosura, do të jetë një prioritet i angazhimit tim në krye të Forcave të Armatosura. AFA-ja do të vijojë me procesin e riakreditimit insitucional, duke konsoliduar dhe vënë në eficiencë të plotë njësitë kryesore, ato bazë dhe organet e tjera drejtuese, koordinuese dhe mbështetëse. Bashkëpunimi me Akademinë Ushtarake do të vijojë deri në konsolidimin dhe transformimin e plotë të këtij institucioni arsimor. AFA-ja do të forcojë identitetin dhe peshën në zhvillimin e mendimit shkencor ushtarak, duke i paraprirë ndryshimeve në mjedisin e sigurisë, si dhe evolucionit teknologjik”*.

Me kalimin në sistemin 4-vjeçar të ciklit të studimeve për vitin akademik 2023-2024, synojmë që të çelim edhe programin e Master Shkencor për të dy programet “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” dhe “Shkenca Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes”, gjatë vitit akademik 2024-2025. Në vizionin afatgjatë të Akademisë së Forcave të Armatosura, është edhe çelja e programeve të doktoratës gjatë vitit akademik 2025-2026 të fokusuara në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shkencave të Komunkimit, Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ky realitet i ri do t’u shërbejë më së miri të rinjve që do t’i bashkohen Forcave të Armatosura, sepse do të shërbejnë në një realitet të ri operacional, më të mirëpajisur, më të mirë trajnuar dhe më të mirë edukuar falë asistencës amerikane.

Natyrisht ky transformim nuk mund të shihet i shkëputur nga zhvillimet dinamike dhe shumëplanëshe që shoqërojnë realitetin rreth nesh, stadin shoqëror, dimensionin e vendit tonë si një spirancë stabiliteti në hapësirën e Europës Adriatike, si një vend që ka nisur negociatat e anëtarësimit në BE, në linjëzim të plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së<sup>8</sup>, duke synuar një konsolidim të vazhdueshëm ekonomiko-shoqëror. Sfidat komplekse me të cilat përballlet rajoni ynë dhe më gjerë, imponojnë adoptimin e një qasjeje fleksible në përgjigjen ndaj tyre.

<sup>7</sup> Vizioni i shefit të Shtabit të Përgjithshëm për periudhën 2022-2025.

<sup>8</sup> <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/negociatat-e-anetaresimit/kapitujt-e-acquis/kapitulli-31-politika-e-jashtme-e-sigurise-dhe-e-mbrojtjes/>



Një komponent tepër i rëndësishëm, është formësimi i gjeneratës së re me aftësimin për analizim dhe përgjigje fleksible të institucioneve të sigurisë. Arsimimi dhe kultura e dijes janë një komponent tepër i rëndësishëm në ekonominë e dijes kombëtare, ndaj në këtë kontekst farkëtimi i një gjenerate të re oficerësh të dobishëm, jo vetëm si pjesë e Forcave të Armatosura, por edhe si një vlerë e shtuar në shoqëri, është një domosdoshmëri jetike për vendin. Pavarësisht natyrës së sfidave, përballja me realitetet e reja të mjedisit të sigurisë, nuk është më vetëm domain i Forcave të Armatosura, në kushtet kur duhet të përballemi si komb, si shoqëri, ndaj të qenurit në linjën e parë me më të mirët, i jep një dimension të ri këtij angazhimi.

Në themel të sistemit tonë të arsimit ushtarak<sup>9</sup>, është formësimi i një trupe drejtuesish të adaptueshëm dhe të aftë, që të mendojnë në mënyrë kritike si drejtues të cilët kanë vlerat e duhura, atributet dhe aftësitë për të kryer ashtu siç duhet detyrat e tyre. Kjo gjeneratë e re drejtuesish duhet të gëzojë njohuritë e duhura të operimit të Forcat e Armatosura, si dhe ndërveprimit në aktivitetet shumëpalëshe me aleatët dhe partnerët tane ushtarakë. Duke pasur njohuritë specifike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ata do të dinë të absorbojnë shpejt dinamikat e operimit në një mjedis sigurie shumë kompleks, shpesh të dyshimtë dhe shumë shpejt të ndryshueshëm. Si vend anëtar i NATO-s, këta drejtues duhet të dinë të ndërtojnë ekipe efektive, plotësisht të aftë të mbështesin operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mesin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të shpejtë dhe të vazhdueshëm, por duke ditur të vendosin në balancë dhe ndjeshmëritë specifike të vende anëtare të aleancës.

Në kontekstin e realitetit të ri në Europë prej agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, veprimtaria e Forcave të Armatosura është rivendosur në fokusin kryesor të të gjitha shoqërive europiane, por zhvillimet dinamike në fushën e zhvillimit ushtarak, nuk mund të shihen të shkëputura nga arsimimi ushtarak. Shumë prej vendeve anëtare të NATO-s dhe BE-së, përveç ndihmës në teknikë luftarake dhe asete financiare, kanë ofruar si komponentë të rëndësishëm, trajnimet dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit të Forcave të Armatosura të Ukrainës, në përballjen me agresionin ushtarak rus. Ky element ka rinxjerrë në pah rëndësinë e vijimit të proceseve edukuese në fushën e arsimit ushtarak, edhe në kohë lufte si një komponent i rëndësishëm, i cili duhet të vijojë në mënyrë lineare, pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhet vendi.

Në kuadër të investimit në arsimim dhe trajnim, Shtetet e Bashkuara kanë trajnuar tashmë më shumë se 3.100 trupa ukrainase, për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të caktuara të armëve, duke përfshirë obusë, automjete të blinduara dhe sistemin raketor të artillerisë me lëvizshmëri të lartë

<sup>9</sup><https://www.mod.gov.al/images/akteligjore/rekrutimenaxhimpersoneli/2021/urdher-765-080621-politikat-arsimimit.pdf>

(HIMARS)<sup>10</sup>. Aleatët e tjerë perëndimorë po kryejnë gjithashtu trajnime për armët që ata ofrojnë. Në nëntor 2022, BE-ja nisi zyrtarisht një mision trajnimi për trupat ukrainase të quajtur “Misioni i Ndhmës së Bashkimit European në Ukrainë” (EUMAM Ukraine), duke përbërë misionin më të madh të trajnimit ushtarak që BE-ja ka nisur ndonjëherë. Ai synon të trajtojë fillimisht 15.000 trupa ukrainase në fushën e betejës. Misioni fillimisht është projektuar për dy vjet dhe pritet të arrijë vlerën e rreth 60 milionë eurove (62.2 milion dollarë) në vit<sup>11</sup>.

## PËRFUNDIME

Misioni ynë si Akademi është zhvillimi i forcës së brendshme të secili kadet, individualisht, natyrisht me ndihmesën e teknologjisë dhe mjetet e tjera si instrumente plotësuese, në një proces të pandalshëm dhe bashkudhëtar në karrierën ushtarake.

Arsimimi ushtarak mbetet një sfidë e përhershme e zhvillimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura e njëherazi, ai përbën një zgjedhje të qëndrueshme dhe të sigurtë, për gjithë të rinjtë që e përqafojnë atë.

Arsimimi ushtarak është një faktor thelbësor dhe me efekt në sigurinë kombëtare. Në këtë kontekst, përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave dhe programeve të studimit, mbetet në qendër të veprimtarisë së stafit akademik.

Kërkimi shkencor dhe inovacioni përbëjnë komponentin e dytë të rëndësishëm për të gjithë personelin akademik kërkimor dhe shkencor, jo vetëm si një nevojë e kohës, por edhe si një vlerë e shtuar e dijës në fushën e mbrojtjes.

Bashkëpunimi me akademitë partnere, por edhe me institucionet e arsimit të lartë brenda vendit, do të vijojë të jetë prioritet në shkëmbimin e përvojës, por edhe në zhvillimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta.

## Burime të shfrytëzuara

1. <https://www.tradoc.mil.al/rreth-kds/vizioni-misioni>
2. <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-156-dt.-19.2.2020-AFA.pdf>
3. <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/behavioral-sciences-and-leadership>
4. <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/social-sciences/international-affairs>
5. <https://www.westpoint.edu/academics/academic-departments/social-sciences>

<sup>10</sup> <https://www.europalire.org/a/lufta-ne-ukraine-trajnimet-shba-/32225603.html>

<sup>11</sup> <https://www.botasot.info/europe-bota/1903237/be-nis-ndihmen-ushtarake-per-ukrainen-dhe-rimbushjen-e-rezervave-te-armeve/>

6. <https://www.tradoc.mil.al/lajme/550-nje-ekip-nga-akademia-ushtarake-e-west-point-shba-zhvilloi-nje-vizite-pune-ne-akademie-e-forcave-te-armatosura>
7. Vizioni i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për periudhën 2022-2025
8. <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/negociatat-e-anetaresimit/kapitujt-e-acquis/kapitulli-31-politika-e-jashtme-e-sigurise-dhe-e-mbrojtjes/>
9. <https://www.mod.gov.al/images/akteligjore/rekrutimenaxhimpersoneli/2021/urdher-765-080621-politikat-arsimimit.pdf>
10. <https://www.europaelire.org/a/lufta-ne-ukraine-trajnimet-shba-/32225603.html>
11. <https://www.botasot.info/europe-bota/1903237/be-nis-ndihmen-ushtarake-per-ukrainen-dhe-rimbushjen-e-rezervave-të-armëve/>



# ARSIMIMI NË FUSHËN E SIGURISË, ECURIA DHE SFIDAT

**Prof. Dr. Kristaq XHARO**

Lektor për Çështjet e Sigurisë në Universitetin  
European të Tiranës

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Koncepti dhe mjedisi i sigurisë janë në evolucion të vazhdueshëm, të vrullshëm e më të ndërlikuar. Skenarët ndryshojnë vazhdimisht dhe bashkë me ta, procesi bëhet gjithnjë e më kompleks. Mënyra më efektive për t'iu përgjigjur skenarëve, është të përgatitesh për ndryshimin.*

*Në përfundim, institucione mendimi si universitete, akademi, kolegje, institute, e të tjera, angazhohen të njohin, të studiojnë, shpjegojnë dhe të paraprijnë zhvillimet në fushën e sigurisë: duke ofruar studime, analiza dhe rekomandime shkencore për dinamikën e zhvillimeve në këtë fushë.*

*Për të operuar me të njëjtin standard me partnerët, por edhe për të harmonizuar mënyrën e veprimit në nivel kombëtar, e vetmja rrugë për të përballuar sfidat shumëplanëshe në fushën e sigurisë mbetet arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi me programe bashkëkohore.*

*Për këto çështje, institucionet akademike kanë rol parësor jo vetëm në vetë angazhimin, por edhe në përafrimin e aktorëve të tjerë dhe krijimin e një mjedisi dhe klime të ngrohtë, bashkëpunuese dhe intelektuale, duke tërhequr debatin në auditor për këto çështje.*

## PËRMASAT E SIGURISË DHE KONCEPTIMI I SAJ

Kohë më parë, Tomas Hobbes shkruante: *“Pa siguri nuk ka vend për industri...për art, për letërsi, për shoqëri dhe çfarë është më e tmerrshme, pa siguri reflektohet një ankth i pandërprerë, shoqëruar me rrezik të dhunshëm për jetën, vetmi, varfëri, mizerje, brutalitet dhe pamjaftueshmëri...”*<sup>1</sup>.

Siguria është substance e jetës njerëzore. Të jesh i sigurtë, do të thotë të jesh i pa shqetësuar nga rreziqet apo frika. Ekonomia dhe siguria vazhdojnë të dominojnë zhvillimin e shoqërisë në çdo kohë dhe në çdo sistem. Nga ky ndikim nuk ka “shpëtuar” as epoka jonë.

Siguria vazhdon të mbetet një nga dilemat më të mëdha të shoqërisë. Globi nuk fitoi më shumë siguri edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, kohë kur pritej nga të gjithë të besonin për një epokë paqësore. Që nga viti 1989, sipas UCDP (Uppsala Conflict Data Program), një nga forumet më prestigjioze në çështjet e sigurisë, janë regjistruar 144 konflikte të armatosura në mbi 80 rajone, ku jo më pak se 47 prej tyre, për nga shkalla e angazhimit dhe pasojave, vlerësohen në përmasat e luftërave. Vetëm në 10 vitet e fundit numri i konflikteve aktive është rritur nga 31 në 37, ndërsa janë realizuar vetëm 6 marrëveshje për ndërprerje konflikti. Dukuria tjetër lidhet me pasojat, veçanërisht numri i viktimave të konflikteve të armatosura, që nga viti 1989 i kaluar të 6 milionë persona. Nga këta, mbi 90% janë civilë dhe 3 në 4 të vrarë, janë fëmijë dhe gra. Jo më pak se 50 milionë vlerësohet nga UNDP numri i refugjatëve që janë zhvendosur nga zonat e konfliktit<sup>2</sup>.

Me fundin e Luftës së Ftohtë dhe zhvillimet drastike që e pasuan atë në lëmin politik, ekonomik dhe kulturor, u kuptua se përqafimi i një këndvështrimi të ngushtë mbi sigurinë, i parë kryesisht si një rrezik ushtarak që vinte nga jashtë, nuk ishte i mjaftueshëm.

Përqendrimi tek aspekti ushtarak kishte lënë mënjanë çështje që kishin të bënin me ekonominë, politikat identitare, nacionalizmin, shtetet e dobëta apo të dështuara, konfliktet etnike, e të tjera, edhe pse mjaft nga konfliktet dhe krizat të cilat dominuan ambientin ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, buronin nga problemet në fushat e theksuara më sipër. Holsti mbështet idenë se *lufta brenda shtetit* është kthyer sot në normën e re, ndërsa *ajo ndërshtetërore*, në plotësuese. Ndryshimet në natyrën e luftës dhe ambientin politik ndërkombëtar, i nxitën studiuesit të zgjeronin gamën e rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pavarësisht nga sa më sipër, më tepër se gjithçka, ajo që ndryshoi perceptimin

<sup>1</sup> Thomas Hobbes, (1640), *Elements of Law, Natural and Politic*.

<sup>2</sup> <https://www.undp.org> › UNDP Crisis Offer 2022.

e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare të kohës që jetojmë, por edhe asaj çfarë pritet në një të ardhme jo të afërt, janë ngjarjet në Ukrainë. Edhe pse përpara luftës në Ukrainë, dukeshin si “të ngrirë” konfliktet ndërshtetërore, kjo pak e kishte përmirësuar nivelin e sigurisë. Konflikte me frymëzues aktorë jo-shtetërorë, që nisen nga nivele periferike e nacionale, po mbartnin kapacitete për të vënë në rrezik sigurinë rajonale dhe më gjerë. Në mjedisin aktual të e sigurisë, mjafton të veçojmë qoftë edhe tre zhvillime, në përmbajtje dhe në shtrirje në përmasat e krizave, që kanë pështjelluar thellësisht komunitetin ndërkombëtar, ku ato në përmasat e krizave rajonale, nuk kanë lënë në periferi as vendin tonë.

Ngjarjet në Ukrainë, jo vetëm për nga distanca, jo më larg se 1300 km, por edhe nga konteksti i brendisë dhe i formatit, e më parë konflikti në Siri- Irak, vetëm 1000 km, na ka afruar shumë pranë krizave rajonale me pasoja të drejtpërdrejta. Në përmasat gjeografike, por tashmë edhe gjeopolitike, këto zhvillime “mbërthejnë” edhe vendin tonë në zonat e krizave.

*Në vlerësim gjeopolitik, mjedisi ynë i sigurisë ndikohet drejtpërdrejt nga këto zhvillime në nivel të mjaftueshëm për të reflektuar.*

## **ZHVILLIMI I KONCEPTIT TË SIGURISË, NEVOJË PËR REFLEKTIM**

Shkencat politike ende vazhdojnë të debatojnë për një përkufizim përfundimtar dhe gjithëpërfshirës të fjalës “siguri”, ndonëse kjo fjalë e përmendur gjithnjë e më shumë qysh prej viteve ‘60-të, nënkuptonte më së shumti karakterin e një sigurie të brendshme. Vështirësia qëndron në faktin që siguria është shndërruar në një “term catch-all” i botës moderne.<sup>3</sup> Kësisoj mund të thuhet se ky term tashmë ka hyrë në çdo fushë dhe si pasojë është e vështirë, të jepet një përkufizim gjithëpërfshirës. Po ashtu edhe në aspektin e politikës ndërkombëtare, termi siguri është i diskutueshëm.

Me të nënkuptohet vendosja e prioriteteve në synimet politike dhe zgjedhja e mjeteve, me të cilat duhet të arrihen këto synime.<sup>4</sup>

Studimet akademike për çështjet e sigurisë kombëtare duket se i kanë fillimet e tyre në vitet ‘40-të dhe sigurisht Lufta e Dytë Botërore dhe një ndikim nxitës në këtë drejtim. Siç ka shkruar studiuesi Uilliam Fox, në punimin e tij të hershëm, në këtë fushë, në mes të viteve ‘50-të, *“Ishte e pritshme që 15 vitet e luftës botërore, por edhe të tensionit të pasluftës, me probleme të sigurisë kombëtare në qendër të interesit publik dhe qeveritar, do të kishin ndikim dhe*

<sup>3</sup> Daase, Christopher (2020), Internationale Risikopolitik. In: Daase, Christopher / Feske, Susanne / Peters, Ingo (Hg.), Internationale Risikopolitik.

<sup>4</sup> Po aty.

*do të linin gjurmë dominante në aktivitetet kërkimore e shkencore...’’<sup>5</sup>.*

Madje David Balduin, profesor nga universiteti John Hopkins, shkon aq larg, sa i përshkruan këto vite të hershme si...*“Periudhën më emocionuese dhe krijuese në tërë historinë e studimeve të sigurisë...”*<sup>6</sup>, periudhë e cila shënoi edhe krijimin e shkollave të reja me fokus në sigurinë kombëtare. Për shkak se studimet e sigurisë nuk u konceptuan si një disiplinë e veçantë akademike në atë kohë, reflektoi në aludimin edhe nga një numër studiuesish, se ajo nuk arriti të shfaqej direkt si një disiplinë me kufij të përcaktuar qartë. Kështu, ndoshta ajo për një kohë relativisht të gjatë, u ndesh më shumë se çdo disiplinë tjetër me “ndërthurje”, por edhe “ndërhyrje” në disiplinat e tjera të shkencave politike, diplomatike, ushtarake e sociale.

Në të njëjtën kohë, një axhendë akute e dilemës së sigurisë, e cila më parë kishte dërguar spiralen e botës në dy konflikte katastrofike, motivoi një dëshirë për të njohur dhe zhvilluar kërkimet në aspektet e sigurisë kombëtare dhe globale. Si pjesë e kësaj përpjekjeje, integrimit të forcave të armatosura me teknika jo vetëm ushtarake, por të ndërthurura me ato që përmendëm më lart, iu kushtua një vëmendje e veçantë. Paralel me këto zhvillime, ndoshta dhe në mënyrë të ngjashme, u bënë përpjekje intelektuale për të shqyrtuar çështjet e sigurisë edhe më thellë sesa ato ushtarake, por edhe në objektiva të tjera kombëtare, të tilla si mirëqenia ekonomike dhe liria individuale<sup>7</sup>.

Në ditët tona, në këtë kuadër, koncepti i sigurisë evoluon dhe pasurohet aq shpejt, sa që ndryshon dhe shkurton ciklet e hartimit të derivateve që lidhen me të si strategjitë, doktrinën, standardet, politikat apo dokumenteve të tjera, të cilat afrohen për të menaxhuar e parashikuar zhvillimet në procesin e sigurisë. Dihet që vendi ynë, ka parametra modeste të fuqisë për të ndikuar, apo për të qenë faktor i rëndësishëm në çështje të sigurisë rajonale dhe globale, duke filluar që nga parametrat ushtarakë; ekonomikë; socialë, etj. Edhe pse duke mos mundur të jetë aktiv i angazhuar në zonat e krizave, ai mund të vazhdojë të jetë tërësisht vulnerabel ndaj efekteve direkt, apo rrjedhøjave të mëvonshme të këtyre zhvillimeve.

Mjafton të kalojmë tangent nëpër tre momente që thajse kanë risjellë në vëmendje nevojën për rishikim të konceptit të sigurisë si në konceptimin teorik, ashtu edhe në kontekstin real të zhvillimit të ngjarjeve. Së pari konflikti në Ukrainë, i cili mbetet në dinamikën e tij më të vrullshme, si një konflikt i armatosur midis shteteve.

<sup>5</sup> William T.R. Fox, “Civil-Military Relations Research: The SSRC Committee and Its Research Survey”, vol.6, no.2, January 1954, p.279.

<sup>6</sup> Balduin D. David A. Baldwin (1995) Security Studies And The End Of The Cold War; World Politics 48 (October 1995), 117-141.

<sup>7</sup> For further reading see Fox, ‘Civil-Military Relations Research’, pp.278–88.



Së dyti, konflikti në Lindjen e Mesme me famëkeqin ISIS, si një konflikt sa i brendshëm, sa fetar, po aq edhe civil, që u zgjerua edhe në fronte tradicionale të luftës në fronte, e së treti krizën e refugjatëve që tashmë ka marrë forma rrjedhëse, të cilat i kalojnë ato të shteteve apo rajonit.

Të tre këto zhvillime gjenden brenda kontekstit të sigurisë dhe mjaftojnë, për të kuptuar përmasat që ka marrë jo vetëm konteksti, por edhe vetë koncepti i sigurisë. Doemos së bashku me të, edhe nevoja e vëzhgimit, analizës dhe trajtimit në kushte të reja të të gjithë kurrikulës së studimit e konceptimit të sigurisë.

Një ditë të ‘bukur’, pa asnjë argument logjik, Rusia sulmoi Ukrainën, duke derdhur gjithë arsenalin konvencional. Dhe si një përplasje e përgjakshme, lufta krijoi fronte. Në frontin e parë gjenden një ushtri agresive ruse dhe një shtet në mbrojtje, me forcat e armatosura, territoriale, civile e vullnetare, me gra, fëmijë, e të moshuar. Në thellësi, një Rusi tjetër, ku qeveria fsheh çdo informacion nga lufta dhe propaganda zyrtare nxit urrejtje, por që nuk arrijnë të krijojnë front.

Më në thellësi në një front sa moral edhe inkurajues, e gjithë bota e qytetëruar, në krah të një Ukraine martire. Ukraina tashmë është kthyer në ndërgjegjen e botës së civilizuar. SHBA, NATO dhe Europa, por edhe mbarë komuniteti ndërkombëtar, po e konsiderojnë Ukrainën si simbol për vlerat më të larta humane. Është inkurajues fakti, që Shqipëria dhe Kosova gjenden të vendosura në këtë front dhe në mënyrë dinamike po tregojnë vlera modeste por serioze, me kontribut të spikatur në linjën e angazhimit të NATO-s, dhe komunitetin europian, duke u gjendur në anën e duhur të historisë.

## **VLERËSIMI I SKENARIT UKRAINAS**

Vlerësohet nga shumica e studiuesve të huaj, si një skenar nga më të mundshmit për të ardhmen, që do të mund të jetë rrezik potencial për sigurinë, veçanërisht në shtetet e vogla dhe të brishta. Nuk paraqet çudi fakti që në shumicën e analizave në perëndim, përfshirë edhe ato të shërbimeve inteligjente, vendet e Ballkanit, për më tepër të Ballkanit Perëndimor, klasifikohen si “shtete të vegjël, por edhe të brishtë”. Vendi ynë nuk përjashtohet nga ky klasifikim.

Skenari ukrainas, në çdo kohë mund të lulëzojë në secilin prej këtyre vendeve, të cilëve historia u ka lënë edhe pakica kombëtare, ndasi fetare, diferenca sociale e kulturore, etj.

Skenari në Ukrainë, nuk munda të zgjidhej për një kohë të shkurtër. Ai vazhdon të jetë i sfiduar në kërkim të një zgjidhjeje, e cila nuk duket të jetë e shpejtë. Ukraina, tashmë, po përdoret si një “case study”, ku angazhohen jo vetëm organizatat më të fuqishme ndërkombëtare, politika botërore, por

edhe mendjet më të shquara në çështjet e sigurisë, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare (Kisinger).

Ka ardhur koha që koncepti i sigurisë të evoluojë bazuar edhe mbi këtë skenar, duke reflektuar jo vetëm thjesht për shkak të afërsisë gjeografike, sesa për arsye të përmbajtjes.

Në një ambient politik anarkik ndërkombëtar, raporti midis mjedisit të jashtëm e të brendshëm ishte paracaktuar thelbësisht.

Nga njëra anë për të balancuar pushtete të fuqishme në sistemin ndërkombëtar, e nga ana tjetër për të alokuar burime shtesë për sigurinë kombëtare<sup>8</sup>.

Pak më parë edhe për ngjarjet në konfliktin që sapo lamë pas, atë të ISIS, direkt apo indirekt ne ishim në kontekstin e krizës në Irak e Siri. Ndërkohë, ajo që mund dhe duhej të ishte kontributi ynë më i madh, e që varej nga ne, është fakti që në atë situatë nuk arritëm të kufizonim apo ndalonim (edhe fizikisht) ata dhjetëra e qindra bashkëkombës “vullnetarë” “foreign fighters”, që nga vendi, trojet apo emigrimi, t’u bashkohen ekstremistëve të ISIS.

Aktualisht ka pak analiza të plota apo prognoza, si, dhe përse, “vullnetarët” shqiptarë iu bashkuan ISIS. Masat e ndërmarra ligjore duken pozitive, por ato janë “muri” i fundit i llojit refleksiv dhe jo pro-aktiv. Si të tilla ato janë e do të mbeten detyruesisht të pamjaftueshme dhe kryesisht për të kufizuar pasojat.

Në këtë situatë, edhe nëse formacionet e ISIS u shpartalluan, kjo nuk duket se mbyll menjëherë efektin e pasojave të fenomenit ISIS, qoftë edhe në vendin tonë. Problematika do të vazhdojë të ndikojë direkt ose jo. në mjedisin e sigurisë sonë të brendshme. Kjo imponon që koncepti i sigurisë dhe studimet që lidhen me të, do duhet të evoluojnë, të njohin e pranojnë në këtë kontekst, në gjerësi dhe në përmbajtje.

Kriza e refugjatëve nga trojet shqiptare duket se trokiti në dyert e Europës pak më parë sesa kriza që sot konsiderohet tronditëse. Mbi 30 mijë shqiptarë morën rrugën e emigrimit brenda një periudhe të shkurtër duke iu shtuar gati mbi 30% të gjithë popullsisë, që ishte larguar më parë. Janë alarmante faktet, që konfirmojnë uljen e numrit të popullsisë: në 2011 ky numër ishte 7.7% më e vogël se në 2001, ose me 230 mijë persona më pak. Nëse vazhdon ky trend, do të jemi në nivelin e kërcënimit të sigurisë kombëtare, kur popullsia e vendit tonë pas 10-15 vjetësh do të jetë sa 50% e asaj të viti 1990. Në situata të tilla, çdo vend në përfundim të lindje, do të vlerësohte si një nga rreziqet më potenciale të sigurisë kombëtare dhe në mënyrë urgjente do të hartojnë strategji për të shmangur rrezikun ndaj këtij elementi të fuqisë kombëtare.

---

<sup>8</sup> Kenneth Waltz, *Theory of International Politics*, (New York: Random House, 1979)

Pati një debat pas dhe për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, por ai çuditërisht u fokusua vetëm si shqetësim i disa komuniteteve fetare dhe disa të vetëquajtura pakica minoritare, për reduktimin e numrit të tyre. Faktet që u përmendën më sipër, janë kambana për fuqinë, detyrimisht edhe sigurinë kombëtare dhe rishikimin e konceptit të sigurisë në një mjedis të ri.

## **PËRVOJA JONË STUDIMORE NË FUSHËN E SIGURISË**

Deri pak kohë më parë i vetmi institucion akademik që kish për objekt studimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, ishte Akademia e Mbrojtjes. Ky institucion përfaqësonte në të njëjtën kohë institucionin më të respektuar e më të lartë arsimor në strukturat e sigurisë. Që prej fundviteve 1970, në bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave<sup>9</sup>, në këtë Akademi filluan kualifikimet pasuniversitare, të cilat fokusoheshin kryesisht në studime kërkimore në fushën e mbrojtjes. Kujtojmë gjithashtu se kandidatë nga struktura të tjera, si nga Policia e shtetit, Garda, Shërbimi Informativ deri edhe nga Ministria e Jashtme ndiqnin kurse kualifikimi në këtë institucion. Kjo periudhë korrespondon me kohën kur edhe në vende të tjera (perëndim apo lindje) studimet e mbrojtjes identifikoheshin me studimet e sigurisë. Akademia e Mbrojtjes kishte njëkohësisht edhe atributin në dhënien e titujve dhe gradave shkencore.

Pas viteve '90-të u zhvillua prirja për të futur në objektin e studimeve një spektër më të gjerë sesa fusha e mbrojtjes. Bëhej fjalë për studimet e sigurisë. Bashkëpunimi me institucione të ngjashme në perëndim, kryesisht gjermane dhe amerikane, synuan t'i jepnin institucioneve akademike natyrën dhe përmbajtjen e këtyre vendeve, që ishin në pararojë të mendimit teorik.

Në vitet 2000, u poqën kushtet për programe dhe kurrikula të vendeve perëndimore, ndikuar edhe nga objektivat e integritetit të vendit në Aleancën veri-atlantike. Kjo çoi në sanksionimin edhe ligjërisht të zgjerimit të fushës së studimit, nga fusha e mbrojtjes, në atë të sigurisë dhe mbrojtjes. Ky ishte njëkohësisht hopi cilësor në vend, që jo vetëm aplikoheshin studimet në këtë fushë, por edhe afroheshin në një cikël akademik, me gjithë kontekstin e vet. Deri në vitin 2011, në këtë institucion u mbrojtën punime nga Fusha e Sigurisë, që zinin 12.03% në vlerën totale të temave të ciklit të tretë dhe doktoraturave, të mbrojtura në këtë Akademi qysh në vitin 1982 (131 doktoratura), kur u mbrojt edhe doktoratura e parë në këtë institucion.<sup>10</sup>

Vala tjetër e evoluimit në fushën e studimeve të sigurisë dhe mbrojtjes vlerësohet rreth vitit 2010. E përfshirë, përsëri, në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në këtë Akademi rifilloi procesi i arsimimit në ciklin

<sup>9</sup> Agron Agolli: Kualifikimi shkencor në Forcat e Armatosura 1974-2012, Tiranë 2012, f. 10.

<sup>10</sup> Po aty, f. 14.

e dytë dhe të tretë të studimeve në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Të diplomuarit e këtij programi u pajisën me një paketë konceptesh teorike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe dimensionet e sigurisë kombëtare, rajonale, europiane dhe globale, mbi gjeopolitikën, mbi marrëdhëniet me publikun, me institucionet ndërkombëtare, etj.

Këto koncepte synojnë që të ndikojnë drejtpërsëdrejti në krijimin e specialistëve të aftë në institucionet e sigurisë kombëtare, apo si ekspertë pranë autoriteteve publike, që operojnë në sferën e sigurisë kombëtare, madje edhe në organizmat ndërkombëtare të profilit (OKB, NATO, BE etj).

Më tej, një pjesë e të diplomuarve, supozohej se duhej të formonte edhe elitën e studiuesve, pedagogëve dhe analistëve të ardhshëm për problemet e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Eksperienca e mëparshme 40-vjeçare dhe bashkëpunimi me institucione të ngjashme perëndimore, shërbeu si garanci për suksesin e objektivave në këtë fushë. Por, pavarësisht nga sa më sipër, procesi u ndërpre, duke krijuar kështu një vakuum në këto studime.

Ndërprerja e studimeve në Akademi e këtij programi, bëri që një numër i konsiderueshëm i stafit pedagogjik të kualifikuar të orientohej drejt ofertës, çka mund të llogaritet në një investim të humbur të strukturave të sigurisë, si në pikëpamje financiare, ashtu edhe në atë profesionale. Ndoshta një bashkërendim i këtij institucioni me institucionet e tjera arsimore universitare (publike apo jo publike), që lëvrojnë fushën e studimeve të sigurisë, mund të krijojë më tepër mundësi për të siguruar koherencën dhe vijueshmërinë e studimeve në këtë fushë, por edhe krijimin e një axhende dinamike të studimeve të sigurisë.

Doemos që, në kuadër të liberalizimit të procesit arsimor, u afruan një numër institucionesh të tjera arsimore jopublike, të cilat tentojnë të mbulojnë studimet në këtë fushë. Megjithatë, në periudhën aktuale këto institucione janë të limituara, për shkak të specifikave, stafit dhe interesit.

## NEVOJA PËR NJË PLAN ECURIE NË STUDIMET E SIGURISË

Aktualisht, interesi i studimeve në çështje të sigurisë ka filluar të rigjallërohet. Është koha kur “globalizimi” po zëvendëson “ndërvarësinë ...si një *kuiz* i ri midis studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare”.<sup>11</sup> Në harmoni me këtë, studiuesit e sigurisë ndodhen në mes të debatit për përballje ndaj kërcënime të shumëllojshme mjaft të larmishme dhe që ndryshojnë vazhdimisht. Robert Kaplan, në esenë e famshme “Coming Anarchy”, parashikon se me shfaqjen e

<sup>11</sup> Robert O. Keohane and Joseph S. Nye Jr., ‘Globalization: What’s New? What’s Not? (And So What?)’, *Foreign Policy*, Issue 118, Spring 2000, pp.104–119.

kësaj larmie , autoriteti formal po vihet në dilemë...<sup>12</sup>.

Koncepti dhe mjedisi i sigurisë janë në evolucion të vazhdueshëm, të vrullshëm dhe të pandërprerë. Skenarët ndryshojnë vazhdimisht dhe procesi i sigurisë shfaqet përherë e më i vështirë.

Mënyra më efektive për të parashikuar të mundshmen është të përgatitesh për ndryshimin.

Forumet akademike janë në frontin e analizave, vlerësimeve dhe mundësive të zgjidhjes.

Në përfundim, institucione të shquara intelektuale: universitete, akademi, kolegje dhe institute, angazhohen t'i studiojnë, shpjegojnë dhe t'u paraprijnë zhvillimeve në fushën e sigurisë. Ato u ofrojnë institucioneve vendimmarrëse (me porosi ose dhe në mënyrë të pavarur), analiza dhe rekomandime shkencore për dinamikën e zhvillimeve.

Ashtu si koncepti, edhe studimet e sigurisë kanë ardhur duke u zgjeruar e thelluar dhe sot ato mbulojnë terriore të çështjeve të pleksura, në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë, me impakte në mbijetesën e komunitetit. Ato variojnë nga konceptet tradicionale, që lidheshin kryesisht me sovranitetin dhe elementë të fuqisë ushtarake, e që zhvillohen më tej në shkaqet dhe pasojat e konflikteve *në* dhe *midis* shteteve. Studimet merren me kapacitetet ekonomike, konfliktet etnike, religjioze dhe ideologjike, me burimet energjetike, shkencore dhe teknologjike.

Ato vazhdojnë me kërcënimet e sigurisë njerëzore dhe stabilitetin e shteteve nga degradimi politik dhe mjedisor, sëmundjet infektive, ndryshimet klimaterike, e deri në aktivitetin e aktorëve jo-shtetërorë. Demonstrimi më tipik i evoluimit të konceptit të sigurisë, është Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, miratuar në Samitin e Madridit në 2022, ku vizioni bazë i aleancës lidhet me parandalimin dhe “human security”<sup>13</sup>.

Aktualisht studimet e sigurisë, siç e përmendëm edhe më lart, në vendin tonë janë në një periudhë ku ndeshen me shembuj, por edhe dilema të ndryshme. Sikur të mos mjaftonte kjo, ende ka një distancë midis institucioneve akademike dhe vendimmarrëse. Analizat dhe ndërtimi i programeve ndodhen përballë vështirësive të rindërtimit mbi një mjedis të ri gjeopolitik, qoftë edhe për shkak të zhvillimeve që cituam më lart ku kërkohet të angazhohet vendi ynë, vetë apo në aleancë, në nivel rajonal e më gjerë. Studimet e punimet akademike të sigurisë, kërkohet të bëhen përherë e më aktuale. Aktualisht

<sup>12</sup> Robert D. Kaplan, ‘The Coming Anarchy’, *The Atlantic Monthly*, vol.273, issue 2, February 1994, p.44-76..

<sup>13</sup> Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s 2022 <https://www.nato.int/strategic-concept/>

institucionet akademike me vështirësi po kapërcejnë thatësinë që u krijua për dy dekada në përgatitjen e specialistëve të fushave të sigurisë.

Për një kohë, kur mungoi strategjia apo vizioni perspektiv mbi bazë kombëtare për përgatitjen e këtyre kontingjenteve, ky hendek u kërkua të mbushej me kontributet e veçanta të ndihmave që dhanë aleatët perëndimorë në fushën e sigurisë.

Qendra Marshall dhe disa nga kolegjet e famshme në SHBA, Gjermani, Turqi dhe vendet e tjera të NATO-s, u bënë kontribuuesit kryesorë përgjatë më shumë se 20 viteve, për të minimizuar boshllëkun. Nëpërmjet programeve trajnuese dhe kualifikuese në institucionet perëndimore, u investua në burime intelektuale, të cilat mund të shërbenin në një të ardhme për të krijuar bazamentin për analiza, studime e vlerësime të mirëfillta në fushën e sigurisë.

Është gjithashtu fakt që mungesa e ideve, vizionit, vëmendjes apo interesit për këto investime, nuk arritën të vlerësoheshin, por u tjetërsuan dhe shpesh u humbën në amullinë e përgjithshme.

... Sot, vendi ynë angazhohet në operacione ndërkombëtare të sigurisë, ruajtjes së paqes, menaxhimit të krizave, ruajtjes së mjedisit, fatkeqësive natyrore etj, jo vetëm në kontribute forcash, por edhe në shtabe e organizata ndërkombëtare, të cilët në objektin e tyre kanë studime, vlerësime hartime dhe zbatime planesh e strategjish.

Jo vetëm në këtë drejtim, por specialistë për çështje të sigurisë, janë të kërkuar pothuaj në të gjitha dikasteret e linjës, e deri në institucione qendrore si: qeveri, parlament, presidencë, duke kapërcyer limitet dhe objektivat jo vetëm në Forcat e Armatosura, Forcat e Rendit, apo Shërbimet Inteligjente etj. Në vlerësim statistikor është një numër i konsiderueshëm (disa mijë), i atyre që angazhohen në çështjet e sigurisë. Për të operuar me të njëjtin standard me partnerët, por edhe për të harmonizuar mënyrën e veprimit në nivel kombëtar, e vetmja rrugë për ata që angazhohen në çështjet e sigurisë mbetet arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi, me programe bashkëkohorë.

Institucionet akademike kanë rol parësor jo vetëm me atë që theksuam që në krye të radhës, studime të sigurisë, por edhe në afrimin e një mjedisi dhe klime intelektuale për këto çështje. Është mjaft kuptimplotë ajo çka Freedman-i, artikulon: *“...padyshim që, nëse studimet e sigurisë duhet të ekzistojnë dhe të evoluojnë, ato detyrimisht duhet të jenë të ngulitura në sistemin universitar. -Edhe pse studimet e sigurisë,- vazhdon ai,- bëjnë pjesë në politika relevante dhe teori veprimi, ato para së gjithash duhet të jenë fusha dhe disiplina intelektuale, që duhet dhe do të mund të reflektojnë në performanca shtetërore”*<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Friedman “Next Hundred Years”. Tirana 2010.

Më e vështirë sesa njohja e rreziqeve dhe sfidave të sigurisë, është të përgatitesh për tu përballur. Dhe përballja nuk mund të realizohet me slogane apo me konferenca pompoze, por me programe që zhvillohen në dimension horizontal dhe vertikal.

Ky është kontribut i drejtpërdrejtë në mjedisin e sigurisë, mjedis që duhet të na interesojë të gjithëve. Nuk mund të jemi të sigurtë, kur nuk kuptojmë se si duhet të sigurohemi.

Skenarët dhe sfidat e sigurisë nuk mund ti përballojmë në mënyrë diletante dhe delirante. Parë në këtë këndvështrim, ajo çka paraqitet si sfidë e studimeve të sigurisë për të ardhmen, konsiston më së shumti, *së pari* në pyetjet se, cilat zhvillime relevante në fushën e sigurisë, siç janë pasiguria, rreziqet, kërcënimet etj, do të dominojnë studimet në këtë fushë për të paktën 20 vitet e ardhshme. *Së dyti*, cilat tema dhe fusha studimore do të mbizotërojnë në fushën e sigurisë për dhjetëvjeçarët e ardhshëm dhe *së treti*, cilat perspektiva disiplinore dhe ide, identifikohen përballë studimeve në fushën e sigurisë dhe cilat janë sfidat për të ardhmen e studimeve në këtë fushë.

Megjithatë ekziston optimizmi se fusha e studimeve të sigurisë do të zgjerohet më tej, për të shqyrtuar shumë çështje emergjente. *“...Kërcënimet e bazuara tek emergjencat dhe fatkeqësitë me potencialin për të shkaktuar një shkallë të lartë dëmsh në hapësirë të shkurtër kohe, i janë shtuar “menysë” së zgjidhjeve të mundshme për studiuesit e sigurisë..<sup>15</sup> .*

Studimi i çështjeve të sigurisë do të përshtatet me këto rrethana, për t’u përballur me sfidat e reja.

Në rastin e ndryshimit të mjedisit, qasja më e mirë mendohet se do të jetë analiza dhe studimi rast pas rasti i kërcënimeve dhe afrimi ndaj tyre, sipas tipologjisë dhe gjeografisë së kërcënimit.

Kolegji dhe institucionet akademike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, edhe pse janë aktorët më të rëndësishëm në studimet akademike, tanimë ato nuk janë të vetmit.

Sepse aktorë të tjerë institucionalë apo individualë, publikë apo jo publikë, kanë hyrë në këtë lojë me pretendime.

Kjo siguri që paraqet një sfidë, por po aq është edhe një avantazh për të diskutuar, debatuar dhe afruar, ide të reja në këtë fushë. Por, mbi të gjitha, më shumë se konkurrentë, atdhet ta konsiderojnë njëri-tjetrin, bashkëpunëtorë në një qellim mjaft të rëndësishëm, që është siguria.

---

<sup>15</sup> Christian Enemark, *Disease and Security: Natural Plagues and Biological Weapons in East Asia*, (London: Routledge, 2007), p.1.

## Burime të shfrytëzuara

1. Thomas Hobbs (1640) *Elements of Law, Natural and Politic*
2. <https://www.undp.org> › UNDP Crisis Offer 2022
3. Daase, Christopher (2020), Internationale Risikopolitik. In: Daase, Christopher / Feske, Susanne / Peters, Ingo (Hg.), Internationale Risikopolitik.
4. William T.R. Fox, “Civil-Military Relations Research: The SSRC Committee and Its Research Survey”, vol.6, no.2, January 1954.
5. Balduin D. David A. Baldwin (1995) Security Studies And The End Of The Cold War; World Politics 48 (October 1995).
6. For further reading see Fox, ‘Civil-Military Relations Research’.
7. Kenneth Waltz, *Theory of International Politics*, (New York: Random House, 1979)
8. Agron Agolli, Kualifikimi shkencor në Forcat e Armatosura 1974-2012, Tiranë 2012.
9. Robert O. Keohane and Joseph S. Nye Jr., ‘Globalization: What’s New? What’s Not? (And So What?)’, *Foreign Policy*, Issue 118, Spring 2000.
10. Robert D. Kaplan, ‘The Coming Anarchy’, *The Atlantic Monthly*, vol.273, issue 2, February 1994.
11. Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s 2022, <https://www.nato.int/strategic-concept/>
12. Friedman “Next Hundred Years”. Tirana 2010
13. Christian Enemark, *Disease and Security: Natural Plagues and Biological Weapons in East Asia*, (London: Routledge, 2007).



## RUBRIKA E DYTË

### Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimet inovative

Profesor Doktor Ethem Ruka, Rektor i Universitetit “Luarasi”, vjen në faqet e kësaj Reviste me punimin me titull *“Roli i teknologjisë së informacionit në shoqërinë moderne”*. Profesor Ruka, me horizontin që ka, nënvizon disa anë të kësaj çështjeje:

...”Inteligjenca artificiale është pjellë e inteligjencës njerëzore dhe synon të simulojë atë biologjike. Një makinë inteligjente duhet të kuptojë, arsyetojë, perceptojë, dialogojë, të përshtatet e të nxejë dije, ashtu si edhe truri i kafshëve dhe njeriut. Në fund të fundit, inteligjenca artificiale është një simulim i sjelljeve të njeriut nga pajisjet kompjuterike, madje duhet të zgjidhë disa probleme më mirë nga ç’mund t’i zgjidhë vetë njeriu.

Sot, megjithëse kemi mbërritur në kohën e revolucionit digjital, rëndësia e fjalës dhe shkrimit nuk humbën asnjëherë. Shkrimi nuk e zëvendësoi asnjëherë fjalën e artikuluar dhe as teknologjia kompjuterike nuk ka për ta zëvendësuar as fjalën e folur dhe as atë të shkruar. Nëse mënyrat e komunikimit ndryshojnë, thelbi mbetet gjithmonë i njëjtë. Këto *tri forma* komunikimi mbeten edhe sot tërësisht komplementare të njëra-tjetrës.

Profesori analizon përparësitë dhe anët negative të teknologjisë së informacionit në funksionimin e strukturave shtetërore ose private. Ai vazhdon më poshtë me nëntitullin *“Sulmet dhe mbrojtja kibernetike”*.

Prej teknologjisë së informacionit, kanë përfituar të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore duke filluar nga ekonomia, biznesi, industria, sistemi bankar, edukimi, mjedisi, transporti, media, komunikimi, agjencitë e monitorimit të ligjit, çështjet sociale, shërbimet inteligjente, mbrojtja e gjithçka tjetër.

Përvoja e deritanishme ka treguar se kjo teknologji ka pikat e saj të dobëta të cilat bëhen pre e hakerimit.

Në bazë të sulmeve kibernetike qëndrojnë motive nga më të ndryshmet, duke filluar nga ato personale, e deri në sulmet e një shteti, ndaj një shteti tjetër.

Mbrojtja kibernetike kërkon përpjekje në nivel kombëtar, por edhe bashkëpunim më të gjerë ndërkombëtar”, përfundon Profesor Ruka.....

Punimi i dytë në këtë Rubrikë vjen nga Kolonel Ulsi Rexhaj, drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak, me titull *“Inovacioni dhe projekti inovativ, kërkesë e kohës”*. Kolonel Rexhaj jep qysh në fillim të punimit të tij, një përkufizim gjithëpërfshirës:

...Inovacioni është një proces me anë të të cilit një domen, një produkt ose një shërbim, rinovohet dhe përditësohet duke aplikuar procese të reja, duke futur teknika të reja, ose duke krijuar ide të suksesshme për të krijuar vlera të reja të organizimit të punës, shërbimit, menaxhimit etj.

Në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, inovacioni përfshin një kuadër konceptual i cili specifikon një grup të përgjithshëm faktorësh, marrëdhëniet mes tyre, nivelet e analizës dhe shqyrtimit të attributeve të tjera përkatëse, të tilla si faktorët e dobët dhe të fortë të novacionit dhe një tipologji të rezultateve të inovacionit.

Një sistem inovacioni mbrojtës mund të përkufizohet si një rrjet organizmash dhe institucionesh që ndjekin në mënyrë interaktive shkencën, teknologjinë dhe veprimtaritë, lidhur me novacionet për të çuar më tej zhvillimin e interesave dhe kapaciteteve të mbrojtjes, veçanërisht të lidhura me veprimtaritë strategjike, mbrojtëse dhe civilo-ushtarake me përdorim të dyfishtë. Ndërsa ato të mbrojtjes tradicionale janë të kufizuara në kufijtë kombëtarë dhe të aleancës.

Projekti inovativ është një sistem kompleks i veprimeve që synojnë arritjen e qëllimeve të caktuara në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Ai përfshin një plan kërkimor të kufizuar në kohë, i cili përfshin krijimin e ideve, produkteve ose shërbimeve të reja, në zhvillimin e fushave të tilla si: arsimi, teknologjia, modelet e biznesit, ekologjia etj. Ato mund të jenë teknike, menaxheriale, administrative, ekonomike dhe organizative. Në termin më të thjeshtë, është përdorimi i ideve dhe qasjeve të reja, ose për të zgjidhur problemet ekzistuese. Pra, do të thotë të jesh krijues i diçkaje të re, ose të vlerësosh efektivitetin e praktikave të reja, apo të ndryshuara. Programi inovativ është një kompleks i projekteve inovative të ndërlidhura, si dhe projekte që kanë për qëllim mbështetjen e aktivitetit.

Risitë janë një konstante në zhvillimin e qenies njerëzore, e për këtë arsye projektet inovative janë veprimet në të cilat zbatohen njohuritë, aftësitë dhe

teknikat për t'iu përgjigjur nevojave të reja teknologjike, ekonomike, sociale, kulturore etj.”, përfundon Kolonel Rexhaj.

Nënkolonel Dritan Merdani, drejtor i Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike vjen me punimin e tij me titull *“Siguria kibernetike në Forcat e Armatosura”*.

Nënkoloneli e vendos theksin në rreziqet që ekzistojnë në këtë fushë, por edhe në fushat prioritare të mbrojtjes kibernetike, duke këmbëngulur në vlerësimin e vazhdueshëm. Ai nënvizon:

“Për Forcat e Armatosura, rreziku për sigurinë e sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike të MM/FA-ve, vlerësohet shumë i lartë, veçanërisht në lidhje me informacionin që trajtohet në këto struktura. Përballja dhe menaxhimi i këtyre rreziqeve duhet të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit, koordinimit dhe partneritetit, ndërmjet të gjitha palëve të përfshira në fushën e sigurisë kibernetike.

Fushat prioritare për Mbrojtjen Kibernetike janë zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike, mbrojtja e rrjeteve të komunikimit dhe informacionit të MM/FA, trajnime dhe stërvitje, kërkime shkencore dhe teknologji, bashkëpunim civilo-ushtarak dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Në fushën e trajnimit, theksi i kushtohet rritjes së trajnimit të mbrojtjes kibernetike të specialistëve të NJUSK dhe trajnimit kibernetik të ndërgjegjësimit të të gjithë përdoruesve të rrjeteve kompjuterike të MM/FA. Është gjithashtu e rëndësishme që dimensionin kibernetik të trajtohet në mënyrë të mjaftueshme në stërvitje, për të përmirësuar aftësitë e personelit të MM/FA, në reagim ndaj krizave kibernetike dhe hibride, duke përmirësuar procedurat e vendimmarrjes dhe disponueshmërinë e informacionit.

Për shkak të ritmit të lartë të ndryshimit të teknologjisë dhe zhvillimeve të shpejta në mjedisin e kërcënimeve të hapësirës kibernetike, është e nevojshme të ndërmerret vlerësim i vazhdueshëm dhe rishikime të rregullta mbi përshtatshmërinë e politikave të sigurisë kibernetike në MM/FA, me qëllim përparimi teknologjik, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi me vendet e tjera, në mënyrë që të jemi në gjendje të reagojmë më shpejt, sesa dobësitë dhe kërcënimet”, përfundon nënkolonel Merdani.



# ROLI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHOQËRINË MODERNE

**Prof. Dr. Ethem RUKA**  
Rektor i Universitetit "Luarasi"

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Qysh nga viti 1960 e deri më sot, industria e teknologjisë së informacionit njohu një revolucion të vertetë. Ajo ka rimodeluar shoqërinë njerëzore dhe e ka bërë botën më të vogël, duke shpërthyer barrierat që ndajnë popujt dhe kulturat që ata kanë krijuar. Sot, shërbimet publike e shëndetësore, edukimi, qeverisjet, biznesi, financat e sistemet bankare, transporti, aeronautika, shërbimet e mbrojtjes dhe inteligjencës, tregtia online, rrjetet sociale etj, nuk mund të imagjinohen pa teknologjinë e informacionit. Kjo teknologji krahas të mirave të pafundme, ka sjellë edhe një sërë anësh negative në jetët tona.*

*Ajo ka reduktuar kontaktet njerëzore, ka rritur dembelizmin, ka cenuar jetën private të njeriut, ka rritur shantazhin dhe ka viktimizuar shumë qenie njerëzore, ka rritur jetën sedentare e për pasojë edhe incidencën e shumë sëmundjeve si obeziteti dhe sëmundjet kardiovaskulare, ka rritur varësinë njësoj si drogat, ka rritur mbingarkesën me informacione të padobishme, ka dëmtuar rëndë pronësinë intelektuale etj.*

*Sulmet kibernetike shfrytëzojnë pikat e dobëta të sistemeve të informacionit dhe ndërhyjnë për të vjedhur, ekspozuar, ndryshuar, çaktivizuar ose edhe për t'i shkatërruar ato. Kohët po tregojnë se këto sulme janë një hap para sistemeve të mbrojtjes kibernetike. Siguria kibernetike i kapërcen kufijtë kombëtarë, ndaj duhet një strategji më e koordinuar mes vendeve aleate të bllokut euroatlantik.*

**Fjalë kyçe:** Teknologji informacioni, inteligjencë artificiale, sulm kibernetik, mbrojtje kibernetike, biznes, edukim, shëndetësi, mbrojtje, shërbime inteligjente

## HYRJE

**T**ë gjitha pajisjet që kapin, përpunojnë, arkivojnë, ruajnë, mbrojnë dhe shpërndajnë informacion, përfshihen në teknologjitë e informacionit.

Ndonëse në formë primitive, elementet e teknologjisë së informacionit, i takojmë qysh në prehistori. Njerëzimi e ka transmetuar informacionin, edhe pa pajisjet e sotme. Gjuha ishte elementi thelbësor i komunikimit e transmetimit të informacionit nga një individ në tjetrin. U desh shumë kohë, deri sa njeriu të regjistronte atë që vërente në natyrë në faqet e shpellave përmes piktogrameve të vizatuara apo gdhendura.

Me zbulimin e shkrimit, arkivimi i informacionit dhe transmetimi i tij kaloi në një stad më të përparuar. U desh të kalonin edhe 2500 vite të tjera për të arritur deri te printimi me shtypshkronjën Gutenberg. Tashmë informacioni mund të ruhej e të shpërndahej në formën e shtypshkrimeve, duke u bërë burim dijeje për shumë e shumë më tepër njerëz.

Dikur, njeriu numrin e krerëve e kopesë së bagëtive apo ditëve e regjistronte me vija në kockat e kafshëve apo trungjet e pemëve. Më vonë, vijat u shndërruan në numra. Mijëra vjet para erës sonë mbledhjet dhe zbritjet bëheshin me kleçka druri.

Aty nga viti 1900, një grup peshkatarësh zbuluan një anije të mbytur në brigjet e ishullit Antikythera në veri të Kretës. Një grup arkeologësh arritën në përfundimin se anija, ndoshta romake, mund të ishte mbytur 100-40 vite para erës së re.

Në të u gjetën skulptura mermeri, si dhe një pajisje e veçantë dhe e panjohur, që u quajt mekanizmi Anthikythera, një lloj “kompjuteri” analog mekanik, i cili mesa dukej përdorej për llogaritjen e kalendarit hënor, diellor dhe yllësitë në përgjithësi.

Anthikythera shënon fazën e parë të teknologjisë kompjuterike (3000-1540 para erës sonë) që është pranuar të quhet faza para-mekanike. Faza e dytë ose mekanike (1450-1840) nënkupton pajisjet llogaritëse që shfrytëzonin ingranazhet.

Makina e parë llogaritëse mekanike që mund të kryente katër veprime u shpik në vitin 1645. Faza tretë (1840-1940) i takon gjeneratës së kompjuterëve elektromekanikë. Kompjuterët e viteve 1943-1955, si Collussus, IBM SSEX, IBM 704 etj., kishin tub vakumi, ku vendoseshin qarqet logjike.

Në vitin 1947 u shpikën transistorët (gjysmëpërçuesit) prej silici, të cilët shënuan një revolucion të vërtetë në fushën e elektronikës. Ata i hapën rrugën ndërtimit të kompjuterëve elektronikë me qarqe të integruara, që shënuan

fazën e katërt të teknologjisë kompjuterike. Shpejtësia dhe fuqia llogaritëse e kompjuterëve ka ardhur duke u rritur më mënyrë eksponenciale.

Termi ‘teknologji informacioni’ u përmend për herë të parë në vitin 1958 nga Harold Leavitt dhe Thomas Whisler në një artikull të botuar në revistën “*Harvard Business Review*”. Në këtë artikull ata shprehen se: “*Teknologjia e re, ende nuk kanë një emër. Ne do ta quanim atë teknologji informacioni*”.

Sot në fushën e teknologjisë së informacionit përfshihen rrjetet, pajisjet, softuerët, si dhe sistemet e ruajtjes dhe administrimit të të dhënave. Këta përbërës janë të rëndësishëm për çdo lloj sipërmarrjeje private e publike. Bazat e sotme të të dhënave janë në gjendje të ruajnë dhe organizojnë një masë të jashtëzakonshme informacioni, i cili përditësohet në mënyrë të pandërprerë dhe mund të shfrytëzohet në çdo çast të ditës. Ai mund të transferohet nga një cep i botës në tjetrin.

Sistemet e menaxhimit të bazës së të dhënave, si dhe rrjeti i parë i transferimit të tyre lindën aty nga fundi i viteteve 1960, kur për herë të parë u vu në punë projekti “Arpanet” i financuar nga Agjencia e Projekteve Kërkimore të Avancuara (DARPA) të Departamentit amerikan të mbrojtjes. Kjo periudhë shënon edhe fillimin e kohës moderne të teknologjisë së informacionit.

Këto sisteme u përmirësuan dhe janë në gjendje të ruajnë e të bëjnë të shfrytëzueshëm një sasi kolosale informacioni, pa gabime e në një kohë shumë të shkurtër dhe nga një numër i madh përdoruesish.

Më vonë, krahas teknologjive të informacionit, u zhvilluan vrullshëm edhe teknologjitë e komunikimit. Këto dy lloj teknologjish konverguan në një të vetme aty nga vitet 1970, kur teknologjitë e informacionit filluan të zbatoheshin edhe në rrjetin e telekomunikimit.

Kjo konvergjencë ndodhi atëherë kur telefonia, radioja, televizioni, gazetatat, të dhënat informatike etj, u vendosën mbi një platformë të njëjtë siç ishte interneti, me anë të të cilit mund të shpërndahej një masë e madhe informacioni, në kohë reale.

Termi i përbashkët *teknologji informacioni dhe komunikimi* nënkupton një fushë të gjerë zbatimesh, ku përfshihen teknikat informatike, audiovizuale, multimediat, interneti, telekomunikimi etj. Kjo teknologji u lejon përdoruesve të komunikojnë e të sigurojnë akses të shpejtë në informacionin e çdo lloj natyre.

Sot, gati 66% e popullsisë së botës ose 5.3 miliardë njerëz kanë akses në internet, kur në vitin 2018 këtë mundësi e kishin vetëm 51% e popullsisë botërore ose 3.9 miliardë njerëz. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me abonentët celularë, të cilët këtë vit arrijnë në 5.7 miliardë ose 71% e popullsisë së botës.

Sot jetojmë në kohën e teknologjisë dixhitale të informacionit, siç është mjegullnaja apo reja informatike (Claud). Kjo mjegullnajë mbulon thujtë të gjithë rruzullin tokësor dhe na bën të jemi në kohë reale më afër njëri-tjetrit.

Pajisjet kompjuterike janë bërë gjithmonë e më të sofistikuara dhe më “inteligjente”. Përkufizimi i inteligjencës ka qenë dhe mbetet mjaft i diskutueshëm. Inteligjenca njerëzore konsiderohet si aftësia e përgjithshme mendore, që veç të tjerash përfshin aftësinë për të arsyetuar, planifikuar, zgjidhur problemet, menduar në mënyrë abstrakte, për të kuptuar idetë e ndërlikuara, për të mësuar shpejt dhe për të mësuar nga përvoja.

Inteligjenca artificiale është pjellë e inteligjencës njerëzore dhe synon të simulojë atë biologjike. Një makinë inteligjente duhet të kuptojë, arsyetojë, perceptojë, dialogojë, të përshtatet e të nxëjë dije, ashtu si edhe truri i kafshëve dhe njeriut. Në fund të fundit, inteligjenca artificiale është një simulim i sjelljeve të njeriut nga pajisjet kompjuterike, madje të zgjidhë disa probleme më mirë nga ç’ mund t’i zgjidhë vetë njeriu.

Sot, megjithëse kemi mbërritur në kohën e revolucionit digjital, rëndësia e fjalës dhe shkrimit nuk humbën asnjëherë. Shkrimi nuk e zëvendësoi asnjëherë fjalën e artikuluar dhe as teknologjia kompjuterike nuk ka për ta zëvendësuar as fjalën e folur dhe as atë të shkruar. Nëse mënyrat e komunikimit ndryshojnë, thelbi mbetet gjithmonë i njëjtë. Këto tri forma komunikimi mbeten edhe sot tërësisht komplementare të njëra-tjetrës.

## **PËRPARËSITË DHE...**

Fuqia e informacionit po shtrihet kudo dhe është në dispozicion të gjithkujt. Kudo që ndodhemi në shtëpi, në punë, me pushime, duke fluturuar në avion, apo duke lundruar në det shkruajmë mesazhe, shfetojmë bibliotekat online, krijojmë galeri fotosh, shkarkojmë muzikë, video e filma, etj.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit kanë rimodeluar shoqërinë njerëzore. Ato e kanë bërë botën më të vogël duke shpërdhëyer barrierat që ndajnë popujt dhe kulturat që ata kanë krijuar. Sot, shërbimet publike e shëndetësore, edukimi, qeverisjet, biznesi, financat e sistemet bankare, transporti ajror, tokësor e detar, aeronautika, shërbimet e mbrojtjes dhe inteligjencës, tregtia online, rrjetet sociale etj, nuk mund të imagjinohen pa teknologjinë e informacionit

Në një farë mënyre e gjithë bota është bërë më e vogël, më e ndërruar, më përfituese por edhe më e rrezikuar. Industria e teknologjisë së informacionit, jo vetëm që i ka dhënë tregut një pafundësi pajisjesh të reja, por ka imponuar sjellje të reja në shoqërinë e sotme njerëzore. I gjithë ky revolucion, si çdo revolucion tjetër paraardhës, ka të mirat dhe mangësitë e tij.



Kompjuterizimi ka lënë pas një sërë praktikash rutinore e të mërzitshme, duke na dhënë mundësinë të kursejmë kohën, të rritim rendimentin, të regjistrojmë e analizojmë një numër të pafund të dhënash, të komunikojmë më shpejt e në kohë reale, pavarësisht nga largësia. Po ashtu, teknologjia e informacionit ka lehtësuar shpejtësinë e shërbimeve publike, aksesin e menjëhershëm për informacionit e duhura, fuqizimin e inovacionit, parandalimin e krimit, modernizimin e edukimit, përmirësimin e shërbimeve inteligjente, shëndetësore dhe sistemeve bankare, fuqizimin e mbrojtjes, krijimin e mjediseve inteligjente, etj.

Ndërkaq teknologjia e informacionit ka revolucionarizuar mënyrën se si njerëzit komunikojnë mes tyre. Ajo ka rritur fluksin e komunikimeve dhe ka ulur në mënyrë drastike kostot në raport me vite e vite më parë. Email-i, posta zanore, videokonferencat, rrjetet sociale buletinet online, e mesazhet e çastit janë vetëm disa, nga risitë që kursejnë kohë dhe që reduktojnë aktivitetet e padobishme njerëzore. Rritja e komunikimit elektronik ka qenë e dobishme për biznesin, arsimin, marrëdhëniet ndërkombëtare, e shumëçka tjetër.

Koha është element thelbësor në ekonominë e tregut. Teknologjia e informacionit kursen kohë dhe koha e kursyer në biznes, është vlerë që konvertohet në më shumë rendiment, më shumë prodhim e më shumë fitim. Me sistemet dixhitale, njerëzit mund t'i përmbushin shumë më shpejt dhe pa gabime detyrimet në krahasim me metodat tradicionale manuale.

Në kohën e sotme inovacioni është çelësi i suksesit. Falë teknologjisë të informacionit, industria dhe biznesi mund të ideojnë më shumë produkte të reja, t'i reklamojnë më mirë dhe të sjellin më afër prodhuesin me konsumatorin dixhital. Sot produktet mund të bëhen më të njohura jo vetëm në nivel lokal, por edhe në atë ndërkombëtar.

Kontaktet virtuale, pa qenë nevoja të shpenzohet kohë me udhëtime, tregtia *online*, *e-commerce* e shumë risi të tjera. Këto i kanë dhënë biznesit e tregtisë më shumë frymëmarrje dhe një përmasë gjithmonë e më globale.

Teknologjia e informacionit ka ndryshuar dhe vazhdon të ndryshojë natyrën e operacioneve bankare. Në të kaluarën, njerëzit nuk mund të kryenin transaksione pa vizituar bankën e tyre. Tani, shumë banka dhe institucione financiare kanë faqe interneti dhe aplikacione në telefoninë celulare që u lejojnë klientëve të marrin shërbime të reja e të shpejta, pa qenë nevoja për të ardhur fizikisht në bankë.

Teknologjia e informacionit ka revolucionarizuar cilësinë dhe sistemin tradicional arsimor. Mësimi online, edukimi në distancë, e-learnig, mësimdhënia virtuale, platformat elektronike edukative, interneti, bibliotekat online, video-konferencat, shtrirja e multimedias në shkollë etj, kanë

përmirësuar mësimdhënien dhe përvetësimin e dijeve nga nxënësit dhe studentët.

Izolimi i rreth 4 miliardë njerëzve për gati dy vite nga pandemia e Covid-19, do të kishte qenë një katastrofë e vërtetë për edukimin në botë, nëse nuk do të ishte kaluar në mësimdhënien online.

Po kaq shtrirje të gjerë kanë marrë teknologjitë e informacionit edhe në sektorin e shëndetësisë.

Falë tyre sot mund të ruajmë e transmetojmë informacione që kanë të bëjnë me të dhënat mjekësore, me asistencën mjekësore në distancë, përmirësimin e teknologjive të diagnostikimit, kurimit, ndërhyrjeve kirurgjikale, pa shkuar më tej në përpunim të të dhënave të pafundme, që burojnë nga kërkimet në fushën e biologjisë molekulare.

Kështu, përshembull, baza e të dhënave të biologjisë molekulare përfshin një masë të jashtëzakonshme informacionesh të dobishme për funksionet, ndërtimin dhe lokalizimin e geneve, ndërtimin e proteinave, për proceset metabolike, mikroçipet biologjike, etj.

Jo vetëm kaq, por falë kësaj teknologjie u vunë në dispozicion të të gjitha kombeve raportet e hartuara nga ekspertët 21 vendeve të botës, të cilat shërbyen për orientimin e politikave lokale për përballimin e situatës.

Sot po ecet me shpejtësi drejt qyteteve dhe banesave inteligjente (Smart City). Administratorët e qyteteve kanë nevojë të grumbullojnë sa më shumë informacion për trafikun, temperaturën, ndotjen, konsumin, administrimin e mjetëve, për politikat e shumta sociale etj.

Ndërlidhja mes botës fizike dhe botës dixhitale quhet Interneti i gjërave (Internet of Things). Të dhënat e grumbulluara nga sensorët e shumtë janë kolosale (Big Data). Këto të dhëna jo vetëm që duhen grumbulluar e ruajtur, por edhe përpunuar. Mbi bazën e këtyre të dhënave vendimmarrësit ndërmarrin pa humbur kohë politika që përmirësojnë jetën e qytetarëve.

E ardhmja u takon qyteteve inteligjente, të cilët shpejt do të kalojnë nga fazat e sotme eksperimentale, në realitetet të prekshme për gjithë zonat urbane.

Teknologjia e informacionit ka dhënë rezultate befasuese në luftën kundër kriminalitetit e terrorizmit, si dhe në parandalimin e tyre. Siguria e jetës së qytetarëve është thelbësore për standardet e një demokracie funksionale. Pa të dhënat e grumbulluara, të ruajtura e të përpunuara nga makinat inteligjente, nuk mund të ketë aksione të shpejta dhe efikase, e asnjë bashkëpunim të shpejtë ndërkombëtar.

Krimet e natyrave të ndryshme ndodhin kudo, e në çdo kohë. Ato mund të

jenë individuale, por edhe në formën e grupeve kriminale. Këta aktorë për të fshehur gjurmë e krimit përdorin edhe teknologjinë e informacionit. Prandaj agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit duhet të jenë një hap para tyre, e për këtë duhen harduerë e softuerë të rinj.

Hetimi i suksesshëm ka nevojë për analiza të rrjeteve, për harta krimi, për sisteme të informacionit gjeografik (GIS), për informacione biometrike, gjurmët e gishtave, analizat e ADN-së, njohjen e fytyrave dhe njohjen e zërit, për analiza të sakta të armëve të përdorura në krim, për videovëzhgime etj.

(Placeholder1) Teknologjia kanë ndryshuar vazhdimisht taktikat e mjetet që përdoren në luftërat moderne. Zbatimi i revolucionit të teknologjisë së informacionit për çështjet ushtarake (IT-RMA) e merr fillimin e vet në vitet 1960 - 1970. Ideja e paksimit të forcave njerëzore në terren falë teknologjive të reja po bëhet gjithmënë e më mbizotëruese në lufrat moderne. Zotërimi i informacionit dhe shfytëzimi i tij në fushëbetejë, është bërë zemra e suksesit të operacioneve ushtarake. Doktrina e sotme ushtarake, duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit, synon zotërimin e ajrit, tokës, detit dhe sulmeve kibernetike.

Teknologjia e informacionit ka sjellë paisje të reja të cilat jo vetëm që sigurojnë komunikimin e trupës në kohë reale, por edhe grumbullimin e informacionit nga rrjetet e sensorëve ambientale pa kabëll (RCSF), dronëve inteligjentë dhe satelitëve për qëllime ushtarake. Këto informacione janë thelbësore për të njohur me saktësi pozicionimin, arsenalin e armëve, zhvendosjen e forcave armike si dhe përqendrimin e goditjes mbi to.

Është e pamundur që të flitet me hollësi për të gjitha fushat e jetës në të cilat teknologjia e informacionit ka shtrirë kthetrat e saj. I gjithë njerëzimi është futur në një rrugë zhvillimi, e cila nuk bën dot pa teknologjinë e informacionit. Ajo e ka shndërruar botën një qytet global, në një botë që ndihet më e vogël nga sa është realisht.

## **ANËT NEGATIVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Teknologjitë nga natyra e tyre janë indiferente, por përdorimi i tyre nga njeriu mund të përdoret si për mirë, edhe për keq. E njëjta gjë vlen edhe për teknologjinë e informacionit, e cila veç të mirave të përmendura më sipër, ka sjellë me vete një sërë disavantazhesh e rreziqesh evidente.

Sot jemi bërë tërësisht të varur nga teknologjia e informacionit. Le të imagjinojmë për një çast, botën e sotme pa internet. Gjithçka do të paralizohej. Do të paralizoheshin shërbimet bankare, komunikimi mes njerëzve e institucioneve, nuk do të funksiononin shërbimet publike, do të bllokoheshin sistemet e transportit ajror, detar e tokësor, nuk do të kishte më media sociale,

do të përplaseshin trenat dhe avionët, qytetet nuk do të furnizoheshin me energji elektrike dhe armët bërthamore mund të dilnin nga kontrolli.

Varësia jonë nga teknologjia e informacionit është e pashmangshme. Ajo krahas të mirave të pafundme që i ka prurë shoqërisë moderne, ka sjellë edhe një sërë anësh negative në jetët tona të përditshme.

Teknologjia e informacionit ka reduktuar kontaktet njerëzore, e për pasojë ka dobësuar demokracinë e drejtpërdrejtë. Ajo ka rritur dembelizmin, ka cenuar jetën private të njeriut, ka rritur shantazhin dhe ka viktimizuar shumë qenie njerëzore.

Teknologjia e informacionit ka rritur jetën sedentare e për pasojë edhe incidencën e shumë sëmundjeve si obeziteti e sëmundjet kardiovaskulare, ka ulur aktivitetin fizik, ka rritur varësinë njësoj si drogat, ka rritur mbingarkesën me informacione të padobishme e të gënjeshtërtë, ka dëmtuar rëndë pronësinë intelektuale etj.

Teknologjitë e reja për shkak të automatizimit, robotizimit e pajisjeve inteligjente kanë ndikuar në uljen e numrit të vendeve të punës. Shumë vende pune kërkojnë nivel të lartë në njohjen e logjistikës informatike, gjë që nuk është e aritshme nga shumica e njerëzve të pakualifikuar.

Shpesh për të ulur kostot operative, të dhënat dërgohen për t'u përpunuar në vende të tjera, duke prekur punësimin në vendin e origjinës. Për shkak të ndryshimeve të shpejta teknologjike, një pjesë e punonjësve që nuk arrijnë të përditësohen, janë të detyruar të lënë vendet e punës.

Ndërkaq shumë të dhëna dërgohen të përpunohen në vende ku kostoja operative është e ulët, gjë që ndikon negativisht në punësimin e vendeve të origjinës. Teknologjia e informacionit ka sjellur pabarazi mes vendeve të zhvilluara e atyre në zhvillim. Kjo bën që varfëria të rritet edhe më shumë në një pjesë të mirë të vendeve të botës.

Truri i njeriut, një pjesë të detyrimeve mendore, ua ka deleguar makinave inteligjente dhe kjo përbën një problem jo të vogël afatgjatë. Qëkurse njeriu shpëtoi nga jeta individuale dhe filloi të urbanizohej falë revolucionit bujqësor, truri i njeriut ka filluar të zvogëlojë përmasat e tij. Ndoshta teknologjia e informacionit, do vazhdojë të zvogëlojë akoma më shumë përmasat e këtij organi nga 1500 gramë mesatarisht, në 1300 gramë.

## **SULMET DHE MBROJTJA KIBERNETIKE**

Sulmet kibernetike shfrytëzojnë pikat e dobëta të sistemeve të informacionit dhe ndërhyjnë në mënyrë të paligjshme për të vjedhur, ekspozuar, ndryshuar, çaktivizuar ose edhe për t'i shkatërruar ato. Agjencitë e specializuara për

identifikimin e sulmeve kibernetike tregojnë se numri sa vjen e rritet në të gjitha vendet e botës.

Sot, numri i sulmeve kibernetike në botë llogaritet në qindra mijëra në ditë. Forumi Botëror i Ekonomisë e konsideron sulmin kibernetik si një nga pesë rreziqet më të mëdha të botës së sotme. Ato fillojnë nga hakerimet për arsye individuale, e përfundojnë deri te lufta dhe terrorizmi kibernetik. Kostoja e përgjithshme vjetore në rrang botëror vlerësohet rreth 6 trilionë dollarë në vit.

Rendja mbas shtrirjes me shpejtësi të teknologjisë së informacionit, jo gjithmonë shoqërohet me sisteme të sigurta të mbrojtjes të të dhënave. Kohët po tregojnë se sulmet kibernetike janë një hap përpara sistemeve të mbrojtjes kibernetike.

Motivet që qëndrojnë pas sulmeve kibernetike janë nga më të ndryshmet. Ato mund të bëhen për motive kriminale, siç është përfitimi financiar përmes vjedhjes, për qëllime politike, për vjedhje të dhënash nga shërbimet inteligjente, për sabotim të kundërshtarit, vjedhje teknologjish të reja e për lloj-lloj arsyesh të tjera.

Sulmet kibernetike kundër një vendi, mund të realizohen nga aktorë të jashtëm ose të brendshëm. Kërcënimet e jashtme zakonisht organizohen nga grupe kriminale, hakera profesionistë, apo aktorë të sponsorizuar nga qeveri të ndryshme.

Hakerat, duke gjurmuar pikat e dobëta të teknologjisë kompjuterike dhe rrjeteve informatike, kanë mundur të godasin mjaft vende të zhvilluara. Kështu, në vitin 2017 u ndërmor një sulm i gjerë kibernetik që paralizoi kompjuterët e kompanive shumëkombëshe dhe të shërbimeve publike në rreth njëqind vende.

Ndër viktimat e këtij sulmi ishin spitalet britanike, shumëkombëshet Renault dhe FedEx, Ministria e Brendshme Ruse, operatori spanjoll i telekomit Telefónica, kompania gjermane hekurudhore, e shumë e shumë aktivitete të tjera.

Qysh nga viti 1982, kur u shënuar sulmi i parë kibernetik për sabotimin e gazsjellësit trans-siberian e deri më sot, sulmet e kësaj natyre janë rritur dhe kanë marrë përmasa të rrezikshme.

Sulme të tilla kanë pësuar Estonia, Ukraina, Irani, SHBA, Bangladeshi, Koreja e Jugut, Gjermania, Anglia, vendi ynë dhe shumë e shumë vende të tjera. Një pjesë e autorëve të këtyre sulmeve janë identifikuar, por shumica e të tjerëve mbeten ende të dyshuar.

Shqipëria qysh prej dy vitesh ka qenë dhe vazhdon të jetë nën një sulm të

egër kibernetik, i cili ka synuar të vjedhë, ekspozojë e bllokojë, të dhënat qeveritare dhe të sektorit privat. U bllokuan përkohësisht shërbimet sociale dhe u ekspozuan të dhënat personale të gjendjes civile, u bllokua gjithë sistemi i-albania, u piratuan të dhëna sensitive të Ministrisë së Rendit, shërbimit informativ, TIMS, targave të automjeteve, rrogave të sektorit publik dhe privat, të llogarive bankare në disa raste, e shumë sektorë të tjerë.

Sistemet qeveritare qëndruan të mbyllura deri në neutralizimin e sulmeve, falë bashkëpunimit intensiv të AKSHI me ekipin e Mikrosoft, ekipin e “Jones Group International” dhe kompanitë shqiptare në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Ky sulm ishte dhe vazhdon të jetë një agresion i hapur ndaj vendit tonë. E gjithë kjo tablo tregoi se sa të dobët ishin sitemet tona të të dhënave dhe sa pak kishim investuar në mbrojtjen kibernetike të tyre. Përvoja tregoi se mbrojtja kibernetike nuk është më, një çështje e mbyllur brenda një vendi, por një strategji e koordinuar mes vendeve aleate të Bllokut Euroatlantik.

Kjo është arsyeja që pranë Universitetit “Luarasi” qysh prej një viti është hapur Akademia e Mbrojtjes Kibernetike në bashkëpunim me një nga kompanitë lider izraelite “Elta System”, që punon për departamentin e Mbrojtjes së Izraelit. Të diplomuarit tanë në këtë Akademi janë pajisur me certifikata të njohura ndërkombëtarisht për sigurinë kibernetike dhe janë punësuar në mënyrë të menjëhershme.

## PËRFUNDIME

Në një vështrim të përgjithshëm, revolucioni në fushën e teknologjisë së informacionit ka ndryshuar me shpejtësi botën dhe vetë shoqërinë njerëzore. Sot jetojmë në erën e teknologjisë numerike. Falë kësaj teknologjie, bota është zvogëluar dhe është shndërruar në një qytet global dixhital. Prej teknologjisë së informacionit, kanë përfituar të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore duke filluar nga ekonomia, biznesi, industria, sistemi bankar, edukimi, mjedisi, transporti, media, komunikimi, agjencitë e monitorimit të ligjit, çështjet sociale, shërbimet inteligjente, mbrojtja e gjithçka tjetër.

Bota është bërë e ndërvarur tërësisht prej kësaj teknologjie me të mirat dhe anët negative të saj. Përvoja e deritanishme ka treguar se kjo teknologji ka pikat e saj të dobëta të cilat bëhen pre e hakerimit. Në bazë të sulmeve kibernetike qëndrojnë motive nga më të ndryshmet, duke filluar nga ato personale, e deri në sulmet e një shteti, ndaj një shteti tjetër.

Mbrojtja kibernetike kërkon përpjekje në nivel kombëtar, por edhe bashkëpunim më të gjerë ndërkombëtar.

## Burime të shfrytëzuara

1. Charlton M. (2009:) *A Handbook of Information Technology*, 2009, Global Media:3
2. Cisco Annual Internet Report (2018–2023): *White paper*, [www.cisco.com/whitepaper-c11-741](http://www.cisco.com/whitepaper-c11-741) 490
3. Buntin M.B., Burke M.F., Hoaglin M.C., Blumenthal D. (2021): Profiles of innovation in health care delivery, *Health affairs*, vol. 30 no.3.
4. Daintith, John, ed. “IT”, *A dictionary of Physics*, Oxford University Press, ISBN 9780199233991, retrieved 31 decembre 2019
5. Deb S. (2014): Information Technology, Its Impact on Society and Its Future, *Advances in Computing*, vol. 4 (1).
6. Dobre C, Xhafa F. (2014): Intelligent Services for Big Data science, Elsevier: *Future Generation Computer Systems*, vol.37.
7. Ghadban N. (2015): Fusion de l’information dans les réseaux de capteurs: application à la surveillance de phénomènes physiques, <https://thepressfree.com/larmee-a-une-nouvelle-doctrine-pour-le-xxie-siecle-et-cest-de-la-haute-technologie>.
8. Li Y., Liu Q. (2021): A comprehensive review study of cyber-attack and cyber security; Emerging trends and recent developments, *Energy Reports* Vol. 7.
9. Albert M., William W. C. R. (2020), The COVID-19-crisis and the information polity: An overview of responses and discussions in twenty-one countries from six continents, *Juornal: Information Polity*, vol. 25, no.3.
10. Pereira, E.M., Columbia University Clinical Genetics Professionals. & Chung, W.K. (2020): COVID-19’s Impact on Genetics at One Medical Center in New York. *Genet Med* **22**, 1467–1469
11. Pros and Cons of Information Technology [https://honestproscons.com/pros-and-cons-of-information-technology/#Loss\\_of\\_communication\\_skills](https://honestproscons.com/pros-and-cons-of-information-technology/#Loss_of_communication_skills)
12. Saldanha T. J. V., Lee D. & Mithas S. (2020): Aligning Information Technology and Business: The Differential Effects of Alignment During Investment Planning, Delivery, and Change, *Information Systems Research* vol.31, no.44
13. Shaurya Vir Singh Pathania Sh. V. S., (2022): Impact of information technology in the area of education, *International Research Journal of Engineering and Technology* (IRJET) e-ISSN: 2395-0056 Volume: 09 Issue: 07
14. 2022 Cyber security Statistics: The Ultimate List of Stats, Data: <https://purplesec.us/resources/cyber-security-statistics>





# INOVACIONI DHE PROJEKTI INOVATIV, KËRKESË E KOHËS

**Kolonel Msc. Ulsi REXHAJ**

*Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor  
Ushtarak, AFA*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Në Fjalorin e Shqipes së Sotme të vitit 1984, në faqen 799, citohet dhe shpjegohet fjala “Novator”: -“Ai që paraqet dhe vë në jetë metoda ose ide të reja e përparimtare në një fushë të prodhimit, të shkencës etj”. Prej këtej rrjedh edhe fjala novatorizëm, e cila përshkruhet në atë Fjalor.*

*Domethënë, e shqipëruar, do të thotë shpikje e një procesi a mekanizmi të ri, gjetja e një zgjidhjeje të pa qenë më parë, e cila shpie më përpara prodhimin, procesin, a diçka tjetër.*

*Fjala “novacion” rrjedh nga folja latine “innovare”, që do të thotë të rinovosh. Në anglisht kuptohet si “Investimet në Novacion.”*

*Prandaj edhe nga në këtë punim, për marrëveshje fjale do të përdorim fjalën “inovacion”, e cila për shkak të përdorimit të gjerë sot në botë, po “fiton qytetarinë” edhe në Gjuhën Shqipe.*

*Inovacioni është një proces me anë të të cilit një domen, një produkt ose një shërbim, rinovohet dhe përditësohet duke aplikuar procese të reja, duke futur teknika të reja, ose duke krijuar ide të suksesshme për të krijuar vlera të reja të organizimit të punës, shërbimit, menaxhimit etj.*

*Në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, inovacioni përfshin një kuadër konceptual i cili specifikon një grup të përgjithshëm faktorësh, marrëdhëniet mes tyre, nivelet e analizës dhe shqyrtimit të attributeve të tjera përkatëse, të tilla si faktorët e*

*dobët dhe të fortë të novacionit dhe një tipologji të rezultateve të inovacionit.*

*Një sistem inovacioni mbrojtës mund të përkufizohet si një rrjet organizmash dhe institucionesh që ndjekin në mënyrë interaktive shkencën, teknologjinë dhe veprimtaritë lidhur me novacionet për të çuar më tej zhvillimin e interesave dhe kapaciteteve të mbrojtjes, veçanërisht të lidhura me veprimtaritë strategjike, mbrojtëse dhe civilo-ushtarake me përdorim të dyfishtë. Ndërsa ato të mbrojtjes tradicionale janë të kufizuara në kufijtë kombëtarë dhe të aleancës.*

*Këto çështje do të trajtojnë edhe ky punim, aq sa është e mundur në kuadrin e një shkrimi për Revistën.*

## KUSHTE DHE KRITERE

Aftësia për të qenë inovativ është një faktor kryesor që ndikon në planifikimin strategjik dhe gjithashtu është pranuar se ajo çon në krijimin e sigurisë.

Nevoja për reformim, modernizim gjithëpërfshirës të stadeve aktuale të zhvillimit dhe moduleve përkatëse, lind nga fakti se në kushtet e globalizimit ekonomik dhe politik, mjedisi mjaft konkurrues i biznesit sjell ndryshime të shpejta në zbulimin e mundësive, në punësim dhe në mënyrën e menaxhimit të ekonomisë kombëtare. Prandaj, kjo është arsyeja që aftësitë e nevojshme duhet të përvetësohen në procesin e zhvillimit, të bëhen gjithnjë e më të gjera dhe të dalin gjithnjë e më shumë përtej kornizave “klasike” të deritanishme, **me** qëllim që të krijohet me sukses. Inovacioni është procesi i përfitimit të diçkaje që tashmë ekziston, si dhe përmirësimi i saj, qoftë ky, produkt, shërbim apo edhe proces e për këtë, duhet të jemi në gjendje të identifikojmë mundësitë dhe të përfitojmë prej tyre.

Inovacioni është një nga temat më të rëndësishme në lidhje me zhvillimet e sotme, konkurrencën afatgjatë dhe arritjen e sigurisë globale. Fjala “novacion” rrjedh nga folja latine innovare, që do të thotë të rinovosh. Nga anglishtja kuptohet në “Investimet në Novacion.” Inovacioni është një proces me anë të të cilit një domen, një produkt ose një shërbim rinovohet dhe përditësohet duke aplikuar procese të reja, duke futur teknika të reja ose duke krijuar ide të suksesshme për të krijuar vlera të reja të organizimit të punës, shërbimit, menaxhimit etj.

*“Inovacioni është funksioni specifik i sipërmarrjes, qoftë në një biznes ekzistues, një institucion, shërbim publik ose një sipërmarrje e re, e nisur nga një individ apo institucion. Është mjeti me të cilin sipërmarrësi, ose krijon burime të reja të prodhimit të pasurisë, ose i pajis burimet ekzistuese me potencial të shtuar për të krijuar pasuri.”<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> Peter F Drucker- Austrian-American consultant

Procesi, mund të jetë aq i thjeshtë sa të bësh një ndryshim të vogël, ose po aq kompleks sa të riparosh apo ndryshosh plotësisht, një sistem të tërë. Por çfarëdo forme që të marrë, inovacioni gjithmonë përfshin kreativitetin dhe ndërmarrjen e rrezikut. Inovacioni mund të jetë një shtytës thelbësor i zhvillimit dhe nëse do të krijojmë vazhdimisht, prirjet janë që të jemi më të suksesshëm, sesa ata që nuk e bëjnë këtë.

Disa faktorë kritikë që ndikojnë dhe kontribuojnë në procesin e inovacionit janë:

Së pari, duhet të kesh një kulturë të fortë inovacioni. Kjo do të thotë nxitja e një klime, ku individët të ndjehen të inkurajuar për të dalë me ide të reja dhe të shpërblehen për marrjen e rreziqeve.

Së dyti, duhet të kesh burimet e duhura si: laboratorët e kërkimit dhe zhvillimit, ekipet e projektimit, mbështetjen, menaxhimin dhe financimin.

Së treti, është thelbësore të kemi një vizion të qartë strategjik, i cili mbështet inovacionin dhe ndihmon në drejtimin e vendimmarrjes.

Për të pasur një sistem inovacioni të suksesshëm, duhet të jemi në gjendje të identifikojmë mundësitë dhe të përfitojmë prej tyre. Kjo përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e asaj çfarë kemi dhe të kuptuarit se çfarë duam dhe kemi nevojë. Kërkon gjithashtu të qëndrojmë përpara tendencave dhe të jemi të gatshëm të eksperimentojmë me ide të reja.

## **FUSHAT DHE...**

Inovacioni mund të zhvillohet në forma dhe fusha të ndryshme. Kur flasim për inovacionin, shumica e njerëzve mendojnë për produkte të reja, ndërkohë që ka një gamë të gjerë të fushave dhe rezultateve të inovacionit. Më poshtë po rendisim më të zakonshmet:

### **1. Inovacioni i produktit dhe performancës së produktit.**

Zhvillohet një produkt i ri ose përmirësohet performanca e një produkti ekzistues, ky është lloji më i zakonshëm i inovacionit.

### **2. Inovacioni i teknologjisë.**

Teknologjitë e reja janë bazë për shumë risi të tjera, si p.sh. interneti, i cili në vetvete ishte një risi, por edhe ka sjellë risi të tjera, në fusha të ndryshme.

### **3. Inovacioni i modelit të biznesit.**

Përdorimi i kanaleve të ndryshme, teknologjive dhe tregjeve të reja mund të çojë në modele të reja të cilat mund të krijojnë, ofrojnë dhe kapin vlerën e kërkuar. Ekosistemet dixhitale janë një shembull i mirënjohur i inovacionit.

#### **4. Inovacioni organizativ.**

Menaxhimi dhe ndarja e burimeve në një mënyrë të re mund të jetë gjithashtu një risi. Në këtë mënyrë është e mundur të përdoren burimet dhe asetet në një mënyrë krejtësisht të re.

#### **5. Inovacioni i procesit.**

Inovacioni në procese mund të përmirësojë efikasitetin ose efektivitetin e metodave ekzistuese.

#### **6. Marketingu – Inovacioni i kanalit të ri.**

Metoda të reja për të kapur dhe mbajtur vëmendjen nëpërmjet përdorimit të koncepteve inovative të marketingut apo përdorimit të kanaleve të reja.

#### **7. Inovacioni i rrjetit.**

Duke lidhur grupe dhe palë të ndryshme interesi mund të krijohen vlera shtesë. Ky lloj inovacioni është shumë i zakonshëm për shkak të përdorimit të shërbimeve TIK.

#### **8. Angazhimi/Mbajtja e kontakteve.**

Koncepte dhe modele inovative që përpiqen të rrisin angazhimin dhe të ruajnë nivelin e kontakteve.

### **LLOJET E ZHVILLIMIT TË INOVACIONIT**

Duhet të kuptojmë se ka mënyra të ndryshme të zhvillimit, ku inovacioni mund të ketë ndikim dhe të japë rezultate në produkte, shërbime, apo procese. Më së shpeshti ne i dallojmë llojet e inovacionit në varësi të faktit, nëse ato sjellin zhvillime të reja apo ndryshime në teknologji:

1. *Inovacioni progresiv*: Teknologjia ekzistuese, tregu ekzistues.

Një nga format më të zakonshme të inovacionit që ndeshim. Ai përdor teknologjitë ekzistuese brenda tregut ekzistues, me qëllim përmirësimin e asaj që ekziston duke shtuar veçori të reja.

2. *Inovacioni arkitektonik*: Teknologjia ekzistuese, treg i ri.

Është zbatimi i aftësive, ekspertizës dhe teknologjive në një treg tjetër. Këto sot mund t'i shohim vetëm te gjigantët e teknologjisë, si Amazon, Google etj.

3. *Inovacion rinovues*: Teknologji e re, treg ekzistues.

Lidhet kryesisht me aplikimin e teknologjive, proceseve ose modeleve të reja në ambientet ekzistuese. Ndonjëherë teknologjitë dhe modelet e reja, fillimisht mund të duken inferiore ndaj zgjidhjeve ekzistuese, por pas përshtatjes ato

tejkalojnë modelet ekzistuese.

#### 4. *Inovacioni thelbësor*: Teknologji e re, treg i ri.

Kjo është mënyra stereotipe se si shumica e njerëzve e shohin inovacionin. Inovacioni radikal përfshin krijimin e teknologjive, shërbimeve dhe modeleve krejtësisht të reja.

### **PROJEKTET INOVATIVE DHE KLASIFIKIMI I TYRE**

Lind pyetja: Çfarë është projekti inovativ?

Projekti inovativ është një sistem kompleks i veprimeve që synojnë arritjen e qëllimeve të caktuara në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Ai përfshin një plan kërkimor të kufizuar në kohë, i cili përfshin krijimin e ideve, produkteve ose shërbimeve të reja, në zhvillimin e fushave të tilla si arsimi, teknologjia, modelet e biznesit, ekologjia etj. Ato mund të jenë teknike, menaxheriale, administrative, ekonomike dhe organizative. Në termin më të thjeshtë është përdorimi i ideve dhe qasjeve të reja, ose për të zgjidhur problemet ekzistuese. Pra do të thotë të jesh krijues i diçkaje të re, ose të vlerësosh efektivitetin e praktikave të reja, apo të ndryshuara. Programi inovativ është një kompleks i projekteve inovative të ndërlidhura, si dhe projekte që kanë për qëllim mbështetjen e aktivitetit.

Risitë janë një konstante në zhvillimin e qenies njerëzore, e për këtë arsye projektet inovative janë veprimet në të cilat zbatohen njohuritë, aftësitë dhe teknikat për t'iu përgjigjur nevojave të reja teknologjike, ekonomike, sociale, kulturore etj.

Objektivat kryesorë të një projekti inovativ janë:

- Identifikimi i karakteristikave e ndryshme të inovacionit.
- Shpjegimi dhe analizimi i secilës nga karakteristikat inovacionit.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të projekteve inovative sipas qasjeve dhe objektivave që i mbështesin ato, rrjedhimisht ato janë krijuese për faktin sepse lindin nga një ide, që çon në një veprim dhe kështu kërkojnë të zgjidhin ose përmirësojnë një problem, burim ose mbështetjen zhvillimin në përgjithësi.

#### ***Projekt teknologjik inovativ.***

Janë ato projekte që bazohen në krijimin, modifikimin ose jo përshtatjen e një biznesi ose produkti, apo shërbimi teknologjik social përmes njohurive, metodave, proceseve dhe instrumenteve. Këto projekte lindin nga mungesa ose dështimet, si dhe problemet e paraqitura nga mallra e shërbime të tjera, që përfshijnë teknologjinë. Prandaj, lind ideja për të ofruar zgjidhjen më të mirë,

ose përgjigjen ndaj nevojave të përdoruesve.

### ***Projekte novatore ekologjike.***

Janë ato projekte që synojnë zhvillimin e praktikave të përgjegjshme për përdorimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore dhe mjedisit. Në përgjithësi, qëllimi kryesor i këtyre projekteve është kujdesi dhe ruajtja e natyrës. Këto projekte ekologjike karakterizohen nga kërkimi i pajisjeve dhe mjeteve për të riparuar dhe rivendosur mjedisin, si dhe duke vlerësuar, e matur ndërhyrjen e njeriut në përdorimin e burimeve natyrore. Zbatuesit e këtyre projekteve, duhet të dinë rëndësinë dhe ndjeshmërinë e ekosistemeve të ndryshme në lidhje me shkatërrimin ose përkeqësimin e tyre natyral.

### ***Projekt novator arsimor.***

Këto projekte propozojnë strategji për krijimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe të nxënies përmes praktikave pedagogjike, menaxhimit institucional dhe administrativ, mjeteve të vlerësimit, metodave dhe burimeve arsimore, vlerave dhe përmbajtjes, që i përgjigjen nevojave të studentëve dhe zhvillimit arsimor të një vendi.

### ***Rëndësia e klasifikimit.***

Nisur nga idetë që ato zbatojnë, si dhe zgjidhjet teknike që ofrojnë, mund të kenë nivele të ndryshme të rëndësisë shkencore dhe teknike:

- Modernizimi (teknologjia bazë nuk është subjekt i ndryshimeve drastike).
- Inovacioni (përshkrimi i produktit të ri dallon shumë nga ai i mëparshëm).
- Zhvillimi (produkti do të krijohet për shkak të zgjidhjeve të avancuara teknike).
- Niveli “pioner” (koncepte apo teknologji të reja dhe materiale që nuk ekzistojnë më parë).

Niveli i rëndësisë së projektit të inovacionit përcakton kompleksitetin, shkallën, veçoritë e promovimit të rezultateve të procesit dhe përbërjen e interpretuesve, gjë që ndikon menaxhimin e projektit.

### ***Pyetje dhe mëdyshje, karakteristikat e projektit inovativ:***

1. A ekziston një zgjidhje efektive, por “më pak inovative” për çështjen apo problemin?

Shumë çështje apo probleme që ne përpiqemi t'i zgjidhim nëpërmjet projekteve të zhvillimit/ndihmës, mund të kenë zgjidhje që ne e dimë se si funksionojnë. Këto zgjidhje nuk janë të reja dhe ne kemi mjaft të dhëna për të treguar, se ato janë efektive në dhënien e zgjidhjes.

## 2. Si parashikohet që do të jetë kohëzgjatja e suksesit (ose dështimi)?

Nyja kyçe e inovacionit është ideja se duhet bërë diçka të re, qoftë duke përdorur teknologji të re, ose një proces apo qasje të re ndaj një problemi ekzistues. Nëse ajo që po provohet nuk është “e re” në një farë mënyre, atëherë ndoshta nuk është “novatore”. Suksesi ose dështimi afatgjatë i një inovacioni është i panjohur. Mund të arrihet sukses në një fushë, por risia mund të ketë pasoja negative të padëshiruara në të tjerat.

## 3. A është inovacioni juaj ekonomikisht i shkallëzuar?

E rëndësishme është të gjykohet për projektin: -A ka të ngjarë të ofrojë ai, shkallëzimin më të mirë ekonomik? Kjo mund të jetë mjaft e vështirë për t’u përcaktuar, pasi inovacioni ka të bëjë me të provuarit e gjërave të reja.

## 4. Çfarë tjetër mund të bëhet me paratë e donatorëve që po thith projekti juaj?

Për këtë pyetje, duhet llogaritur se çfarë tjetër më prioritar mund të financohet me paratë që po harxhohen për kërkimin, shkallëzimin dhe zbatimin e inovacionit. Funksionimi i një projekti përpara zgjidhjeve të njohura si efektive, mund të rezultojë në rendimente më të ulëta, e për më pak përfitues.

## 5. A po përpiqeni të zgjidhim problemin themelor duke përdorur vetëm teknologjinë?

Teknologjia mund të zhvillojë shumë gjëra në një procesi ekzistues. Megjithatë, ajo nuk mund të zgjidhë e vetme një problem themelor. Zhvillimi i një sistemi të keq dhe përsëritja e tij me teknologji më të mirë, mund të mos çojë domosdoshmërisht në përmirësime.

### ***Karakteristikat e një projekti inovativ:***

- Ka një strategji kërkimore dhe praktike të mirë vendosur dhe relevante në lidhje me objektivat e propozuara.
- Kërkon t’u përgjigjet ose të arrijë qëllime më të larta, sesa projektet inovative të mëparshme .
- Menaxhohet nga ekspertë të zonës së studimit dhe me aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur.
- Mjedisi i punës bazohet në besimin dhe kapacitetin e të gjithë atyre, që marrin pjesë në projekt.
- Teoria është pika fillestare për të zhvilluar idetë e ngritura në projekt.
- Është një mjet për sfidën e vazhdueshme të zhvillimit dhe sipërmarrjes, por nuk është qëllim në vetvete.
- Strategjia inovative e projektit, duhet të jetë e hartuar mirë për të përcaktuar

objektivat që duhen përmbushur.

Projektet inovative, në varësi të natyrës, kohëzgjatjes dhe asaj çfarë ofrojnë, mund të klasifikohen edhe si më poshtë:

1. Sipas natyrës së objektivave:

- Përfundimtarë.
- Të ndërmjetëm.

2. Sipas periudhës së zbatimit:

- Afatshkurtër.
- Afatmesëm.
- Afatgjatë.

3. Sipas nevojave që projekti kënaq. Këto projekte mund të përqëndrohen në krijimin e diçkaje të re ose në plotësimin e nevojave ekzistues.

4. Sipas llojit të inovacionit (krijimi i një produkti të ri ose përmirësimi, riorganizimi i strukturës së menaxhimit, etj.).

5. Sipas shkallës së vendimeve të marra, ato mund të kenë karakterin e mëposhtëm:

- Individual.
- Rajonal.
- Industrial.
- Kombëtar ose ndërkombëtar.

6. Shkalla e detyrave:

- Projektet më vete, janë projekte që kryhen nga një kompani në kornizat e rrepta financiare dhe afatet kohore, e që kanë një qëllim inovativ të qartë.
- Shumë projekte janë programe komplekse që synojnë arritjen e qëllimeve komplekse.
- Projektet e mëdha janë programe shumëplanëshe që kombinojnë një numër të madh projektesh të cilët kanë një qëllim të vështirë për t'u arritur.

## **ZBATIMI I PROJEKTEVE INOVATIVE**

Çdo projekt kalon nëpër faza të caktuara të zhvillimit, që nga fillimi, e deri në përfundimin e tij. Tërësia e fazave të projektit formon ciklin e zhvillimit të tyre, nga ideimi deri në zbatim. Ato ndryshojnë në varësi të organizimit të punës dhe fushës së veprimi të aktivitetit. Pasi krijohen projektet inovative



kalojnë nëpër fazën e zhvillimit, implementimit dhe përfundimit. Vlen të përqendrohet vëmendja në fazat kryesore, të cilat janë:

*Formimi dhe gjenerimi i ideve; Vlerësimi dhe eksplorimi i mundësive; Përgatitja e dokumentacionit për kontraktim dhe bashkëpunim; Përgatitja e dokumentacionit për hartimin e projektit; Puna për zhvillimin dhe zbatimin e programit; Monitorimi, optimizimi dhe shkallëzimi i treguesve.*

Në fazën e projektimit, vëmendje i kushtohet suksesit dhe efektivitetit të projektit. Megjithatë, detajet e ekzistencës së tij në këtë moment, nuk janë shumë të rëndësishme. Veçanërisht të rëndësishme janë risitë që do të sjellë konkurrenca, mbrojtja e licencave dhe disponueshmëria e patentës. Përveç kësaj, projektet inovative kërkojnë investime të fondeve të alokuara për përmirësimin e arritjeve.

Për zbatimin e projekteve përdoren njëkohësisht, si burimet e financimit të brendshëm, edhe ato të financimit të jashtëm. Burimet e brendshme janë nga fondet e veta, ndërsa burimet e jashtme të financimit përfshijnë fondet e huazuara, financimet nga buxheti apo donacionet e ndryshme. Inovacioni ndonjëherë është një fushë kritike kyçe për mbijetesë, prandaj duhet inkurajimi i ideve në mënyrë aktive, bashkëpunim me kompani të reja inovative dhe me palët e interesuara, si dhe gjithmonë duhet të pyeten ekspertët. Mbrojtja e inovacioneve është domosdoshmëri e vazhdueshme dhe metodat kryesore të mbrojtjes janë “mbrojtja ligjore” dhe “avantazhi i lëvizjes së parë”.

### ***Rreziqet e projekteve inovative.***

Projektet inovative janë programet me rrezikun më të madh për investime. Për këtë arsye, krijuesit e tyre duhet të vlerësojnë me të vërtetë aftësitë dhe mundësitë e tyre. Më tërheqës për investime, janë programet që synojnë promovimin e produkteve të reja. Projektet që lidhen me promovimin e teknologjive të reja karakterizohen nga një rrezik i shtuar, pasi është shumë më e vështirë për ta, që të krijojnë një koncept marketingu. Problemet me financimin lindin në rast se projekti ka një fazë të papërfunduar të kërkimeve. Atëherë, ekziston një mundësi e madhe për të pasur rezultat negativ.

Rreziqet e projekteve të inovacionit vijnë nga pasiguria, pasi marrja e vendimeve dhe zbatimi i tyre bëhet në kohë të ndryshme. Prandaj vlerësimi i rrezikut është baza e vendimeve që merren. Për klasifikimin e tyre, është e këshillueshme që të aplikohet parimi i vlerësimit në bllok, i cili siguron shpërndarjen e rreziqeve sipas kategorive, grupit, llojit, etj. Rreziqet e projekteve të inovacionit mund të klasifikohen si më poshtë:

- Parashikueshmëria: rreziqe të parashikueshme dhe të paparashikueshme.
- Mundësia e krijimit me dashje.

- Ekzistenca e dëmit, deri në kohën e zbulimit.
- Dëmi që shkaktohet në vendin e zbulimit.
- Mënyrat dhe metodat e zbulimit.
- Për arsye të shfaqjes.
- Për shkaktarët e shfaqjes.
- Me kohëzgjatjen e veprimit të rrezikut.
- Nëse është i mundur sigurimi nga rreziku.
- Për mundësitë dhe metodat e eliminimit të pasojave.
- Në shfaqjen gjatë fazave të procesit teknologjik.
- Sipas kushteve të prodhimit.
- Me çmime fikse.

Për të vlerësuar rreziqet e një projekti të ri, kërkohet të përcaktohet shkalla e kërkimit, pajtueshmëria me programin e strategjisë së tregut dhe marketingun. Veprimet për klasifikimin, vlerësimin dhe studimin e rreziqeve, janë të domosdoshme, pasi do duhet të menaxhohen ato.

### ***Vlerësimi i efektivitetit të projektit të inovacionit.***

Duhet të theksohet se risia në biznes kërkon investime të konsiderueshme intelektuale, financiare dhe të punës. Përveç kësaj duhet të investohet jo vetëm në projekt, por edhe për personelin që do zbatojë inovacionin, për punonjësit e kompanisë. Efektiviteti i një projekti inovativ varet si nga pjesëmarrësit, ashtu edhe nga treguesit përkatës të tyre. Gjithashtu edhe nga vëmendja dhe rëndësia që i kushton institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit, si edhe se sa është në gjendje të tërheqë vëmendjen e grupeve të interesit, për fonde shtesë. Vlerësimi i efektivitetit të projektit të inovacionit, bazohet në parimet e mëposhtme:

- Sa dhe si janë aplikuar çmimet për shërbimet, burimet, mallrat që sigurohen nga projekti ose janë instaluar në treg;
- Ndryshimet e mjeteve monetare duhet të llogariten në të njëjtat monedha siç parashikohet nga programi për pagesën e produkteve dhe blerjen e burimeve, të cilat më pas do të konvertohen në monedhën bazë, sipas normës aktuale;
- Në llogaritjet është e nevojshme të merret parasysh fitimi nga veprimtaria financiare dhe investuese, si dhe të zbatohet skema e financimit të projektit;
- Është e nevojshme të merren parasysh kontributet për fonde shtesë dhe të

ardhurat e nxjerra prej tyre.

Në procesin e llogaritjes së treguesve të efektivitetit të kompanive pjesëmarrëse, vlen të merren parasysh shpenzimet, pavarësisht nëse ato janë të tyre, ose të huazuara. Pagesat për huatë do të quhen dalëse dhe fondet e huazuara - hyrje.

## INOVACIONI NË FUSHËN E MBROJTJES

Arritja dhe ruajtja e avantazhit është një përpjekje e pafundme për fushën e mbrojtjes. Intensifikimi i rivalitetit gjeo-strategjik dhe gjeo-ekonomik midis fuqive të mëdha dhe revolucioni teknologjik global që ndodh në fushën civile dhe ushtarake, ndikojnë në riformësimin e natyrës dhe shpërndarjen e fuqisë globale.

Më së pari duhet të përkufizohet qartë dhe saktë, çfarë nënkuptohet dhe çfarë nuk nënkuptohet me inovacion në mbrojtje. Ndonjëherë inovacioni i mbrojtjes përdoret në mënyrë të ndërsjellë me terma dhe koncepte të tjera, që duken të ngjashme, ndonëse jo identike. Ato kanë dallime të rëndësishme, si inovacioni ushtarak, ose inovacioni i sigurisë kombëtare. Tom Mahnken, Andrew Ross dhe Tai Ming Cheung e kanë përcaktuar inovacionin e mbrojtjes si *“transformimin e ideve dhe njohurive në produkte, procese dhe shërbime të reja ose të përmirësuara, për aplikime ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë”*.<sup>2</sup> Ata dallojnë inovacionin e mbrojtjes nga inovacioni ushtarak, i cili sipas tyre është i përqendruar kryesisht në inovacionin e luftës, i cili përfshin inovacionin e produktit dhe inovacionin e procesit, inovacionin teknologjik, operacional dhe organizativ dhe synon të rritë aftësinë e forcave të armatosura për t’u përgatitur, luftuar dhe fituar luftën. Me fjalë të tjera, inovacioni i mbrojtjes është më i gjerë duke përfshirë edhe domenin civil, veçanërisht bazën industriale të mbrojtjes dhe bazën tregtare të lidhur me përdorim të dyfishtë, ndërsa inovacioni ushtarak është i fokusuar më ngushtë në fushën ushtarake.

Inovacioni ushtarak është një nga temat më të rëndësishme në arenën e studimeve strategjike dhe një përpjekje e pafund e institucioneve të mbrojtjes. Për përcaktimin e termit “inovacion ushtarak” apo inovacion në fushën e mbrojtjes, nuk ka ende përcaktime përfundimtare, sepse atë që dikush mund ta konsiderojë një risi, një tjetër mund ta quajë një përshtatje të një teknologjie, doktrine ose taktike ekzistuese, apo asnjëra prej tyre.

Për të ecur përpara në këtë drejtim, duhet të gjenden tema të përbashkëta dhe diferencuese në një gamë të gjerë përkufizimesh dhe (nganjëherë) në

<sup>2</sup> Tai Ming Cheung, Thomas G. Mahnken dhe Andrew L. Ross, ‘Korniza për analizimin e mbrojtjes dhe inovacionit ushtarak kinez’, në Tai Ming Cheung (Ed), *Formimi i fuqisë ushtarake të Kinës: Një kornizë e re për vlerësimin Inovacioni* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 2014).

një terminologji konceptuale kontradiktore. Fillimisht duhet të vlerësojmë studimet ekzistuese dhe rishikojmë artikujt, rastet dhe shembujt e propozuar të inovacionit ushtarak. Më pas duhet të propozojmë një kuadër të ri, i cili duhet të bazohet në kërkimet ekzistuese dhe sugjeron një rrugë tjetër, për kërkimet e ardhshme. Për këto, duhet demonstruar besueshmëria e tyre dhe aplikimi për rastet më të spikatura.

Arritja e avantazheve teknologjike është një përpjekje e pafund për institucionet e mbrojtjes. Përpjekjet në kuadrin e konkurrencës afatgjatë janë zhvilluar me një trend të qëndrueshëm në rritje, por herë pas here janë ndërprerë nga periudha trazirash dhe shkatërrimesh. Këto kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve të shkaktuara nga bashkimi i dy zhvillimeve transformuese: së pari, është intensifikimi i rivalitetit gjeo-strategjik dhe gjeo-ekonomik midis fuqive të mëdha, veçanërisht midis SHBA-së dhe Kinës. Së dyti, është një revolucion global teknologjik që po ndodh si në fushën civile, ashtu edhe në atë ushtarake. Të marra së bashku këto dinamika, premtojnë të riformësojnë rrënjësisht natyrën dhe shpërndarjen e fuqisë globale.

Ky synim për kërkim dhe inovacion, ndryshon lojën dhe është bërë një prioritet i ngutshëm për fuqitë ushtarake kryesore në botë, gjë që ka çuar në rritjen e institucioneve dhe organizmave për të zhvilluar shprehimisht teknologji të avancuara ushtarake, si dhe strategji doktrinale e operacionale. Krijimi dhe rritja e rolit të këtyre institucioneve, tregon rëndësinë që institucionet e mbrojtjes po i kushtojnë inovacionit. Për të kuptuar dinamikën e peizazhit global të inovacionit të mbrojtjes, për të identifikuar se ku janë trendet në këtë përpjekje për kufirin teknologjik, për të përcaktuar se sa shpejt dhe me efektivitet po ecin dhe për të vlerësuar se kush po fiton tani, edhe në planin afatgjatë, është e domosdoshme të shikohet tërësia e ndërmarrjes së inovacionit të mbrojtjes së një vendi, se si ajo lidhet me trendet teknologjike të mbrojtjes kombëtare dhe globale.

Identifikohen tre komponentë kyç si për inovacionin e mbrojtjes, ashtu edhe për atë ushtarak, teknologjik, organizativ dhe doktrinor. Teknologjia shërben si burim i dimensionit *harduerik* të inovacionit mbrojtës dhe ushtarak, si dhe produkteve të saj konkrete. Ndryshimet organizative dhe doktrinale, *softueri* i inovacionit, ofrojnë atë që në literaturën e gjerë karakterizohet si inovacion i procesit. Ndërsa mbrojtja dhe inovacioni ushtarak, trajtojnë marrëdhëniet e ndërsjella midis këtyre tre dimensioneve. Në inovacionin e mbrojtjes, dimensionin teknologjik zë një rol më të spikatur për shkak të një fokusi më të madh në proceset e kërkimit, zhvillimit dhe blerjes. Inovacioni ushtarak ka tentuar të vendosë theksin në çështjet doktrinare dhe të luftës.

### ***Korniza konceptuale e inovacionit të mbrojtjes.***

Korniza konceptuale e inovacionit të mbrojtjes specifikon një grup gjithëpërfshirës faktorësh, marrëdhëniet ndërmjet tyre, nivelet e analizës dhe ekzaminimit të attributeve të tjera përkatëse, si faktorët e dobët dhe të fortë të inovacionit, edhe një tipologji të rezultateve të inovacionit. Pavarësisht se ajo ofron një bazë për kërkimin e përgjithshëm krahasues të inovacionit të mbrojtjes nëpër vende, teknologji dhe produkte, nuk synon të japë shpjegime të sjelljes ose rezultateve, që është kompetencë e teorive dhe modeleve.<sup>3</sup>

Baza e një kornize është koncepti i një sistemi inovativ të mbrojtjes, i cili rrjedh nga nocioni i sistemit kombëtar të inovacionit. Sistemet kombëtare të inovacionit janë ekosisteme komplekse, në zhvillim të vazhdueshëm që përfshijnë “të gjithë faktorët e rëndësishëm ekonomikë, socialë, politikë, organizativë, institucionalë dhe të tjerë që ndikojnë në zhvillimin, përhapjen dhe përdorimin e inovacioneve”.<sup>4</sup> Mënyrat e ndryshme se si janë ngritur dhe funksionojnë, që organizmat dhe institucionet inovative brenda vendeve ndihmojnë për të shpjeguar ndryshimin në stilin kombëtar të inovacionit.

Kornizat dhe teoritë e nxjerra nga studimi i procesit të politikave publike, janë gjithashtu të dobishme në formësimin e kornizës së sistemeve të inovacionit të mbrojtjes. Në veçanti dallohen tre të tilla:

- Grupi i kornizave të zgjedhjes racionale institucionale, që fokusohen në mënyrën se si rregullat institucionale formësojnë sjelljen e aktorëve racionalë.<sup>5</sup>
- Korniza e ekuilibrit të pikëzuar që argumenton se bërja e politikave zakonisht zhvillohet në mënyrë *incrementale*<sup>6</sup> për periudha të gjata, por evidentohet nga periudha të shkurtra me ndryshime të mëdha.
- Korniza e koalicionit të avokimit<sup>7</sup> që shqyrton ndërveprimin e koalicioneve brenda nënsistemeve të politikave.<sup>8</sup>

Kuadri i sistemeve të inovacionit të mbrojtjes përfshin një sërë konceptesh të

---

<sup>3</sup> Edella Schlager, “A Comparison of Frameworks, Theories, and Models of Policy Processes” (Boulder, Co: Westview 2007).

<sup>4</sup> Charles Edquist and Bjorn Johnson, ‘Institutions and Organizations in Systems of Innovation’, (Oxford: Routledge, 2005); and Charles Edquist, ‘Systems of Innovation: Perspectives and Challenges’ (Oxford University Press, 2004)

<sup>5</sup> Elinor Ostrom, ‘Institutional Rational Choice: An Assessment of the Institutional Analysis and Development Framework’, in Sabatier, Theories of the Policy Process.

<sup>6</sup> Kuptimi rritës

<sup>7</sup> Avokimi është proces i ndërmarrjes së veprimeve për të krijuar ndryshime.

<sup>8</sup> Paul Sabatier and Christopher Weible, “The Advocacy Coalition Framework”, (Boulder, Co: Westview 2007).

paraqitura në këto korniza, si rrjetet dhe nënsistemet dhe faktorët institucionale.

Inovacioni i mbrojtjes përkufizohet si transformimi i ideve dhe njohurive në produkte, procese dhe shërbime të reja ose të përmirësuara, për aplikime ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë. Ky përkufizim i referohet kryesisht organizatave dhe aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen dhe shkencën, teknologjinë dhe bazën industriale civilo-ushtarake me përdorim të dyfishtë. Të përfshira në këtë nivel janë ndryshimet në planifikim, programim, buxhetim, kërkim, zhvillim, blerje dhe procese të tjera të biznesit.

Një sistem i inovacionit të mbrojtjes mund të përkufizohet gjerësisht si një rrjet organizmesh dhe institucioneve që ndjekin në mënyrë interaktive aktivitete të lidhura me shkencën, teknologjinë dhe inovacionin për të çuar më tej zhvillimin e interesave dhe aftësive të mbrojtjes, veçanërisht të lidhura me aktivitetet strategjike, të mbrojtjes dhe me përdorim të dyfishtë civilo-ushtarake. Ndërsa sistemet e inovacionit të mbrojtjes kanë qenë tradicionalisht të kufizuara brenda kufijve kombëtarë, ka pasur një tendencë në rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar të mbrojtjes, në periudhën pas Luftës së Ftohtë, veçanërisht midis SHBA dhe Europës, që ka tejkaluar identitetin kombëtar. Vlen të theksohen dy aspekte të këtij përkufizimi:

- Organizmat inovativë i referohen subjekteve që janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mbështetjen e procesit të inovacionit. Ato përfshijnë institutet kërkimore, universitetet, agjencitë shtetërore, njësitë ushtarake, agjencitë industriale të mbrojtjes dhe ndërmarrjet publike e private, në nivel qendror dhe lokal.
- Natyra e ndërveprimit ndërmjet organizmave inovative është kritike dhe kjo realizohet nëpërmjet rregullimeve institucionale të përcaktuara mirë, të cilat janë norma, rutina, zakone, praktika të vendosura dhe rregulla të tjera të lojës që ekzistojnë për të udhëhequr funksionimin e sistemit dhe ndërveprimet ndërmjet tyre.

Sistemet e inovacionit të mbrojtjes janë të formave, përmasave dhe niveleve të ndryshme të avancimit teknologjik, por vetëm një numër i vogël vendesh, individualisht ose në bashkëpunim me vendet partnere, janë të gatshëm dhe të aftë të përballojnë funksionimin dhe mbështetjen e kërkimit, zhvillimit, inxhinierisë dhe prodhimit. Këto sisteme komplekse përbëhen nga komponentë të shumtë që lidhen dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme.

### ***Kategoritë e faktorëve.***

Në procesin e inovacionit të mbrojtjes, janë të përfshirë grupe të ndryshëm faktorësh dhe korniza dallon shtatë kategori:

- *Faktorët katalitikë:* janë faktorët që nxitin inovacionin e një natyre zëvendësuese.

- *Faktorët hyrës*: janë forma materiale, financiare, teknologjike dhe forma të tjera të kontributeve që alokohen në sistemin e inovacionit të mbrojtjes.
- *Faktorët institucionalë*: janë rregulla, norma, rutina, praktika të vendosura, ligjet dhe strategjitë që rregullojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet ndërmjet aktorëve (individëve dhe grupeve) brenda dhe jashtë sistemit të inovacionit të mbrojtjes.<sup>9</sup>
- *Struktura dhe faktorë të tjerë*: janë struktura formale të krijuara me një qëllim të qartë dhe posaçërisht si aktorët kryesorë, brenda sistemit të inovacionit të mbrojtjes dhe njësive kryesore të analizës.
- *Rrjetet dhe nënsistemet*: janë rrjetet sociale, profesionale, virtuale dhe lloje të tjera të rrjeteve që u lejojnë aktorëve, veçanërisht individëve dhe mjeteve për t'u lidhur me njëri-tjetrin brenda dhe përtej sistemeve të inovacionit të mbrojtjes, si brenda dhe jashtë vendit.<sup>10</sup>
- *Faktorët kontekstualë*: kjo kategori mbulon grupin e faktorëve të ndryshëm që ndikojnë dhe formësojnë mjedisin e përgjithshëm të inovacionit të mbrojtjes.
- *Faktorët e prodhimit*: janë përgjegjëse për përcaktimin e natyrës së produkteve dhe proceseve që dalin nga sistemi i inovacionit.

Kjo listë e gjerë e kategorive dhe faktorëve nuk është aspak shtrëuese. Ajo është përpjekje fillestare për të përcaktuar kapur komponentët dhe nxitësit më të spikatur dhe domethënës të sistemit të inovacionit të mbrojtjes. Këto kategori janë të ndërveprueshme dhe ka raste kur faktorët mund të mbivendosen midis tyre.

### ***Llojet e rezultateve të inovacionit.***

Rezultatet e inovacionit që konkludojnë nga ndërveprimet midis faktorëve të ndryshëm të këtij kuadri që shtrihen nga kopjimi i thjeshtë dhe deri te inovacioni shumë i sofistikuar thelbësor:

1. *Imitimi i dyfishtë*: Produktet, zakonisht të marra nga burime të huaja, kopjohen nga afër me pak ose aspak përmirësime teknologjike.
2. *Imitimi krijues*: Kjo përfaqëson një formë më të sofistikuar imitimi që gjeneron produkte imituese me karakteristika të reja të performancës.
3. *Përshtatja kreative*: Produktet janë ideuar nga teknologjitë ekzistuese me prejardhje të huaja, por mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme prej tyre.

<sup>9</sup> Ostrom, "Institutional Rational Choice: An Assessment of the Institutional Analysis and Development Framework", in Sabatier, Theories of the Policy Process, 26.

<sup>10</sup> Mark Zachary Taylor, The Politics of Innovation (Oxford University Press, 2016), 157–68.



4. *Inovacioni në rritje*: Ky është përditësimi dhe përmirësimi i kufizuar i sistemeve dhe proceseve ekzistuese, mund të jetë një përmirësim gradual i një sistemi përmes futjes së nënsistemeve të përmirësuara.

5. *Inovacioni arkitektonik*: Kjo mund të dallohet midis varianteve të produktit dhe procesit dhe i referohet risive të(ri)dizenjimit të sistemeve të prodhimit, në një qasje të integruar që përmirëson ndjeshëm proceset, por që zakonisht nuk rezultojnë në risi radikale të produktit.

6. *Risi përbërëse ose modulare*: Kjo përfshin zhvillimin e teknologjisë së re të komponentëve që mund të instalohen në arkitekturën e sistemit ekzistues.

7. *Risi radikale ose asgjësuese*: Kjo kërkon përparime të mëdha si në teknologji ashtu edhe në arkitekturë, që vetëm vendet me kapacitete dhe personel me bazë të gjerë, të klasit botëror, së bashku me burime të thella financiare dhe gatishmërinë për të marrë rrezikun, mund të angazhohen në to.

## PËRFUNDIME

Duke shqyrtuar rolin, ndikimet dhe implikimin e inovacionit në nevojën për reformim, modernizim gjithëpërfshirës të stadeve aktuale të zhvillimit, është domosdoshmëri që në të ardhmen të zhvillohen ide, rregulla dhe standarde të reja në zhvillimin e inovacionit, duke motivuar nëpërmjet politikave kombëtare e ndërkombëtare. Kuptohet, nuk duhet të harrojmë faktin se këto përpjekje do të jenë dhe nën ndikimin e globalizmit dhe gjithëpërfshirjes. Fakt është se inovacioni ka ndryshuar dhe gjeneruar ide të reja për explorimin e mundësive për modernizim, monitorim, optimizim dhe shkallëzim të treguesve dhe nevojave teknologjike, ekonomike, doktrinare, sociale, kulturore etj.

Zhvillimi dhe inovacioni duhet të bëhen kryefjala e punës kërkimore e shkencore të stafeve akademike-mësimore dhe strukturave kërkimore e shkencore, me qëllim për t'i paraprirë të rejave dhe të panjohurave, për të qenë sa më të suksesshëm në përballje me sfidat e sigurisë në të ardhmen. Përmes modernizimit duhet të zgjerojmë bazën e mendimit, duke përfshirë sa më shumë të rinj dhe duke tentuar që inovacioni të kthehet në mënyrë të natyrshme të menduari.

Pjesëmarrja aktive në projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore, duke bashkëpunuar edhe me partnerët, ofron kërkim dhe inovacion. Kjo kërkon përpjekje shumë të mëdha dhe duhet të bëhet pjesë e punës sonë të përditshme, duke synuar standarde ndërkombëtare dhe konkurruese.

Inovacioni nga shtetet e mesme dhe të vogla ka më shumë mundësi që të përqendrohet në zhvillimin e aftësive të veçanta dhe jo të gjithanshme, siç janë: inovacioni arkitektonik-rikonfigurimi i *harduerit* dhe *softuerit*, i



teknologjisë, doktrinës dhe organizimit. Mungesa e burimeve financiare në zhvillimin, prodhimin, blerjen, vendosjen dhe punësimin e aftësive të reja, mund të përbëjë rreziqe për rendin dhe stabilitetin rajonal e global, në kuadrin e intensifikimit të konflikteve globale gjeopolitike.

Shqipëria për herë të parë është bërë pjesë e raportit “Rankimi European i Inovacionit” (*European Innovation Scoreboard*), i cili paraqet një vlerësim krahasues të performancës së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të shteteve anëtare të BE-së, vendeve të tjera europiane dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria renditet si një vend inovator në zhvillim me një rankim 41,7%, krahasuar me mesataren e BE-së. Pika të forta relative që kanë ndikuar në rankimin e Shqipërisë janë: teknologjitë e lidhura me mjedisin; shitjet e produkteve innovative; të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe inovatorët e produkteve.

### **Burime të shfrytëzuara:**

1. Abramovitz, Moses, “Catching Up, Forging Ahead, and Falling Behind”, *Journal of Economic History* 46/386.
2. Baumgartner, Frank and Bryan Jones, *Agendas and Instability in American Politics* (Chicago: University of Chicago Press 1993).
3. Black, Jeremy, *War and Technology* (Bloomington, IN: Indiana University Press 2013).
4. Cheung, Tai Ming, ‘The Chinese Defence Economy’s Long March from Imitation to Innovation’, *Journal of Strategic Studies* 34/3 (June 2011).
5. Edquist, Charles, “Systems of Innovation: Perspectives and Challenges.”
6. Edquist, Charles and Bjorn Johnson, “Institutions and Organizations in Systems of Innovation”, (Oxford: Routledge 2005).
7. Nelson, Richard, Ed, *National Innovation Systems* (Oxford University Press 1993).
8. Parker, Geoffrey, “The Military Revolution: Military Innovation and the Rise of the West”, 1500-1800 (Cambridge University Press 1996).
9. Taylor, Mark Zachary, “The Politics of Innovation” (Oxford University Press 2016).
10. *International journal of innovation management*.
11. Florence Bailey: “WHYTT Magazine”.
12. Peter Drucker: “Innovation and entrepreneurship”.
13. <http://www.instat.gov.al>

14. <https://morethandigital.info/en/innovation-definition-innovation-types-and-meaning/>
15. <https://www.tandfonline.com/loi/fjss20> Journal of Strategic Studies
16. <https://research-and-innovation.ec.europa.eu>
17. <https://warbletoncouncil.org/>

# SIGURIA KIBERNETIKE NË FORCAT E ARMATOSURA

**Nënkolonel Dritan MERDANI**

*Drejtor i Njësisë Ushtarake të Sigurisë  
Kibernetike*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Zhvillimi i internetit në dhjetëvjeçarët e fundit, si dhe ndryshimet e reja në teknologji, kanë sjellë ndryshime rrënjësore dhe sfida në çdo shoqëri, në mbarë botën. Jeta jonë e përditshme, të drejtat e njeriut, ekonomitë dhe ndërveprimet shoqërore, ndikohen thellësisht nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Një hapësirë e përbashkët dhe e lirë kibernetike, promovon përfshirjen sociale dhe politike, thyen barrierat e komunikimit midis vendeve, komuniteteve dhe qytetarëve, siguron transparencë, duke lejuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe ideve në kohë reale, në të gjithë globin.*

*Të gjitha zhvillimet dhe rritja e përdorimit të teknologjive së informacionit dhe komunikimit, vijnë me përfitime të mëdha, por në të njëjtën kohë sjellin kërcënime.*

*Prandaj mbrojtja kibernetike dhe siguria janë vendimtare. Në hapësirën kibernetike, ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme nga individë dhe grupe të ndryshme me interesa keqdashës, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e shteteve. Ndërhyrjet në privatësi dhe vjedhjet e identitetit, janë gjithashtu një problem në rritje dhe shumë shqetësues për të gjithë shoqërinë.*

## GJENDJA E SIGURISË KIBERNETIKE NË FA

Situata të tilla tregojnë se hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë. Aktorët e kërcënimit kibernetik kërkojnë gjithnjë e më shumë të destabilizojnë vendin tonë duke përdorur aktivitete dhe fushata keqdashëse kibernetike.

Ata janë në gjendje të arrijnë një gamë të gjerë efektesh me rëndësi taktike, operacionale dhe strategjike, duke përfshirë aktivitete shkatërruese në hapësirën kibernetike, duke vlerësuar se mund të veprojnë pa u ndëshkuar, kur aktivitetet e tyre fshihen nga publiku. Ndikimi individual ose i grumbulluar i këtyre aktiviteteve dhe fushatave keqdashëse kibernetike, mund të ndikojë ndjeshëm në sigurinë, kohezionin dhe besueshmërinë. Ai mund të dëmtojë infrastrukturën dhe sektorët kritikë, duke ndikuar potencialisht në aftësinë e FA-ve, për të realizuar detyrat kryesore kushtetuese.

Për Forcat e Armatosura, rreziku për sigurinë e sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike të MM/FA-së, vlerësohet shumë i lartë, veçanërisht në lidhje me informacionin që trajtohet në këto struktura. Përballja dhe menaxhimi i këtyre rreziqeve duhet të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit, koordinimit dhe partneritetit, ndërmjet të gjitha palëve të përfshira në fushën e sigurisë kibernetike.

Në kuadër të planeve të veprimit, në zbatim të këtyre strategjive, janë bërë përmirësime të ndjeshme në rritjen e aftësive organizative kundrejt kërkesave të sigurisë kibernetike. Është siguruar një qasje gjithëpërfshirëse e strukturave të MM/FA-së, për të pasur një kuptim më të qartë për hapësirën kibernetike dhe dobësitë e saj.

Janë shtuar kapacitetet operacionale të SNI-ve, në aspekte të ndryshme të sigurisë kibernetike, duke është rritur ndërgjegjësimin e personelit në lidhje me sigurinë kibernetike.

Rritja e varësisë gjithnjë e më shumë ndaj internetit të sistemeve të Komunikimit dhe të Informacionit të FA, solli si domosdoshmëri që Ministria e Mbrojtjes të përgatitë dokumentet strategjikë në mbështetje të zhvillimeve të reja. Në vitin 2016 filloi përgatitja dhe miratimi i dokumentit të Strategjisë për Mbrojtjen Kibernetike, e cila rishikohet çdo dy vjet.

Aktualisht është në veprim Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike e viteve 2021-2023. Kjo strategji ka si vizion garantimin e hapësirës kibernetike të sigurtë, në të gjithë aktivitetin e MM-së dhe FA-ve.

Kjo realizohet nëpërmjet zhvillimit dhe vendosjes në efikasitet të kapaciteteve për sigurinë kibernetike, për të konsoliduar aftësitë mbrojtëse dhe kundërvepruese, si dhe përmes rritjes së vetëdijes, profesionalizmit dhe fuqizimit të bashkëpunimit

e koordinimit, me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i saj është mbajtja e një mjedisi elektronik të sigurt, elastik e të besueshëm që mbështet sigurinë në MM/FA, i cili rrit përfitimet digjitale në interes të misionit dhe detyrave specifike, garantimi i Sigurisë Kibernetike nëpërmjet mbrojtjes së Infrastrukturave të Informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike, ndërtimi i një mjedisi të sigurt, duke edukuar dhe ndërgjegjësuar personelin e MM/FA-së, si dhe rritja e bashkëpunimit kombëtar me atë ndërkombëtar, si anëtar i NATO-s në fushën e sigurisë kibernetike.

Gjatë kësaj kohe, janë identifikuar infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të informacionit në FA, të cilat përfshihen në infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme kombëtare. Janë hartuar masat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në këto infrastruktura, si dhe është ngritur Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike si njësi e specializuar për mbrojtjen kibernetike për FA-të. Masat përfshijnë gjithashtu mbrojtjen e sistemeve të MM/FA-ve të ndërlidhura me nyjet e komunikimit dhe sisteme të tjera kombëtare, të cilat janë zhvilluar dhe ndërtuar për të ndihmuar në shpërndarjen e shërbimeve që shkëmbehen ndërmjet MM/FA-ve dhe strukturave të tyre të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, me struktura të tjera kombëtare, ose jashtë vendit.

Në vazhdim të kësaj, FA duke u bazuar në ligjin 2/17 “Për Sigurinë Kibernetike” zbatojnë një sërë masash, duke përfshirë zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI), për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit për garantimin e shërbimeve bazë për MM/FA-në, të menaxhimit të aseteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Realizimi i kontrollit dhe vlerësimit të vijueshëm të masave të sigurisë, të reflektimit të kërkesave të sigurisë në projektet e reja të sistemeve të komunikimit dhe informacionit, zbatimit të teknologjive mbrojtëse dhe të akreditimit të SKI-ve. Kjo krijon mundësinë e reduktimit të portave të hyrjes së internetit (internet gateway) në sistemet e MM/FA-së në numrin më të vogël praktik që nevojitet, duke rritur efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe sigurinë, partneritet ndërmjet të gjitha strukturave të MM/FA-së, të cilat marrin shërbimet e sistemeve nëpërmjet nyjeve të ndërlidhura në sistem dhe palëve të tjera të sigurisë në strukturat e FA-së. Kjo promovon siguri efektive në ndërlidhjen e sistemeve të MM/FA-së, duke u mbështetur në standardet kombëtare të sigurisë dhe ato të NATO-s, si dhe rishikimin e politikave, standardeve dhe procedurave të sigurisë në MM/FA, për të siguruar që politikat e sigurisë dhe standardet, vijnë të mbajnë përputhshmëri me zhvillimet e teknologjisë së informacionit në praktikën më të mira.

Rëndësi të veçantë për FA-të ka trajnimi i personelit të saj për ndërgjegjësimin mbi sigurinë kibernetike për personelin e MM/FA-së në lidhje me një sërë kërcënimesh të sigurisë së informacionit dhe politikat dhe procedurat për

adresimin e tyre. Një trajnim i tillë merr një larmi formash dhe temash të ndryshme. Trajnimi dhe programi janë integrale për ndërtimin e një kulture të sigurisë në organizatat moderne, të varura nga bota digjitale. Ai duhet të jetë ofrimi i këshillave koncize, vepruese dhe të paharrueshme, se si të zvogëlohen rreziqet që lidhen me sigurinë kibernetike dhe teknologjinë e informacionit, qofshin ato digjitale apo fizike.

Personeli në strukturat e MM/FA-së që përdor sistemet e komunikimit dhe informacionit, si dhe pajisjet elektronike për një larmi qëllimesh me një ritëm gjithnjë e në rritje, duhet të jetë i vetëdijshëm mbi kërcënimet kibernetike, të kuptojë mjedisin kibernetik dhe rreziqet e tij.

Edukimi dhe trajnimi duhet të përfshijë të gjitha shtresat e institucionit për të bërë të vetëdijshëm personelin e MM/FA-së për mundësitë dhe rreziqet e botës digjitale. Kjo siguron që të zbulohen sulmet në internet dhe të përfshijnë masa mbrojtëse të shpejta. Duke zhvilluar programe për stërvitje mbi sigurinë kibernetike, të testojë dhe të përmirësojë më tej programet e përgjigjes ndaj incidenteve kibernetike.

Edhe pse në hapat e para, MM dhe FA rëndësi të madhe i kanë kushtuar forcimit të aseteve kibernetike gjatë misionëve dhe stërvitjeve shumëkombëshe. Si mundësi e të ardhmes, përdorimi i aseteve digjitale në operacionet ushtarake, institucionet e mbrojtjes do të përqendrohen posaçërisht në zhvillimin e mëtejshëm të një doktrine mbrojtëse kibernetike, zhvillimin e aseteve ofensive dhe përgatitjen e udhëzimeve për përgatitjen e njësive kibernetike. Ajo synon asete me një model fleksibël, vendosjen e aseteve mbrojtëse digjitale gjatë misionëve, zhvillimin e tyre dhe aseteve të inteligjencës kibernetike për përdorim taktik, si dhe integrimin e aspekteve kibernetike në procesin e vendimmarrjes operative, para dhe pas operacioneve.

## **NJËSIA USHTARAKE E SIGURISË KIBERNETIKE**

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike (NJUSK) është strukturë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në varësi të drejtpërdrejtë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e ngritur me urdhrër të Kryeministrit nr. 76, datë 10.06.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010, të Kryeministrit”, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, ndryshuar me urdhrin e KM nr. 151, datë 07.09.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010, të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

Qëllimi i kryesor është menaxhimi i sistemeve të sigurisë kibernetike që mbikëqyrin në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa ndërprerë gjatë gjithë javës (24/7), Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI-të) të Forcave të

Armatosura (FA) nga ndërhyrjet e pa autorizuar në këto sisteme, për të siguruar infrastrukturë të qëndrueshme të rrjeteve statike dhe të dislokueshëm, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponibilitetin e informacionit si brenda territorit të vendit, ashtu dhe në kuadër të operacioneve të NATO-s.

### **Parimet që duhet të ndiqen**

Përgjegjësia themelore e mbrojtjes kibernetike për MM/FA është të mbrojë SKI-të e saj në përputhje me ligjin 2/17 “Për Sigurinë Kibernetike” dhe aktet e dalë prej tij.

Programet e edukimit dhe ndërgjegjësimin do të ekzekutohen për të siguruar që përdoruesit të ndërgjegjësohen për përgjegjësitë e tyre dhe rëndësinë e adoptimit të higjienës së mirë kibernetike, në mënyrën e tyre të punës.

Mbrojtja kibernetike duhet të përfshihet në planifikimin ushtarak në të gjitha nivelet e komandim-drejtimin. Kërcënimet dhe rreziqet kibernetike duhet të merren parasysh në përputhje me Planifikimin e Operacioneve të vendit dhe të NATO-s.

Mbrojtja kibernetike duhet të përfshihet në të gjitha aktivitetet e Arsimit, Trajnimit, Stërvitjeve dhe Vlerësimit në përputhje me kërkesat e detajuara në Stragjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike në veprim dhe të Strategjisë së Mbrojtjes Kibernetike të MM.

Stërvitjet ushtarake në parim, duhet të përfshijnë skenarë sfidues kibernetikë për të përmirësuar aftësinë e komandantëve dhe personelit, për të vepruar në mjedise të degraduara kibernetike.

Incidentet kibernetike trajtohen në pesë faza:

*Parandalimi:* Masat për të rritur qëndrueshmërinë ndaj incidenteve të mundshme kibernetike; *Zbulimi:* Aftësitë dhe procedurat për të zbuluar incidentet kibernetike; *Përgjigjja:* Aftësitë dhe procedurat për të reaguar ndaj incidenteve kibernetike dhe për të zbutur ndikimin e tyre në misionet në vazhdim; *Kalimi në operacionalitet:* Kapacitetet dhe procedurat për të rifituar aftësinë për të arritur qëllimin dhe detyrat e Komandantit; *Feedback:* Mësimet e nxjerra për të mundësuar përmirësim të vazhdueshëm dhe për t’u përshtatur me rreziqet e mundshme duke rritur qëndrueshmërinë kibernetike.

### **FUSHA E PESTË E OPERACIONEVE**

Vendimet e Samitit të Varshavës të vitit 2016 konfirmuan mandatin mbrojtës të NATO-s dhe hapësirën kibernetike si një “domen” operacional, në të cilin NATO-ja duhet të mbrojë veten me efektivitet, ashtu siç vepron në ajër, tokë dhe det.

Në cilësinë e vendit anëtar të NATO-s, Shqipëria njeh hapësirën kibernetike si domenin e pestë të luftës, së bashku me tokën, detin, ajrin dhe hapësirën. Në këtë këndvështrim, hapësira kibernetike paraqet sfida dhe siguria në këtë hapësirë arrihet vetëm duke menduar në nivel global dhe duke punuar ngushtë në nivel ndërkombëtar. Me partnerët ndërkombëtarë, NATO-ja mund të mbështesë FA-në në përgatitjen e standardeve të sigurisë, në promovimin e një shkëmbimi më të mirë të informacionit dhe njohurive, si dhe në sigurimin që vendet mund të operojnë më mirë së bashku.

Zbatimi i suksesshëm i misioneve dhe operacioneve të FA-së varet gjithnjë e më shumë nga aksesit i pandërprerë në një hapësirë të sigurt kibernetike, dhe për këtë arsye kërkohen kapacitete operacionale kibernetike të fuqishme dhe elastike.

Objektivi i MM është të zhvillojë më tej politikën e saj për mbrojtjen kibernetike, duke marrë parasysh zhvillimet përkatëse në fushat të tjera që identifikojnë mbrojtjen kibernetike si një element kyç, si dhe duke njohur nevojën për operacione kibernetike mbrojtëse në çdo kontekst operacional. Ky objektivi bazohet në ndërgjegjësimin aktual dhe parashikues të situatës të sofistikuar në hapësirën kibernetike, duke përfshirë aftësinë për të kombinuar sasi të mëdha të dhënash dhe inteligjencë nga burime të shumta, në mbështetje të vendimmarrjes së shpejtë dhe rritjes së automatizimit të procesit të mbledhjes, analizës dhe mbështetjes së të dhënave.

Fushat prioritare për Mbrojtjen Kibernetike janë zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike, mbrojtja e rrjeteve të komunikimit dhe informacionit të MM/FA, trajnime dhe stërvitje, kërkime shkencore dhe teknologji, bashkëpunim civilo-ushtarak dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Në fushën e trajnimit, theksi i kushtohet rritjes së trajnimit të mbrojtjes kibernetike të specialistëve të NJUSK dhe trajnimit kibernetik të ndërgjegjësimit të të gjithë përdoruesve të rrjeteve kompjuterike të MM/FA. Është gjithashtu e rëndësishme që dimensionin kibernetik të trajtohet në mënyrë të mjaftueshme në stërvitje, për të përmirësuar aftësitë e personelit të MM/FA, në reagim ndaj krizave kibernetike dhe hibride, duke përmirësuar procedurat e vendimmarrjes dhe disponueshmërinë e informacionit.

Hapësira kibernetike është një fushë me zhvillim të shpejtë, prandaj zhvillimet e reja teknologjike duhet të mbështeten, si në fushën civile, ashtu edhe në atë ushtarake. Bashkëpunimi civilo-ushtarak në fushën kibernetike, është kyç për të siguruar një përgjigje koherente ndaj kërcënimeve kibernetike.

Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë mund të ndihmojë në rritjen e sigurisë kibernetike në MM/FA dhe më gjerë, e në promovimin e parimeve dhe vlerave të vendit tonë.



Në kuadër të aktiviteteve me NATO-n, në njohjen e realiteteve të reja të kërcënimeve të sigurisë ndaj saj, krerët e shteteve dhe qeverive aleate janë zotuar të sigurojnë, që Aleanca të ecë paralel me peizazhin e kërcënimit kibernetik në zhvillim të shpejtë, e se të gjitha vendet do të jenë në gjendje të mbrohen në hapësirën kibernetike si në ajër, në tokë dhe në det.

Programi i NATO-s “Cyber Defence Pledge”, i cili përfshin dakordësinë e vendeve të Aleancës që të zgjerojnë mbrojtjen kibernetike për rrjetet dhe infrastrukturën kombëtare, të cilat konsiderohen si një çështje me prioritet në të cilën çdo vend aleat, në respekt të përgjegjësisë së tij, të përmirësojë qëndrueshmërinë dhe aftësinë për t’u përgjigjur shpejt dhe me efektivitet ndaj sulmeve kibernetike. Çdo vend aleat, është dhe do të jetë përgjegjës për të mbrojtur rrjetat e tij kombëtare, të cilat duhet të jenë të përshtatshme me ato të NATO-s dhe të njëri-tjetrit, si dhe të zgjerohet shkëmbimi i informacionit për mbështetje të përbashkët në parandalimin, zvogëlimin dhe rigjenerimin nga sulmet kibernetike.

## **SFIDAT E VAZHDUESHME TË MBROJTJES KIBERNETIKE**

Sfidat e sigurisë për (SNI/SKI) përfshijnë të gjitha nivelet e strukturave të MM/FA-së, duke filluar nga pajisjet individuale, që përdoren në mjediset zyrtare të punës, deri në sigurimin e sistemeve themelore, të cilat janë kritike për mbarëvajtjen e punës. Disa nga sfidat që karakterizojnë këtë situatë dhe orientimet për të ardhmen, janë:

Hapësira kibernetike është e domosdoshme për kryerjen e detyrave kryesore FA, edhe pse kërcënimet kibernetike ndaj sigurisë së vendit tonë dhe Aleancës së NATO-s po bëhen komplekse, shkatërruese, shtrënguese, gjithnjë e më të shpeshta. Aktivitetet dhe fushatat e vazhdueshme keqdashëse kibernetike nga aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, përfshirë ato që sponsorizohen nga shtete, si për vjedhje informacioni, ashtu edhe si pjesë e fushatave hibride, janë gjithnjë e më të zakonshme në mjedisin ndërkombëtar.

Hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë. Aktorët e kërcënimit kërkojnë gjithnjë e më shumë të destabilizojnë, duke përdorur aktivitete dhe fushata keqdashëse kibernetike, nën prapësinë e një sulmi të armatosur. Ata janë në gjendje të arrijnë një gamë të gjerë efektshëm me rëndësi taktike, operacionale dhe strategjike, përfshirë aktivitete shkatërruese në hapësirën kibernetike, duke vlerësuar se mund të veprojnë pa u ndëshkuar, kur aktivitetet e tyre fshihen nga publiku. Ndikimi individual ose i grumbulluar i këtyre aktiviteteve dhe fushatave keqdashëse kibernetike, mund të ndikojë ndjeshëm në sigurinë e vendit, si dhe të dëmtojë infrastrukturën e sektorë jetikë të vendit, duke ndikuar potencialisht në kapacitetet e FA për të kryer tri detyrat e saj kryesore.

Paralelisht me përparimet e rëndësishme në teknologjive të reja ndërveprimi i tyre është kompleks me sistemet e reja, ekzistuese dhe të trashëguara dhe ndikojnë në natyrën, shtrirjen dhe ndikimin e mundshëm të kërcënimeve kibernetike ndaj vendit.

Aktorët kibernetikë keqdashës gjithashtu kërkojnë gjithnjë e më shumë të shfrytëzojnë “besimin” që përdoruesit u japin ofruesve, produkteve dhe proceseve për të kryer aktivitete keqdashëse. Kjo përfshin kërkimin për të shfrytëzuar dobësitë në zinxhirët e furnizimit të harduerit dhe softuerit, si dhe shënjestrimin e shërbimeve të transferuara, tek ofruesit e shërbimeve të menaxhuara. Përveç kostove të drejtpërdrejta ekonomike dhe të reputacionit, besimi në një hapësirë të lirë kibernetike, të menaxhuar nëpërmjet një modeli me shumë palë të interesuara, po çënohet.

**Sulmet kibernetike.** Hapësira kibernetike, të cilën çdokush mund ta përdorë pa kufij kohorë dhe gjeografikë, jep në mënyrë asimetrike avantazhe për sulmuesit keqdashës, për ata që mbrohen. Sulmuesit në fushën kibernetike janë të ndryshëm dhe vështirësia për t’u identifikuar, ua bën punën më të lehtë. Kriminelët kibernetikë (nga hakerat individualë deri në grupet e organizuara kriminale, madje edhe shtete), mund të përdorin avantazhin e metodave për të lëshuar sulme, të cilat janë të pa gjurmueshme dhe të vështira për t’u eliminuar. Si rezultat i metodave të sofistikuar, zhvillimit të mjeteve teknologjike të sulmeve kibernetike keqdashëse, ato mund të ekzekutohen në kohë shumë të shkurtër. Nga ana tjetër, kërkuesit shkencorë për të identifikuar një sulmues në hapësirën kibernetike, mund të shpenzojnë javë të tëra, muaj, deri edhe vite. Kundërmasat janë gjithmonë të vonuara në raport me zhvillimin e shpejtë të sulmeve. Sponsorizimi i këtyre sulmeve nga shtetet është kërcënim serioz, gjithnjë e në rritje ndaj sigurisë kombëtare, e në veçanti ndaj objektivave ushtarake, të cilat do të jenë gjithnjë e më shumë pikësypnim i sulmeve nëpërmjet spiunazhit dhe sabotazhit kibernetik.

Rritja eksponenciale e ndërlidhjeve të internetit ka çuar në një rritje të konsiderueshme të incidenteve të sulmeve kibernetike, shpesh me pasoja katastrofike dhe të rënda. Sulmet janë zgjedhja kryesore për të kryer dëme në hapësirën kibernetike, duke shfrytëzuar dobësitë ekzistuese, apo duke përdorur karakteristikat unike të teknologjive në zhvillim. Zhvillimi i mekanizmave më inovativë dhe më efektivë të mbrojtjes nga sulmet, është konsideruar si kërkesë urgjente në komunitetin e sigurisë kibernetike. Për të ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, duhet bërë një përmbledhje e dobësive më të shfrytëzuara në harduerin, softuerin dhe nivelet e rrjeteve ekzistuese.

Siguria kibernetike ka të bëjë me kuptimin e çështjeve rreth sulmeve të ndryshme kibernetike dhe krijimin e strategjive të mbrojtjes (d.m.th.

kundërmasat) që ruajnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e çdo teknologjie digjitale dhe informacioni.

**Komunikimi dhe transmetimi i informacionit:** Zhvillimi i internetit dhe i sistemeve të reja kompjuterike, telefonave mobile, pajisjeve magazinuese të lëvizshme dhe tabletat, na e kanë lehtësuar shumë procesin e komunikimit dhe transmetimit të informacionit. Na kanë bërë më eficientë në kryerjen e aktiviteteve të punës, por njëkohësisht jemi bërë më të pambrojtur e të ekspozuar ndaj rreziqeve kibernetike, në mjedisin ku ushtrojmë detyrat funksionale. Një sfidë e veçantë për shoqëritë e hapura është përdorimi i komunikimit digjital për të ndikuar në mendimin e publikut, përshembull nëpërmjet përpjekjeve të fshehura për të ndikuar në diskutimet mbi mediat sociale, duke manipuluar informacionet në portalet e lajmeve. Kjo qasje tashmë ka fituar një rëndësi të veçantë, si një nga elementet e luftës hibride. Megjithatë avantazhet e metodave të reja të komunikimit dhe mënyrave të përdorimit të sistemeve të informacionit dhe internetit, privatësia personale është gjithashtu e kërcënuar, për shkak të abuzimit me identitetin, e cila është një sfidë në rritje për çdo individ dhe autoritet institucional.

## PËRFUNDIME

**Vlerësim i vazhdueshëm.** Për shkak të ritmit të lartë të ndryshimit të teknologjisë dhe zhvillimeve të shpejta në mjedisin e kërcënimeve të hapësirës kibernetike, është e nevojshme të ndërmerret vlerësim i vazhdueshëm dhe rishikime të rregullta mbi përshtatshmërinë e politikave të sigurisë kibernetike në MM/FA, me qëllim përparimi teknologjik, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi me vendet e tjera, në mënyrë që të jemi në gjendje të reagojmë më shpejt, sesa dobësitë dhe kërcënimet.

Një hapësirë kibernetike e sigurt dhe elastike, na lejon të krijojmë një themel të fortë mbi sfidat e hapësirës komplekse kibernetike.

**Përgjegjësitë e ndara:** Të gjithë përdoruesit e sistemeve në MM/FA, gjatë shfrytëzimit të përfitimeve nga rrjetet kompjuterike, duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të siguruar sistemet që përdorin, të bëjnë kujdes gjatë komunikimit dhe ruajtjes së informacionit e të dhënave, si dhe të kenë detyrim për të respektuar informacionin dhe sistemet e të tjerëve.

**Partneritet:** Bazuar në përgjegjësitë e ndara, një përjasje në sigurinë kibernetike, nëpërmjet partneritetit me të gjithë aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e sigurisë kibernetike, është themelore për të pasur sukses.

**Menaxhimi i rrezikut:** Në një botë të globalizuar, në të cilën të gjitha sistemet e lidhura me internetin janë potencialisht të prekshme dhe sulmet kibernetike janë të vështira për t'u zbuluar, nuk ka siguri kibernetike absolute. Ne duhet të

zbatojmë një përjasje të bazuar në rrezikun ndaj sistemeve, për të vlerësuar, vendosur prioritete dhe për të mbështetur burimet e aktiviteteve të sigurisë kibernetike.

**Mbrojtja e vlerave të Forcave të Armatosura:** Ne duhet të ndjekim politika të sigurisë kibernetike që përmirësojnë individin dhe sigurinë kolektive në Forcat e Armatosura, duke ruajtur të drejtën e individëve në MM/FA, për privatësinë dhe vlera të tjera themelore. Ruajtja e këtij ekuilibri është një sfidë e vazhdueshme, për të përballuar sfidat komplekse që paraqet siguria kibernetike në MM/FA.

## Burime të shfrytëzuara

1. Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”.
2. Ligji nr. 64/2014 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
3. Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22.05.2006) (Ndryshuar me ligjin nr. 25/2012, datë 15.03.2012).
4. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
5. VKM nr.1084, datë 28.12.2020 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2020-2025”.
6. VKM nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”.
7. VKM nr. 542, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI)”.
8. VKM nr. 141, datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.
9. NIST Special Publication 800-61 Revision 2 “Computer Security Incident Handling Guide”, National Institute of Standards and Technology, U.S. Department of Commerce, August 2012.
10. “Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike”, MM 2021-2023.

## RUBRIKA E TRETË

### Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen

Në shkrimin e dy kolonelëve Hysni Gjergji dhe David Rroku trajtohet çështja e integritetit të shteteve të rajonit. Kjo çështje shikohet në prizmin e kërcënimeve që vijnë nga pozicioni i Rusisë.

“Rusisë i intereson sabotimi i kohezionit atlantik dhe europian në shtetet që aspirojnë për BE dhe NATO, në “Europën e re” dhe Ballkan, pasi demokratizimi i tyre i rrezikon drejtpërdrejt pushtetin autokratik të Putinit. “Rusia nuk mund të konkurrojë me ideale, me ide demokratike apo me fuqi të butë, të cilat nuk i ka aplikuar kurrë në territorin e vet. Prandaj Moska i sulmon ato vende që prirën nga perëndimi; sulmon vlerat demokratike perëndimore të Ballkanit dhe investon gjithmonë lidhjet ideologjike, fetare, që e kanë mbajtur të lidhur me të shkuarën këtë rajon,- shkruan profesor Shaban Murati te “Rusët po vijnë”.

Rusisë, për ta destabilizuar Perëndimin, nuk i duhet që t’i sjellë tanket në Uashington ose në Bruksel, por i mjafton që të krijojë vatra të reja, në mënyrë që vëmendja të zhvendoset plotësisht në veprime të tjera. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Kosovën.

Moska ka ngritur në Beograd një qendër të fshehtë përgjimi për të gjetur dhe goditur kundërshtarët opozitarë të Putinit në Rusi. Ministri i brendshëm serb Vulin i jep informacione të BIA-s dhe të qendrës së përbashkët ruso-serbe sekretarit të shtetit për sigurinë kombëtare të Rusisë Nikolai Patrushev, të cilat çuan në arrestimin e aktivistit të opozitës ruse Andrei Pivovarov.

Në tre vitet e fundit, bazuar vetëm në publikimet në media, del qartë se nëse asnjë shtet europian i vetëm nuk është “kursyer” nga sulmet hibride të Rusisë. Gjykatat ndërkombëtare po ndërgjegjësohen për këtë rrezik në rritje. Kështu,

më 21 shtator 2021 Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë një vendim ku nënvizohet se Rusia është përgjegjëse për vrasjen e ish-oficerit të sigurisë Aleksandër Litvinenko në Londër.

-Përfshirja e Ballkanit Perëndimor në axhendën e NATO-s, si dhe në Konceptin Strategjik 2022-2023, do të ishte i vetmi paralajmërim i fortë që iu çohet “autokracive”, që po përpiqen të sabotojnë dhe destabilizojnë rajonin tonë përmes taktikave hibride”- përfundojnë autorët.

Në shkrimin me titull “*Rusia midis të kaluarës dhe të ardhmes – NATO-s, zgjerimi dhe vazhdimësia*”, të nënkolonel në rezervë Kanan Himaj, trajtohet...

“Evoluimi i politikës së sigurisë ruse në mënyrë të shpejtë në tre dekadat e fundit, me fokus në “korrigjimin e padrejtësive historike”. Ajo ka rritur “merakun” se shpërbërja e ish-Bashkimit-Sovjetik është tragjedia më e madhe gjeopolitike e shekullit të kaluar, duke synuar për t’u imponuar për një arkitekturë të re sigurie, ndryshe nga sot.

Shkrimi përqendrohet në disa aspekte të trashëgimisë kushtetuese ruse, si; strategjitë e sigurisë të cilat kanë qenë të lidhura me zgjerimin e NATO-s, gjatë dhe pas periudhës së Luftës së Ftohtë.

Është konkluduar se konceptet e sigurisë kombëtare të Rusisë ndjekin nga afër procesin e zgjerimit të NATO-s. Natyra e vendosjes, konceptet e sigurisë dhe mbrojtjes, janë vendimtare në formulimin dhe ndikimin jo vetëm në perceptimin e Kremlinit, por edhe në reagimin e tij, veçanërisht në fushën ushtarake ndaj zgjerimit të aleancës.

Kushtetuta, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia dhe Doktrina Ushtarake e Federatës Ruse, demonstrojnë elemente të dallueshme të kulturës strategjike të vendit dhe politikës së saj të sigurisë. Ajo ka të bëjë kryesisht me pozicionin dhe synimet e Rusisë, të cilat janë transformimi i rendit ndërkombëtar dhe shndërrimi në lider moral në sferën post-sovjetike. Sindroma e Fuqisë së Madhe manifestohet në marrëdhëniet me shtetet fqinje, të cilat sipas autoriteteve ruse nuk duhet të jenë aktorë të pavarur”,- përfundon autori.

# ANËTARËSIMI NË NATO-BE I SHTETEVE TË “EUROPËS SË RE”, E VETMJA PËRGJIGJE E KËRCËNIMIT HIBRID RUS

**Kolonel Hysni GJERGJI**

**Kolonel David RROKU**

*Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Lidhjet e interesave të përbashkëta politike, ekonomike dhe ushtarake të Rusisë me Europën Lindore janë tradicionale, të vjetra dhe deri diku nostalgjikë, ndërsa lidhja e Moskës me Beogradin i bën ata të jenë jo vetëm mbështetës, por edhe të “nevojshëm” për njëri-tjetrin. Viti 2023 nisi me tension të shtuar të situatës në kuvendin e Serbisë dhe Kosovës, e shoqëruar nga kërkesa absurde e Vuçic për të dërguar trupa ushtarake në tokën kosovare, duke shfrytëzuar në mënyrë cinike rezolutën e OKB-së 1244<sup>1</sup>.*

*Sesioni i 77-të i OKB-së, më 23-25 shtator 2022, e dënoi njëzëri sulmin rus në Ukrainë, po në kundërshtim me këtë frymë, u nënshkrua një marrëveshje në fushën e politikës së jashtme midis Serbisë dhe Rusisë<sup>2</sup>. Në kundërshtim me të gjitha shtetet europiane për të dënuar agresionin rus, përsëri kishte nënshkrim marrëveshjesh midis dy ministrave të jashtëm të Serbisë dhe Rusisë në Nju Jork. Deri më 24 maj 2022 në faqen zyrtare të Ministrisë së Jashtme ruse ishin përmendur 445 herë opinione për Kosovën dhe perspektivën e saj. Kjo*

<sup>1</sup> Kërkesa bazohet te Rezoluta 1244, e 10 qershorit 1999, në kapitullin 2 pika 6 thotë se “Trupat e FRJ mund të kthehen deri në disa qindra ushtarë, për të mbrojtur jetën dhe institucionet fetare të serbëve të rrezikuar në Kosovë”.

<sup>2</sup> Ambasadori i SHBA Christopher Hill; 26 shtator 2022 “askush nuk do të duhej të nënshkruante asgjë me Rusinë”.

*regon interesin në rritje të politikës së Moskës për Europën dhe Ballkanin<sup>3</sup> në përgjithësi, por dhe për shqiptarët në veçanti. Në takimet ndërkombëtare, Putini e përdor rastin e Kosovës, si argument për të fajësuar NATO-n si fuqi “agresore” dhe të njëanshme, që ka sulmuar Beogradin dhe favorizuar të Prishtinën<sup>4</sup>.*

*Precedenti i pavarësisë së Kosovës po përdoret gjerësisht në takimet diplomatike të Lavrov dhe Putin, për ta barazuar këtë çështje me pavarësinë e Krimesë, Donetsk, Luhansk, Zaporizhia dhe Kherson; bashkimin e të cilave me “Nënë Rusi”, Moska e njohu më 30 shtator 2022.*

## HYRJE

Sigurisht, çfarë ndodh në kufijtë lindorë të Aleancës, reflektohet edhe në Ballkan, ku ndasitë etnike, demokracitë e pakonsoliduara, krizat politike, influencat malinje të shteteve “proxy” mund të konsiderohen faktorë kryesorë dhe të rëndësishëm për destabilizim dhe krijim konfliktesh<sup>5</sup>.

Rusisë i intereson sabotimi i kohezionit atlantik dhe europian në shtetet që aspirojnë për BE dhe NATO, në “Europën e re” dhe Ballkan, pasi demokratizimi i tyre i rrezikon drejtpërdrejt pushtetin autokratik të Putinit. “Rusia nuk mund të konkurrojë me ideale, me ide demokratike apo me fuqi të butë, të cilat nuk i ka aplikuar kurrë në territorin e vet. Prandaj Moska i sulmon ato vende që priren nga perëndimi; sulmon vlerat demokratike perëndimore të Ballkanit dhe investon gjithmonë lidhjet ideologjike, fetare, që e kanë mbajtur të lidhur me të shkuarën këtë rajon,- shkruan profesor Shaban Murati te “Rusët po vijnë”.

Studiues të sigurisë ballkanike, europiane dhe globale gjykojnë se konflikti Serbi-Kosovë, dekorimi i Putinit më 9 janar 2023 nga Dodik, lëvizjet nacionaliste, përçarëse dhe antiperëndimore në RMV, krizat politike duke përdorur kishën ortodokse serbe në Malin e Zi, armatosja e Serbisë nga Rusia dhe Kina, sabotimet e infrastrukturës europiane të energjisë me armë kibernetike dhe konvencionale, kriza e energjisë dhe ushqimit që vazhdojnë edhe në 2023, janë veprime të sponsorizuara, të mbështetura, në interes dhe të kryera nga Rusia.

Kremlini me këto veprime synon ta pengojë Beogradin që të afrohet më shumë se duhet me institucionet perëndimore. Serbia me anë të fushatës së çnjohjes pengon integrimin europian të Kosovës, e cila më 12 dhjetor paraqiti

<sup>3</sup> Edi Rama për “Der Spiegel” datë 2 shtator 2022; “Putin po bën gjithçka për të krijuar një fitil të ri konflikti në Ballkan”.

<sup>4</sup> Olaf Scholz takim me presidentin Putin më 15 shkurt 2022, i përsërit tezën ruse për NATO-n si kërcënim për Rusinë, pasi kjo kishte ndodhur edhe në Beograd në 1999.

<sup>5</sup> Niko Peleshi ; Direktiva e Mbrojtjes për vitin 2023



zyrtarisht kërkesën për anëtarësim në BE. Shteti serb po funksionon si një kopje në miniaturë e Federatës Ruse, me opozitë fasadë dhe shtet të pandarë nga kisha. Në janar të 2023 grupi famëkeq VAGNER është shfaqur në murale në Beograd, me qëllim rekrutime të reja për ushtrinë ruse, nga rinia serbe.

## **ËNDRRA “JUGOSLLAVE” E SERBISË, PROJEKT AFATGJATË RUS**

Ukraina është ëndrra neo-sovjetike e Putinit, pasi pavarësia dhe orientimi i saj perëndimor, i rrëzon pretendimet e Rusisë ndaj historisë, identitetit, kulturës dhe territorit të këtij vendi. Separatistët në katër rajonet ukrainase Donjeck, Luhansk, Kherson dhe Zaporizhja njoftuan votime të mbajtura nga 23 deri më 27 shtator 2022, të cilat ishin farse dhe rezultatet nuk janë njohur nga Perëndimi. Futja nën kufirin shtetëror të Rusisë të katër republikave u bë me qëllim legjitimimin e përdorimit të forcës dhe mos lejimin e shteteve të tjera të NATO-s të ndërhyjnë për t'i çliruar. Nëse kjo do të ndodhte, ky do quhej agresion kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të Federatës Ruse, që do të përlligjte përdorimin me shumë gjasa të armëve bërthamore. Lufta në Ukrainë ka treguar se objektiv nuk është vetëm ajo, por vlerat europiane të cilat janë më të brishta dhe më të cenueshme në Ballkanin Perëndimor<sup>6</sup>. Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia mbeten projekte ku nacionalizmi rus bashkë me atë serb ushqejnë dhe përpiqen të rritin mbështetësit nëpërmjet nostalgjikëve<sup>7</sup> dhe “usefull idiots”<sup>8</sup>.

“Moska ka punuar që të destabilizojë Ballkanin me vite, jo se dëshiron që ta pushtojë atë, por me qëllim që të shpërqendrojë vëmendjen e Perëndimit nga ajo që është duke ndodhur në Ukrainë, sidomos tani”<sup>9</sup>. Interesi i Rusisë në Ballkan nuk ka të bëjë me vetë Ballkanin, por me kërkesën për të pasur një derë të hapur në Europë dhe Ballkani është një prej mënyrave më të lehta apo dhe e vetme për ta arritur këtë objektiv.

Marrëdhënia mes Rusisë dhe Serbisë është shumë kontradiktore dhe komplekse, ku 200 mijë rusë janë larguar nga lufta dhe, të strehuar në Serbi, protestojnë kundër luftës në Ukrainë dhe Putinit. Çuditërisht, nga ana tjetër, serbët në Serbi protestojnë pro Putinit. Kjo besohet të ketë ardhur si rezultat

<sup>6</sup> Deputetja laburiste Fleur Anderson 27 prill 2022; “Lufta në Ukrainë konfirmon se Putin ka qëllime të destabilizojë në të njëjtën mënyrë edhe Ballkanin”.

<sup>7</sup> Më 24 qershor 2020, ambasadori rus në Tiranë Afanasov, në emër të Putinit dekoron 20 “veteranë”, ish-ushtarakë me rastin e 75-vjetorit të fitores së Luftës II Botërore, megjithëse shumica e tyre nuk kishin marrë pjesë në këtë luftë.

<sup>8</sup> Termi “idiot i dobishëm” që karakterizonte Leninin, ka qenë prej kohësh në qarkullim për të përshkruar mbështetësit revolucionarë naivë, pa shkak të BS.

<sup>9</sup> Ivana Stradner, hulumtuese në Fondacionin për Mbrojtje të Demokracisë në intervistë me Radion “Europa e Lirë” më 12 gusht 2022.

i dezinformacionit rus për luftën, arsyet dhe situatën e vërtetë në Rusi<sup>10</sup>. Në Serbi është ende vendimi zyrtar në fuqi, që vërteton lëvizjen e mundshme të Rusisë për t'u bashkuar me Serbinë. Ky është një projekt i vjetër shtetëror serb i shpallur më 12 prill të vitit 1999 dhe kërkesa zyrtare e Jugosllavisë i është dorëzuar presidentit Jelcin me firmën e presidentit të Serbisë, Millosheviç. Vendimi i qeverisë dhe i parlamentit të Serbisë për bashkimin me Rusinë, si dhe rezoluta e parlamentit të Rusisë që e miratoi bashkimin e dy shteteve, janë ende në fuqi si akte të vlefshme juridike edhe sot e kësaj dite. Sepse ato nuk i ka shfuqizuar asnjë qeveri e Serbisë dhe asnjë parlament i Serbisë edhe pas ikjes së Millosheviçit. Duma ruse nuk e ka shfuqizuar aktualisht rezolutën e saj të bashkimit të Serbisë me Rusinë dhe dokumentet zyrtare të dy shteteve për bashkim janë në fuqi. Sugjerohet organizimi i një referendumi në Serbi për të pyetur popullin për bashkimin. “Bashkimi i Serbisë me Rusinë nuk është vendim i Vuçiçit, por i popullit. Këtë e përcakton populli me referendum dhe kjo është shprehje e vullnetit të tij, që askush të mos thotë se ky është pushtim, okupim apo përmbyesje<sup>11</sup>”. Projekti i bashkimit të Serbisë me Rusinë përbën një plan tepër të rrezikshëm për Ballkanin, për NATO-n dhe BE-në. Ky do të ishte një burim lufte për shtetet e NATO-s në Ballkan, sepse do të sillte një Rusi kufitare me të gjitha shtetet ballkanike dhe anëtare të NATO-s. Asociacioni i komunave me shumicë serbe që parashikohet të ketë dhjetë komuna, të cilat janë Mitrovicë e Veriut, Klllokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë, bashkë me Republikën Serbska në BiH, kanë gjasa të kthehen në bomba në Ballkan, të komanduara nga Moska.

Rusisë, për ta destabilizuar Perëndimin, nuk i duhet që t'i sjellë tanket në Uashington ose në Bruksel, por i mjafton që të krijojë vatra të reja, në mënyrë që vëmendja të zhvendoset plotësisht në veprime të tjera. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Kosovën<sup>12</sup>. Serbia nga ana e saj deklaron në strategjinë e saj të sigurisë kombëtare si shtete potencialisht armike, Kroacinë, B&H, Shqipërinë dhe shtetin e Kosovës. Beogradi reagon ashpër, duke mbledhur trupa në kufi të Kosovës, duke përfshirë tanke T-72, autoblanda “Lazar” 3 dhe mjete luftarake shumëfunksionale BOV M16 MILOŠ. Serbia nuk është distancuar nga trashëgimia e kohës së Millosheviçit dhe demokracia ishte një periudhë e shkurtër në Serbi. Kryeministri aktual jo vetëm që nuk është distancuar, por deklaron më 4 shkurt 2023 në parlamentin serb se “Albin Kurti nuk duhej liruar nga burgjet serbe”.

<sup>10</sup> Zëri i Amerikës, datë 6 shkurt 2023.

<sup>11</sup> Deklaratë e zëvendëskryetarit të të komitetit të çështjeve ndërkombëtare të Dumës Ruse, Aleksej Çepa, më 12 dhjetor 2022.

<sup>12</sup> Ivana Stradner, bashkëpunëtoresh shkencore në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington deklaruar për radion Europa e Lirë, 13 dhjetor 2022.

Serbia përmes pakicave të saj, e synon Republikën Serbe në Bosnjë, Malin e Zi dhe veriun e Kosovës ta përdorë, jo si urë bashkëpunimi, por ta kthejë në sferë të ndikimit, njësoj siç e kërkon Rusia me Bjellorusinë dhe Ukrainën. “Kremlini përbën rrezik për stabilitetin e rajonit dhe përveç Ukrainës është edhe Ballkani Perëndimor. Ekzistojnë dy pika të ndjeshme në rajon, Republika Serpska dhe veriu në Republikën e Kosovës, ku tentohet të cenohet integriteti i këtyre vendeve, prandaj NATO-ja dhe Bashkimi European duhet t’i kushtojnë vëmendje<sup>13</sup>”.

Vuçiç e ka shprehur më shumë se një herë, se ëndërron lavdinë personale si një bashkues i “trojeve të sllavëve të jugut”, mbasi Putin e ushqen dhe e manipulon atë, për qëllimet gjeopolitike të Rusisë, sidomos pas sulmit ushtarak mbi Kiev. Vuçiç i mbetet borxhli Moskës për bllokimin e hyrjes së Kosovës në Kombet e Bashkuara. Ndërsa nga ana tjetër, varësia ekonomike e Serbisë nga Rusia po zgjerohet, ku së fundmi Beogradi iu bashkua lidhjes së re të gazit natyror rus përmes Bullgarisë dhe Turqisë, me çmime preferenciale. Serbia, duke qenë se kufizohet vetëm me vendet anëtare të NATO-s, nuk ka asnjë arsye të armatoset, përveçse si një nënrepart pararojë i zbulimit rus në Ballkan.

“Qendra humanitare” ruso-serbe pranë kufirit me Kosovën shërben si objekt për mbledhjen e informacionit dhe kryerjen e operacioneve speciale për Moskën. Ministri i jashtëm serb i konfirmon Moskës se Serbia do ta braktisë të ashtuquajturin neutralitet të saj ushtarak dhe do të forcojë bashkëpunimin dhe kontaktet me organizatën ushtarake të CSTO<sup>14</sup> për t’iu kundërvënë NATO-s. Bashkëpunimi mes Moskës dhe Beogradit është shtrirë edhe në luftën për goditjen e kundërshtarëve politikë. Moska ka ngritur në Beograd një qendër të fshehtë përgjimi për të gjetur dhe goditur kundërshtarët opozitarë të Putinit në Rusi. Ministri i brendshëm serb Vulin i jep informacione të BIA-s<sup>15</sup> dhe të qendrës së përbashkët ruso-serbe sekretarit të shtetit për sigurinë kombëtare të Rusisë Nikolai Patrushev, të cilat çuan në arrestimin e aktivistit të opozitës ruse Andrei Pivovarov<sup>16</sup>.

Lideri i serbëve të Bosnjës Dodik, merr “fuqi” nga mbështetja e Moskës dhe Beogradit njëkohësisht. Parakalimi me trupa dhe mjete ushtarake në Sarajevë në janar 2023 është një precedent, i cili do të mund të përsëritet në rastin e

<sup>13</sup> Nga fjalimi i presidentit të RMV Pendarovski më 17 janar 2023 në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror në Davos.

<sup>14</sup> Collective Security Treaty Organization CSTO ka aktualisht 6 anëtarë: Rusia, Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kyrgyzistani dhe Tashikistani.

<sup>15</sup> BIA, shërbimi sekret serb (në serbisht: Bezbednosno-informativna agencija, kyrill Безбедносно-информативна агенција, БИА).

<sup>16</sup> Më 12 janar 2022, eurodeputetja Viola Von Cramon, ka reaguar lidhur me veprimet e Serbisë për ta përgjuar opozitën ruse në Beograd dhe dorëzimin e këtij materiali sekret tek autoritetet ruse në Kremlin.

Kosovës. Zajednica<sup>17</sup> mund të kthehet në rizgjim e konflikteve të vjetra, ndoshta edhe të luftës, në Kosovën e nesërme, sepse prania e një krahine autonome serbe brenda territorit të Kosovës, e bën këtë më të mundshëm konfliktin. Tërheqja e listës serbe nga parlamenti i Kosovës, protestat në fillim të shkurtit 2023 në parlamentin serb, kanë vetëm një qëllim: mosnjohjen e planit franko-gjerman për zgjidhjen e krizës dhe mbajtjen e procesit në të njëjtën linjë me atë të situatës në Ukrainë.

## METODAT DHE ARMËT E LUFTËS RUSE

Lufta e Ftohtë midis Rosisë dhe perëndimit nuk është ndërprerë asnjëherë dhe arma kryesore e kësaj lufte, janë armët hibride me dezinformacion, sabotazh, blerje të liderëve politikë, të cilat synojnë në marrjen e masave aktive për të dobësuar perëndimin; të mbjellë përçarje të të gjitha llojeve, në mes të komunitetit ndërkombëtar dhe aleancës së NATO-s; të mbjellë mosmarrëveshje mes tyre për të dobësuar dhe bërë të pabesueshme SHBA-të dhe NATO-n, në sytë e publikut.

“Nuk është aq aftësia ushtarake e komandantëve ajo që përcakton rezultatin e luftës, sesa vullneti i popujve të përfshirë në këtë luftë. Fitorja nuk varet dhe nuk do të varet kurrë nga pozicioni, armatimi apo numri i trupave. Ajo varet nga ndjenja që vlon në zemrën time, në zemrën tënde dhe në zemrën e gjithkujt që merr pjesë në këtë luftë”<sup>18</sup>. Duke ditur këtë “fat” për luftën e tij të padrejtë, Putini po përpiket me çdo mënyrë dhe mjet për të influencuar në shtetete tjera të Europës, me metoda të luftës “hibride” dhe asaj “jo lineare”. Rusia nuk ka prezencë me trupa ushtarake, në “Europën e Re”, por ajo ka zhvilluar dhe vazhdon kapacitete që të zhvillojë “luftë hibride” me anë të inteligjencës, kundër ndikimit të perëndimit në rajon, si dhe anëtarësimeve në NATO dhe BE të këtyre shteteve.

“Europa e vjetër” ose perendimore, është përcaktuar organizatë armike e Rosisë dhe kjo arriti kulmin më 24 nëntor 2022 kur parlamenti evropian goditet nga një sulm kibernetik, vetëm disa orë pasi PE kishte shpallur Rusinë si shtet që mbështet terrorizmin, nisur nga faktet e grumbulluara në Ukrainë, për vrasje të civilëve dhe sulme kundër shkollave, spitaleve dhe infrastrukturës civile në përgjithësi.

Dështimi në luftën konvencionale kundër Ukrainës parashikohet të kompensohet me rritjen e kapaciteteve hibride të Rosisë kundër NATO-s dhe anëtarëve të saj. Lufta me armët 3S (spiunazh, subversion, sabotazh) dhe 3D (Dimër, Donacione dhe Drithë) është strategji ushtarake që ndërthur luftën

<sup>17</sup> Bashkimi i komunave serbe (në serbisht: Zajednica srpskih opština, ЗСО ) miratuar si asosacion më 2.2.2023 nga Kuvendi i Kosovës, por nuk pranohet nga opozita serbe.

<sup>18</sup> Leon Tolstoi, *Lufta dhe Paqja*, libri i 3-të, pjesa e dytë, kapitulli XXV.

politike, konvencionale, asimetrike, kibernetike, ekonomike si dhe metodat e tjera influencuese të tilla si: lajmet e rreme, diplomacinë, financimin, ligjin dhe ndërhyrjen e huaj në zgjedhje<sup>19</sup>. Operacionet hibride ruse kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë si qëllim të krijojnë një klimë pasigurie dhe mosbesimi, të ndryshojnë e manipulojnë perceptimin e publikut për realitetin perëndimor me ideologji, politikë, para dhe lider në favor të modelit rus.

Kanë ndodhur një varg sulmesh në “Europën e re” të raportuara edhe nga media, që përfshijnë si shkaktarë zyrtarët rusë, nga viti 1995 deri në vitin 2023. Rajoni ynë ka qenë prej kohësh një skenë e rëndësishme aktiviteti për shërbimet inteligjente të Kremlinit, me taktikat e saj hibride, duke synuar të pengojë përpjekjet e vendeve “Europës së re” për anëtarësim në NATO dhe BE. Rastet e denoncuara dhe të përsëritura të spiunazhit dhe sabotazhit kanë prekur edhe disa vende të rajonit, të cilat trashëgojnë marrëdhënie të ngushta me Rusinë, por në mënyrë diplomatike dhe në sy të publikut, duket sikur çdo gjë shkon normalisht.

Oficerët e zbulimit ushtarak rus në Europë kanë përdorur si baza kryesore ambasadat dhe misionet diplomatike, por në shumicën e rasteve punojnë edhe si biznesmenë, gazetarë, turistë, akademike, madje edhe studentë. Agjentët rusë në Europën Lindore jetojnë dhe veprojnë kryesisht “pa rënë në sy” në periferi të qyteteve, duke maskuar mirë misionin e tyre. Nga analiza e aktiviteteve të spiunazhit rus nuk mbetet jashtë asnjë shtet, armik apo mik i Rusisë.

Mediat perëndimore raportojnë për një njësi speciale “29155”, e cila kryen operacione të fshehta speciale jashtë Rusisë. Këto sulme janë ndërthurje e spiunazhit, sabotazhit dhe ekzekutimit të personave me interes për zbulimin rus ose tradhtarët në radhët e tyre. Agjentët e “njësisë speciale 29155” udhëtojnë me identitete false dhe pasaportat e tyre ndërrohen çdo dy vite. Ata kanë numra serialë të rezervuar vetëm për agjentët e zbulimit ushtarak rus GRU<sup>20</sup>.

Dy njësi të tjera, të njohura si njësitë 26165 dhe 74455<sup>21</sup>, janë përmendur në hetimet ndërkombëtare të sulmeve kibernetike. Këto njësi janë të lidhura edhe me përpjekjet për sulm kibernetik ndaj Agjencisë Botërore Antidoping dhe Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike. Goditja kibernetike kundër këtyre dy agjencive u bë për të zhdukur provat, në hetimin e përdorimit nga ana e Rusisë të agjentëve nervorë, përfshirë Noviçokun që këto agjenci po

<sup>19</sup> Kombinimi i këtyre armëve dhe mjeteve përbën armen hibride e cila definohet e propozuar për herë të parë nga Frank Hoffman nga instituti i studimeve politike, Arlington Virginia.

<sup>20</sup> Njësia 29155 raportohet se është e varur nën Komandën e Forcave të Operacioneve Speciale, që ka selinë në Senezh, në veri të Moskës. Komandanti i kësaj komande besohet se është gjeneralmajor Andrei Averyanov.

<sup>21</sup> Më 14 prill 2021 Këshilltari i Posaçëm në SHBA Robert Mueller i ka akuzuar këto njësi në hetimin e tij për sulmet kibernetike ndaj partive politike, në Shtetet e Bashkuara më 2016.

zhvillonin. Megjithëse shfrytëzojnë identitete të rreme, shërbimet inteligjente perëndimore kanë arritur që të identifikojnë disa nga agentët e GRU-së, të cilët ishin të implikuar në sulmin ndaj Emilian Gebrev në Bullgari, në sulmin ndaj Sergei Skripal në Britaninë e Madhe, shpërthimin e depove të municionit në Çeki dhe në tentimin për grusht shteti në Malin e Zi.

## **DENONCIME TË SULMEVE HIBRIDE RUSE, NGA SHTETET E “EUROPËS SË RE”**

Në tre vitet e fundit bazuar vetëm në publikimet në media, del qartë se nëse asnjë shtet europian i vetëm nuk është “kursyer” nga sulmet hibride të Rusisë. Gjykatat ndërkombëtare po ndërgjegjësohen për këtë rrezik në rritje. Kështu, më 21 shtator 2021, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë një vendim ku nënvizohet se Rusia është përgjegjëse për vrasjen e ish-oficerit të sigurisë Aleksandar Litvinenko në Londër. Litvinenko ndërroi jetë në vitin 2006, pasi kishte pirë çaj të helmuar me Polonium-210, një izotop i rrallë radioaktiv. Problem në botën e spiunazhit, subversionit dhe sabotazhit nuk është çfarë zbulohet, por “çfarë nuk shpallet dhe fshihet për t’u përdorur më vonë”. Raporti teorik i agjentëve të zbuluar me ata që nuk mund të zbulohen pranohet të jetë afërsisht 1 me 100, çfarë na bën të mendojmë se sa shumë të tjerë janë në veprim pikërisht tani, pranë dhe midis nesh.

-Shërbimi i kundërzbulimit të Polonisë, gjithashtu ka arrestuar një shtetas polak të dyshuar për spiunazh për shërbimet sekrete ruse në dhjetor 2022. Polonia ka dëbuar 45 diplomatë rusë të dyshuar për spiunazh<sup>22</sup>. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Polonisë tha se ka arrestuar një shtetas rus nën dyshimet se është përfshirë në mbledhjen e informacioneve të njërive të ushtrisë polake, për logjistikën dhe stafin ushtarak, në bazë të kërkesës së inteligjencës ruse GRU. Zyra e Prokurorit në qytetin të Gdanskut, deklaroi më 12 prill 2022 se të dyshuarit, identiteti i të cilit nuk është bërë publik, i është komunikuar masa e paraburgimit prej tre muajsh, duke mos dhënë shumë hollësi. Stanislav Zarin, zëdhënës i shërbimeve të inteligjencës, u shpreh se i dyshuari është arrestuar më 6 prill dhe përballet me dhjetë vjet burgim, nëse gjendet fajtor për spiunazh<sup>23</sup>.

-Mediat çeke dhe të rajonit raportuan më 16 tetor 2020 se ndodhi një shpërthim masiv në një depo municionesh në qytetin Vrbetice të Çekisë, duke vrarë dy persona dhe shkaktoar dëme të mëdha materiale. Një shpërthim kishte ndodhur edhe në dhjetor 2014 me dëme të konsiderueshme materiale. Praga deportoi menjëherë 18 agentë të GRU-së, të cilët kishin pasaporta diplomatike dhe pjesë e stafit diplomatik në ambasadën ruse në Pragë të

<sup>22</sup> Almir Terzic raporton për Anadolu Agency (AA) në datën 23 mars 2022.

<sup>23</sup> Radio Europa e Lirë, 12 prill 2022.

dyshtuar për këto sulme<sup>24</sup>. Organet çeke të prokurorisë më 19 prill 2021 kanë futur në listë edhe dy oficerë të GRU-së: Alexander Mishkin (me identitetin e rremë Alexander Petrov) dhe kolonel Anatoliy Chepiga (me identitetin e rremë Ruslan Boshirov), si të dyshuar për shpërthimin e depove të municionit më 16 tetor 2014. Petrov dhe Boshirov kishin hyrë në Çeki në vitin 2014, duke shfrytëzuar pasaporta false të Moldavisë dhe Taxhikistanit. Të dy janë në kërkim edhe nga Britania e Madhe, si pjesëmarrës në tentativën për likuidimin e Sergei Skripal dhe vajzës së tij Julia.

Në vitin 2018, edhe vendi ynë dëboi dy diplomatë rusë, duke provuar se aktivitetet e tyre nuk ishin në përputhje me statusin e tyre diplomatik. Shqipëria u bashkua me Mbretërinë e Bashkuar, BE-në, SHBA-të dhe Kanadanë në një përgjigje të koordinuar ndaj helmimit me agjentë nervorë të Sergei Skripal, një ish-zyrtar i inteligjencës ruse dhe vajzës së tij, Julia, në Salisbury, Angli. Në janar të 2021, vendi ynë dëboi përsëri një diplomat rus për shkelje të rregullave që synonin ndalimin e përhapjes së koronavirusit. Qeveria shqiptare e shpalli Aleksei Krivosheev person “non grata” dhe i kërkoi atij të largohej nga vendi brenda 72-orësh, për shkak të shkeljeve “të përsëritura” të kufizimeve të pandemisë nga diplomati rus që nga prilli i vitit 2020. Natyrisht ky nuk është fillimi apo i vetmi aktivitet rus kundër interesave dhe ambicieve euroatlantike të vendit tonë. Më 7 mars 2022, Rusia<sup>25</sup> shpall zyrtarisht Shqipërinë vend armik, për arsye të kundërshtimit zyrtar dhe sanksioneve si shkak i agresionit mbi Ukrainë.

Kroacia, përmes kryeministrit kroat Andrej Plenković, deklaroi se Zagrebi kishte vendosur të tregonte “solidaritet me Mbretërinë e Bashkuar” dhe të shpallte të padëshiruar një diplomat rus të akuzuar për spiunazh.

Maqedonia e Veriut shpalli si person “non grata” një diplomat rus i cili duhet të largohet brenda disa orëve. Raportimi vjen nga Ministria e Punëve të Jashtme e RMV e cila deklaroi se “Ministria e Punëve të Jashtme njofton se në bazë të nenit 9 të Konventës së Vjenës për marrëdhënie diplomatike, vendosi të shpallë një diplomat të ambasadës së Federatës Ruse si person “non grata” në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pasi “sjellja e diplomatit nuk ishte në përputhje me sjelljen e pritur nga Maqedonia”<sup>26</sup>.

<sup>24</sup> Shpërthimi ndodhi më 16 tetor 2014, në një depo në qytetin Vrbetice që kishte të depozituara 50 tonë municion, që shkaktoi dy viktima. Një shpërthim tjetër me 13 ton municion ndodhi në depo më 3 dhjetor të 2014.

<sup>25</sup> Deklaratë e Dmitry Medvedev; Qeveria e Federatës ruse ka miratuar më 7 mars një listë të shteteve dhe territoreve të huaja që kryejnë veprime jomiqësore kundër Rusisë, kompanive dhe qytetarëve të saj.

<sup>26</sup> Sipas mediave, më 14 maj 2021, ambasadori rus Sergei Bazdikin u thirr në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RMV për t'u informuar se një nga diplomatët në ambasadën e tij ishte shpallur person i padëshirueshëm



Rumania njoftoi gjithashtu se do të deklaronte një diplomat rus si person “non grata”. Marrëdhëniet diplomatike të Rumanisë me Rusinë kanë qenë të tensionuara, veçanërisht që nga koha kur Rusia aneksoi Krimenë në vitin 2014.

Vitet e fundit në shtetet e Bashkimit Europian dhe Ballkan ka pasur disa raste të dëbimit të “diplomatëve rusë, të cilët në fakt ishin pjesë e shërbimeve të inteligjencës. Në lidhje me rritjen e aktiviteteve të shërbimeve sekrete ruse, SIS-i sllovak ka vite që ka tërhequr vërejtjen.

Sllovakia në raportin vjetor të SIS<sup>27</sup> për sigurinë deklaroi se “aktivitetet e shërbimeve sekrete ruse në Sllovaki janë të fokusuar në sigurimin e informatorëve në organet e administratës shtetërore, në fushën e energjetikës dhe në forcat e sigurisë dhe mbrojtjes. Për aktivitetin e spiunëve ruse thuhet se rusët janë shumë aktivë në Sllovaki dhe përdorin teknika të sofistikuara<sup>28</sup>.

Mali i Zi në tetor 2016 zbulon një komplot të kurditur nga ultranacionalistët serbë dhe oficerë të inteligjencës ruse, për të përmbysur qeverinë e presidentit Gjokanoviç. Mali i Zi dhe Rusia janë në marrëdhënie të tensionuara pas një komploti të mbështetur nga Rusia për të vrarë kryeministrin e Malit të Zi, për të përmbysur qeverinë dhe për të parandaluar anëtarësimin e republikës ish-Jugosllave në NATO. Sipas prokurorëve malazezë, organizatorë të tentativës për grusht shteti në Malin e Zi, në ditën e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016, ishin dy oficerë të GRU-së dhe shfrytëzuan identitete të rreme. Kjo u dëshmuar edhe nga rasti i Eduard Shishmakov, i cili në Serbi kishte shfrytëzuar identitetin e vërtetë Eduard Shirokov<sup>29</sup>. Gjykata e Lartë në Malin e Zi, i ka dënua në mungesë dy agjentët rusë, Eduard Shishmakov me 15 vite burgim dhe Vladimir Popov me 12 vite burgim.

Kosova shpall më 24 tetor 2021 “non grata” 2 diplomatë rusë që akuzohen për spiunazh, shkelje të sigurisë kombëtare dhe tejkalim të statusit të tyre diplomatik<sup>30</sup>. Në datën 7 gusht 2022 shpallet edhe një tjetër person “non grata” nga inteligjenca ruse<sup>31</sup>.

---

<sup>27</sup> Sllovakia Intelligence service

<sup>28</sup> Prononcim i ministrit sllovak të mbrojtjes, Jaroslav Nad, më 11 gusht 2020.

<sup>29</sup> Eduard Shirokov, kishte shërbyer atashë ushtarak në ambasadën e Rusisë në Poloni dhe në vitin 2014 ishte deportuar “non grata” nga Polonia, pasi kishte tentuar të rekrutonte për spiunazh një oficer të lartë të ushtrisë polake.

<sup>30</sup> Deklaratë e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, më 22 tetor 2021, për dy diplomatët e Zyrës Ndërlidhëse të Rusisë në Kosovë, të cilët janë shpallur persona të padëshiruar (*non grata*) dhe janë urdhëruar të largohen nga vendi.

<sup>31</sup> Më 7 gusht 2022, agjencia “Rojters”, referuar ministrit të brendshëm Svelca, shkruan se gazetarja ruse Daria Aslamova, që punon për Komsomolskaja Pravda, u ndalua për aktivitet spiunazhi rus, në kufirin verior në Kosovë.



## “BIJTË” PLANGPRISHËS TË MOSKËS

Serbia, por edhe Greqia dhe Bullgaria nuk vepruan si shtetet e tjera në mbështetje dhe solidarizim me Britaninë për rastin Skripal. Por kjo nuk zgjati shumë, pasi shumë shpejt serbët vërtetuan se “vëllezërit rusë” nuk i kishin kursyer as ata, në sulmet hibride.

-Greqia për shumë vite është njohur si aleate e Rusisë, kryesisht lidhur me kishën ortodokse. Kjo zgjati deri në qershor të vitit 2018, kur Athina urdhëroi dëbimin e dy diplomatëve rusë dhe ndaloi hyrjen e dy të tjerëve me akuzën “Subversion, spiunazh dhe sabotim të integritetit dhe të sigurisë kombëtare të Greqisë”. Qeveria greke akuzoi zyrtarët rusë se po zhvillonin spiunazh për të marrë dhe shpërndarë informacione sensitive lidhur me sigurinë kombëtare. Rusia u përpoq shumë të sabotojë çështje të ndjeshme gjeopolitike në rajon, veçanërisht në lidhje me çështjen e emrit të Maqedonisë<sup>32</sup>. Zhvillimet ndodhën një muaj pasi Maqedonia dhe Greqia ranë dakord për emrin “Maqedonia e Veriut”, pas përpjekjeve të gjata 27-vjeçare në lidhje me këtë çështje.

-Bullgaria ka qenë aleati më i besueshëm politik i Moskës në Europën Lindore gjatë kohës sovjetike, por edhe më vonë pasi ka pasur disa parti pro ruse. Në rastin Skripal, për hir të kësaj miqësie, Sofja në fillim nuk ishte dakord me vendet e Perëndimit. Kjo dilemë nuk zgjati për shumë kohë. Në tetor 2019, udhëheqësi i lëvizjes bullgare “Russophiles” (“Rusofili”), Nikolay Malinov arrestohet me akuzën e “spiunazhit në favor të Rusisë<sup>33</sup>”. Malinov u la i lirë me kusht. Edhe pse nuk duhej të largohej nga Bullgaria, ai arriti të arratisë për në Moskë dhe të dekorohet me një medalje nga presidenti rus Vladimir Putin. Vetëm pas kësaj ngjarjeje të rëndë, Bullgaria dëboi një diplomat rus dhe një tjetri iu refuzua e drejta të hynte në vend. Në shtator 2020, Sofja përballet përsëri me spiunazhin rus dhe dëbon dy diplomatë rusë të akredituar në vend si persona “non grata”. Ata akuzohen se ishin “duke mbledhur informacione sekrete shtetërore në lidhje me Bullgarinë për t’ia dorëzuar ato një vendi tjetër”. Prokurorët bullgarë akuzuan një sekretar të parë në seksionin konsullor të ambasadës ruse në Sofje, se i ishte përfshirë në spiunazh qysh nga viti 2017, duke kërkuar informacion në lidhje me procesin zgjedhor, me qëllim komprometimin e këtij procesi. Një diplomat tjetër rus, që shërbente në zyrën e bashkëpunimit tregtar të Rusisë në Sofje, kishte mbledhur informacione konfidenciale mbi sigurinë e energjisë që nga tetori 2018. Prokurorët bullgarë akuzuan gjithashtu tre rusë për tentativën e vrasjes së një tregtari armësh dhe helmimin e dy bullgarëve të tjerë, e cila po hetohej nga Sofja për lidhje të

<sup>32</sup> Nënshkrimi i marrëveshjes historike midis dy vendeve për çështjen e emrit të Maqedonisë së Veriut, në rajonin kufitar të Prespës, nga kryeministrat grek dhe maqedonas Alexis Tsipras dhe Zoran Zaev, më 17 qershor 2018.

<sup>33</sup> Gazetari Krassen Nikolov, hulumtim në EURACTIV.bg, 29 shtator 2021.

mundshme me helmimin e Skripal. Prokurorët bullgarë njoftuan se 6 shtetas bullgarë akuzohen për spiunazh për Rusinë, duke deklaruar se grupi “përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare, pasi mbledh dhe dorëzon te Rusia sekretet e Bullgarisë, NATO-s dhe Bashkimit Europian”. Sipas prokurorëve, interes të veçantë për spiunët përbënte Qendra e Koordinimit të Marinës së NATO-s, e inauguruar në mënyrë sekrete në Varna.

-Aleancë vëllazërore është njohur miqësia ruso-serbe në shekuj, por çuditërisht ka rezultuar si një luftë e ashpër e inteligjencës në vitet e fundit. Serbia në nëntor të vitit 2019 u përball me spiunazhin rus, pavarësisht nga perceptimi i jashtëm për lidhjet historike midis dy vendeve. Mbështetja për grupet nacionaliste pro ruse në Serbi e Malin e Zi, si dhe depërtimi i spiunazhit rus në institucionet kryesore të sigurisë në Serbi, ka për qëllim të mbajnë Beogradin jo vetëm të mbështetur, por edhe të kontrolluar<sup>34</sup>. Zyrtarët e lartë serbë, “të zënë ngushtë” dhe të befasuar, bënë aludime dhe akuza në lidhje me Bullgarinë si vend që po “minonte” miqësinë historike serbo-ruse. Bëhet fjalë për një video të publikuar nga një gazetar bullgar, ku provohet spiunazh i pastër nga Rusia drejt Serbisë. Në video<sup>35</sup> shihen një oficer rus dhe një serb duke shkëmbyer çantën me dokumente dhe duke numëruar paratë. Oficeri rus u identifikua si Georgiy Kleban, zëvendës atashe ushtarak në ambasadën ruse në Beograd. Presidenti Vuçiç e pranoi vërtetësinë e videos së spiunazhit rus, duke iu drejtuar Moskës vetëm me një fjalë që mbart shumë zhgënjim: “Pse?! Në qershor 2021, në Çaçak të Serbisë kanë ndodhur një seri e shpërthimesh në fabrikën e municioneve “Sloboda”. Sipas mediave serbe, nga këto shpërthime kanë mbetur të plagosur tre punëtorë që kishin punuar në depo.

Nga viti 2001 deri në vitin 2012 kanë ndodhur 36 shpërthime dhe sabotime në depot e armatimit në Serbi, pa autor. Lidhur me këto shpërthime, gazetari Milomir Mariq<sup>36</sup> thotë se kjo mund të jetë vepër e shërbimeve sekrete ruse. “Ka plane të ndryshme për Ballkanin, për të cilat Aleksandar Grusko<sup>37</sup> na ka premtuar se Rusia do të na mbrojë jetën neve serbëve, mirëpo rusët kanë metoda të ndryshme të “mbrojtjes”. Gjithçka bëhej sipas parimit të mosbesimit dhe interesit; “miqësia është miqësi, por kontrolli duhet të jetë kontroll”.

<sup>34</sup> Zv/kryeministria serbe Zorana Mihajlovic; 1 shtator 2022, “Rusia po e keqpërdor faktin që ne nuk kemi vendosur sanksione kundër Rusisë, si tezë që tregon luftën e drejtë të Rusisë në Ukrainë. Në fakt ne kemi mbështetur rezolutën e OKB, që e dënon këtë luftë”.

<sup>35</sup> Videoja u bë publike në Radio Europa e Lirë më 19 nëntor 2019, në gjuhën serbe ku shkruante se një diplomat rus dhe pjesëtar i Shërbimit Informativ Ushtarak GRU Georgij Kleban, ishte xhiruar teksa po i dorëzonte të holla një zyrtari ushtarak Serb me pozitë të lartë, që është agjenti e tij sekret në Serbi.

<sup>36</sup> Milomir Mariq, autor i “Deca Komunizma” (fëmijët e komunizmit) dhe gazetar i “Tv Happy” në Beograd.

<sup>37</sup> Aleksandar Grusko, zëvendësministri rus i Punëve të Jashtme.

## PËRFUNDIME

-Përfshirja e Ballkanit Perëndimor në axhendën e NATO-s, si dhe në Konceptin Strategjik 2022-2023, do të ishte i vetmi paralajmërim i fortë që iu çohet “autokracive”, që po përpiqen të sabotojnë dhe destabilizojnë rajonin tonë përmes taktikave hibride<sup>38</sup>.

-Aleanca Moskë, Minsk dhe Kiev, si rikrijim i BS<sup>39</sup>, duhet të përballlet me aleancën perëndimore<sup>40</sup> duke anëtarësuar në NATO- BE sa më shpejt Ballkanin Perëndimor, në të kundërt boshllëkun do ta mbushë Moska. NATO dhe BE duhet të hartojë plane të qarta për garantimin e sigurisë në Ballkan, me qëllim të çarmatosen zjarrvënësit, në të kundërt Uashingtoni dhe Brukseli do të detyrohen të shuajnë shumë zjarre.

-Influenca ruse në rajon dhe Shqipëri, është herë e dukshme dhe herë e fshehur, por gjithmonë me pasoja. Mbështetësit e Moskës më së shumti gjenden në mes të partive ose liderëve të rajonit tonë që brohorasin; “Poshtë Rusia”, “Rroftë Amerika” dhe “Ne jemi NATO, ne jemi BE” .

-Në kuadër të stabilitetit rajonal, FARSH duhet të jenë promotor i bashkëpunimit sa më konkret me Forcën e Sigurisë së Kosovës, realizimin e stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta, edukim dhe dhënien e ekspertizës më të mirë ushtarake, si dhe mbështetës i fortë për pjesëmarrjen në iniciativa rajonale dhe globale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes<sup>41</sup>.

### Burime të shfrytëzuara

1. Rezoluta 1244 e OKB-së, 10 qershor 1999.
2. Fleur Anderson, deklarata në parlamentin britanik, 27 prill 2022.
3. Leon Tolstoi, “*Lufta dhe Paqja*”, libri i 3-të, pjesa e dytë, kapitulli XXV.
4. Shaban Murati, “*Rusët po vijnë*” 2022; Gazeta Dita, 7 shkurt 2023.
5. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, 2019.
6. Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization, 2010.
7. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të RSH, 2014.

<sup>38</sup> Olta Xhaçka, deklaratë në forumin e ministrave të jashtëm të NATO-s, Riga, dhjetor 2021.

<sup>39</sup> Aleksandër Lukashenko, presidenti i Bjellorusisë deklaroi se është gati që të pranojë në tokën bjelloruse armët bërthamore ruse, nëse NATO bën të njëjtën gjë duke afruar drejt lindjes armët bërthamore të vendosura në Gjermani.

<sup>40</sup> Më 15 dhjetor 2022 kancelari gjerman Olaf Scholz ka deklaruar se është në interesin e Gjermanisë dhe Europës që vendet e mbetura të Ballkanit t’i bashkohen BE-së.

<sup>41</sup> Fjala e SHSHP të RSH Gjenral-Brigade Arben Kingji me 5 gusht 2022

8. Strategjia Ushtarake e RSH, 2015.
9. Samiti i NATO-s, Madrid, qershor 2022.
10. Fatmir Xheladini *“Paradigmat e sigurisë së Maqedonisë: Sfida dhe Mundësi”*.
11. Egidio Ivetic, *Luftërat Ballkanike*.
12. Rexhep Qosja, *Shqipëria dhe Kosova, si kanë qenë dhe si duhet të jenë*.
13. Bardhyl Demiraj, *“Shqiptar dhe shqa”*.
14. Direktiva e Mbrojtjes, për vitin 2023
15. SHSHP Gjeneral Brigade Arben Kingji; Fjalimi i marrjes së detyrës Gusht 2022

# RUSIA MIDIS TË KALUARËS DHE SË ARDHMES - NATO-s, ZGJERIMI DHE VAZHDIMËSIA

**Nënkolonel (R) Msc. Kanan HIMAJ**  
*Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Politika e sigurisë ruse ka evoluar në mënyrë të shpejtë në tre dekadat e fundit, me fokus në “korrigjimin e padrejtësive historike”. Ajo ka rritur “merakun” se shpërbërja e ish-Bashkimit-Sovjetik është tragjedia më e madhe gjeopolitike e shekullit të kaluar; duke synuar për t’u imponuar për një arkitekturë të re sigurie, ndryshe nga sot. Sot, është jetike që perëndimi të njohë se çfarë është në rrezik dhe ta marrë seriozisht për të fituar në kohë për të njohur situatën sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithçka duhet parë me syrin e vëzhguesit të kujdesshëm, sidomos zhvillimet e periudhës së fundit e në mënyrë të veçantë zhvillimet e luftës në Ukrainë.*

*Koncepti i ri Strategjik i NATO-s thekson se: “Agresioni i Federatës ruse kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen dhe ka ndryshuar rëndë mjedisin tonë të sigurisë”.<sup>1</sup> Në tërë politikën dhe filozofinë e saj, ajo ka vendosur në rend të ditës pushtimin brutal dhe të paligjshëm, shkeljet e përsëritura të ligjit ndërkombëtar, humanitar, sulmet dhe mizoritë e tmerrshme, të cilat shkaktojnë vuajtje dhe shkatërrime.*

*Ky artikull vlerëson e analizon ndryshimet dhe vazhdimësitë në strategjitë Ruse, në përgjigje të politikave të zgjerimit të NATO-s. Metodologjia e përdorur ka natyrë ndërdisiplinore pasi diskursi bazohet dhe konceptohet në kontekstin historik me vështirime sociale në zhvillimin bashkëkohor të ngjarjeve.*

<sup>1</sup> Koncepti Strategjik NATO-s, Spanjë, 2022.

*Shkrimi përqendrohet në disa aspekte të trashëgimisë kushtetuese, si; strategjitë e sigurisë të cilat kanë qenë të lidhura me zgjerimin e NATO-s, gjatë dhe pas periudhës së Luftës së Ftohtë<sup>2</sup>.*

*Shkrimi analizon strategjitë ruse në përgjigje të zgjerimit në rritje të NATO-s drejt lindjes. Është konkluduar se konceptet e sigurisë kombëtare të Rusisë ndjekin nga afër procesin e zgjerimit të NATO-s. Natyra e vendosjes, konceptet e sigurisë dhe mbrojtjes, janë vendimtare në formulimin dhe ndikimin jo vetëm në perceptimin e Kremlinit, por edhe në reagimin e tij, veçanërisht në fushën ushtarake ndaj zgjerimit të aleancës.*

**Fjalët kyçe:** Strategjia e sigurisë, Strategjia ushtarake ruse, NATO, Lufta e Ftohtë, siguria, aleanca, planifikimi strategjik, Doktrina Ushtarake

## HYRJE

K aluan 30 vjet nga shpërbërja e ish Bashkimit Sovjetik dhe rënia e murit të Berlinit. Në këtë periudhë, politika e sigurisë së Rusisë është zhvilluar në gjerësi dhe thellësi të gjeopolitikës globale dhe rajonale me tendenca regresive. Rusia dhe NATO kanë pasur një marrëdhënie të gjatë dhe të ndërlikuar, të karakterizuar nga mosbesimi dhe konkurrenca. Në fakt, evolucioni i strategjisë ushtarake sovjetike është i lidhur thellësisht me tendencat e zgjerimit të forcave të NATO-s. NATO me Shtetet e Bashkuara ka vepruar si përcaktuesi kryesor i modernizimit ushtarak sovjetik, i karakterizuar nga përdorimi i luftës moderne, armëve konvencionale të avancuara teknologjikut dhe luftës së informacionit, rritja e përdorimit të hapësirës ajrore dhe hapësirës së jashtme për operacione ushtarake, veçanërisht në epokën e pas Luftës së Ftohtë.

Për të kuptuar më qartë zhvillimin e politikës dhe sigurisë ruse, është e dobishme të analizohen disa nga ngjarjet më të fundit, rrënjët historike të një Rusie në kërkim të një identiteti kombëtar. Pikat kryesore janë modifikimet e Kushtetutës në vitin 2020, “Strategjia e Sigurisë Kombëtare” e rishikuar së fundmi dhe “Politika e Armëve Bërthamore”, e publikuar për herë të parë në vitin 2020.

Dy periudha të dallueshme të zgjerimit të NATO-s kanë ndodhur ndër vite:

Zgjerimi i parë ndodhi gjatë fazës së Luftës së Ftohtë dhe tjetri pas shpërbërjes sovjetike. Rusia ka kundërshtuar çdo raund të përhapjes në rritje të NATO-s në fqinjësinë e saj, deri më tani dhe është ende armiqësore ndaj çdo zgjerimi të ardhshëm të NATO-s drejt lindjes. Fillimi i viteve 1990 u karakterizua nga një periudhë e shkurtër e lidhjeve pozitive midis Rusisë dhe NATO-s, por ky partneritet në zhvillim u përkeqësua shpejt për shkak të veprimit ushtarak

<sup>2</sup> January 2023. NDC Policy Brief Ukraine, NATO and the Black Sea Iulian Romanysyn.

të NATO-s kundër Jugosllavisë (1999), i cili u shoqërua me zgjerimin e NATO-s për të përfshirë Poloninë, Hungarinë, Republika Çeke, Gjeorgjia dhe Ukraina. Kriza e viteve '90-të ishte rezultati i dy perceptimeve të dallueshme të identitetit të vetvetes dhe perspektivës së sigurisë në Europë. Me zgjerimin ushtarak të NATO-s pas Luftës së Ftohtë, kufiri i saj me Rusinë është afuar shumë më afër qendrës kryesore. Kjo frikë e ka shtyrë Kremlinin të nisë një program reformash dhe modernizimi ushtarak të kombinuar me rritjen e konsiderueshme në shpenzimet e mbrojtjes, për të penguar atë që ai e percepton si një kërcënim të drejtpërdrejtë perëndimor për sigurinë ruse.

Në këtë plan, shkrimi synon të hedhë dritë mbi tendencat e zhvillimit të NATO-s dhe gjithashtu përpiqet të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve në zhvillim, midis strategjive ruse dhe me zgjerimin e NATO-s.

## **STRATEGJIA RUSE SHIKON NGA E KALUARA**

Kushtetuta e ndryshuar u ratifikua më 1 korrik 2020, pas një procesi mjaft të ndërlikuar që përfshinte një referendum të mbajtur gjatë tre ditëve për shkak të pandemisë “Konstitutsiia Rossiiskoi Federatsii, 2021”. Cilat ishin ndryshimet më domethënëse dhe çfarë nënkuptonin ato?

Reformat u bënë për të forcuar rolin e Presidentit dhe për t'i lejuar Putinit të kandidojë për rizgjedhje në vitin 2024. Nëse ai vendos për rizgjedhjen në vitin 2030, ai teorikisht mund të jetë president deri më 2036, në moshën 84-vjeçare. Me fjalë të tjera, një president i përjetshëm. Nëse ai vendos të largohet dhe të bëhet senator në Këshillin e Federatës (dhoma e sipërme), imuniteti i tij sigurohet nga ndjekja penale.

Për më tepër, tiparet ideologjike të tekstit të ndryshuar janë më thelbësoret, sidomos pikat e nën nenin 67 të Kushtetutës, theksohet se Rusia është një shtet pasardhës i Bashkimit Sovjetik dhe se Rusia është “e bashkuar nga një histori mijëra vjeçare dhe ruajtëse e kujtimit të paraardhësve të tij, të cilët na kanë dhënë idealet dhe besimin në Zot”. Sipas dokumentit, Federata Ruse gjithashtu “siguron mbrojtjen e së vërtetës historike dhe nuk lejohet nënçmimi i vlerës së veprave heroike të popullit.” Në të njëjtin paragraf thuhet se shteti krijon mundësi që fëmijët të “edukohen në patriotizëm, në frymën publike (grazhdanstvennost) dhe me respekt për të moshuarit”.

Përpjekjet e shtetit për të kontrolluar historiografinë kanë disa forma gjatë pesëmbëdhjetë viteve. Në vitin 2009, u krijua një komision presidencial për të luftuar “falsifikimin e historisë”. Ishte një eksperiment jetëshkurtër dhe komisioni u shpërbë, për ironi, në vitin 2012 i quajtur zyrtarisht “Viti i Historisë Ruse”. Megjithatë, tani po ndodh sërish. Në vitin 2021, u krijua një Komision ndërdeparlamentar për Edukimin Historik nën kujdesin e

Administratës Presidenciale (30 korrik 2021). Presidiumi i Komisionit përfshin Shefin e Inteligjencës së Jashtme (SVR) Sergei Naryshkin, i cili është gjithashtu Kryetar i Shoqërisë Historike Ruse, (Takimi Historik i Komisionit Ndërdepartamental të Arsimit Historik).

Ndryshimet institucionale për “përmirësimin e ekuilibrit të pushtetit”, Putin argumentoi se “një ekuilibër më i madh midis degëve të pushtetit” ishte e nevojshme; megjithatë, pavarësisht disa kompetencave të reja, tendenca e amendamentet synojnë ta bëjnë presidentin edhe më të fuqishëm sesa është aktualisht. Presidenti do të jetë gjithashtu në gjendje, të shkarkojë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese si dhe gjyqtarët e lartë për sjellje të pahijshme.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, presidenti do të ketë imunitet të përhershëm.

Këtu është kritike të pranohet se historia dhe historiografia e Rusisë janë bërë një mjet i politikës së sigurisë në konfrontimin me Perëndimin, si shtypjen e opozitës në vend, ku sot ka burgosur drejtuesin e opozitës ruse<sup>3</sup>. Kohët e fundit, ligji përfshiu kriminalizimin e shpërndarjes së informacionit të rremë për veteranët e Luftës së Madhe Patriotike “Usilena Ugolovnaia Otvetstvennost Za Rabilitatsiiu Natsizma, Ligji për dënimin më të ashpër penal për rehabilitimin e nazizmit 2021”. Ky ndryshim përkoi me gjyqet kundër Aleksei Navalny, duke rezultuar dënime për këtë “krim”, “krimi kundër historisë, 2021”.

Për rrjedhojë, lidhshipi politik e trajton Kushtetutën si një instrument tjetër pushteti. Kjo është diçka që ka ndodhur më parë, fillimisht gjatë përpjekjeve fillestare gjatë Nikollës II<sup>4</sup> në 1905 me Manifestin e Tetorit dhe më pas gjatë Bashkimit Sovjetik. Ajo ishte më shumë një instrument ideologjik dhe politik sesa themeli i shtetit ligjor. Problemet ilustrojnë një mosbesim të thellë, të ndërsjellë midis sundimtarëve dhe nënshtetasve në Rusi. Ndërsa ndryshimet aktuale në Kushtetutën e sotme, ligji përdoret për të mbrojtur pushtetin (carin, udhëheqjen komuniste, presidentin) nga subjektet (Persson 2009).

Strategjia e Sigurisë Kombëtare (NSS) u rishikua në korrik 2021, duke zëvendësuar atë të vitit 2015 (“Strategjia Natsionalnoi Bezopasnosti RF” 2021). Ky dokument është dokumenti më i rëndësishëm strategjik, sipas Ligjit për Planifikim Strategjik. Ai është një dokument i dobishëm sepse përshkruan prioritetet në lidhje me interesat kombëtarë dhe sigurinë kombëtare ruse. Pjesa më e madhe e asaj që përmendet në NSS nuk është ekzekutuar, por flet për drejtimin në të cilin po shkon Rusia - të paktën për sa i përket vullnetit politik.

<sup>3</sup> Shtypi dhe media e ditës, Gazeta “Tema”, data 15. 01.20123

<sup>4</sup> Mbretërimi i Nikollës II, Data e lindjes: 18 maj 1868; Vendi i lindjes: Shën Petersburgu, Rusi (Alexander Palace); Varrë: 17 korrik 1918, Ipatiev House, Rusi. Ai ishte akordi i fundit në sundimin e dinastisë Romanov, njihet me familjen mbretërore. Perandori u ngjiti në fron në 1896.



Ai mbulon disa sektorë me prioritet, si : standardi i jetesës shëndetësore, mbrojtja, hapësira e informacionit, mjedisi, vlerat shpirtërore dhe stabiliteti strategjik.

Dokumenti i sigurisë kombëtare sinjalizon një ndryshim në prioritetet strategjike të Rusisë, me synimin për të “qenë të vetëm” në sistemin ndërkombëtar, koncept dhe vizion ky që mund të sjellë probleme për të ardhmen e rajoneve rreth Rusisë, vendeve Baltike dhe atyre polare<sup>5</sup>.

Strategjia sinjalizon se Moska e sheh veten si palë (dhe aktor) të pavarur të fokusuar në mbështetjen e interesave kombëtarë. Rusia mbetet si një mbështetëse e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe e parimeve të mosndërhyrjes, angazhimi i saj brenda sistemit që synon të formësohet nga pavarësia strategjike e sapo artikulluar.

SSK e Rusisë 2021 kërkon të “përmirësojë parashikueshmërinë në marrëdhëniet midis shteteve”, por largohet nga përsëritjet e mëparshme që përshkruanin se si do të forconte besimin dhe me kë do të bashkëpunonte ajo. Heqja e objektivave dhe interesave në marrëdhëniet e saj me Evropën dhe SHBA sinjalizon rilindjen e një Rusie të pavarur. Koncepti “Bota Ruse” është një platformë e ekspansionit të ri që aktivizon, shfrytëzon dhe përdor atë në favor të interesave, sidomos për popullsinë rusisht - folëse. Platforma që po inicohen edhe në vendet bashkëpunuese të Rusisë, siç është Serbia, me të ashtuquajturën “Bota Serbe”, kanë objektiva të njëjtë edhe në rajonin tonë. Kjo bëhet një sfidë e vështirë kur marrim parasysh interesat strategjike të Rusisë në Arktik dhe Antarktidë - dy zona në të cilat bashkëpunimi konsiderohet vendimtar.

Gjeoeconomia, është gjuha e re strategjike e Kremlinit me strategjinë e vitit 2021, që shfaq gjithashtu interes të ri për “zhvillimin” e “hapësirës së jashtme, të oqeanit botëror” dhe Antarktidës. Këta interesa të përbashkët globalë, veçanërisht hapësira dhe Antarktida, nuk ishin paraqitur në strategjitë e mëparshme të sigurisë kombëtare në kontekstet e zhvillimit. Në të vërtetë, kjo është një strategji e sigurisë të epokës së Putinit.

Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare FR promovon të drejtën ndërkombëtare dhe nënvizon në të gjithë dokumentin epërsinë e sistemit të OKB-së në vend. Kjo tregon largimin e qartë nga dokumenti se nuk do të ketë asnjë normalizim të marrëdhënieve midis Rusisë dhe Perëndimit (ose Lindjes, një e vërtetë e pakëndshme për Pekinin) për vitet e ardhshme.

---

<sup>5</sup> Rajoni i Arktikut është një rajon polar i cili gjendet në pjesën më veriore të botës. Ka shumë analiza dhe studime të cilat flasin për konfliktet ndërshtetërore që karakterizojnë si rajon me burimet e naftës dhe gazit natyror - në zonat e kontestuara detare ndërmjet Kanadasë, Norvegjisë, Danimarkës, SHBA-së dhe Rusisë.

Ekziston një rrezik në rritje që konfliktet e armatosura të përshkallëzohen në luftëra lokale dhe rajonale, duke përfshirë fuqitë bërthamore. Hapësira e informacionit po emërtohet si “sfera të reja të luftës”. Interneti dhe kompanitë ndërkombëtare të IT-së thuhet se përhapin “informacion të rremë”. Rinia në Rusi, sipas NSS, kërcënohet nga “ndikimi shkatërrues”.

Të gjithë paragrafët nga SKK-ja e mëparshme në lidhje me bashkëpunimin me SHBA-në dhe NATO-n për të ruajtur stabilitetin strategjik janë zhdukur, ashtu si edhe formulimet për bashkëpunimin me BE. Seksioni i politikës së jashtme është shkurtuar nga 20 paragrafë në shtatë. Retorika antiperëndimore është bërë më e zhurmshme dhe ka formulime për “shtete jomiqësore” dhe përpjekjen e Perëndimit për të “ruajtur hegjemoninë e tij”. Në të njëjtën kohë, NSS thekson se modeli perëndimor liberal është në krizë dhe në të njëjtën kohë. Perëndimi po përpaket të minojë vlerat tradicionale, të shtrembërojnë historinë botërore, të rishikojë opinionet për rolin dhe vendin e Rusisë. (§19). Përgjashtohen të gjitha referencat për Ukrainën, përveç paragrafit që përcakton se Rusia dëshiron të forcojë lidhjet midis popujve bjellorus dhe ukrainas.

### **ZGJERIMI I NATO-s DHE...**

NATO, një projekt gjeopolitik i udhëhequr nga perëndimi e ka origjinën në Traktatin e Atlantikut të Veriut. NATO ishte kryesisht një pakt sigurie, dhe dy komponentë thelbësorë të NATO-s përfshijnë: “Neni 2, i cili angazhon vendet anëtare të punojnë drejt forcimit të sigurisë, duke forcuar institucionet e tyre të lira” dhe “Neni i famshëm 5, i cili premton mbështetje të sigurisë për çdo shtet anëtar që vihet nën sulm”<sup>6</sup>. Këta dy nene themelorë përbëjnë thelbin dhe shpirtin e konceptit të NATO-s për mbrojtjen kolektive. Traktati pasqyroi një rishikim themelor në politikën e jashtme të SHBA-së. Për herë të parë që nga shekulli XVIII, SHBA-ja kishte lidhur zyrtarisht sigurinë e saj me vendet europiane. Përveç fokusimit në krijimin e një sistemi të mbrojtjes kolektive, NATO gjithashtu kërkoi, të krijonte një marrëdhënie reciproke të dobishme Lindje-Perëndim nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit.

Zgjerimi i parë i NATO-s i lejoi Greqisë dhe Turqisë të anëtarësoheshin si anëtarë të rinj në vitin 1952. Përfshirja e tyre u justifikua kryesisht për arsye sigurie, ekonomike dhe të politikës së jashtme. Arsyet e sigurisë ishin të lidhura me shqetësimin që u desh të haste Greqia pas Luftës së Dytë Botërore për të shtypur një kryengritje komuniste dhe urdhrat e Bashkimit Sovjetik për ngritjen e bazave mbrojtëse në ngushticat turke. Arsyet ekonomike lidhen me planin Marshall të SHBA-së, që synonte të ndihmonte një Europë të rrënuar dhe të dërrmuar të ngrihej ekonomikisht. Arsyet e tjera lidheshin me

<sup>6</sup> Deklarata e Samitit të Wales. 2014. [http://www.nato.int/cps/ic/natohq/official\\_texts\\_112964.htm](http://www.nato.int/cps/ic/natohq/official_texts_112964.htm). më 8 qershor 2022.

doktrinën Truman, e cila jo vetëm garantonte sigurinë e Turqisë dhe Greqisë, por gjithashtu siguronte që ata të ishin në anën e djathtë të Perdes së Hekurt. Shtimi i këtyre dy vendeve “i mundësoi aleancës të forconte krahun e saj jugor për të parandaluar veprimet ushtarake komuniste në Europë në kulmin e luftës koreane”<sup>7</sup>. Pozicioni strategjik i Turqisë ka qenë i rëndësishëm për NATO-n, pasi “ajo shërben si një spirancë jetike lindore, duke kontrolluar ngushticat që çojnë nga Deti i Zi në Mesdhe, së bashku me ndarjen e kufirit me Sirinë, Irakun dhe Iranin”<sup>8</sup>.

Kundërshtari kryesor i Luftës së Dytë Botërore Republika Federale e Gjermanisë u bashkua aleancës perëndimore në 1955, pavarësisht kundërshtimit të hershëm nga Franca dhe Bashkimi Sovjetik. Anëtarësimi në NATO u pa si një hap i madh në rehabilitimin e Gjermanisë pas luftës, pasi ajo ktheu një pjesë të madhe të sovranitetit të saj, i cili u pezullua gjatë pushtimit të pas Luftës së Dytë Botërore dhe krijoi një kurs të ri për Gjermaninë për të luajtur një rol të dukshëm në sigurinë dhe mbikëqyrjen e Europës Perëndimore gjatë viteve të Luftës së Ftohtë. Blerjet e Gjermanisë u bazuan në Strategjinë e re të NATO-s, e miratuar në vitin 1950, e cila kërkonte “riarmatimin e forcave ushtarake gjermane dhe theksonte mbrojtjen e Evropës sa më larg në lindje, dhe në perëndim jo më larg sesa lumi Rhine”<sup>9</sup>.

Procesi i pranimit të Spanjës në NATO, filloi menjëherë pas tranzicionit demokratik të qeverisë, që ndodhi pas vdekjes së Frankos (1975). Pas tranzicionit të Spanjës në një vend demokratik, u bë shumë e lehtë për shtetet anëtare të NATO-s, Britania dhe Franca të justifikonin hyrjen e tyre në organizatë. Megjithatë, një lloj mosmarrëveshjes vazhonte ende midis udhëheqësve socialistë dhe komunistë të Spanjës, të cilët ishin të mendimit se hyrja e Spanjës në NATO do të rriste shkallën e tensionit që ekzistonte midis dy blloqeve konkurruese dhe do ta bënte Spanjën një objektiv të mundshëm të Bashkimi Sovjetik në rastin e një konflikti të ardhshëm. Ata ishin gjithashtu të mendimit se anëtarësimi në NATO nuk do ta ndihmonte Spanjën të rimarrë Gjibraltarin e humbur, pasi anëtarët e NATO-s do të favorizonin Britaninë në këtë drejtim.

Diskutimi rreth zgjerimit të NATO-s në epokën e pas Luftës së Ftohtë u iniciua nga Henry Kissinger qysh në vitet 1991-92., por ishte nën udhëheqjen e Bill Klintonit që programi i zgjerimit të NATO-s përfundimisht mori formën e një politike konkrete. Tendencat për zgjerimit/n të/e NATO-s janë kuptuar nga

<sup>7</sup> Zgjerimi i NATO-s gjatë kohës së Ftohtë: Strategjia dhe sistemi në Aleancën Western. New York: Palgrave; 2000.

<sup>8</sup> Frydrych K. Debati mbi zgjerimin e NATO-s. Lidhjet : Gazeta Tremujore. 2008; 7 (4): 1–42.

<sup>9</sup> Jaroff E. Zgjerimi i NATO-s gjatë dhe pas Luftës Ftohtë. Konferenca e Kërkimit universitar Claremont-UC për Bashkimin Evropian. 2009; (7): 1–17.

Kremlini si një “lojë me shumë zero”, në të cilën vendet anëtare të rajonit euroatlantik po zgjerojnë dominimin e tyre në kurriz të Rusisë. Në vitet pas rënies së Murit të Berlinit dhe të vetë Bashkimit Sovjetik, NATO, ka qenë në gjendje të riformësojë ‘arsye duke u zhvendosur nga: “një organizatë që ofron vetëm mbrojtje kolektive, në një organizatë pro aktive në fushën e sigurisë kolektive”, ky transformim strategjik është i dukshëm, nga misionet e ndryshme bashkëkohore të ndërmarra nga NATO d.m.th. “Operacioni Ocean Shield” dhe “Operation Unified Protector in Libia” në 2011 së bashku me “përpjekjet për ndërtimin e kombit në Afganistan”. Prandaj, NATO “në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, u shfaq si një instrument ushtarak për shtetet anëtare të komunitetit euroatlantik në trajtimin e krizave të mëdha ndërkombëtare, që zakonisht bazohen në mandatin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB)”<sup>10</sup>

Menjëherë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, Moska dukej se po integrohej me komunitetin e sigurisë euroatlantike, duke ndezur shpresa të mëdha për një rend të ri paqësor në hemisferën veriore<sup>11</sup>. Por krijimi i programit Partneriteti për Paqe, i cili kishte për qëllim krijimin e besimit midis NATO-s dhe vendeve të Varshavës, e përkeqësoi këtë partneritet. Moska e perceptoi Partneritetin për Paqe si një mjet për të rritur fuqinë e SHBA-së në Evropë dhe për të ulur ndikimin e Rusisë. Një tjetër pikë kryesore në marrëdhëniet SHBA-Kremlin erdhi në vitin 1994 për shkak të përfshirjes së NATO-s në krizën e Bosnjës, e ndjekur nga vendimi për të zgjeruar anëtarësimin e saj. Forcat e NATO-s kryen ndërhyrjen e tyre të parë të madhe në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila u shoqërua me zbatimin e “Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit”, e cila shpalli fundin e luftës së viteve 1992-1995 në vend. “Forca Zbatuese e udhëhequr nga NATO (IFOR)” u stacionua në dhjetor 1995 dhe u shoqërua nga “Forca e Stabilizimit e udhëhequr nga NATO (SFOR)”, e cila përfundoi në dhjetor 2004.

Një hap ambicioz drejt institucionalizimit të partneritetit Rusi-NATO u hodh në vitin 1997, me “Aktin Themelues NATO-Rusi” i cili u shoqërua shumë shpejt nga institucioni i përbashkët i përhershëm NATO-Rusi.

Ai parashtroi, mekanizmin për të nxitur bashkëpunimin, koordinimin dhe vendimmarrjen e përbashkët midis NATO-s dhe Rusisë. Akti nënvizonte se: duke u nisur nga parimi se siguria e të gjitha shteteve në komunitetin euroatlantik është e pandashme, NATO dhe Rusia do të punojnë së bashku për të kontribuar në krijimin e sigurisë në Europë.<sup>12</sup> Synimi i përbashkët, për

<sup>10</sup> Shea J. Mbajtja e NATO-s relevante. 2012. <http://carnegieendowment.org/2012/04/19>.

<sup>11</sup> Kanet R, Larive M. NATO dhe Rusia: Një fillim i përhershëm i ri. Perceptimet. 2012; 17 (1): 75–96.

<sup>12</sup> Akti themelues NATO-s Në dispozicion nga: [http://www.nato.int/cps/cn/natohq/official\\_texts\\_25468.htm](http://www.nato.int/cps/cn/natohq/official_texts_25468.htm). 9 qershor 2022.

të ndërtuar një mbrojtje të fortë në rajonin euroatlantik, nuk mund të zgjaste shumë për shkak të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë.

Fushata ajrore e vitit 1999 e NATO-s në Kosovë, pa miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, u realizua si pjesë e planit të NATO-s për sigurinë në Europë. Pavarësisht se i është akorduar një aleancë speciale me NATO-n sipas Aktit Themelues, përpjekja e Ruisë për të kundërshtuar ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë nuk ishte e suksesshme.

Vala e dytë e “zgjerimit të NATO-s në administratën e Bushit, përqafoi shtatë vende, përkatësisht Bullgarinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë, të cilët iu bashkuan NATO-s në vitin 2004. Këto zgjerime që ndodhën në epokën e pas Luftës së Ftohtë (1999 dhe 2004), ishin të ndryshme nga ana cilësore dhe sasiore nga zgjerimet e mëparshme. Nga ana sasiore në hapësirën e pesë viteve, numri i vendeve anëtare të NATO-s u rrit nga 16 në 26. Anëtarësimet zgjeruan ndjeshëm zonat kufitare të Aleancës ngjitur me Rusinë dhe rritën madhësinë e zonës nën ombrellën e sigurisë kolektive në Europë me afro 30% dhe ndikuan në rritjen e përplasjeve midis Ruisë dhe vendeve të komunitetit euroatlantik”<sup>13</sup>. Për më tepër, lufta në Irak i shtyu më tej marrëdhëniet NATO-Rusi në një nivel të ulët, dhe pati frikë për rikthimin e dyshimeve dhe armiqësisë së vjetër të Luftës së Ftohtë. Rusia, së bashku me Gjermaninë dhe Francën, refuzuan dhe kufizuan me sukses nëpërmjet rezolutës së OKB-së, përdorimin e forcës ushtarake kundër Sadam Huseinit. Kjo çoi në një përplasje të tensionuar midis forcave të Ruisë dhe NATO-s.

Administrata e Obamës (2009) promovoi politikën e dyerve të hapura të zgjerimit të NATO-s. Politika theksoi përfshirjen e shteteve të reja europiane në aleancën ushtarake të udhëhequr nga SHBA për të ruajtur sigurinë dhe stabilitetin e rajonit euroatlantik. Shtetet e Bashkuara mbështetën fuqimisht hyrjen e vendeve si Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Gjeorgjia dhe Ukraina dhe argumentuan se ato duhet të ftohen për t’u bashkuar me Planin e Veprimit të Anëtarësimit në NATO (MAP). Në Samitin e NATO-s, Bukuresht 2008, si Shqipërisë ashtu edhe Kroacisë iu drejtuan ftesat për anëtarësim, të cilat kulmuan me pranimin e tyre zyrtar në samitin e NATO-s në Strasburg në prill 2009<sup>14</sup>. Ftesa për Malin e Zi për t’u bërë anëtar i 29-të i aleancës ushtarake shihet nga Rusia si një lëvizje e hapur konfrontuese.

Trump, presidenti i 45-të i Shteteve të Bashkuara, ishte një zë kritik ndaj NATO-s, duke këmbëngulur që vendet europiane duhet të paguajnë për mbrojtjen e tyre kolektive dhe në këmbim të japin koncesione për interesat

<sup>13</sup> Deklarata e Samitit të Bukureshtit. 2008. nga: [http://www.nato.int/cps/in/natohq/official\\_texts\\_8443.htm](http://www.nato.int/cps/in/natohq/official_texts_8443.htm) 9 qershor 2022.

<sup>14</sup> Çfarë ka të drejtë Trump për NATO-n. 2017; 96 (5): 108-114. <https://www.jstor.org/stable/44821874>, 11 qershor 2022.

e SHBA-së në tregti. Në maj të 2017 në Bruksel, ai deklaroi: “Anëtarët e NATO-s më në fund duhet të kontribuojnë pjesën e tyre të drejtë. Europa duhet të bëjë më shumë”,<sup>15</sup> Kjo u pasua nga pranimi i Malit të Zi si anëtar i 29-të i aleancës së NATO-s më 5 qershor 2017. Veprimi tregoi se Presidenti Trump dëshironte të zgjeronte aleancën e NATO-s në ato vende në rajon që ndajnë qëndrimin e tij të kujdesshëm ndaj Iranit, veçanërisht Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA). Në vitin 2020, Maqedonia e Veriut përfundoi integrimin në NATO dhe u bë anëtar i 30-të e saj.

## **...STRATEGJIA DHE DOKTRINA USHTARAKE RUSE**

### **Strategjia Ushtarake Ruse (periudha e Luftës së Ftohtë).**

Periudha pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore përfaqësoi një periudhë jashtëzakonisht të trazuar në zhvillimin e ushtrisë sovjetike në shumë aspekte. Nga ana tjetër, udhëheqësi sovjetik theksoi gjithashtu zhvillimin e atyre teknologjive ushtarake në të cilat BS kishte qenë më i mangët: armët bërthamore, radarët, raketat dhe motorët reaktivë. Ai gjithashtu ndërmori ndërtimin e një marine të madhe, në thelb konvencionale.

Qasja e NATO-s në këtë periudhë, tërheq vëmendjen Samiti i Londrës në korrik 1990, ajo ftoi “Hungarinë, Çekosllovakinë, Poloninë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Bashkimin Sovjetik për të vendosur marrëdhënie të rregullta diplomatike me aleancën. Kjo çoi në krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) në 1991”<sup>16</sup>. Këshilli u pa si një hap i madh drejt zhvillimit të marrëdhënieve midis vendeve të NATO-s dhe ish-blokut sovjetik. Por përpjekjet e mëtejshme të Gorbaçovit si desovjetizimi dhe dekomunizimi i Evropës Lindore të shoqëruara me bashkimin e Gjermanisë në vitin 1990 sollën ndryshime të mëdha në gjeopolitikë dhe u shënuan nga fundi i paktit të Varshavës, dështimi i këshillit NACC dhe shpërbërja e Bashkimi Sovjetik.

Diskutimi rreth zgjerimit të NATO-s në epokën e pas Luftës së Ftohtë u iniciua nga Henry Kissinger qysh në vitet 1991-92. Nën udhëheqjen e Bill Klintonit, programi i zgjerimit të NATO-s përfundimisht mori formën e një politike konkrete. Tendencat zgjerimit të NATO-s janë kuptuar nga Kremlini si një “lojë me shumën zero”, në të cilën vendet anëtare të rajonit euroatlantik po zgjerojnë dominimin e tyre në kurriz të Rusisë.

Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, pati një rivendosje në marrëdhëniet Rusi-SHBA, presidentët e të dy vendeve u takuan dhe Rusia nën drejtimin e Putinit ra dakord të ndihmonte SHBA-në në Afganistan. Afganistani konsiderohet të

<sup>15</sup> Staar R, Lee W. Politika Ushtarake Sovjetike: që nga World War II. Kaliforni: Hoover Press; 1986.

<sup>16</sup> Hass M. Reformat Ushtarake Ruse: Fitorja pas njëmbëdhjetë vjet dështimi? Instituti Holandez i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. 2011; (5): 64–117.

jetë “operacioni i parë jashtë zonës i NATO-s dhe më i madhi përsa i përket aftësive ushtarake dhe vendosjes së forcave. Disa pika kryesore të kontributit të Rusisë në këtë mision ishin: lejimi i SHBA-së për të operuar në hapësirën ajrore të Azisë Qendrore, të cilën Rusia e konsideronte si në territorin e saj të ndikimit, mbështetja e Forcave të Armatosura afgane, stërvitja e forcave afgane kundër narkotikëve etj. Kjo shkrimje në marrëdhëniet Rusi-NATO u përforcua më tej me krijimin në vitin 2002 të “Këshillit NATO-Rusi (NRC)” në Samitin e Romës. NRC zëvendësoi Këshillin e Përhershëm të Përbashkët NATO-Rusi (PJC), i cili shërbeu për të përmirësuar koordinimin midis NATO-s dhe Federatës Ruse dhe për të adresuar çështjet e sigurisë ndërkombëtare dhe projektet e përbashkëta midis dy palëve.

Federata Ruse publikoi dokumentin e saj të fundit ushtarak në fillim të qershorit 2020 të titulluar, “Mbi Parimet Themelore të Politikës Shtetërore të Federatës Ruse për parandalimin bërthamor”, ai përshkruan kërcënimet dhe rrethanat që mund të çojnë në përdorimin e armëve bërthamore nga Rusia. Në dokument thuhet në mënyrë specifike se, Rusia i sheh armët bërthamore si një masë vetëm parandaluese, ai thekson se, politika e parandalimit bërthamor të Rusisë “është mbrojtëse nga natyra, ajo ka për qëllim ruajtjen e potencialit të forcave bërthamore në nivelin e mjaftueshëm për parandalimin bërthamor dhe garanton mbrojtjen e sovranitetit kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit, si dhe parandalimin e një kundërshtari të mundshëm nga agresioni kundër Federatës Ruse dhe/ose aleatëve të saj.”<sup>17</sup> Perceptimet e kërcënimit janë ngurtësuar në lidhje me Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, dhe qeveria ruse duket se është në procesin e përditësimit të disa dokumenteve të strategjisë së sigurisë kombëtare.

Strategjia dhe Doktrina Ushtarake e Rusisë është krijuar për të “edukuar” vëzhguesit e Rusisë, politikëbërësit, udhëheqësit ushtarakë dhe komunitetin më të gjerë të politikës së jashtme në lidhje me FA dhe institucionet e sigurisë në të gjithë spektrin gjeografik, doktrinar dhe zonat e fushës të përgjegjësisë së tyre. Duke trajtuar dhe studiuar në gjithë kapitujt e doktrinës, duke filluar nga doktrina “hibride” e luftës, deri te roli që luajnë armët bërthamore në strategjinë e saj, në luftën kibernetike dhe elektromagnetike, në qëndrimin e Moskës në Arktik ose Detin e Zi, dhe mësimet që FA kanë nxjerrë nga operacionet e tyre të vazhdueshme në Siri dhe Ukrainën lindore.

Elemente gjeografike të strategjisë së Rusisë që tërheqin vëmendjen, janë: lufta në Ukrainë, strategjia e saj në Detin e Zi dhe Mesdhe; ofensiva strategjike ruse në Lindjen e Mesme dhe strategjia e Detit Baltik.

---

<sup>17</sup> Forcat e Armatosura Ruse: Modernizimi dhe Reformat Ushtarake. RAPORTI CRS 2020. nga: <https://sgp.fas.org/crs/row/IF11603.pdf>, më 10 qershor 2022]



Po kështu, strategjia dhe doktrina ruse nuk lenë mënjane çështjet për elementet jo konvencionale të strategjisë dhe doktrinës si: lufta ‘hibride’, lufta e Gjeneratës së Re; Doktrina dhe Strategjia Bërthamore; “Strategjia asimetrike” e Putinit: armët bërthamore të tipit të ri në politikën e mbrojtjes; përdorimi sulmues dhe mbrojtës i sigurisë së informacionit.

Nisur nga e shkuara e politikës, strategjisë dhe doktrinës ruse, ata kanë vendosur në fokus deshifrimin e mësimëve të nxjerra dhe implikimet e brendshme e sidomos nga lufta hibride në Ukrainë dhe operacionet në Krime dhe në lindje të saj; operacioni në Siri; koncepti i Kthimit të Mobilizimit Masiv në Ukrainë 2021-2023, etj.

Nisur nga ky këndvështrim, pyetjet kryesore janë: Si lufton Rusia? Si është përvoja në konfliktet moderne që kanë formësuar evolucionin e strategjisë ushtarake të Rusisë? Vlera e informacionit vjen jo vetëm nga një vështrim i pjesshëm për strategjitë ruse në secilin nga teatrot dhe fushat ku Forcat e saj të Armatosura mund të veprojnë. Me rëndësi është se ky informacion synon të paraqesë një përshkrim rreth strategjisë ushtarake të Rusisë si një fuqi globale në rënie, por ende e frikshme. Strategjia Ushtarake e Rusisë dhe Doktrina e saj do të jenë një referencë thelbësore për analistë dhe studiues të sigurisë, për planifikuesit e sigurisë dhe mbrojtjes në organizmat e sigurisë rajonale dhe globale, politikë bërësit në mbarë botën që duhet të merren me sfidat e sigurisë të paraqitura nga Moska.

## PËRFUNDIME

Kushtetuta, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia dhe Doktrina Ushtarake e Federatës Ruse, demonstrojnë elemente të dallueshme të kulturës strategjike të vendit dhe politikës së saj të sigurisë. Ajo ka të bëjë kryesisht me pozicionin dhe synimet e Rusisë, të cilat janë transformimi i rendit ndërkombëtar dhe shndërrimi në lider moral në sferën post-sovjetike. “Sindroma e kalasë së rrethuar” lidhet me konfrontimin me Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj, të cilët për një kohë të gjatë janë akuzuar se kanë shfrytëzuar dobësitë e Rusisë duke ndërhyrë në mjedisin e informacionit rus, ose për të ashtuquajturën “ushtrim i kontrollit mbi Ukrainën”. Sindroma e Fuqisë së Madhe manifestohet në marrëdhëniet me shtetet fqinje, të cilat sipas autoriteteve ruse nuk duhet të jenë aktorë të pavarur.

Programi i modernizimit përfshinte të gjitha pjesët e ushtrisë ruse, duke përfshirë “forcat strategjike bërthamore, jo strategjike bërthamore dhe konvencionale. Ky modernizim ushtarak dhe bërthamor pas Luftës së Ftohtë, u nxit nga ambicia e Presidentit Putin për të rivendosur fuqinë e Rusisë dhe për të ndihmuar në rikthimin e rëndësisë globale, që humbi pas Luftës së Ftohtë. Këto vite, Moska e ka bërë të qartë se inkursionet e vazhdueshme të



NATO-s në zonën e sigurisë së Rusisë, do të shihen si një akt agresioni kundër Federatës Ruse. Kriza dhe shpallja e luftës së Ukrainës, jep një konfirmim përfundimtar të saj.

Duke parë me vëmendje dokumentet kryesore strategjike të Federatës Ruse, vërehet një qasje më represive dhe izoluese, duke hequr dorë nga bashkëpunimi me tendencë imponuese, mbështetur mbi mitet e së kaluarës, të kombinuara me metodat moderne, nga përdorimi i kërcënimeve hibride deri tek armët bërthamore, në interes të arritjes së objektivave të politikës ekspansioniste.

Objektivat dhe synimet ruse të mbartura që prej vitit 2014 e deri në ditët e sotme, kanë shkuar në kahe të kundërt me parashikimet e tyre. Ky tregues i dështimeve të njëpasnjëshme, po shfaqet në luftën në Ukrainë, e cila po përballon me sukses luftën, duke arritur të ndalojë realizimin e objektivit strategjik të Rusisë.

Platforma “Bota Ruse” e transferuar dhe materializuar në rajonin tonë si ajo e ashtuquajtur “bota serbe” kanë si synim instrumentalizimin e popullsisë të tyre në vendet fqinje, për të realizuar destabilizimin e këtyre vendeve për interesat e tyre hegjemoniste, që përbën një kërcënim për mjedisin e sigurisë së Ballkanit Perëndimor.

Në përshtatje me vizionin dhe me sistemin e sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive, mësimet për ne janë të vlefshme për sa njohim dhe shohim synimet e politikës agresive të Rusisë ndaj Ukrainës, por edhe synimeve të fshehura të saj, ndaj rajonit dhe Ballkanit Perëndimor.

Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Sigurisë përcaktoi disa objektiva strategjike të cilat lidhen rishikimin e dokumenteve strategjike për çështjet e sigurisë. Ato detyra janë evidente në Procesin e Planifikimit Strategjik të Sigurisë, të lidhura ngushtë me sfidat e NATO-s (NDPP), sidomos ato të shprehura në Samitin e Madridit 2022 si: shmangia e përshkallëzimit të luftës në Ukrainë; ruajtja e unitetit brenda vendeve anëtare të NATO-s dhe atyre partnere; siguria në shtetet balltike; rritja e shpenzimeve për mbrojtjen (2% të PBB).

### **Burime të shfrytëzuara:**

1. Koncepti Strategjik i NATO-s, Madrid 2022.
2. Presidenti i RSH, Bajram Begaj, Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të RSH, më 23.01.2023.
3. Strategjia e Sigurisë Kombëtare SHBA - 2022.
4. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të RSH -2014.
5. January 2023 NDC Policy Brief Ukraine, NATO and the Black Sea Iulian Romanyshtyn \*

6. NATO Secretary General Jens Stoltenberg at the Annual Conference of the Confederation of Norwegian Enterprises, 05 Jan. 2023 -[Last updated: 06 Jan. 2023.
7. Fjala e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Mircea Geoană në Konferencën mbi Zhvillimin e Partneriteteve të NATO-s në një mjedis të ndryshim të Sigurisë, 08 dhjetor 2022.
8. Wales Summit Declaration. 2014. Available from: [http://www.nato.int/cps/ic/natohq/official\\_texts\\_112964.htm](http://www.nato.int/cps/ic/natohq/official_texts_112964.htm). 8 June 2022.
9. Shea J. Keeping NATO Relevant. 2012. Available from: <http://carnegieendoement.org/2012/04/19/keeping-nato-relevant-pub-47872>.
10. Kanet R, Larive M. NATO and Russia: A Perpetual New Beginning. Perceptions. 2012;17(1).
11. NATO, founding act 1997. Available from: [http://www.nato.int/cps/cn/natohq/official\\_texts\\_25468.htm](http://www.nato.int/cps/cn/natohq/official_texts_25468.htm). 9 June 2022].
12. “Parimet themelore të politikës të Federatës Ruse për parandalimin bërthamor”.2020. Ministria e Punëve të Jashtme Ruse [https://www.policy/international\\_safety/disarmament/-/asset\\_publisher/rp0fiUBmANaH/content /id/4152094](https://www.policy/international_safety/disarmament/-/asset_publisher/rp0fiUBmANaH/content/id/4152094).
13. Hans M. Kristensen & Matt Korda (2020) Forcat bërthamore ruse, 2020, Buletini i shkencëtarëve atomikë, 76:2, 102-117, DOI: 10.1080/00963402.2020.1728985; <https://doi.org/10.1080/00963402.2020.1728985>
14. “Takimi i Zgjeruar i Bordit të Ministrisë së Mbrojtjes” 2020. <http://en.kremlin.ru/events/president/news/64684>.
15. The Basic Provisions of the Military Doctrine of the Russian Federation. 1993. Available from: <https://nuke.fas.org/guide/russia/doctrine/russia-mil-doc.html> 10 June 2022
16. “Takimi i Parë i Komisionit Ndërinstitucional për Edukimin Historik.” 2021. <http://kremlin.ru/events/administration/66806>.
17. “Rusia, krimi kundër historisë”. 2021. 770a. FIDH. <https://www.fidh.org/IMG/pdf/russie-pad-uk-web.pdf>
18. Russian Armed Forces: Military Modernization and Reforms. CRS REPORT 2020. Available from: <https://sgp.fas.org/crs/row/IF11603.pdf> 10 June 2022.

## RUBRIKA E KATËRT

### Shkrime historike

Marrëdhëniet diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë u rivendosën më 15 mars 1991, pas një ndërprerjeje prej 52 vjetësh. Ambasada e SHBA në Tiranë u hap më 1 tetor 1991, me Kristofer Hill si i Ngarkuar me Punë *ad interim* dhe i pasuar nga ambasadori i SHBA Uilliam Eduin Rajerson, i cili ia paraqiti kredencialet e tij Qeverisë së Shqipërisë më 21 dhjetor 1991.

Pra, në datën 15 mars të këtij viti, mbushen 32 vite nga rivendosja zyrtare e marrëdhënieve shqiptaro amerikane.

Për këtë temë, për herë të parë në historinë e kësaj Reviste, vijnë me punimet e tyre shkencore dy akademikë, dy emra të mirënjohur në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe historiografisë shqiptare; Profesor Paskal Milo dhe Profesor Ksenofon Krisafi.

Secili me këndvështirmin e tij, e Profesor Paskal Milo vjen me punimin me titull “*Qëndrimi amerikan në konfliktin shqiptaro-sovjetik*”.

Qysh në fillimvitet '90-të, nga analistë por edhe nga politikanë të ndryshëm, është përhapur opinioni se... “Amerika, as ka dashur t’ia dijë për Shqipërinë në periudhën kur nuk kishte marrëdhënie diplomatike me të”, e se... “Shqipëria nuk përbënte interes për Amerikën në kohën e socializmit”, etj, etj.

Në fakt, ka ndodhur pikërisht e kundërta. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë pushuar asnjëherë së interesuari për Shqipërinë, kuptohet përmes ambasadave në vendet fqinjë me ne, por edhe përmes disa ambasadave të vendeve perëndimore, që funksiononin në Tiranë.

Të gjitha këto, i gjejmë të faktuara me nota diplomatike dhe me telegrame, të cilat

i sjell në shkrimin e tij Profesor Paskal Milo. Më konkretisht, disa fragmente:

“Departamenti i Shtetit ishte njohur me zhvillimin e Kongresit të Partisë Punëtore Rumune në Bukuresht në qershor 1960 dhe me mbledhjen e partive komuniste, që morën pjesë aty në nivelin më të lartë të tyre, me në krye liderin sovjetik Nikita Hrushov. Gjithashtu ishte siguruar edhe informacioni për shfaqjen e mosmarrëveshjeve kino-sovjetike në këtë mbledhje.

Por ajo çfarë nuk dihej ishte arsyeja e mungesës së Enver Hoxhës në kongresin rumun dhe në mbledhjen ndërkombëtare komuniste. Madje Departamenti i Shtetit e konsideronte “të vështirë të merret me mend, se liderët shqiptarë mund të “bojkotojnë” një mbledhje të tillë komuniste ndërkombëtare të rëndësishme, duke patur parasysh varësinë e tyre të madhe politike, ushtarake dhe ekonomike nga Bashkimi Sovjetik.

Zyrtarët francezë u dhanë amerikanëve kopje të dy mesazheve, që ishin dërguar nga ministri francez Keller në Tiranë, njëra në 8 dhe tjetra në 25 korrik 1960. Në të parën Keller njoftonte se Hoxha kishte qenë thjesht i sëmurë nga një sëmundje jo diplomatike, e quajtur ethet e Maltës. Në mesazhin e dytë diplomati francez e mohon informacionin e parë, duke iu referuar përgënjeshttrimit zyrtar shqiptar, të bërë nga ministri i punëve të jashtme Behar Shtylla.

Konflikti shqiptaro-sovjetik, që shpërtheu në fillim të viteve 60, ishte i dyti në Ballkan, pas atij sovjeto-jugosllav të vitit 1948. Ai krijoi në rajon një situatë të re, e cila për të gjithë fqinjët e Shqipërisë shtroi domosdoshmërinë e rishikimit të politikave të tyre afatshkurtra e strategjike në lidhje me këtë vend. Greqia, Italia dhe Jugosllavia, secila nga këndvështrimi i interesave të tyre, në fund të vitit 1961 kishin përpunuar qëndrimet ndaj përçarjes midis Tiranës dhe Moskës, si dhe taktikat që do përdornin në marrëdhëniet me fqinjin e tyre të rebeluar ndaj Bashkimit Sovjetik.

Ambasadori amerikan nga Roma njoftonte Departamentin e Shtetit më 24 Dhjetor 1961 se... “Qeveria italiane tashmë ishte e përgatitur që t’i jepte disa kredi Shqipërisë, në qoftë se ajo do t’i kërkonte ato dhe se për një gjë të tillë, ishte informuar tërthorazi edhe delegacioni tregtar shqiptar, i cili kishte përfunduar një marrëveshje në Romë në fillim të dhjetorit...

...Karamanlisi i shpreh fare hapur pikësynimet greke për Italinë, kur në mesin e dhjetorit 1961 thotë se “Greqia nuk do të dëshironte të shikonte Italinë të kthehej në Ballkan”. Dhe akoma më direkt e afishon këtë qëndrim, Promemorja e 21 dhjetorit që është edhe dokumenti më zyrtar i qeverisë greke, ku, duke bërë fjalë për inkurajimin e Shqipërisë nga Perëndimi, nënvizohet se “Italia vështirë se mund të cilësohet si kanali më i përshtatshëm për zbatimin e një politike të tillë aleate ndaj Shqipërisë, sepse siç e tregon e kaluara e saj në këtë vend, mund të shkaktojë mosbesim dhe dyshim”.

Këto fragmente, sa për të marrë një “shije” nga ana e lexuesit. Të tjerat, në brendësi të shkrimit...

Kurse Profesor Ksenofon Krisafi, rektor i Universitetit Mesdhetar, vjen me një tjetër këndvështrim në punimin e tij, në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Me titullin *“Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane para 28 korrikut 1922”*.

...“Marrëdhëniet ndërshtetërore, vendosen dhe zhvillohen nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ose të tërthorta, por nuk përjashtohet që ndonjëherë të realizohen edhe pa raporte të kësaj natyre. Kështu duket se ka ndodhur edhe në marrëdhëniet e shqiptarëve me amerikanët. Në kuptimin simbolik, zanafilla e tyre konsiderohet koha kur shtetas amerikanë kanë zbritur në trojet shqiptare, ose kur shqiptarë kanë shkelur në kontinentin amerikan.

Profesor Krisafi e nis historikun e këtyre marrëdhënieve me një libërth me titullin “Mary Ball Washington”, i botuar në SHBA në vitin 1850 nga Virginia Carmichael, që është ndër të parët ku përmenden shqiptarët, e ku flitet për origjinën shqiptare të presidentit amerikan Xhorxh Uashingtonit (George Washington).

Në librin e sipërcituar, shkruhet se e ëma e tij, ishte fëmija e dy prindërve shqiptarë, me origjinë nga rrethinat e Pejës, që kishin emigruar në kontinentin amerikan në vitin 1706. Lindi në Lively të Virxhinias dhe e quajtën Maria Bala, emër të cilin do ta amerikanizonte më vonë, në Mary Ball. Rasti e dha që në vitin 1731 të bëhej gruaja e dytë e Augustine Uashingtonit dhe më 22 shkurt 1732 solli në jetë George Uashingtonin, një prej etërve themelues të SHBA.

Për ekzistencën e lidhjeve spontane, jo institucionale, shqiptaro-amerikane, bëhet fjalë edhe në disa shkrime publicistike të shtypit amerikan, prej fillimit të shek. XIX. Midis tyre është reportazhi i dy gazetarëve amerikanë, të cilët më 8 prill të vitit 1819, zbritën në molin e Sajadhës së Çamërisë, për të shkuar tek Ali Pashë Tepelena. Në Janinë, në kryeqendrën e pashallëkut të tij, vepronin edhe konsullatat e Francës, Anglisë dhe të Rusisë.

John A. Kasson, shefi i legatës amerikane në Vjenë, i cili mbulonte edhe rajonet e Malit të Zi dhe të Shqipërisë, në telegramin e datës 5 maj 1880, drejtuar Sekretarit të shtetit-Evarts, ai shkruan: -“Çështja e marrëdhënieve midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, po tërheq përsëri vëmendjen dhe ka shkaktuar shqetësim... kanë filluar lëvizjet popullore e ushtarake dhe të huajt nuk kanë informacione se reagimi dhe lëvizjet, mund të përfshijnë edhe kombe të tjerë në luftë...

Nëpunës të Departamentit të Shtetit i përsëritën Çekrezit se Uashingtoni kishte nevojë të krijonte bindje për qëndrueshmërinë e shtetit shqiptar, seriozitetin, shtrirjen territoriale, efikasitetin e veprimtarisë së qeverisë dhe individëve që ishin në krye të vendit. Për këtë arsye kërkuan informacione plotësuese

nga përfaqësitë e tyre diplomatike dhe konsullore në Athinë, Beograd, Romë, Trieste etj. Morën gjithashtu edhe informacionin e Komisionit hetimor të Lidhjes së Kombeve që ishte dërguar në Shqipëri”...

Le ta lejojmë lexuesin që kureshtjen e tij ta kënaqë në faqet e shkrimit të Profesor Krisafit.

Në këtë Rubrikë, vjen gjithashtu me punimin e tij një akademik i mirënjohur, Profesor Neritan Ceka.

Është ndoshta arkeologu më i spikatur që kemi sot, madje edhe trashëgimtar i një emri të ndritur të arkeologjisë shqiptare, Profesor Hasan Ceka.

Ai ka përzgjedhur për Revistën punimin me titull *“Beteja e Pelionit në lashtësi”*.

Mbasi ballafaqon historianët romakë të kohës me veprat që ata kanë lënë të shkruara, Profesor Ceka vjen me mendimin e konsoliduar të historianëve dhe të arkeologve shqiptarë, i cili bazohet vetëm në artefakte.

...“Beteja e Aleksandrit të Madh kundër ushtrisë ilire të mbretit Kleit, që u zhvillua pranë qytetit Pelion të Dasaretisë më 335 p.es. njihet si e vetmja humbje e strategut të madh të Antikitetit pikërisht në fillim të karrierës së tij ushtarake. Historiani romak i fillimit të shek. I es., Kurt Rufi, dhe ai grek i fillimit të shek II e.s., Arriani i Nikomedisë, na kanë lënë përshkrime të hollësishme të asaj beteje, por a mund t’i besojmë autorëve që shkruanin për një ngjarje që kishte ndodhur rreth disa qindra vjet para tyre?

Burimi i vetëm i të dy historianëve besohet se kanë qenë shënimet e gjeneralit të Aleksandrit, Ptoleme Lagut, me origjinë nga Eordea, pra nga rajoni i sotëm i Kosturit. Kjo mund të shpjegojë edhe informacionin e hollësishëm që përmban përshkrimi i fushatës së Aleksandrit prej tyre, që e bën betejën e Pelionit njerën nga ngjarjet luftarake më të dokumentuara të historisë ushtarake ilire. Si u zhvillua ajo betejë?

Sipas tij mbreti i ilirëve, Bardhyli, pasi kishte humbur dy herë luftën kundër Filipit II të Maqedonisë, “i ishte bindur fituesit”. Pas vdekjes së tij “i biri i tij, i quajtur Kleit, duke menduar se kishte ardhur koha për të fituar lirinë, atëherë kur Aleksandri ishte i zënë me një luftë përtej Istrit me popuj të fuqishëm, i bëri fiset e tij të rroknin armët dhe lidhi aleancë me Glaukiasin, mbretin e ilirëve që quhen taulantë”.

Pavarësisht nga tërheqja e rregullt dhe pa humbje, që i detyrohej disiplinës së reparteve të ushtrisë maqedonase, po aq sa edhe talentit ushtarak të Aleksandrit vetëm 21 vjeçar, kjo ishte jo vetëm një humbje në planin ushtarak, por edhe në atë politik, sepse pas largimit me turp të ushtrisë së Aleksandrit, krijoheshin mundësitë e ringjalljes së Mbretërisë së Bardhylit në një aleancë të fuqishme

me mbretin Glaukias të Ilirisë”...

Punimi i Profesor Cekës është i mbushur me fakte dhe data, me dokumente të cilat lexuesi do t'i shijojë në leximin e tij.

Doktori i shkencave Kolonel në rezervë Ulsi Meta, vjen në Revistë me një punim interesant me titull *“Telegrami i parë shqiptar; i dekriptuar në vitin1914”*.

Koloneli në rezervë, njihet prej vitesh për punimet e tij shkencore.

Por e veçanta e këtij punimi, është se na sjell në dritë zbërthimin e të parit telegram në Shqipëri, në vitin e largët 1914.





# QËNDRIMI AMERIKAN NË KONFLIKTIN SHQIPTARO- SOVJETIK

Prof. Dr. Paskal MILO

## Trajtesë e shkurtuar.

*Amerikanët u kapën në befasi nga fillimi i konfliktit shqiptaro-sovjetik në verën e vitit 1960. Mungesa e postit diplomatik në Tiranë i kishte privuar ata nga informacionet e dorës së parë. Ato që siguroheshin dhe aq sa dërgoheshin nga legatat franceze dhe italiane kishin qënë të dobishme por jo të mjaftueshme.*

*Departamenti i Shtetit ishte njohur me zhvillimin e Kongresit të Partisë Punëtore Rumune në Bukuresht në qershor 1960 dhe me mbledhjen e partive komuniste, që morën pjesë aty në nivelin më të lartë të tyre, me në krye liderin sovjetik Nikita Hrushov. Gjithashtu ishte siguruar edhe informacioni për shfaqjen e mosmarrëveshjeve kino-sovjetike në këtë mbledhje.*

*Por ajo çfarë nuk dihej ishte arsyeja e mungesës së Enver Hoxhës në kongresin rumun dhe në mbledhjen ndërkombëtare komuniste. Madje Departamenti i Shtetit e konsideronte “të vështirë të merret me mend, se liderët shqiptarë mund të “bojkotojnë” një mbledhje të tillë komuniste ndërkombëtare të rëndësishme, duke patur parasysh varësinë e tyre të madhe politike, ushtarake dhe ekonomike nga Bashkimi Sovjetik”.<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Mesazh (Airgram) i Departamentit për ambasadat amerikane në Paris dhe Romë, 4 gusht 1960. NARA. R. G. 59. General Records of the Department of State. Central Decimal File 1960-1963. Box. No. 1925.

## ARSYEJA E MUNGESËS

Për të mësuar shkakun real të mungesës së Hoxhës në Bukuresht, Departamenti i Shtetit porosi ambasadorët amerikanë në Paris dhe Romë në 4 gusht 1960 që të interesoheshin pranë ministrive të punëve të jashtme të Francës dhe Italisë. Detyra ishte që të merrnin çdo informacion apo komente që ato mund të kishin nga legatat e tyre në Tiranë për mungesën mjaft të dukshme të Hoxhës ose të Shehut në Kongresin e pak kohëve më parë të Partisë Punëtore Rumune, në të cilin u dëgjuan thashetheme për mosmarrëveshje kino-sovjetike.<sup>2</sup>

Enver Hoxha nuk shkoi me qëllim në Bukuresht. Ishte i vetmi ndër udhëheqësit komunistë të Europës Qendrore e Lindore që mungoi në kongresin e komunistëve rumunë, por dërgoi një koleg tjetër të tij atje, Hysni Kapon. Mungesa e tij nuk ishte e rastit. Enver Hoxha që në shkurt të vitit 1960 gjatë vizitës së tij në Moskë, ishte informuar nga sovjetikët për mosmarrëveshjet me kinezët.

Ai kishte ndjekur nga afër polemikën ideologjike sovjeto-kineze të zhvilluar gjatë muajve të fundit dhe ndihej afër pozitive kineze, sepse ndër të tjera Pekini mbante qëndrime kritike ndaj Titos. Nuk është e qartë nëse kinezët e kishin informuar deri në qershor Hoxhën, qoftë edhe në mënyrë sekrete për pikëpamjet e tyre zyrtarisht. Për të sqaruar qëndrimin e tyre e për të patur një informacion më të saktë, ai në fund të majit e fillim të qershorit dërgoi në Pekin tre anëtarë të Byrosë Politike.

Ende pa e përpunuar përfundimisht taktikën e tij, Hoxha u njoftua nga Kapo në Bukuresht se sovjetikët e kishin informuar për pikëpamjet e tyre në lidhje me mosmarrëveshjet me Partinë Komuniste të Kinës. Një ditë përpara takimit të përfaqësuesve të lartë të partive në Bukuresht, delegacioni sovjetik kishte shpërndarë letrën voluminoze, ku kërkohej me urgjencë dënimi i kinezëve.

Informacioni që kryqëzohej në Tiranë sa nga Bukureshti po aq edhe nga Pekini e shtynë përfundimisht udhëheqësin shqiptar që të merrte vendimin që do të sillte gjithë ato rrjedhoja për marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike. Kapo u udhëzua që të mos bashkohej me kritikant antikineze të sovjetikëve dhe propozoi bisedime të drejtpërdrejta sovjeto-kineze për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.<sup>3</sup> Qëndrimi shqiptar ishte i papritur për Hrushovin. Ai kishte shfaqur mjaft herë pakënaqësi ndaj Hoxhës dhe e kishte kritikuar, por nuk kishte dyshuar se ai nuk do ta mbështeste në polemikën me kinezët. Por ndodhi ajo që siç do të shkruante në atë kohë politologu i mirënjohur amerikan Zbigniew Brzezinski... “Për herë të parë në historinë e Bllokut Lindor, partitë e vogla mundën të

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Raport mbi zhvillimin e punimeve të Konferencës së Bukureshtit në Plenumin XVII të K.Q. PPSH, 11-12 korrik 1960. AQSH. Fondi 14/APL<sub>00</sub>. Viti 1960. Dosja Nr. 2, fl. 1418.

paraqesin opsione kundër Bashkimit Sovjetik, që udhëheqësit e tyre mund të ballafaqoheshin publikisht dhe ende të qëndrojnë brenda bllokut.”<sup>4</sup>

Rëndësia dhe karakteri i aktit disident të Hoxhës në Bukuresht, duhet gjykuar për kohën kur ndodhi, për t’u vlerësuar objektivisht. Ai shënoi fillimin e një përkeqësimi progresiv të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike që përfundoi pas 18 muajsh me ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike midis të dy vendeve. Përtej motiveve personale që ka patur Enver Hoxha për ruajtjen e pushtetit, rezistenca e tij antisovjetike ka patur edhe elementë të tjerë. Ai nuk u tërhoq deri në fund, ndonëse ofertat pajtuese dhe për kompromis, nuk munguan nga ana e Hrushovit. Hoxha nuk ishte idealist dhe as parimor por një politikan tashmë me përvojë, që mbrojtjen e regjimit të tij arriti ta paraqesë si mbrojtje të sovranitetit kombëtar.

Kur konflikti shqiptaro-sovjetik shpërtheu hapur, në botën perëndimore nuk munguan vlerësime dhe analiza të kësaj natyre. Nuk ka dyshim që në Shqipëri sovjetikët nuk arritën të krijojnë një opozitë të fortë të brendshme kundër Hoxhës për ta përmbysur atë, ndonëse tentuan. Vetë Hoxha sapo nuhati një tentativë të tillë, me përvojë të gjatë në qërimin e hesapeve në regjimin e tij, nuk u la kohë sovjetikëve për ta rrëzuar nga brenda. Që nga fillimi i konfliktit Hoxha mori garanci nga kinezët për ndihma për mbijetesë e zhvillim. Së fundi, Moska nuk mund të zbatonte “variantin hungarez” të ndërhyrjes e të pushtimit të Shqipërisë jo vetëm për shkak të largësisë gjeografike por edhe të koniunkturës ndërkombëtare.<sup>5</sup>

Zyrtarët francezë u dhanë amerikanëve kopje të dy mesazheve, që ishin dërguar nga ministri francez Keller në Tiranë, njëra në 8 dhe tjetra në 25 korrik 1960. Në të parën Keller njoftonte se Hoxha kishte qenë thjesht i sëmurë nga një sëmundje jo diplomatike, e quajtur ethet e Maltës. Në mesazhin e dytë diplomati francez e mohon informacionin e parë, duke iu referuar përgënjeshtërimit zyrtar shqiptar, të bërë nga ministri i punëve të jashtme Behar Shtylla.<sup>6</sup>

Edhe burimet e ministrisë së jashtme italiane me origjinë nga Tirana, në fillim përmendin si shkak ethet e Maltës, por pak më vonë ato njoftojnë se... “Shpjegimi më i mundshëm i mungesës së Hoxhës në Kongresin e Bukureshtit, është se delegacioni shqiptar ishte instruktuar të mos pajtohej me qëndrimet sovjetike dhe Hoxha në këto rrethana nuk kishte kurajë të kundërshtonte Hrushovin”.<sup>7</sup> Në tetor 1960 Departamenti i Shtetit siguroi dy raporte nga

<sup>4</sup> Zbigniew Brzezinski. The Soviet Blok. Unity and Conflict. Revised Edition. Frederick A. Praeger, Publisher. New York, 1962. p. 430.

<sup>5</sup> William E. Griffith. Albania and Sino-Soviet Rift. The M. I. T. Press. Cambridge, Massachusetts, 1963, p. 3.

<sup>6</sup> Mesazh i Ambasadës amerikane në Paris për Sekretarin e Shtetit, 11 gusht 1960. NARA. . . Box. No. 1925.

<sup>7</sup> Mesazh i Ambasadës amerikane në Romë për Sekretarin e Shtetit, 24 gusht 1960. NARA. . .

ministria e jashtme franceze për Shqipërinë, njëri prej të cilëve i ishte dërguar edhe NATO-s. Francezët, ndonëse nënvizonin disa fakte, midis të cilave edhe blerjen urgjente të grurit francez nga ana e Qeverisë Shqiptare, në shtator 1960 besonin se “Ka pak shanse që divergjencat midis Tiranës dhe Moskës të marrin një karakter të ashpër. Largimin e Liri Belishovës nga Byroja Politike e KQ të PPSH dhe zëvendësimin e saj me Ramiz Alinë, ata gabimisht e interpretuan si një gjest të Enver Hoxhës për të rivendosur kredinë e tij pranë Hrushovit”.<sup>8</sup>

Ky mendim i diplomacisë franceze mbështetej edhe në vizitën që shefi i komunistëve francezë Moris Torez bëri në korrik 1960 në Tiranë dhe në Moskë, mision ky që synonte pajtimin dhe kompromisin midis Hrushovit dhe Enver Hoxhës, para mbledhjes së përgjithshme ndërkombëtare komuniste në Moskë në nëntor 1960. Megjithatë, mbledhja e Moskës jo vetëm që nuk i afroi, por ishte edhe takimi i fundit i tyre, i cili u pasua nga veprime që nuk kishin nevojë më, për t’u analizuar dhe për të parë hendekun e thellë që u krijua në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike.

Amerikanët në fillim duket se nuk e kanë vlerësuar shumë, ose më mirë nuk e menduan se grindja Moskë-Tiranë do të merrte përmasat që mori. Kjo përshtypje krijohet edhe nga fakti se në arkivin e Departamentit të Shtetit, nuk kishte dokumente për këtë çështje deri në gjysmën e vitit 1961. Në gjysmën e dytë të atij viti, interesi amerikan për Shqipërinë vjen në rritje.

Në 15 gusht Sekretari i shtetit Dean Rusk u drejtohet ambasadave amerikane në Paris, Romë dhe Ankara. Në telegramin që u dërgon theksohet se: “Departamenti interesohet për ndjekjen sa më nga afër e sa më të plotë që të jetë e mundur, të zhvillimeve të brendshme aktuale në Shqipëri, të shfaqjeve të vazhdueshme të përçarjes në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, si dhe të zgjerimit të natyrës së mbështetjes ekonomike dhe politike që i është dhënë regjimit shqiptar nga komunistët kinezë”.

Ambasadave të mësipërme u kërkohet që: “Shteteve të Bashkuara t’u sigurohej mundësisht maksimumi i informacioneve që qeveritë franceze, italiane dhe turke, merrnin prej misioneve diplomatike, ose prej burimeve të tjera në Shqipëri, në lidhje me zhvillimet e brendshme dhe të jashtme të këtij vendi.”<sup>9</sup> Në fund të nëntorit 1961, përsëri Rusk u kërkoi ambasadave amerikane në Paris, Bon, Romë, Athinë, Ankara dhe Honkong, informacione të tjera për Shqipërinë, të cilët kanë të bëjnë me konfliktin sovjetiko-shqiptar”. Veçanërisht porosiste Sekretari i shtetit: “Interes parësor për informim, kanë përpjekjet e

---

Box. No. 1925.

<sup>8</sup> Valixhja diplomatike (Air Pouch). Ambasada amerikane në Paris për Departamentin e Shtetit, 19 tetor 1960. NARA. . . Box. No. 1925.

<sup>9</sup> Tel. i Departamentit të Shtetit për Ambasadat amerikane në Paris, Romë dhe Ankara, 15 gusht 1961. NARA...Box. No. 1926.

regjimit shqiptar për të siguruar ndihmë ekonomike në Perëndim, qëndrime popullore pro ose kundër Enver Hoxhës, çfarëdo treguesish për koncesione ndaj popullsisë, mobilizimin e forcave të armatosura, aktivitetet e teknikëve kinezë dhe zhvillimet e reja në marrëdhëniet me Europën Lindore, Kinën dhe BRSS”.<sup>10</sup>

Rusk në mënyrë të veçantë kërkoi “çdo informacion në lidhje me vlerësimet greke dhe jugosllave për fuqitë, dobësitë, problemet dhe perspektivat e ardhshme të regjimit të Tiranës”.<sup>11</sup>

## U RINGJALLËN AMBICIET E VJETRA TË FQINJËVE

Konflikti shqiptaro-sovjetik, që shpërtheu në fillim të viteve 60, ishte i dyti në Ballkan, pas atij sovjeta-jugosllav të vitit 1948. Ai krijoi në rajon një situatë të re, e cila për të gjithë fqinjët e Shqipërisë shtroi domosdoshmërinë e rishikimit të politikave të tyre afatshkurtra e strategjike në lidhje me këtë vend. Greqia, Italia dhe Jugosllavia, secila nga këndvështrimi i interesave të tyre, në fund të vitit 1961 kishin përpunuar qëndrimet ndaj përçarjes midis Tiranës dhe Moskës, si dhe taktikat që do të përdornin në marrëdhëniet me fqinjin e tyre të rebeluar ndaj Bashkimit Sovjetik.

Për Athinën konflikti shqiptaro-sovjetik ishte në favor në Perëndimit, por veçanërisht të Greqisë. Ajo u tërhoqte vëmendjen aleatëve të saj se “çdo ndryshim në orientimin e jashtëm të Shqipërisë, drejtohej kundër interesave të tyre të përbashkëta”. Kryeministri Konstandin Karamanlis në dhjetor 1961, shprehej se Greqia ishte për një Shqipëri të pavarur dhe për t’i dhënë një mbështetje që ta ruante pavarësinë nga Moska.

Për qeverinë greke mbështetja duhej të ishte ekonomike dhe politike, por disi e kufizuar, “aq sa ekonomia e Hoxhës të mbijetojë (jo të fuqizohet – larg qoftë!) dhe jeta e tij politike të zgjatet”.<sup>12</sup> Aforizma e njohur “armiku i armikut tim është miku im”, është tepër e përshtatshme për të karakterizuar qëndrimin e Greqisë dhe të Perëndimit në përgjithësi ndaj Enver Hoxhës dhe regjimit të tij, në kohën e konfliktit shqiptaro-sovjetik.

Klasa politike greke pas Luftës së Dytë Botërore, nuk kishte patur ndonjë simpati për Enver Hoxhën dhe regjimin komunist në Shqipëri. Përkundrazi, politika greke, e inkuadruar në strategjinë e përgjithshme perëndimore kundër

<sup>10</sup> Udhëzim i Departamentit të Shtetit për Ambasadat e postet konsullore në Ankara, Paris, Romë, Athinë, Beograd e Honkong për mbledhjen e informacioneve për Shqipërinë, 28 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>11</sup> Mesazh i Sekretarit të Shtetit Rusk për Ambasadat amerikane në Athinë e Beograd, 27 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>12</sup> Tel. i Ambasadorit amerikan në Athinë, Briggs për Sekretarin e Shtetit, 15 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

komunizmit, kishte bërë mjaft përpjekje për ta rrëzuar atë dhe regjimin e tij. Mirëpo në fillimin e viteve 60-të prishja shqiptaro-sovjetike krijoi rrethana të tjera që diktonin një qëndrim tjetër, të kundërt nga ai i mëparshmi. -Greqia preferon Hoxhën, - i thoshte sekretari i përgjithshëm i ministrisë së punëve të jashtme Palamas, konsullit amerikan Benet, në fund të tetorit 1961, por ajo... “nuk ka ndonjë dashuri për Hoxhën dhe nuk e shikon atë si individ... Në qoftë se Hoxha do të përmbysset dhe në vend të tij do të vihet një kukull sovjetike, atëherë sovjetikët do të riktheheshin në Shqipëri. Kjo do të kishte implikime ushtarake përfshirë rikthimin e mundshëm të nëndetëseve sovjetike në Adriatik”. Athina midis dy të këqijave zgjidhte të keqen më të vogël. Ministri i jashtëm grek Evangjelos Averof i thoshte ambasadorit amerikan në Athinë se “Hoxha anti Moskës është para e pistë në bankën e botës së lirë, njësoj (në mos me erë më të keqe) se Tito”.

Duke qenë se rezistenca e tij ndaj Hrushovit objektivisht u shërbente edhe interesave greke, Karamanlisi njoftonte Uashingtonin se “Greqia do t’i japë një farë ndihme ekonomike dhe ndoshta politike regjimit të tanishëm shqiptar, në qoftë se Hoxha do ta kërkojë atë”.<sup>13</sup>

Konflikti shqiptaro-sovjetik ngjalli ambiciet dhe rivalitetet e vjetra të fqinjëve të Shqipërisë, dyshimet dhe rezervat midis tyre. Tradicionalisht në Shqipëri janë përplasur dy çifte interesash: italo-jugosllave dhe italo-greke. Sapo shpërtheu hapur çarja midis Tiranës dhe Moskës, qeveria greke nxitoi të shpallë “hands-off policy” në Shqipëri. Kjo thirrje më tepër i adresohet Romës dhe Beogradit.

Pothuajse në të gjitha demarshet që Athina bëri në Uashington në tetor-dhjetor 1961, për të shprehur qëndrimet e saj ndaj konfliktit shqiptaro-sovjetik, nënvizohen synimet e vjetra italiane në Shqipëri, si dhe shqetësimet greke për një rol eventual të italianëve në këtë vend. Më 31 tetor 1961, Palamas i shfaqti rezervat e qeverisë greke konsullit amerikan në Athinë, Benet, duke i thënë se “Italianët nuk e kishin mprehtësinë e duhur psikologjike për situatën shqiptare”.<sup>14</sup>

Palamasi sugjeronte francezët, si më të përshtatshëm dhe shprehte keqardhjen që britanikët nuk ishin përfaqësuar në Tiranë, sepse ata do të dinin se si ta shfrytëzonin situatën. Këtë ide e zhvillon më gjerë ministri i jashtëm Averof në takimin me ambasadorin amerikan, 10 ditë më vonë. -Franca, thoshte ai, -e cila ka legatë në Tiranë, është fuqia që duhet të luajë rolin kryesor. -Do të ishte shumë e dobishme, sugjeronte Averofi për Shtetet e Bashkuara, që nëpërmjet Francës, t’i jepeshin Shqipërisë ndihma në grurë, ushqime etj. Por ai dyshonte “nëse Franca do të

<sup>13</sup> Tel. i Ambasadës amerikane në Athinë, për Sekretarin e Shtetit, 15 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>14</sup> Tel. i konsullit amerikan Benet në Athinë për Sekretarin e Shtetit, 31 tetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

dëshironte ta luante këtë rol, pa nxitjen dhe interesimin amerikan”.<sup>15</sup>

Karamanlisi i shpreh fare hapur pikësynimet greke për Italinë, kur në mesin e dhjetorit 1961 thotë se “Greqia nuk do të dëshironte të shikonte Italinë të kthehej në Ballkan”. Dhe akoma më direkt e afishon këtë qëndrim, Promemorja e 21 dhjetorit që është edhe dokumenti më zyrtar i qeverisë greke, ku, duke bërë fjalë për inkurajimin e Shqipërisë nga Perëndimi, nënvizohet se “Italia vështirë se mund të cilësohet si kanali më i përshtatshëm për zbatimin e një politike të tillë aleate ndaj Shqipërisë, sepse siç e tregon e kaluara e saj në këtë vend, mund të shkaktojë mosbesim dhe dyshim”.<sup>16</sup>

Grekët gabonin kur dyshonin se italianët ishin për rrëzimin e regjimit të Hoxhës. Përkundrazi. Ministria e jashtme italiane kishte mendimin se... “Perëndimi do të kishte shumë avantazhe, po qe se do të mbante statuskuonë në Shqipëri, e të ruante regjimin anti Moskë dhe anti Beograd të Enver Hoxhës”. Italianët i shfaqin hapur synimet e tyre për të marrë nën kujdes Shqipërinë dhe për këtë e dinë se, në radhë të parë, duhet të fitojnë mbështetjen e amerikanëve. -Italia thoshin ata, është në pozitën më të mirë për të ndihmuar në mbajtjen e statuskuosë në Shqipëri.

Argumentet që paraqiteshin, ishin se... “Marrëdhëniet tregtare italo-shqiptare ishin forcuar në mënyrë të konsiderueshme që nga zbatimi i bllokadës ekonomike sovjetike në fillim të vitit 1961, se blerjet shqiptare ishin rritur dukshëm, se negociatat midis firmave italiane dhe qeverisë shqiptare kishin ecur përpara për ndërtimin e një uzine të madhe të plehrave kimike, se Shqipëria ka nevojë për materiale, pajisje industriale dhe mjete transporti, e të gjitha këto mund t’i gjejë tek Italia, se qeveria italiane ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar Shqipërinë, edhe në fushën e bujqësisë etj.”<sup>17</sup>

Ambasadori amerikan nga Roma njoftonte Departamentin e Shtetit më 24 Dhjetor 1961 se... “Qeveria italiane tashmë ishte e përgatitur që t’i jepte disa kredi Shqipërisë, në qoftë se ajo do t’i kërkonte ato dhe se për një gjë të tillë, ishte informuar tërthorazi edhe delegacioni tregtar shqiptar, i cili kishte përfunduar një marrëveshje në Romë në fillim të dhjetorit. Italianët ishin shumë të kujdesshëm në hapat e afrimit të tyre me Tiranën, sepse nuk dëshironin që t’u jepnin “fqinjëve të Shqipërisë, veçanërisht Jugosllavisë, ndonjë arsye për të dyshuar në depërtimin italian në Shqipëri”.

Qeveria italiane, gjithashtu u deklaronte aleatëve të saj, se e konsideronte

<sup>15</sup> Tel. i Ambasadorit amerikan në Athinë, Briggs për Sekretarin e Shtetit, 10 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>16</sup> Promemorje Greke për Shqipërinë, 21 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>17</sup> Mesazh i Ambasadorit amerikan në Romë, Reinhardt për Sekretarin e Shtetit, 24 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.



çështjen shqiptare të rëndësishme dhe se “nuk ka vend për veprime aventureske nga ana e vendeve të tjera në adresë të Shqipërisë, mbasi një ndërhyrje e tillë, do të kishte rrjedhoja serioze dhe do të kthente pas një situatë, e cila është duke u zhvilluar tani në favor të Perëndimit”.<sup>18</sup>

## INTERESIMI I SHBA PËR SHQIPËRINË

Me këtë deklaratë italianët paralajmëronin për rreziqe që mund të vinin nga një agresion jugosllav kundër Shqipërisë, zëra këto që ishin përhapur nga një shkrim i gazetarit të mirënjohur C. L. Sulsberger në “New York Times”. Sipas kësaj gazete, “Hrushovi dhe Tito kishin arritur një marrëveshje, që i lejonte Beogradit dorë të lirë në rregullimin e punëve në Shqipëri”.

Departamenti i Shtetit iu drejtua ambasadës amerikane në Beograd, për të marrë informacione më të sakta. Ambasadori amerikan në Beograd Xhorxh Kenan, (George F. Kennan), i dërgoi qendrës së tij mjaft raporte interesante, në të cilat ai skicoi politikën jugosllave ndaj Shqipërisë. Në 19 Nëntor 1961 ai i shkruante Rusk-t, duke iu referuar ngjarjeve shqiptare se... “Jugosllavët natyrisht i kanë ndjekur ngjarjet e kohëve të fundit, me interesin më të madh dhe me një përzjerje shprese dhe shqetësimi”... dhe se “ata padyshim do të ishin shumë të kënaqur, ta rrëzojnë Hoxhën në favor të një regjimi komunist–revizionist miqësor ndaj Jugosllavisë, në qoftë se do të kishin aftësinë për ta bërë këtë përmes intrigës dhe manipulimit në Partinë Komuniste Shqiptare dhe pa patur nevojën e ndërhyrjes ushtarake”.<sup>19</sup>

Jugosllavët e kishin bërë të qartë se nuk kishin ndonjë simpati për Hoxhën e Shehun, por as edhe mendonin për një ndërhyrje ushtarake në Shqipëri. Ata disa herë i kishin siguruar amerikanët për një gjë të tillë. Nga dokumentet e hulumtuara në arkivin e Departamentit të Shtetit, del se “Beogradi nuk kishte frikë nga fakti se italianët dhe grekët mund të fitonin një avantazh më të madh mbi jugosllavët në Shqipëri, sesa nga depërtimi i kinezëve në këtë vend”.

Qeveria jugosllave mendonte se “është e rëndësishme të lirohet Hoxha nga varësia e tij e plotë prej ndihmës kineze” dhe se “armiqësia e vendosur e Shqipërisë për Jugosllavinë do të zbutet pasi Hoxha të jetë i lirë nga varësia e tij e plotë nga Kina”. Do të ishte një gjykim naiv të supozohej se jugosllavët në një situatë tepër të komplikuar në të cilën ndodhej Shqipëria, të merrnin në konsideratë vetëm ndërhyrjen kineze në Shqipëri. Tito ishte i përgatitur që të vepronte, por kjo do të varej nga rrethanat që do të mund të krijoheshin. Beogradi ishte shumë konspirativ dhe Kenani i shkruante Departamentit se “Jugosllavët këtu janë të heshtur sa gurët, rreth konditave të brendshme të

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Tel. i Ambasadorit amerikan në Beograd Xhorxh Kennan (George Kennan) për Sekretarin e Shtetit, 19 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.



Shqipërisë dhe të gjitha gjykimet tona, qëndrojnë në strukturën e brishtë të asaj që duket”.<sup>20</sup>

Çështja shqiptare në fillimin e viteve 60-të u bë një nga temat qendrore të politikës perëndimore. Ajo u diskutua jo vetëm në nivelin e qeverive, por disa herë edhe në nivelin e NATO-s dhe të organizmave të saj politikë dhe ushtarakë. Nuk ka dyshim që rolin kryesor në përpunimin e qëndrimeve perëndimore ndaj Shqipërisë në kohën e konfliktit me Bashkimin Sovjetik, e luajtën Shtetet e Bashkuara. Kjo, jo vetëm për shkak se vendet perëndimore dhe veçanërisht fqinjët e Shqipërisë, Italia dhe Greqia ishin në konsultime të rregullta me Shtetet e Bashkuara për këtë çështje, por se në fund të fundit ishin qëndrimet amerikane, ato që u përqaftuan nga të gjithë të tjerët. Uashingtoni udhëhoqi të gjithë procesin e bisedimeve për të përpunuar një politikë të përbashkët.

Në 28 nëntor 1961 diplomacia amerikane bëri një gjest domethënës politik, i cili ishte njëkohësisht edhe një mesazh për regjimin e Hoxhës. Me rastin e festave kombëtare, përvjetorin e pavarësisë dhe atë të çlirimit nga pushtimi fashist në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, përfaqësuesi i përhershëm i Shqipërisë në OKB, Halim Budo dha pritjen e zakonshme festive e diplomatike.

Për habinë e tij, një telefonatë nga zyrat e Misionit amerikan në OKB, njoftoi se në këtë pritje dëshironte të merrte pjesë edhe një përfaqësues i këtij Misioni në nivelin e ambasadorit në emër të Adlai Stivenzonit, përfaqësuesi i përhershëm i SHBA në OKB.

I njëjti veprim u krye edhe nga misioni britanik në OKB. Kjo ndodhte për herë të parë dhe Halim Budo njoftoi me urgjencë Tiranën prej nga erdhi edhe pëlqimi për të mirëpritur përfaqësuesit perëndimorë.<sup>21</sup>

Po kështu për herë të parë Departamenti i Shtetit nuk bëri deklaratë për Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë në 28 nëntor me fjalorin e viteve të kaluara.<sup>22</sup>

Ky qëndrim ishte vetëm një hap, një sondazh në procesin e përpunimit të politikës amerikane ndaj Shqipërisë. Kjo etapë, mbështetur në dokumentet amerikane, ka zgjatur afërsisht deri në fundin e janarit 1962. Amerikanët para se të vendosnin kanë dashur të grumbullojnë një informacion të bollshëm dhe analitik nga burime të ndryshme, e veçanërisht nga fqinjët e Shqipërisë.

Në radhë të parë, Departamentit të Shtetit i ka interesuar të mësojë diçka më shumë rreth karakterit dhe personalitetit të Enver Hoxhës, thellësisë së bindjeve të tij ideologjike dhe shkaqeve reale të prishjes me sovjetikët. Interesante në

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Radiogram i Përfaqësuesit të përhershëm të Shqipërisë në OKB, Halim Budo për ministrinë e punëve të jashtme, 2 dhjetor 1961. AMEPJ. Viti 1961. Dosja Nr.367, fl. 55.

<sup>22</sup> Po aty.

këtë drejtim është biseda e zhvilluar më 18 nëntor 1961 midis Dean Rusk-ut dhe ministrit italian të punëve të jashtme Senji (Antonio Segni) në Uashington.

Sekretari i Shtetit, siç nënkuptohet nga biseda, dëshironte të dinte nëse Enver Hoxha ishte njeri me bindje të thella ideologjike ose jo, sepse këtu ishte edhe kyçi i shpjegimit të konfliktit të tij me Hrushovin. Pasi mori përgjigjen e ministrit të jashtëm italian se Hoxha nuk ka mendime të thella ideologjike, Rusk-u konkludoi se... “Në qoftë se Hoxha ishte në gjendje të prishej me sovjetikët, ai mund të jetë në gjendje të prishet edhe me kinezët, që janë më larg. Çështja është se ku do të shkonte ai atëherë”.<sup>23</sup>

Departamenti i Shtetit në fazën e parë nuk nxitohet të nxjerrë konkluzione, të cilat mund edhe të ishin të nxituara e për rrjedhojë edhe të dëmshme.

Në tetor 1961, qeveria greke kritikonte Shtetet e Bashkuara se mbanin një qëndrim indiferent ndaj Shqipërisë dhe... “Nuk kanë interes, të shohin ndonjë interes” te regjimi i Hoxhës. Dean Rusk autorizoi ambasadorin amerikan në Athinë, që t’i komunikojë gojarisht Averofit se “Shtetet e Bashkuara, nga ana e tyre, janë duke ruajtur një interes aktiv për situatën shqiptare, duke studiuar atje rrjedhën e ngjarjeve nga sa më afër që të jetë e mundur... Dhe se “në situatën e tanishme shumë delikate dhe shumë fluide, Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi në përgjithësi, kur shohin gjendjen nga afër, duhet të veprojnë me maturi dhe nuk duhet të marrin iniciativa, të cilat do të nxisnin Pekinin dhe Moskën, që të kapërcenin diferencat ekzistuese në lidhje me Shqipërinë, e ndoshta i detyrojnë shqiptarët të tërhiqen nga kundërshtimi i tanishëm i hapur ndaj Bashkimit Sovjetik”.<sup>24</sup>

Kujdesi amerikan për hapa të matura në adresë të Shqipërisë, përcaktohej edhe nga dy faktorë të tjerë.

Së pari, Departamenti i Shtetit mendonte se ndihma kineze nuk do të ishte e mjaftueshme për shqiptarët dhe regjimi i Hoxhës pas një farë kohe, do të ishte i detyruar të kërkonte ndihmën materiale perëndimore. Për rrjedhojë këshillonte Rusk- “Do të jetë avantazhi më i madh për Perëndimin ta lerë çorbën e tanishme të ziejë ngadalë”.<sup>25</sup>

Së dyti, amerikanët besonin se ishte e mundur që gjatë kësaj kohe forcat tashmë të angazhuara, të kishin kryer lëvizjen e Shqipërisë në drejtim të Perëndimit.

Qëndrimin e mësipërm Departamenti i Shtetit do ta konfirmojë përsëri në

<sup>23</sup> Memorandum bisedimi midis Sekretarit të Shtetit, Dean Rusk dhe ministrit të punëve të jashtme të Italisë, Antonio Segni, 18 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>24</sup> Tel. i Sekretarit të Shtetit, Dean Rusk për Ambasadën amerikane në Athinë, 17 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926

<sup>25</sup> Po aty.

10-ditshin e dytë të janarit 1962. Më 9 Janar “Zëri i Popullit”, organi qendror i PPSH, si në shumë raste të tjera, u zgjodh nga Enver Hoxha për t’i lëshuar një sinjal afrimi Perëndimit.

Në kryeartikullin e kësaj gazete shprehej dëshira e qeverisë shqiptare për të vendosur marrëdhënie diplomatike dhe për të patur marrëdhënie të mira tregtare dhe kulturore me të gjitha vendet perëndimore.<sup>26</sup> Kryeartikulli pati një jehonë të gjerë ndërkombëtare. Ndër të tjera dy gazeta kryesore amerikane, “Uashington Post” dhe “New York Times” më 11 janar, tërhoqën vëmendjen për këtë kryeartikull dhe e interpretuan atë “si një iniciativë shqiptare, të motivuar nga ndjenja gjithnjë në rritje e izolimit dhe të presioneve ekonomike, që rezultojnë nga mungesa e ndihmës së bllokut sovjeta-europiano-lindor, për Shqipërinë”.

Nisur nga ky kryeartikull, sekretari i Shtetit, Rusk u dërgoi telegram të gjitha ambasadave amerikane në Europë më 13 janar 1962, në të cilin sqaronte pozicionin e qeverisë amerikane në lidhje me Shqipërinë. Aty thuhej se “Shtetet e Bashkuara po vazhdojnë t’i ndjekin nga afër dhe me interes zhvillimet shqiptare, por besojnë se do të ishte e parakohshme në këtë fazë për to, që të përpiqeshin të formulonin çfarëdo konkluzioni bazë, në lidhje me kursin e ardhshëm të ngjarjeve shqiptare, apo të ndërmarrë iniciativa në adresë të Shqipërisë. Shtetet e Bashkuara nuk kanë aktualisht plane për njohjen dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me regjimin shqiptar”.<sup>27</sup>

Dy javë më vonë, Departamenti i Shtetit përfundoi studimin e titulluar “Vendime të menjëhershme politike të Shteteve të Bashkuara lidhur me Shqipërinë”.

Në formën e një letre ky studim u diskutua dhe u miratua më 26 janar, në mbledhjen e grupit të përhershëm të Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe pak më vonë, edhe nga presidenti John F. Kennedy. Presidenti amerikan ka qenë i interesuar për çështjen shqiptare personalisht, gjë që e dëshmon ndër të tjera edhe diskutimi i tij me ministrin e jashtëm austriak Kraiski dhe presidentin jugosllav Tito.

Pas miratimit nga Presidenti, studimi mori vlerën e dokumentit bazë orientues “Në lidhje me problemet politike që kanë dalë nga situata aktuale e Shqipërisë në mosmarrëveshjet e saj me sovjetikët...”. Ky dokument që Departamenti i Shtetit e quante “formulimin më të fundit dhe më të gjerë të politikës së Shteteve të Bashkuara”, u rekomandua të diskutohej në takimin e këshilltarëve politikë të NATO-s. Qëllimi i diskutimit ishte... “Përpjekja për të koordinuar politikatat imediate të anëtarëve të NATO-s për Shqipërinë në situatën e saj

<sup>26</sup> “Zëri i Popullit”, 9 janar 1962.

<sup>27</sup> Tel. i Sekretarit të Shtetit, Dean Rusk për ambasadat amerikane në Europë, 13 janar 1962. NARA. . . Box. No. 1926.

aktuale, veçanërisht në lidhje me pikat G dhe H të deklaratës, që kanë të bëjnë me çështjet tregtare dhe me zgjerimin e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë, me shtetet jo anëtarë të bllokut”.<sup>28</sup>

Dokumenti i cituar është një njoftim i gjerë që Departamenti i Shtetit ua dërgonte përfaqësuesve amerikanë në shtabin e NATO-s në Paris më 21 shkurt 1962. Për fat të keq në arkiv ekzistonte vetëm faqja e parë e këtij dokumenti, kështu që edhe informacioni është i mangët për gjithë përmbajtjen e tij.

Në pranverën e vitit 1962, amerikanët iu qasën më afër se kurrë problemit shqiptar. Më 11 prill, Departamenti i Shtetit u dërgoi të gjitha ambasadave dhe misioneve diplomatike amerikane udhëzimin me subjekt: “Hapja e një linje komunikimi me Shqipërinë”.

Departamenti njoftonte se... “Interesi i politikës së Shteteve të Bashkuara për Shqipërinë është rritur” dhe... “Pa asnjë ndërhyrje ose iniciativë nga Shtetet e Bashkuara, çështja e Shqipërisë në konfliktin kino-sovjetik, mosbesimi i regjimit shqiptar për sovjetikët dhe çarja e hapur midis partisë e shtetit shqiptar me Moskën, është zhvilluar në një mënyrë që u shërben interesave tona”.<sup>29</sup>

Edhe ky dokument që përbëhet prej 28 faqesh, është i klasifikuar dhe në dosje ndodhet vetëm faqja e parë, por edhe atë sa është, dëshmon se amerikanët kanë konkluduar që është e nevojshme të lidhen në një mënyrë ose tjetër me Tiranën. Ndoshta ky ka qenë edhe një nga vendimet që u morën në nivelin më të lartë të administratës së Kenedit në fund të janarit e fillim të shkurtit 1962.

Departamenti i Shtetit informonte se në mungesë të një linje kontakti me shqiptarët... “Është e dëshirueshme të hapet një kanal, përmes të cilit Shqipëria mund të afrohet jo zyrtarisht me Shtetet e Bashkuara, në një kohë që ajo mund të dëshironte të bënte takime esenciale dhe përmes të cilave, Shtetet e Bashkuara mund të hetojnë zhvillimin e qëndrimit shqiptar ndaj Perëndimit”.<sup>30</sup>

Në dosje nuk kishte ndonjë dokument tjetër, që të tregonte se si do të mund të realizohej ky kanal komunikimi, e nëse ai realisht arriti të vendosej. Gjykuar nga zhvillimet e mëvonshme ka më shumë mundësi që i gjithë projekti të ketë mbetur në kuadrin e ideve.

Enver Hoxha u shkëput nga Hrushovi, por jo nga stalinizmi. Ndarja e bujshme nuk ndodhi për shkaqe parimore siç u paraqit në fillim, por për arsye të sigurisë së pushtetit, që sovjetikët kishin filluar t’ia minonin nga brenda. Ajo nuk synonte

<sup>28</sup> Mesazh konfidencial i Departamentit të Shtetit për përfaqësinë amerikane në NATO në Paris, 21 shkurt 1962. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>29</sup> Mesazh i Departamentit të Shtetit për misionet diplomatike të Shteteve të Bashkuara, 11 prill 1962. NARA. . . Box. No. 1926.

<sup>30</sup> Po aty.

kapërcimin e ylberit politik dhe bashkimin e Shqipërisë me Perëndimin.

Uashingtoni e testoi shpejt këtë mundësi dhe e kuptoi që regjimi komunist shqiptar nuk e kishte vullnetin që të ndryshonte ngjyrën, thjesht manovronte për të ruajtur pushtetin. Por qoftë edhe për faktin që u shkëput nga blloku sovjetik, ishte në interes të Perëndimit. Mbështetur në këtë logjikë, me sugjerimin e Shteteve të Bashkuara, në Komitetin Politik të NATO-s, u vendos që të ndiqej një politikë realiste ndaj Shqipërisë, të zhvilloheshin marrëdhëniet diplomatike e tregtare, të mos pengohej forcimi i marrëdhënieve mes Tiranës e Pekinit, por të evitoheshin iniciativat direkte të vendeve anëtare në favor apo kundër regjimit, që mund të interpretohej si një ndërhyrje në konfliktin sovjet–shqiptar.<sup>31</sup>

### **Burimet e shfrytëzuara**

- 1- Mesazh (Airgrame) i Departamentit për Ambasadat amerikane në Paris dhe Romë.
- 2- Raport mbi zhvillimin e punimeve të Konferencës së Bukureshtit.
- 3- Zbigniev Brzezinski. “The Soviet Blok. Unity and Conflict. Revisted Edition.”
- 4- William E. Griffith. Albania and Sino–Soviet Rift. The M. I. T. Press. Cambridge, Massachusetts, 1963.
- 5- Mesazh i Ambasadës amerikane në Paris për Sekretarin e Shtetit, 11 gusht 1960. NARA. . . Box. No. 1925.
- 6- Mesazh i Ambasadës amerikane në Romë për Sekretarin e Shtetit, 24 gusht 1960. NARA. . . Box. No. 1925.
1. Valixhja diplomatike (Air Pouch). Ambasada amerikane në Paris për Departamentin e Shtetit, 19 tetor 1960. NARA. . . Box. No. 1925.
2. Tel. i Departamentit të Shtetit për Ambasadat amerikane në Paris, Romë dhe Ankara, 15 gusht 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
3. Udhëzim i Departamentit të Shtetit për Ambasadat e postet konsullore në Ankara, Paris, Romë, Athinë, Beograd e Honkong për mbledhjen e informacioneve për Shqipërinë, 28 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
4. Mesazh i Sekretarit të Shtetit Rusk për Ambasadat amerikane në Athinë e Beograd, 27 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
5. Tel. i Ambasadorit amerikan në Athinë, Briggs për Sekretarin e Shtetit, 15 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.

---

<sup>31</sup> Settimio stallone. Una speranza che non c’era. Quindici anni di rapporti politici ed economici italiano – albanesi (1961- 1976). Gli anni della distensione. Le relazioni italiano – albanesi nella fase centrale della Guerra fredda. Editori GLF Laterza. Prima edizione maggio 2019. a cura di Paolo Rago, p. 11-12.

6. Tel. i konsullit amerikan Benet në Athinë për Sekretarin e Shtetit, 31 tetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
7. Tel. i Ambasadorit amerikan në Athinë, Briggs për Sekretarin e Shtetit, 10 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
8. Promemorje Greke për Shqipërinë, 21 dhjetor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
9. Mesazh i Ambasadorit amerikan në Romë. . . Box. No. 1926.
10. Tel. i Ambasadorit amerikan në Beograd Xhorxh Kennan (George Kennan) Box. No. 1926.
11. Radiogram i Përfaqësuesit të përhershëm të Shqipërisë në OKB, AMEPJ. Viti 1961. Dosja Nr.367, fl. 55.
12. Memorandum bisedimi midis Sekretarit të Shtetit, Dean Rusk dhe ministrit të punëve të jashtme të Italisë, Antonio Segni, 18 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926.
13. Tel. i Sekretarit të Shtetit, Dean Rusk për Ambasadën amerikane në Athinë, 17 nëntor 1961. NARA. . . Box. No. 1926
14. Gazeta “Zëri i Popullit”, 9 janar 1962.
15. Mesazh konfidencial i Departamentit të Shtetit 21 shkurt 1962. NARA. . . Box. No. 1926.
16. Mesazh i Departamentit të Shtetit, 11 prill 1962. NARA. . . Box. No. 1926.
17. Settimio stallone. (1961- 1976). Le relazioni italiano – albanesi nella fase centrale della Guerra fredda. Editori GLF Laterza. Prima edizione maggio 2019. a cura di Paolo Rago.

# MARRËDHËNIET SHQIPTARO-AMERIKANE PARA 28 KORRIKUT 1922

**Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI**

*Dekan i FSHF, Universiteti Mesdhetar*

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Akti i 28 korrikut të vitit 1922<sup>1</sup>, i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA, ka një parahistori interesante gati dy shekulle. Për ta kuptuar dhe interpretuar atë duhet të mbahet parasysh se marrëdhëniet shoqërore, ku përfshihen edhe marrëdhëniet ndërshtetërore, vendosen dhe zhvillohen nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ose të tërthorta, por nuk përjashtohet që ndonjëherë të realizohen edhe pa raporte të kësaj natyre.*

*Kështu duket se ka ndodhur edhe në marrëdhëniet e shqiptarëve me amerikanët. Në kuptimin simbolik, zanafilla e tyre konsiderohet koha kur shtetas amerikanë kanë zbritur në trojet shqiptare ose kur shqiptarë kanë shkelur në kontinentin amerikan. Gjykuar sipas konvencionit të mësipërm, mbështetur edhe në botime kushtuar marrëdhënieve shqiptaro-amerikane, mësohet se origjina e tyre zbret thellë në histori.*

*Në një libërth me titullin “Mary Ball Washington”,<sup>2</sup> i botuar në SHBA në vitin 1850 nga Virginia Carmichael, që është ndër të parët ku përmenden shqiptarët, flitet për origjinën shqiptare të presidentit amerikan Xhorxh Uashingtonit (George Washington).*

<sup>1</sup> Dita e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

<sup>2</sup> *Mary Ball Washington* by Virginia Carmichael, Mary Washington Branch, Association for the Preservation of Virginia, Antiquities (1967).

## GJYSMA SHQIPTARE E UASHINGTONIT

Në librin e sipërcituar, shkruhet se e ëma e tij, ishte fëmija e dy prindërve shqiptarë, me origjinë nga rrethinat e Pejës, që kishin emigruar në kontinentin amerikan në vitin 1706. Lindi në Lively të Virxhinias dhe e quajtnë Maria Bala, emër të cilin do ta amerikanizonte më vonë, në Mary Ball. Rasti e dha që në vitin 1731 të bëhej gruaja e dytë e Augustine Uashingtonit dhe më 22 shkurt 1732 solli në jetë George Uashingtonin, një prej etërve themelues të ShBA. Mbështetur në këtë-le ta quajmë “lidhje gjaku”, autorë të ndryshëm përpiqen të argumentojnë prejardhjen shqiptare të presidentit amerikan.<sup>3</sup> Shumica e studiuesve të kësaj fushe e cilësojnë legjendë. Sidoqë të jetë, e vërtetë apo e stisur, tingëllon interesante, pikënisje origjinale, unikale e marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, sepse në themel vendoset figura e presidentit të parë të ShBA, e cila mund të konsiderohet si kolateral virtual, për besnikërinë e shqiptarëve ndaj SHBA.<sup>4</sup>

Për ekzistencën e lidhjeve spontane, jo institucionale, shqiptaro-amerikane, bëhet fjalë edhe në disa shkrime publicistike të shtypit amerikan, prej fillimit të shek. XIX. Midis tyre është reportazhi i dy gazetarëve amerikanë, të cilët më 8 prill të vitit 1819, zbritën në molin e Sajadhës së Çamërisë, për të shkuar tek Ali Pashë Tepelena. Shkrimi është publikuar në revistën Amerikane “*The North-American Review and Miscellaneous Journal*”, në vitin 1820. Mban titullin “*Visit to Joannina and Ali Pasha*”. Autorët thonë se Aliu u kërkoi ndihmë për të vendosur raporte diplomatike dhe lidhje tregtare me SHBA,

<sup>3</sup> Carl Woodward, gazetar, reporter amerikan, autor i dhjetëra librave dokumentarë për presidentët amerikanë dhe historive nga Shtëpia e Bardhë, thotë se kishte gjetur në arkiva një letër të George Washington, ku fliste për shqiptarët. Woodward shkruan: “Mbaj mend që, kur mora letërën për t’ia treguar Bill Klintonit në një nga shumë intervistat dhe i thashë: “Ja, Bill, kjo është ajo që kam zbuluar nga arkivat e Uashingtonit”, ai tha: “E kam parë Çarl, e kam parë. Nëse nuk do ta kisha parë, zoti e di nëse do të kishim ndërhyrë në Kosovë”. Sipas John McCallum, gazetar i Reuters, duket se ka edhe një provë tjetër që vjen nga Instituti i Biokimisë dhe Gjenetikës, Zvicër. Ai ka publikuar rezultatet e hulumtimit mostrave gjenetike të ish-presidentit amerikan George Washington, i cili rezulton se ishte 50 përqind shqiptar. Autori thotë gjithashtu se ekspertë të fushave të tjera kanë kërkuar ta konfirmojnë këtë pohim, duke përmendur prova nga gjenealogjia, gjuhësia etj. John McCallum-Sipas “Reuters”, “George Washington, shqiptari që krijoi Amerikën”, Citohet sipas “Prizrenpress”, 12/30/2019.

<sup>4</sup> Për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane janë shkruar libra dhe artikuj të shumtë. Midis tyre janë librat e Haris Silajxhiq “*Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*”, Ndriçim Kullës, “*Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës*”, Ilir Ikonomit, “*Faik Konica - Jeta në Uashington dhe Pushtimi*”, Agron Alibali, “*Faik Konica, dritëhijet e një diplomati*”, Nasho Jorgaqit, “*Jeta e Fan S.Nolit, Mal Berisha, - Charles Telford Erickson, Një jetë e jashtëzakonshme kushtuar Shqipërisë*”, Peter Lucas, - “*Misioni amerikan në Shqipëri, Operacionet sekrete të Oss-it dhe bashkëpunimi me partizanët komunistë gjatë Luftës së dytë Botërore*” libri i Profesor Paskal Milos kushtuar 100 vjetorit të marrëdhëniet shqiptaro-amerikane (në proces botimi), si dhe disa shkrime me vlerë të studiuesve Irakli Koçollari, Auron Tare etj. Për këtë arsye autori është ndalur në vështirimin historik dhe juridiko-ndërkombëtar të zhvillimeve që, sipas gjykimit të tij, përfaqësojnë interes të veçantë në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.



madje edhe dërgimin e një konsulli amerikan në Janinë,<sup>5</sup> në kryeqendrën e pashallëkut të tij, ku vepronin edhe konsullatat e Francës, Anglisë dhe të Rusisë.

Se çfarë ndodhi në vijim nuk dihet, por vështirë të mendohet që zhvillimet e asaj kohe jepnin shanse për ndonjë rezultat konkret. Sepse jo më larg se tre vite më pas, koka e Aliut do të udhëtonte drejt Stambollit në tepsinë e mjalit, kurse trupi do t'i varrosej në Janinë. Nga ana tjetër duhet pasur parasysh se shërbimi diplomatik amerikan, sapo kishte mbushur 40-vjetorin e krijimit të tij.

Nuk besohet se do të kishte arritur të krijonte përfytyrimet e duhura rreth pashallëkut të Janinës, një strukturë politiko-administrative *sui generis*, që ekzistonte disa mijëra milje larg Uashingtonit, që ta vendoste kërkesën e Pashait në rendin e ditës së veprimtarisë së vet. Edhe nëse e pranojmë atë të kapërcyer e të zgjidhur pozitivisht, mund të shfaqej si faktor tjetër pengues statusi dhe personaliteti i themeluesit të tij, të cilat rrethoheshin nga pikëpyetje të shumta.

Kjo dëshmi, përveç se sjell një këndvështrim interesant mbi politikën e jashtme të Ali Pashës, tregon gjithashtu se lidhjet shqiptaro-amerikane, në njëfarë kuptimi nisin së paku nga dekada e dytë e shekullit XIX.

Rreth 50 vjet më vonë, shqiptarët “do të kapërcenin” sërish Atlantikun. Në 1873 në kontinentin amerikan “do të mbërrinte” Skënderbeu. Do ta çonte poeti Henry Wadsworth Longfellow, të shndërruar në një ndër personazhet e vëllimit të tretë të veprës së tij, “*Rrëfenja të një hani ndanë udhës*”, pjesë e të cilit ishte edhe poemti kushtuar Skënderbeut.<sup>6</sup> Ai tregon gati me hollësi kthimin e Skënderbeut në Krujë dhe e përshkruan me vlerësime gati superrelative për inteligjencën, trimërinë dhe heroizmin.<sup>7</sup> Duke bërë të njohura fitoret, cilësitë dhe vlerat e udhëheqësit shqiptar, ua prezantonte amerikanëve si një legjendë me vokacion të rëndësishëm kombëtar e europian.

Shqipëria dhe shqiptarët do të vazhdonin të mbeteshin pjesë e vëzhgimit të herëpashershëm politik dhe diplomatik të Amerikës.

Kronologjia modeste e raporteve shqiptaro-amerikane vazhdon me indikacione që i përkasin çerekut të fundit të shek. XIX, kur në Uashington mbërrinin njoftime për zhvillimet që përshkonin botën shqiptare. Ishte koha e rikonfigurimeve gjeopolitike në territoret osmane, në hapësirat juglindore të kontinentit europian. Ato u sanksionuan me vendimet e Kongresit të Berlinit, nëpërmjet të cilave Koncerti i Madh i Fuqive zyrtarizoi krijimin e disa

<sup>5</sup> Irakli Koçollari, 1819 / “Dy gazetarët amerikanë që intervistuan Ali Pashën”, “Java News”, 15/02/2016.

<sup>6</sup> Henry Wadsworth Longfellow, - “*Rrëfenja të një Hani ndanë Udhës*”, 1873.

<sup>7</sup> Po aty.

shteteve të rinj në gadishullin ballkanik, të zmadhuar me aneksimin e trojeve shqiptare. Si reagim dhe si formë e vetëmbrojtjes kombëtare, u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Jehona e trazirave politike dhe gjeostrategjike, produkte të së ashtuquajturës “*Kriza Lindore*”, u ndie edhe në Departamentin Amerikan të Shtetit, ku mbërrinin njoftime rreth zhvillimeve ballkanike. Mbërrinin gjithashtu opinione e konsiderata për çka ndodhte në territoret shqiptare. Midis tyre ishin edhe ato që përcilleshin nga John A. Kasson, shefi i legatës amerikane në Vjenë, i cili mbulonte edhe rajonet e Malit të Zi dhe të Shqipërisë.<sup>8</sup>

Ai përshkruante përkeqësimin e situatës në Ballkan, si pasojë e vendimeve të Kongresit të Berlinit, të cilin e cilësonte si “një akt që vendosi pranimin me dhunë të dispozitave të tij, që nuk kishin fare, as natyrë juridike, as drejtësi juridiko-ndërkombëtare dhe që bazoheshin në pazaret e shumicës së Fuqive të Mëdha”, të cilat, përtej drejtësisë, kishin parë interesat e veta dhe ishin vendosur haptas kundër shqiptarëve e Shqipërisë, në dëm të më të dobët dhe më të pambrojturit. Sipas Kasson, ai ishte “një Traktat që mbijeton vetëm nga vazhdimi në pushtet i shtetarëve që ishin personalisht përgjegjës për miratimin e tij”.

Ndalej edhe në gjendjen e vështirë në trojet e Shqipërisë veriore dhe te përplasjet e dhunshme shqiptaro-malazeze, rrjedhojë e tentativave për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, për kalimin të trojeve shqiptare në shtetin e Malit të Zi.

Në telegramin e datës 5 maj 1880, drejtuar Sekretarit të shtetit, Evarts, ai shkruan se “Çështja e marrëdhënieve midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, po tërheq përsëri vëmendjen dhe ka shkaktuar shqetësim... kanë filluar lëvizjet popullore e ushtarake dhe të huajt nuk kanë informacione se reagimi dhe lëvizjet, mund të përfshijnë edhe kombe të tjerë në luftë... po rezistohet që të eliminohet mozaiku, vërtet jo perfekt i quajtur “Traktati i Berlinit”, në një zonë të territorit shqiptar që i është kaluar Malit të Zi, çka supozon nxitjen e shkallës së armiqësisë së luftëtarëve shqiptarë. Janë grumbulluar mijëra forca nga të dyja palët dhe nderi i Fuqive të Mëdha është vënë në lojë në këtë kohë.”<sup>9</sup>

Ai shton se shqiptarët jo vetëm janë të vendosur për të mbajtur çdo hektar të territorit të tyre, por... “Janë të prirur të shkëpusin lidhjet me Portën e Lartë;

<sup>8</sup> Materiale të përcjella prej tyre për këtë periudhë, gjenden sidomos në arkivin e marrëdhënieve të jashtme. Një prej tyre që duket se duhet të jetë ndër të parët është raporti i 14 prillit 1880. Shih, Foreign Relations, No.40. *Mr. Kasson to Mr. Evarts, No. 310, Legation of the United States, Vienna, April 14, 1880*, citohet nga Llesh Kola, - *SHBA-Shqipëri: 100 vjet qëndrime e marrëdhënie miqësore*, Tiranë, 2022.

<sup>9</sup> Foreign Relations, No.40. *Mr. Kasson to Mr. Evarts, No. 320, Legation of the United States, Vienna, May 5, 1880*, citohet nga Llesh Kola, - *SHBA-Shqipëri: 100 vjet qëndrime e marrëdhënie miqësore*, Tiranë, 2022.

se... ky zgjim është shoqëruar para pak kohësh, edhe me një deklaram ku u bëhet thirrje shqiptarëve për pavarësinë”.<sup>10</sup> Në telegramin tjetër të 13 majit 1880, Kasson pohon se “shqiptarët... kanë marrë në duart e veta fatin e kombit dhe kanë deklaruar pavarësinë e kombit dhe të territorit të tyre kundër gjithë të ardhurve. Qeveria e Portës së Lartë nuk pranohet më dhe dekretet anti-shqiptare të Fuqive të Mëdha, janë refuzuar”.<sup>11</sup> (korsivi i autorit).

Zhvillimet tronditëse në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, janë trajtuar edhe në një varg shkrimesh të mëvonshme në shtypin amerikan. Nëpërmjet tyre mund të plotësohet më mirë kuadri i përgjithshëm i qëndrimit të Uashingtonit ndaj ngjarjeve në Shqipëri, në çerekun e fundit të shek. XIX.

Historia e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dëshmon se interesi i SHBA ndaj Shqipërisë, ka ecur pothuajse në mënyrë lineare, pa pretenduar natyrisht që ajo të ishte në epiqendrën e vëmendjes së tyre. Disa nga objektivat strategjike të politikës amerikane si kudo, ashtu siç dihet, janë realizuar edhe nëpërmjet veprimtarisë së shoqatave bamirëse, gazetarëve, klerikëve dhe udhëtarëve amerikanë. Në vendin e vet, ata, së bashku me suveniret, çonin edhe rrëfenja, mbresa, histori, kuriozitete.

Shqipëria përshkruhej si oaz ekzotik në qendër të Europës, si vend ku banonte një popull me virtyte të larta e të çmuara. Një prej tyre, artikulli i 20 prillit 1903, botuar në “*New York Daily Tribune*”, mban titullin “*Rajon i egër, por me bukuri magjepsëse*”, *Malazetët: Plava dhe Gucia, kafshatë që s’kapërdihet*”.<sup>12</sup> Shkrimi i 29 prillit 1904, “*Shqiptarët, një racë e rrallë; miq dhe armiq të turqve*”, botuar në gazetën amerikane “*The Seattle Star*”, i vlerëson shqiptarët për besnikërinë, krenarinë, mikpritjen etj. Pohimet e mësipërme pozitive u kundërviheshin opinioneve denigruese, që i paraqitnin ata si njerëz të egër.

Vëmendjes së Departamentit të Shtetit, nuk i shpëtuan zhvillimet që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe daljen në skenë të një subjekti të ri juridiko-ndërkombëtar në Ballkan. Burim informacionesh ishin njoftimet e shtypit që pasqyronin ngjarjet në Shqipëri, raportet e përfaqësuesve të shoqatave bamirëse, si dhe të përfaqësuesve diplomatikë e konsullorë amerikanë në Shqipëri dhe në vendet fqinjë, të agjentëve të shërbimeve inteligjente etj.

Ndër të parat që dhanë lajmin për shpalljen e pavarësisë ishin gazeta “*New York Times*”, e datës 28 nëntor 1912, e cila shkruante “se flamuri kombëtar

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Foreign Relations, No.42. Mr. Kasson to Mr. Evarts, No. 322, Legation of the United States, Vienna, May 13, 1880

<sup>12</sup> Citohet sipas Armand Plaka, i cili thotë se artikulli është botuar në “*New York Daily Tribune*”, 20 prill 1903.

shqiptar,... u ngrit dje pasdite (të premtën) pa ceremoni mbi ndërtesat qeveritare... Në port është hequr çdo flamur turk”. Gazeta tjetër “*Los Angeles Times*”, shkruante më 1 dhjetor 1912, se kishte lindur shteti më i ri i Europës, i quajtur Albania, e cila sapo u shkëput nga dominimi Otoman duke u përpjekur të zinte vend në radhën e shteteve të civilizuar të botës.

Shtypi jepte njoftime edhe për Ismail Qemalin, protagonistin e ngjarjes, për të cilin vinin në dukje mbështetjen që kishte nga Austro-Hungaria. Bënin fjalë për telegramet që ai, me cilësinë e kryeministrit të qeverisë shqiptare, u kishte dërguar qeverive austriake, franceze dhe italiane, duke u kërkuar njohjen e shtetit dhe mbrojtjen e tij nga copëtimi”.

Janë me shumë interes dhe të argumentuara bukur, pikëpamjet e shfaqura dhe qëndrimet që mbaheshin nga shtypi amerikan, si reagim ndaj kësaj ngjarjeje. Duke i quajtur njohje të shtetit shqiptar veprimet, diskutimet dhe komunikimet e deriatëhershme të Fuqive të Mëdha, në kuadrin e Konferencës së Ambasadorëve dhe jashtë saj, ata theksonin me shumë të drejtë se “njohjen e shtetit shqiptar e solli nevoja e ruajtjes së ekuilibrave të shteteve europiane”. Më saktë këtë mendim e përçonte gazeta “*New York Times*”. Analiza e saj, e botuar në numrin e 13 prillit 1913, spikaste për sensin e fortë realist dhe objektiv në trajtimin e faktorëve ndikues, qëllimet e tyre, rreziqet e përplasjeve, etj.

Autori thoshte se “Trajtimi i çështjes shqiptare nga Fuqitë e Mëdha i afrohet shumë traditës së vjetër të politikës europiane... Shqipëria është duke u bërë autonome, jo sepse është e drejta e shqiptarëve për të qenë të lirë, por vetëm sepse shteti shqiptar i nevojitet Austrisë si kundërbalancë ndaj Serbisë..., Gjermanisë... Sepse një Serbi e fuqishme do të paralizonte Austrinë, që ishte pjesëtare e Aleancës Tripalëshe; Italisë sepse ajo nuk mund të lejonte që Austria të gëzonte monopolin e mirëdashjes së shqiptarëve, si dhe Antantës, sepse çdo qëndrim tjetër do t’i hapte telashe të pafundme për politikën e saj të jashtme, madje mund të çonte në luftë.”<sup>13</sup>

Në dhjetëvjeçarin në vijim, hapësira e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane është e pasur me shumë më tepër episode, madje me interes të veçantë.

Prof. Paskal Milo, në një shkrim, ku flet për kërkimet në arkivat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të hapura deri në janarin e 1996, thotë se “Dokumenti i parë për Shqipërinë, i përkiste datës 27 prill 1914”. Bëhet fjalë për një letër të Kristo Dakos, drejtuar konsullit amerikan në Selanik. Ndërkohë që përçapja e parë nga pala shqiptare për të kërkuar njohjen ndërkombëtare nga ana e Uashingtonit, u ndërmorr nga kryetari i shtetit, Princ Vidi, më 8 maj 1914.

---

<sup>13</sup> *Now distorts “liberators”*, *New York Times*, 13 prill 1913. Citohet nga Valentina Duka, vep. cit. f. 113.

Ai i dërgoi presidentit Uillson njoftimin për ardhjen e tij në fronin e Shqipërisë. Duke iu referuar “lidhjeve ekzistuese ndërmjet popullit shqiptar dhe kombit amerikan”, siç shkruante ai, kërkohej njohja ndërkombëtare. “Interesi që keni treguar gjithmonë ndaj vendit tim, –shkruante Vidi, –më bën të shpresoj se do të më akordoni miqësinë tuaj dashamirëse, për të forcuar pozitën ndërkombëtare të shtetit të ri, i cili është i destinuar të luajë një rol të rëndësishëm në ekuilibrin e Ballkanit”. Ishte një tekst i formuluar nga zyrtarët e kabinetit të princit, me një përmbajtje, format dhe gjuhë standarde, që duket se u është drejtuar edhe disa vendeve të tjerë. Në optikën juridiko-ndërkombëtare përmbajtja kishte formën e kërkesës për njohje dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Nuk kemi gjetur ndonjë të dhënë rreth qëndrimit amerikan ndaj propozimit shqiptar, por duket se shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, largimi i Vidit nga Shqipëria dhe pezullimi i ekzistencës së shtetit shqiptar si subjekt i së drejtës ndërkombëtare gjatë Luftës, nuk i lanë kohë administratës amerikane për ta trajtuar.

Megjithatë, duket se Uashingtoni nuk qëndroi refraktar ndaj kërkesës dhe në përgjithësi ndaj ngjarjeve në Shqipërinë e asaj kohe.

### KAMBANA E UILLIAMS-it

Një muaj pas njoftimit të Vidit, Departamenti i Shtetit komunikoi me ministrin e vet fuqplotë në Greqi, Xhorxh Fred Uilliams, i akredituar në Greqi dhe në Mal të Zi, që mbulonte edhe Shqipërinë, duke qenë gjithashtu vëzhgues i ShBA në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit në Durrës. E porositi që të ndërmerre një tur vizitash në Shqipëri e në Mal të Zi, në një kohë të përshtatshme, gjatë muajve qershor-korrik të atij viti.<sup>14</sup>

Uilliams arriti në Durrës në 18 qershor, ku u takua me autoritetet si dhe me anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Ato që shikonte nëpër Shqipëri, e tronditën. Pas kthimit në Athinë, më 7 korrik 1914, dërgoi në Uashington raportin për vizitën dhe paraqiti dorëheqjen. E motivoi me indinjatën ndaj qëndrimit mizor të Fuqive të Mëdha, sipas tij, shkaktare të gjendjes tepër të rëndë në Shqipëri. Në një konferencë shtypi tha se kishte parë ngjarje të tmerrshme, të cilat i shtoheshin therorive të Traktatit të Londrës dhe lëshoi alarmin për mjerimin e papërshtueshëm të shqiptarëve, shkaktuar nga genocidi, mizoritë, masakrat e ushtrive të fqinjëve dhe padrejtësitë.

Ato i ka përshkruar edhe në librin “*Shqiptarët*”, ku ndër të tjera, thuhet se “E lashë Shqipërinë në vuajtje dhe të mbytur në gjak nga faji i Europës... Unë protestova kundër paudhësisë së Europës kundrejt Shqipërisë, lashë

<sup>14</sup> Ndrçim Kulla, “*Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës*”, Plejad, Tiranë 2017, f. 84.

vendin tim zyrtar dhe ju siguroj se ajo ditë që unë protestova për Shqipërinë është dita më e lumtur e jetës sime... Unë jam gati për çdo shërbim për lirinë dhe shpëtimin e Shqipërisë edhe me jetën time.”<sup>15</sup> “Shqiptarët nuk kërkojnë mëshirë, por drejtësi.”<sup>16</sup>

Të dhënat e raportit të Xhorxh Fred Uilliams-it, Departamenti i Shtetit nuk mund të mos i merrte në konsideratë, sepse raporti përshkohej nga tone realiste, të cilat e pikturonin vendin ashtu siç ishte, për fat të keq pa shtet, pa rend, pa rregull, me një situatë konfuze, kaotike, ku mbizotëronin përplasjet, dhuna dhe ku nuk dukej asgjë premtuese në horizont. Kjo tablo e zymtë nuk linte aspak hapësirë për njohjen e Shqipërisë. Ajo kishte emrin shtet, por në krye ndodhej një “princ, i cili vetquhej mbret, pa fuqi, pa territor dhe pa shtetas, me përjashtim të gruas dhe fëmijëve të tij”,<sup>17</sup> siç shprehej Uilliamsi.

Kërkesën e Vidit administrata amerikane e la në heshtje, në pritje të zhvillimeve të tjera në të ardhmen. Megjithatë inkurajoi nismat e humanistëve, personalitetëve të politikës, kulturës dhe të shoqatave të ndryshme për të ndihmuar popullin shqiptar me ushqime, veshje, çadra, medikamente, vajguri etj për të përballuar krizën e rëndë humanitare. “*Albanian Relief Fund*”(ARF), dha alarmin se në brigjet e Adriatikut rreth 500 mijë njerëz, të zhveshur e të zbatthur, të uritur, të pa ushqyer e të sëmurë, janë duke vdekur.

Ajo ngriti në këmbë gjithë strukturat organizative të shoqërisë civile, grumbulloi ndihma humanitare dhe i erdhi në ndihmë shqiptarëve. Kjo nismë bashkohej me episode e tjera, të ndodhura në Shqipëri, ShBA dhe gjetiu, të cilat janë evidentuar si dëshmi e dëshirës së amerikanëve dhe shqiptarëve për të ndërtuar marrëdhënie në interes të tyre dhe për të kultivuar ndjenja miqësore, respekti dhe vlerësimi për njëri-tjetrin.

Si provë e saj, nëse vazhdojmë ta shohim me rezervë udhëtimin e nënës së Xhorxh Uashingtonit në vitin 1706, thuhet se shqiptari i parë në Amerikë ishte Dom Preng Doçi, i cili pasi kishte marrë miratimin nga Selia e Shenjtë, u nis për mision në Tokën e Re (Amerikë) në vitin 1877. Por zakonisht si i tillë, si shqiptari i parë që shkeli kontinentin e ri, përmendet Koli Kristofori, nga fshati Katund i Korçës, të cilin e kanë quajtur edhe Kolombi shqiptar, duke përafuar mbiemrin–Kristofori, me emrin Koli, si shkurtim i emrit Kolombi. Ai mbërriti në 1886 dhe u bë pararendësi i migrameve të tjera në dekadat e mëvonshme. Në vitin 1906 numri i shqiptarëve kishte arritur në 5 mijë, kurse në pragun e Luftës së Parë Botërore, ishin rreth 30 mijë vetë. Në të dy luftërat

<sup>15</sup> “*Shqiptarët*”, Xhorxh F. Williams, Argeta - LMG, Tiranë 2003, f. 4.

<sup>16</sup> Po aty, f.56.

<sup>17</sup> Po aty.

botërore numri i atyre që u rreshtuan në ushtritë amerikane ishte 8414 vetë.<sup>18</sup>

## VEPRA E NOLIT

Shqiptarët e vendosur në ShBA, të organizuar në Federatën “*Vatra*”, kontribuan fuqimisht për të ndihmuar çështjen kombëtare të shqiptarëve. *Vatra* kishte përcaktuar si orientim strategjik të politikës dhe veprimtarisë së saj edukimin e shqiptarëve me idetë, mentalitetin dhe kulturën amerikane të shtetformimit, zhvillimin ekonomik, politik, social e kulturor të Shqipërisë së ardhshme. Noli, një ndër drejtuesit e saj, shprehte bindjen se shumë shqiptarë që ishin detyruar të emigronin në Amerikë, kishin dëshirë të ktheheshin në atdhe dhe të jepnin ndihmesën në zhvillimin e tij dhe, “me futjen e koncepteve amerikane të lirisë, ekonomisë dhe zhvillimit politik”, ta futin Shqipërinë në rrugën e rilindjes ekonomike dhe kulturore. Institucionet arsimore amerikane, sipas mendimit të Nolit, do të ishin “shpëtim për Shqipërinë, duke patur parasysh se kultura anglosaksone i përshtatet më mirë shpirtit puritan të racës shqiptare”.

Janë të panumërta angazhimet e “*Vatrës*”, klubeve dhe shoqatave të tjera të shqiptarëve në Amerikë, si dhe të gazetave e revistave që ata publikonin, për sensibilizimin e qarqeve politike amerikane në dobi të çështjes shqiptare.<sup>19</sup> Përmendet ndërhyrja e fundit të vitit 1917, kur doli në shesh përmbajtja e Traktatit të fshehtë të Londrës, të 26 prillit 1915. Noli, me cilësinë e kryetarit të “*Vatrës*”, i dërgoi Sekretarit të Departamentit të Shtetit, R. Lansing, një telegram, ku denonconte Traktatin dhe i drejtohej Presidentit Uillson... “Të përdorte gjithë ndikimin e tij moral, për të penguar copëtimin e Shqipërisë”.<sup>20</sup>

Në vazhden e përpjekjeve të viteve 1917-1918, përfaqësuesit e *Vatrës*, morën nga presidenti i asaj kohe, T. Ruzvelt, deklarin se “Shqiptarët i dua dhe i admirojmë se janë një racë e vjetër dhe trima, që meritojnë të shpëtohen dhe të vetëqeverisen... dhe se independenca e Shqipërisë duhet restauruar dhe garantuar nga fuqitë aleate.”<sup>21</sup>

Në memorien e shqiptarëve ka lënë gjurmë sidomos takimi i Nolit me presidentin Uillson në 4 korrik 1918, në jahtin presidencial “*Myflower*”, në lumin Potomac, ku u ndodh si delegat i *Vatrës* në kongresin e kombeve të

<sup>18</sup> Viron Prodan, “Kontributi i emigrantëve shqiptarë në ShBA, në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore”. Në libër tregohet se gjatë Luftës së Parë Botërore në ushtrinë amerikane morën pjesë 4973 shqiptarë, kurse në Luftën e Dytë Botërore ishin 3441 shqiptarë. Citohet nga gazeta “Dita”, 11, 12, 13 Janar, 2018.

<sup>19</sup> Për *Vatrën* shih edhe Mal Berisha, - *Roli i federatës pan-shqiptare Vatra në mbrojtjen e kufijve dhe pavarësinë e Shqipërisë para dhe gjatë Konferencës së Paqes në Paris*, Kumesë në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës *Dielli*, Nju Jork, 30 Tetor 1999.

<sup>20</sup> Nasho Jorgaqi, - *Jeta e Fan S.Nolit*, f. 344-345.

<sup>21</sup> Po aty, f. 353.



shtypur. Presidenti më garantoj thotë Noli, për përkrahjen e çështjes shqiptare me fjalët: “Unë do të kem vetëm një zë në kongresin e paqes dhe atë zë do ta përdor, edhe për të drejtat e Shqipërisë”. Kjo e entuziazmoi tej mase Nolin, i cili i tha: “Ai zë është i mjaftë për shqiptarët dhe ata do të jenë vdekërisht të gëzuar dhe fare të sigurtë për të drejtat e tyre.”

Uillsoni nuk e harroi Shqipërinë në Konferencën e Paqes. Ai u shpreh kundër planit për copëtimin e saj, sipas përcaktimeve të Traktatit të fshehtë të Londrës.

Por ekzaltimi i shqiptarëve dhe veçanërisht i Nolit do të kthehej në zhgënjim, kur mori vesh se presidenti Uillson, për një varg arsyes, nuk “e mbajti fjalën”, sepse në diskutimet e para gjatë punimeve të Konferencës së Paqes, ra dakord që Italisë t’i jepej Vlora. -Presidenti Uillson, - tha Noli gjithë dhimbje, “provoi të jetë dëshpërimi i tërë botës.”<sup>22</sup> Ai duhet “të çlirohet nga frika e traktateve sekrete”. Dhe meqenëse tani shpresa e tij kishte mbetur te populli amerikan dhe te Senati, thoshte se është detyrë e Senatit që ta korigjojë atë. Përfundonte me shprehjen: “SOS-i i Shqipërisë janë SHBA-të.”<sup>23</sup>

E vërteta ishte që presidenti Uillson nuk e kishte harruar Shqipërinë në Konferencën e Paqes. Ai dha porosi që konsulli amerikan i akredituar në Torino, Josef Haven, të bënte një vizitë në Shqipëri. Gjatë muajve shkurt-gusht 1919, konsulli përshkoi vendin nga jugu në veri. Sipas udhëzimeve, duhet të verifikonte nga afër realitetet, ndjenjat e njerëzve rreth përkatësisë së tyre kombëtare etj. Fjala ishte sidomos për banorët e zonave pranë kufirit, për të cilët përfaqësues të shteteve fqinjë në forumet e Konferencës deklarorin se ata donin bashkimin me Greqinë, Serbinë ose Malin e Zi. Haven, përveç përshtypjeve shumë pozitive për vendin, për shqiptarët, për dashurinë e tyre për atdheun, dëshirën për progres ekonomik, social e kulturor, dalloj edhe falsitetin e propagandës së shteteve fqinjë, të cilët synonin që me dhunë, kërcënime, intimidime, mashtrime e falsifikime të manipulonin opinionin publik, veçanërisht protagonistët në Konferencën e Paqes.<sup>24</sup>

Raportin ia përcolli delegacionit amerikan. Opinionet e tij objektive kthjelluan shumë të vërteta rreth Shqipërisë. Argumentet dhe faktet e sjella, duhet të kenë ndikuar deri diku edhe në qëndrimin e presidentit Uillson dhe delegacionit amerikan, për të kundërshtuar planin për copëtimin e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Traktatit të fshehtë të Londrës. Iu hap rruga bllokimit të zbatimit të Traktatit të fshehtë të Londrës dhe ruajtjes së Shqipërisë, që kishte mbetur sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve.

<sup>22</sup> Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 380.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Për vizitën e J. Haven flet me hollësi edhe Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri: 1897-1942*, Shtëpia botuese *Nereida*, Tiranë, 2000, f. 166-169.



Qarqet politike të shqiptarëve, të etura për korrigjimin e padrejtësive që i bëri Shqipërisë Konferenca e Ambasadorëve, kërkonin rikthimin e të gjitha trojeve etnike shqiptare brenda shtetit kombëtar, pa marrë në konsideratë faktin që Konferenca e Paqes ishte gjithë rreziqe e të papritura për zhdukjen edhe të asaj Shqipërie që la pas Londra e 1912-1913, për të kënaqur lakmitë e pafundme të fqinjëve.

Si jehonë e këtij qëndrimi të paqortueshëm, “*Ylli i mëngjesit*”, në një nga numrat e vitit 1920 shkruante: “Kuptohet që shqiptarët nuk u kënaqën, sepse me të drejtë prisnin që, duke u mbështetur në parimet e presidentit Uillson, në këtë konferencë do të fitonin bashkimin kombëtar duke marrë përbrenda kufijve të Shqipërisë Kosovën dhe Çamërinë dhe të siguronin përgjithnjë independencën e vendit të tyre”.<sup>25</sup>

Qëndrimi i SHBA dhe Presidentit Uillson në Konferencën e Paqes, i parë në tërësi dhe i vendosur në kontekstin e të gjithë faktorëve që ndikonin në vendimmarrjet e mëdha të asaj kohe, në njëfarë kuptimi, e shpëtoi Shqipërinë.

Nuk u zbatuan as Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, e as ai i 13-14 janarit 1920, që parashikonin ndarjen e saj midis fqinjëve. Prandaj Noli, që, me sa duket kishte reflektuar dhe e kishte kuptuar raportin midis dëshirave, mundësive dhe realiteteve, në fjalimin e mbajtur në parlamentin shqiptar, më 11 shkurt 1924, për të nderuar kujtimin e presidentit Uillson, solli ndërmend fjalët që ai i kishte thënë në vitin 1918, gjatë takimit në Malin Vernon. Me respektin që meritonte ky mik i madh i shqiptarëve tha: -“Ai e mbajti fjalën. Në janar 1920, një erë zie dhe dëshpërimi kish rënë më të gjitha anët e vendit tonë, i cili qe si i vdekur në agoni. Projektet e copëtimit të Shqipërisë redaktuar prej Aliatëve, ishin njohur dhe pritej vetëm një firmë që të bëhej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e Presidentit Wilson, firmë që nuk u vu në atë projekt aq të padrejtë. Presidenti Wilson, jo vetëm që nuk vuri firmën, por u përgjegj me dy nota, në të cilat mpronte të drejtën e Shqipërisë së vogël për vetëqeverim, dy nota që janë dy nga xhevairët më të ndritshëm të karrierës së tij të shkëlqyer. Ato nota ndaluan copëtimin e Shqipërisë që gëzojmë sot.”<sup>26</sup> Prof. Nasho Jorgaqi pohon se ai e quajti Uillsonin- “Amerikani i madh, idealist bujar, diell i vegjëlisë, mbrojtës i Shqipërisë”. Sipas tij Amerika u bë për shqiptarët fushë pune, se një e katërta e Shqipërisë së jugut ushqeheshin me kurbetin e Amerikës, po dhe shkollë, ku mësuan të respektojnë ligjet, disiplinën, vlerën e organizimit, detyrat ndaj atdheut.”<sup>27</sup>

<sup>25</sup> Konferenca e Paqes dhe Shqipëria, në *Ylli i mëngjesit*, Viti 1920, f. 321-327.

<sup>26</sup> *Fan Noli, Vepra*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi 6, f. 155.

<sup>27</sup> *Zani i Malsisë*, January 8, 2018 - *Comments Off on, Prof. Dr. Nasho Jorgaqi tregon për rolin e Fan Nolit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane*.

Më saktë, më qartë, më mirë dhe më bukur, nuk mund të përkufizohej kontributi i ShBA dhe presidentit të saj Uillson për shpëtimin e Shqipërisë në vitin 1920. Këtë e bënte një njeri i madh, siç ishte Fan Noli, që i ndodhur në role protagonistit në shumë nga zhvillimet politike shqiptare, dinte dhe vlerësonte me objektivitet gjithçka kishte ndodhur. Madje, përpara të vërtetës, pati kurajon të bënte një “prapa-ktheu” nga deklarimi i tij katër vjet më parë. Ishte kjo arsyeja pse Noli, kur erdhi në krye të qeverisë shqiptare në 1924, më 21 gusht 1924, mori vendimin për t’i dhënë Shëngjinit emrin e Uillsonit.<sup>28</sup>

### EDHE PROTEKTORAT...

Propaganda e madhe e bërë në Shqipëri edhe nga Federata “Vatra” në ShBA, si dhe në gjithë mjediset shqiptare, brenda e jashtë, krijoi një mit për Amerikën dhe presidentin e asaj kohe. Rrjedhojë ishte propozimi i avancuar në qarqe të caktuara për t’ia besuar ShBA-së mandatin për Shqipërinë, i cili në bazë të Traktatit të fshehtë të Londrës, 1915, i ishte caktuar Italisë. Më 9 janar të vitit 1920, pikërisht në ato ditë gjithë tension për çështjen shqiptare, kur në Konferencën e Paqes në Paris, diskutohej për copëtimin e Shqipërisë, përfaqësues të parisë së Tiranës, gjykuan t’i transmetonin Uashingtonit, propozimin e dhënies Amerikës, të mandatit për mbikëqyrjen e Shqipërisë. Për këtë arsye, në kërkim të rrugëdaljeve për shpëtimin e atdheut, ata morën takim me dy zyrtarë të Kryqit të Kuq amerikan në Tiranë dhe iu lutën që këtë kërkesë t’ia përcillnin qeverisë së tyre.<sup>29</sup>

Çështja e mandatit amerikan mbi Shqipërinë, e rikthyer në bisedimet e qarqeve politike shqiptare, në fundin e Luftës së Parë Botërore, tërhoqi edhe vëmendjen e presidentit Uillson, Departamentit të Shtetit dhe strukturave të tjera të administratës amerikane. Rezulton që të jetë diskutuar seriozisht, në detaje duke marrë në konsideratë gjithë faktorët influentë të brendshëm e ndërkombëtarë, ndikimin që mund të kishte në raportet e ShBA me aleatët e vet, etj. Kishte mendime pro dhe kundër dhe secila palë paraqiste argumentet e veta. Deri afër kohës kur do të merrej vendimi në Konferencën e Paqes në Paris, alternoheshin herë varinati pro, e herë ai kundër. Në prillin e vitit 1919 delegacioni shqiptar, në Konferencë i përcolli asaj një letër, të nënshkruar nga Mehmet Konica, Mihal Turtulli dhe Mithat Frashëri, në të cilën kundërshtohet mandati italian, i parashikuar nga Traktati i fshehtë i Londrës i 1915 dhe propozohej mandati amerikan.

<sup>28</sup> *Po aty*. Noli është përpjekur të kontribuonte maksimalisht për forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë e ka bërë nëpërmjet ndërhyrjeve në personalitete të larta të politikës, kulturës, artit, fesë etj të shoqërisë amerikane, deri edhe të disa prej presidentëve amerikanë siç ishin T. Ruzvelti, U. Uillsoni, F. Ruzvelti, H. Trumani, D. Ajzenhaueri e Xh. Kenedi, me të cilët ai ishte takuar ose kishte pasur lidhje.

<sup>29</sup> *Ilir Ikonimi: 1920, kur paria e Tiranës i kërkonte amerikanëve të merrnin “në dorë” Shqipërinë*, Gazeta Shqiptarja.com, 19 Prill 2018.

Në letër thuhej se vetëm Amerika disponon autoritetin e nevojshëm moral për realizimin e një mandati mbi Shqipërinë.<sup>30</sup> Memorandumi dërguar Konferencës, përgatitur kryesisht nga Mehmet Konica dhe amerikanë Çarls Telford Erikson, mbante titullin “Gjashtë arsye për të cilat Amerika duhet të bëhet mandatore ndaj Shqipërisë”.<sup>31</sup> Midis tyre përmendej fjala vjen, sepse ajo hyri në luftë për synime morale dhe mandati mbështetej mbi parimin e mbrojtjes së popujve dhe kombeve të vegjël, që ishte shpallur nga Presidenti Uillson. Amerika me mandatin mbi Shqipërinë do të përmbushte një nga angazhimet e Konferencës për mbrojtjen e të drejtave të kombeve dhe për vendosjen e kufijve mbi baza etnike. Detyra e Amerikës është të mbetet në Europë, që të ndihmojë në çlirimin e popullit shqiptar dhe t’i ndihmojë atij të ngrihet dhe “me bekimin e gjithë botës, të vendosë harmoninë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në Ballkan.”<sup>32</sup> “Detyra e Amerikës është që këtë “popull të varfër mes të varfërve” ta pranojë me një dashuri prindërore, sepse bëhet fjalë “për një racë të përcaktuar qartë, jashtëzakonisht të fortë dhe të bashkuar.”<sup>33</sup> Në mbështetje të këtij propozimi Çarls Telford Erikson tha në Senatin Amerikan më 2 shtator 1919 se: “Te shqiptarët gjen virtyte, të cilat do ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Propaganda sistematike i ka paraqitur ata si armiq të qytetërimit dhe plaçkitës, por kjo është një gënjeshtëri... Ata janë inteligjentë, fisnikë, punëtorë, mikpritës... besnikë deri në vdekje. Të tillë popull kam njohur unë dhe jam krenar që sot po e përfaqësoj këtu”<sup>34</sup>

Ia vlen të përmendet edhe argumentimi që bën një nga përfaqësuesit e shqiptarëve të asaj kohe, Gjergj (Gaqo) Adhamidhi bej Frashëri, i prezantuar me disa ofiqe, si ish-përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Romë, delegat i Republikës së Korçës, Kryetar i Komitetit Kombëtar shqiptar, si dhe kryetar i shoqërisë “Bashkimi” në Egjipt dhe delegat i “Vatrës”. Ai thoshte se “shqiptarët për nga natyra janë krenarë dhe të pavarur dhe etnikisht kanë rrënjë të përbashkëta me skocezët, prandaj kanë dëshirë të pranojnë t’i drejtojnë funksionarët anglezë dhe amerikanë, pasi janë të bindur në sinjeritetin e tyre, sepse e dinë që janë superiorë në raport me kombet e tjera dhe se amerikanët nuk kërkojnë të dominojnë.”<sup>35</sup>

Propozimi për mandatin amerikan kërkohej për një periudhë 1-2 vjeçare,

<sup>30</sup> Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit*, Dituria, Tiranë 1999, f. 93.

<sup>31</sup> C.T.Erikson, *Six Reasons Why America Should Become Mandatorty for Albania*, Paris, May 1919, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 91.

<sup>32</sup> Po aty, f. 91.

<sup>33</sup> Po aty, f. 92.

<sup>34</sup> U.S.Senate, 66 Congress, I-st session, Hearing before the Committee on Foreign Relations, Sen, doc, no 106 Washington, 1919, f. 971-1011.

<sup>35</sup> Po aty, f. 91.

ndoshta edhe më gjatë, por për ato territore shqiptare, në jug e në veri, që rivendikoheshin nga fqinjët. Ai u përvijua më tej si mandat i mirëfilltë, i diskutuar krahas mandatit zviceran, atij britanik dhe francez.<sup>36</sup> Pretendimi italian përjashtojë nga shqiptarët për shkak të frikës së shndërrimit në një mburojë juridiko-ndërkombëtare për aneksim. Në dokumentacionin e prodhuar në Departamentin e shtetit dhe në institucione të tjera, janë gjetur edhe skicë-ide konkrete, se si mund të ishte ky mandat ndaj Shqipërisë,<sup>37</sup> por në fund të fundit, triumfoi mendimi që e kundërshtonte. Dëshira e shqiptarëve dhe tundimi në ndonjë nga hallkat e administratës amerikane mbetën një utopi kurioze. I tillë kishte mbetur edhe propozimi për kandidaturën e ish presidentit amerikan, Teodor Ruzvelt (Theodore Roosevelt) si princ i Shqipërisë, në vitin 1913-1914, të cilit madje iu akordua edhe medalja e parë e shtetit shqiptar të kohës së princ Vedit, “Urdhri Mbretëror i Shqiponjës së Zezë”. Ajo iu dha gjithashtu edhe dy amerikanëve të tjerë, Dr. Layman Abbot, për editorialet në gazetën “*The Outlook*”, ku përkrahej çështja shqiptare, si dhe filantropistit Charles Richard Crane.

## KËRKESË TJETËR PËR NJOHJE

Ndërkohë shqiptarët duke e ditur mirë peshën dhe potencialin e jashtëzakonshëm politik të ShBA në skenën botërore, nuk i reshtën përpjekjet për të tërhequr përkrahjen dhe mbështetjen e tyre. Në fillimin e vitit 1920 qeveria shqiptare kërkoi zyrtarisht njohjen e ShBA për pavarësinë e Shqipërisë, shtetit dhe qeverisë së saj.<sup>38</sup> Ajo u nis nga një episod i ndodhur në fundin e vitit 1919, shpallja e Memorandumit anglo-franko-amerikan të 9 dhjetorit 1919 për statusin dhe shtrirjen e Shqipërisë. Në tekstin e Memorandumit thuhej shprehimisht se Italia “merr mandat mbi shtetin e pavarur shqiptar.”<sup>39</sup> Kjo ritheksohej edhe në një akt tjetër, ku shtetet e mësipërm përcaktonin kushtet e mandatit italian mbi Shqipërinë dhe deklararin se ShBA, Anglia dhe Franca dëshirojnë të nënvizojnë “pavarësinë e Shqipërisë”. Edhe pse këta dy dokumente përfaqësonin akte të copëtimit të mëtejshëm të shtetit shqiptar të shpallur më 28 nëntor 1912 dhe të njohur në 29 korrik 1913, nga një pikëpamje strikte juridike, pranimi i “shtetit të pavarur shqiptar” dhe “pavarësisë së Shqipërisë”, nëpërmjet fjalëve të shkruara shprehimisht në tekstin e tyre, përfaqësojnë një njohje të tërthortë nga të tre shtetet autore të Memorandumit.

Amerikanët do të avanconin edhe më tej, do të ndërmerinin një hap praktik. Departamenti i Shtetit njohu në mënyrë gjysmëzyrtare me cilësinë e

<sup>36</sup> Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 93, 98.

<sup>37</sup> Po aty, f. 89-102.

<sup>38</sup> Po aty, f. 126.

<sup>39</sup> Po aty, f. 127.

komisionerit Konstandin (Kostë) Çekrezin si përfaqësues të Shqipërisë, të cilën Amerika nuk e kishte njohur ende zyrtarisht. Çekrezi, më 27.03.1920 kreu madje edhe ritin klasik të fillimit të detyrës si përfaqësues i shtetit shqiptar në ShBA, dorëzoi letrat kredenciale (!) që ishin nënshkruar nga kryeministri, Sulejman Delvina dhe ministri i Punëve të Jashtme, Mehmet Konica. Por, iu sugjerua që kontaktet do t'i mbante me Seksionin për Lindjen e Afërt në Departamentin e Shtetit, i cili ishte ngarkuar edhe me ndjekjen e çështjeve për Shqipërinë.<sup>40</sup> Ai hapi edhe përfaqësinë shqiptare në Uashington, e cila pas pak kohe u mbyll për arsyë financiare. Më 14.04.1922, u hap në Nju Jork nënkonsullata shqiptare, në krye të së cilës u vendos Konstandin (Koço) Tashko, me rangun e nënkonsullit.<sup>41</sup> Qëndrimi i mësipërm i administratës amerikane, i gjykuar nga pikëpamja juridiko-ndërkombëtare është disi i veçantë, përfaqëson një precedent në mos të panjohur, së paku tepër të rrallë, në praktikën ndërkombëtare.

Gjithë këto veprime, të interpretuara në optikën juridiko-ndërkombëtare mund të konsiderohen si njohje e shtetit dhe e qeverisë shqiptare. Por autoritetet amerikane duket se, pavarësisht se kishin pranuar kryerjen e procedurave të mësipërme, tregoheshin tej mase prudentë, që ato të mos identifikoheshin si njohje ndërkombëtare e Shqipërisë nga ShBA. Justifikimi i përdorur ishte që edhe pse parimisht ishin “për ekzistencën e shtetit shqiptar”, “nuk ishin ende të bindur për efikasitetin dhe stabilitetin e tij.”<sup>42</sup> Kujdesi shkonte deri në ekstrem, sa që shmangeshin sistematikisht përpjekjet e Çekrezit për kontakte direkte me nivele përfaqësuese në Departamentin e Shtetit. Madje edhe shkresat e dërguara prej tij përcilleshin e merreshin në dorëzim në forma të tërthorta që atij të mos i krijoheshin përshtypja se po trajtohej si përfaqësues i një shteti të njohur ndërkombëtarisht.<sup>43</sup>

Autoritetet amerikane kishin përdorur këtë mënyrë veprimi edhe me përfaqësuesit e rreth 20 shteteve të tjerë, të cilët endeshin nëpër mjediset sekondare qeveritare amerikane, me synimin për të tërhequr vëmendjen e Departamentit të Shtetit, me shpresë që një ditë të siguronin njohjen e vendit të vet.<sup>44</sup> Bëhej shumë përpjekje nga zyrtarët e Uashingtoni që në raportet me këta “përfaqësues” të mos toleronin asnjë pakujdesi që mund të jepte përshtypjen se ishin njohur zyrtarisht. Nëpunës të Departamentit të Shtetit i përsëritën Çekrezit se Uashingtoni kishte nevojë të krijonte bindje për qëndrueshmërinë

<sup>40</sup> National Archives of the USA, Uashington D.C, Decimal File, 1910-1939 (në vijim N.A.) 87501B11/2.(Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.)

<sup>41</sup> N.A. 875.1b11/3, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

<sup>42</sup> N.A. 875.01/122, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

<sup>43</sup> N.A. 875.01/184 dhe 875.01/188, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

<sup>44</sup> Ilir Ikononi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: UET Press, Tiranë 2017, f. 18.

e shtetit shqiptar, seriozitetin, shtrirjen territoriale, efikasitetin e veprimtarisë së qeverisë dhe individëve që ishin në krye të vendit. Për këtë arsye kërkuan informacione plotësuese nga përfaqësitë e tyre diplomatike dhe konsullore në Athinë, Beograd, Romë, Trieste etj. Morën gjithashtu edhe informacionin e Komisionit hetimor të Lidhjes së Kombeve që ishte dërguar në Shqipëri.<sup>45</sup>

Ndërkaq, edhe pse Kostë Çekrezi vazhdonte të punonte dhe të kryente detyrën e përfaqësuesit të akredituar *sui generis* të Shqipërisë, Tirana kërkoi dhe mori pëlqimin që me këtë mision të ngarkohej amerikanin Çarl Telford Erikson.<sup>46</sup> Ai mbërriti në Uashington për të marrë në dorëzim zyrën dhe detyrën, por u njoftua se në Shqipëri kishte patur ndryshime qeveritare. Ky zhvillim si dhe problemet financiare krijuan paqartësi se kush realisht ishte “përfaqësuesi” i Shqipërisë në Uashington. Të dy punonin paralel, duke mos i kursyer akuzat ndaj njëri-tjetrit për paaftësi dhe gabime në veprimtari. Departamenti i Shtetit, pa e njohur në mënyrë eksplicite qeverinë e Tiranës, vazhdonte komunikimet me Kostë Çekrezin, nëpërmjet të cilit merrte hera-herës informacionet që i duheshin. Kur Konferenca e Ambasadorëve në Paris miratoi vendimin e 9 nëntorit 1921 për Shqipërinë, ishte Çekrezi ai që njoftoi Departamentin e Shtetit se Anglia dhe Franca e njohën Shqipërinë.<sup>47</sup>

## MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE, 1922

Dukej se gjithçka shkonte në favor të njohjes, por Uashingtoni kësaj here nuk donte të ngutej, kishte ende çështje që donte t’i sqaronte deri në imtësi. Të tilla ishin paqartësitë dhe incidentet në kufijtë e Shqipërisë me fqinjët, statusi i të ashtuquajturës Republikë e Mirditës etj. Në informacionet për Shqipërinë që mbërrinin në Uashington kishte edhe të dhëna me interes të posaçëm, siç ishin fjala vjen perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë mbështetur mbi pasuritë minerale që ishin zbuluar në vend, veçanërisht nafta dhe mineralet e tjera, ndër të cilat platini, siç u thoshte Çekrezi amerikanëve, burimet ujore, pyjet etj.<sup>48</sup>

Qëndrimet reticente vazhdonin mbështetur kryesisht mbi pretekste të improvizuara, si problemet e brendshme shqiptare, ndërhyrjet dashakeqe të

<sup>45</sup> N.A. 875.01/65; N.A. 875.01/77; N.A. *Raport on the Albanian situation, October-November, 1921*, by John F. Carter; N.A. 875.00/75; N.A. 875.01/212; N.A. 875.01/255; N.A. 875.01/ 191; N.A. 875.01/162a, 172a. , Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 128-129.

<sup>46</sup> Ilir Ikonimi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: UET Press, Tiranë 2017, f.19. Ndërkaq Mal Berisha, duke iu referuar edhe burimeve arkivore shqiptare konstaton se Ericksoni nuk mori as pëlqimin e autoriteteve shqiptare. Vendimi nr. 1160, i 28 dhjetorit 1920, firmosur nga kryeministri Vroni, përcakton se “U vendos qi Z.Erickson, me që nuk asht nënshkretas shqiptar e me qenë se nuk ka dekret prej Këshillës së Naltë, të mos njihet si përfaqësues i shtetit t’onë.” Arkivi i MPJ, Dosja Nr. 4, Viti 1921, faqe 3.

<sup>47</sup> N.A. 875.01/255, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 129.

<sup>48</sup> N.A. 875.01/189. Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 130.

fqinjëve që përhapnin opinione negative për shqiptarët etj.<sup>49</sup> Më tej interesimi i grupeve të fuqishme amerikane, veçanërisht atyre të industrisë së nxjerrjes dhe shfrytëzimit të naftës, siç ishin “*Sinkler Exploration Company- Sinkler*”, “*Standard Oil Company*” dhe të tjera<sup>50</sup> bëri që në Departamentin e Shtetit dosja e njohjes së Shqipërisë të shihej me tjetër sy. Në këtë atmosferë ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, Fan Noli, më 28.01.1922, me anën e një letre drejtuar Departamentit të Shtetit, përsëriti kërkesën zyrtare për njohje.<sup>51</sup>

Çështja do të lëvizte pas vizitës që bëri në vend konsulli amerikan i Tanzherit, Maxwell Bllejk, të cilin qeveria amerikane e caktoi njëkohësisht edhe si përfaqësuesin e saj në Shqipëri. Në realitetin shqiptar ai konstatoi elemente pozitivë në favor të njohjes. Në raportin e përcjellë në Uashington, krahas mundësive për bashkëpunim ekonomik me përfitime interesante, rreshtonte edhe frymën proamerikane të shqiptarëve, të cilët, siç shkruante ai, janë të bindur në desinteresimin e amerikanëve nga pikëpamja politike, si dhe në atë që kapitali amerikan mund të ndihmojë në zhvillimin e vendit.<sup>52</sup>

Më 25 korrik 1922, Bllejkut i mbërriti njoftimi i shumëpritur nga Departamenti i Shtetit, në të cilin porositej që në datën 28 korrik 1922 duhet t’i dorëzonte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë një notë me tekstin e përgatitur paraprakisht nga desk oficeri përkatës i Departamentit në Uashington. Argumentimi që përdorej ishte si vijon:

... “Qeveria e SHBA... “e udhëhequr nga qëndrimi i suksesshëm i qeverisë kombëtare shqiptare” e njeh *de jure* qeverinë e Shqipërisë.<sup>53</sup>

Më 28 korrik 1922, pas shumë ngurrimesh, Shtetet e Bashkuara e njohën *de jure* Shqipërinë<sup>54</sup> dhe shpallën vendosjen e marrëdhënieve diplomatike...

## Burime të shfrytëzuara

1. *Mary Ball Washington* by Virginia Carmichael, Mary Washington Branch, Association for the Preservation of Virginia, Antiquities (1967).
2. Carl Woodward, gazetar, reporter amerikan, autor i dhjetëra librave dokumentarë për presidentët amerikanë dhe historive nga Shtëpia e Bardhë, thotë se kishte gjetur në arkiva një letër të George Washington, ku fliste për shqiptarët. Woodward

<sup>49</sup> N.A. 875.01/88,

<sup>50</sup> N.A. 875.6363/11; N.A. 875.6363/22.

<sup>51</sup> N.A. 875, *Letër e Fan Nolit drejtuar Departamentit të Shtetit, më 28.01.1922*.

<sup>52</sup> Papers Relating to the Foreign Relations of the United States of America, 1915-1939, (Washington D.C.; Government Printing Office) – Papers, 1922, vol.I, f.603.

<sup>53</sup> N.A. 875.01/233.a. Silajxhiç, f. 138.

<sup>54</sup> Ilir Ikonimi, “*Faik Konica, Jeta në Uashington*”, vep. cit. f. 20.



shkruan: “Mbaj mend që, kur mora letrën për t’ia treguar Bill Klintonit në një nga shumë intervistat dhe i thashë: “Ja, Bill, kjo është ajo që kam zbuluar nga arkivat e Uashingtonit”, ai tha: “E kam parë Çarl, e kam parë. Nëse nuk do ta kisha parë, zoti e di nëse do të kishim ndërhyrë në Kosovë”. Sipas John McCallum, gazetar i Reuters, duket se ka edhe një provë tjetër që vjen nga Instituti i Biokimisë dhe Gjenetikës, Zvicër. Ai ka publikuar rezultatet e hulumtimit mostrave gjenetike të ish-presidentit amerikan George Washington, i cili rezultoi se ishte 50 përqind shqiptar. Autori thotë gjithashtu se ekspertë të fushave të tjera kanë kërkuar ta konfirmojnë këtë pohim, duke përmendur prova nga gjenealogjia, gjuhësia etj. John McCallum-Sipas “Reuters”, “George Washington, shqiptari që krijoi Amerikën”, Citohet sipas “Prizrenpress”, 12/30/2019.

3. Irakli Koçollari, *1819 /” Dy gazetarët amerikanë që intervistuan Ali Pashën”*, “Java News”, 15/02/2016.
4. Henry Wadsworth Longfellow, - “*Rrëfenja të një Hani ndanë Udhës*”, 1873.
5. Foreign Relations, No.40. *Mr. Kasson to Mr. Evarts, No. 320, Legation of the United States, Vienna, May 5, 1880*, citohet nga Llesh Kola, - *SHBA-Shqipëri: 100 vjet qëndrime e marrëdhënie miqësore*, Tiranë, 2022.
6. Foreign Relations, No.42. *Mr. Kasson to Mr. Evarts, No. 322, Legation of the United States, Vienna, May 13, 1880*
7. *Now distuts “liberators”*, *New York Times*, 13 prill 1913. Citohet nga Valentina Duka, vep. cit. f. 113.
8. Ndrim Kulla, “*Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës*”, Plejad, Tiranë 2017, f. 84.
9. “*Shqiptarët*”, Xhorxh F. Williams, Argeta - LMG, Tiranë 2003, f. 4.
10. Viron Prodani, “Kontributi i emigrantëve shqiptarë në ShBA, në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore”. Citohet nga gazeta “Dita”, 11, 12, 13 Janar, 2018.
11. Për *Vatrën* shih edhe Mal Berisha, - *Roli i federatës pan-shqiptare Vatra në mbrojtjen e kufijve dhe pavarësinë e Shqipërisë para dhe gjatë Konferencës së Paqes në Paris*, Kumtesë në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës *Dielli*, Nju Jork, 30 Tetor 1999.
12. Nasho Jorgaqi, - *Jeta e Fan S.Nolit*.
13. Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri: 1897-1942*, Shtëpia botuese *Nereida*, Tiranë, 2000.
14. *Konferenca e Paqes dhe Shqipëria*, në *Ylli i mëngjesit*, Viti 1920.
15. *Fan Noli, Vepra*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi 6.
16. *Zani i Malsisë*, January 8, 2018 - *Comments Off on, Prof. Dr. Nasho Jorgaqi tregon për rolin e Fan Nolit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane*.



17. *Ilir Ikonimi: 1920, kur paria e Tiranës i kërkonte amerikanëve të merrnin “në dorë” Shqipërinë*, Gazeta Shqiptarja.com, 19 Prill 2018,
18. Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit*, Dituria, Tiranë 1999.
19. C.T.Erikson, *Six Reasons Why America Should Become Mandatoty for Albania*, Paris, May 1919, Citohet nga Haris Silajxhiç.
20. U.S.Senate, 66 Congress, I-st session, Hearing before the Committee on Foreign Relations, Sen, doc, no 106 Washington, 1919.
21. Ilir Ikonimi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: UET Press, Tiranë 2017.
22. N.A. 875.01/65; N.A. 875.01/77; N.A. *Raport on the Albanian situation, October-November, 1921*, by John F. Carter; N.A. 875.00/75; N.A. 875.01/212; N.A. 875.01/255; N.A. 875.01/ 191; N.A. 875.01/162a, 172a. , Citohet nga Haris Silajxhiç.
23. *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States of America, 1915-1939*, (Washington D.C.;Government Printing Office) – Papers, 1922, vol.I.



# BETEJA E ALEKSANDRIT TË MADH NË PELION TË ILIRISË MË 335 p.e.s.

**Prof. Neritan CEKA**

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Beteja e Aleksandrit të Madh kundër ushtrisë ilire të mbretit Kleit, që u zhvillua pranë qytetit Pelion të Dasaretisë më 335 p.e.s. njihet si e vetmja humbje e strategut të madh të Antikitetit pikërisht në fillim të karrierës së tij ushtarake. Historiani romak i fillimit të shek. I es., Kurt Rufi, dhe ai grek i fillimit të shek II e.s., Arriani i Nikomedisë, na kanë lënë përshkrime të hollësishme të asaj beteje, por a mund t'i besojmë autorëve që shkruanin për një ngjarje që kishte ndodhur rreth disa qindra vjet para tyre?*

*Burimi i vetëm i të dy historianëve besohet se kanë qenë shënimet e gjeneralit të Aleksandrit, Ptoleme Lagut, me origjinë nga Eordea, pra nga rajoni i sotëm i Kosturit<sup>1</sup>. Kjo mund të shpjegojë edhe informacionin e hollësishëm që përmban përshkrimi i fushatës së Aleksandrit prej tyre, që e bën betejën e Pelionit njerën nga ngjarjet luftarake më të dokumentuara të historisë ushtarake ilire. Si u zhvillua ajo betejë?<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> Straboni (VIII, 3,8) e referon këtë në lidhje me fushatën e Aleksandrit kundër të tribalëve të Danubit, të cilët i quante getë: “Aleksandri u fut në vendin e getëve dhe pushtoi qytetin e tyre, pas së cilës u kthye në atdhe me nxitim...Ptolemeu, biri i Lagut, na informon se keltët që banojnë në Adriatik erdhën tek Aleksandri me propozimin për të bërë një traktat miqësie...”.

<sup>2</sup> Beteja e Pelionit është trajtuar nga N. Ceka, *Qyteti ilir në Selcën e Poshtme*, Tiranë, 1985, f. 143 ff.; N. G. L. Hammond, *Alexander's Campaign in Illyria*, JHS, 94 (1974), f. 66-87. Shih për një parashtrim kritik të pikëpamjeve për identifikimin e Pelionit: N. Vujčić, *The City of Pelion and the Illyrian War of Alexander*, *Greek, Roman and Byzantine Studies*, 61 (2021), f. 496–526.

*Arriani dhe Kurt Rufi na kanë transmetuar të njejtin prelude të zhvillimit të betejës, që duket se nuk bënte pjesë në fushatën që Aleksandri i Madh po kryente në pranverën e vitit 335 p.e.s. kundër tribalëve, një popullsi danubiane agresive ndaj kufijve veriorë të Mbretërisë së Maqedonisë. Pas mbarimit me sukses të asaj fushate dhe gjatë kthimit ai kishte vendosur që të godiste njëkohësisht dy popullsi ilire, agrianët dhe paionët në luginën e lumit Strymon (Struma në Bullgarinë perëndimore), kur mori lajmin e një lëvizjeje kundër pushtimit maqedonas në Iliri. Arrian e ka kaluar përciptazi karakterin dhe shkaqet e asaj lëvizjeje, për t'u përqendruar thjesht te përshkrimi i fushatës ilire të Aleksandrit dhe është Kurt Rufi që i shpjegon ato (Ruf. Suppl. I, 12).*

*Sipas tij mbreti i ilirëve, Bardhyli, pasi ishte kishte humbur dy herë luftën kundër Filipit II të Maqedonisë, “i ishte bindur fituesit”. Pas vdekjes së tij “i biri i tij, i quajtur Kleit, duke menduar se kishte ardhur koha për të fituar lirinë, atëherë kur Aleksandri ishte i zënë me një luftë përtej Istit me popuj të fuqishëm, i bëri fiset e tij të rroknin armët dhe lidhi aleancë me Glaukiasin, mbretin e ilirëve që quhen taulantë”.*

## DY AUTORËT E LASHTË DHE...

**T**ë dy autorët shkruanin se lajmi për këtë kryengritje i erdhi Aleksandrit nga Iliria, ndërsa nga një dokument tjetër del se dërguesi i lajmëtarëve ishte gjenerali maqedonas Korragos<sup>3</sup>. Emrin e tij mban kështjella e Hijes së Korbit pranë Maliqit, sepse *Korragos* në greqishten e lashtë përkthehet me shqipen *korb*, gjë që na bën të mendojmë, se ai mund të ketë qenë guvernatori maqedonas i krahinës së Dasaretisë, ku u zhvillua kryengritja, si dhe themelues i kështjellës me emrin e tij.

Të dy autorët na kanë lënë një përshkrim të ngjajshëm të fushatës ushtarake të Aleksandrit të Madh, i cili ndodhej në fillim të saj në lumin Erigon, Crna e sotme e Maqedonisë së Veriut, lugina e sipërme e të cilit të nxirrte për në Maqedoni. Sipas tyre objekti i kësaj fushate ishte goditja e qytetit Pelion, që gjendej “në Dasareti, mbi lumin Eordaik” (Ruf. Suppl. 12). Që nga lugina e Erigonit kishte dy rrugë që mund të nxirrnin në Dasareti. E para kalonte pranë Heraklesë së lynkestëve, në Manastirin e sotëm të Maqedonisë së Veriut, për të hyrë nga Kapshtica për në Fushën e Korcës, që ishte pjesa qendrore e Dasaretisë. Rruga e dytë do të përkonte me *via Egnatia* romake, duke kaluar pranë Prilepit të sotëm mbi liqenin e Ohrit dhe Qafë Thanë, drejt luginës së sipërme të Shkumbinit, të gjitha këto territore të Dasaretisë veriore. Përshkrimi i gjithë kësaj pjese të fushatës mungon tek përshkrimet e të dy autorëve, që e vendosin ushturinë e Aleksandrit të Madh drejtpërdrejt përballë Pelionit, me një objektiv të vetëm që të pushtonte qytetin.

<sup>3</sup> N. Vujčić, *The City of Pelion...*, f.516-517.

Sipas Kurt Rufit ai pati përballë vetëm garnizonin e komanduar nga Kleiti, që fillimisht u përgatit për betejë, duke “zënë vende të përshtatshme, pyje dhe rrugë” dhe duke bërë flijimet<sup>4</sup>. Por ndodhi që ushtria ilire e mënjanoi betejën, duke u tërhequr brenda Pelionit, e ndjekur nga Aleksandri. Ndërsa Kurt Rufi raporton shkurt se Aleksandri po atë ditë vendosi t’i izolojë ilirët nëpërmjet një muri që bllokonte portën e qytetit, Arriani na informon hollësisht, se Aleksandri “u drejtua kundër qytetit Pelion, sepse atë e kishte pushtuar Kleiti si qytetin më të fortë në këtë vend” dhe se... “sapo Aleksandri erdhi pranë këtij qyteti, ngriti lëmin pranë lumit Eordaik dhe vendosi që të nesërmen të sulmonte muret e qytetit”.

Gjithashtu, sipas tij, nuk ishte vetëm garnizoni i qytetit që doli për t’u ndeshur me maqedonasit, por “Kliti me ushtarët e tij kishte zënë dhe mbante malet rreth e rrotull qytetit, që ishin më të larta dhe të pyllëzuara dendur, me qëllim që t’u binte nga të tëra anët maqedonasve në se këta do të sulmonin qytetin” (Arr, Anab. I, 5,7). Pra, ishte e njejta taktikë që do të përdorte Skënderbeu në rrethimet e Krujës, por jo e njejta arritje përfundimtare.

Sipas Arrianit Aleksandri ngriti një kamp të dytë pranë murit të Pelionit dhe vendosi të ndërtonte murin që do t’i bllokonte forcat e Kleitit brenda qytetit. Ardhja e mbretit taulant Glaukias, aleat i Kleitit, me një forcë të madhe luftëtarësh e detyroi Aleksandrin që të “humbë shpresën për të pushtuar qytetin, mbasi në një anë në qytet ishin futur shumë luftëtarë të zotë dhe, nga ana tjetër, ushtria e shumtë e Glaukias do të turrej, në se beteja do të ndizej afër murit”. Ishte koha për të marrë një vendim dhe është Kurt Rufi, që informon se Aleksandri “u detyrua të mirrte masa për të siguruar tërheqjen”.

Kyesorja ishte të shpëtonte nga rrethimi gjeneralin e tij Filotën me kalorësit, të cilët duhet t’i kishte dërguar një ditë më parë për të “siguruar ushqime për kafshët e lëmit” (Ruf. Suppl. I, 12)<sup>5</sup>. Kjo duhet të kishte qenë dita e dytë e qëndrimit të Aleksandrit pranë Pelionit, kur ai u nis me gardën e “*miqve*”, mercenarët agrianë, shigjetarët dhe 400 kalorës për të shpëtuar Filotën nga forcat e Glaukias, që kishin zënë “malet rreth e rrotull fushës, ku do të kërkonte ushqime Filota”.

Fusha gjendej jo më shumë se gjysmë dite larg nga kampi i lumit, nga u nis Filota, sepse “kalorësit dhe karvani ishin në rrezik po t’i zinte nata” (Arrian.

---

<sup>4</sup>Ruf. Suppl.12: “...tre djem të rij dhe tri vajza të reja të shtrirë të vdekur përtokë bashkë me tre desh të zinj..Barbarët u kishin bërë fli zotave të tyre sipas një besimi të shenjtë, për t’u dhënë guxim njerëzve të tyre para se të luftonin...”.

<sup>5</sup>Kurt Rufi na jep kështu një detaj se Filota ishte lënë në kampin e lumit, nga u nis për të kërkuar ushqime jo për ushtrinë, por vetëm “për kafshët e lëmit”, pra të transportit. Arriani, Anab. I, 5,9, e vendos këtë veprim pas ardhjes së Glaukisë, pra në një kohë që do të përbënte një aventurë të pashpjegueshme për trupën e Kleitit.

Anab. I, 5,9-10). Ndërkohë ai kishte lënë pjesën tjetër të ushtrisë për të mbajtur të bllokuar qytetin dhe për të mos lejuar bashkimin e garnizonit të tij me ushtrinë e Glaukias. Me një manovër të shpejtë Aleksandri arriti të nxjerrë trupën e Filotës nga rrethimi dhe ta sjellë në kamp. Ky duhet të ishte kampi pranë mureve, sepse deri në nisjen e tërheqjes së ushtrisë maqedonase nga Pelioni, Aleksandri e mbante atë të palëvizur, nga që pritej që “ushtria që ishte brenda në qytet do ta godiste prapa, kur do të vendoste të largohej nga ky vend”.

Si rrjedhim gjendja ishte e tillë: Aleksandri e kishte mbledhur gjithë ushtrinë në kampin kryesor pranë Pelionit, sepse forcat e Kleitit gjendeshin brenda në Pelion, ndërsa ato të Glaukias “kishin zënë malet e larta me shumë kalorës, shigjetarë, hobetarë dhe hoplitë” (Arrian, Anab. I, 5,12).

Ajo që ndodhi më pas, siç ka qenë përshkruar njëlloj nga Kurt Rufi dhe Arriani, ishte një betejë në tërheqje, në një gjendja jashtëzakonisht të rrezikshme dhe në një terren po aq të pafavorshëm për ushtrinë e Aleksandrit. I rrethuar në tri anë nga ushtria e taulantëve të Glaukias dhe e kërcënuar nga prapa nga garnizoni i Pelionit, që do të dilte nga qyteti, Aleksandrit iu desh të përshkonte fillimisht një grykë, ku terreni “...ishte i ngushtë dhe shumë i veshur; nga një anë e pengonte lumi, kurse nga ana tjetër ngrihej një mal i lartë e i thepisur, kështu që as katër ushtarë me rradhë nuk ishte e mundur të kalonin”(Arrian. Anab., I, 5,12”.

Në ato kushte Aleksandri e radhiti falangën në një thellësi prej 120 rradhësh dhe vendosi në të dy krahët e saj nga 200 kalorës. Në prapavijë vendosi hoplitët, ushtarët e armatosur me mburoja e përkrenare, që sulmuan garnizonin e dalë nga qyteti dhe e detyruan të kthehej përsëri brenda mureve. Ndërkohë falanga marrshoi përpara, e organizuar në formë pyke, duke pasur në krahun e majtë armikun dhe në të djathtin lumin.

Vahu i lumit, ku do të kalonte ushtria maqedonase kontrollohej nga një kodër, e cila ishte zënë nga ilirët, të cilët vetë Aleksandri i sulmoi me gardën e “miqve”. Pasi pushtoi kodrën, qëndroi aty bashkë me mercenarët agrianë dhe me 2000 harkëtarë, që do të mbulonin prapavijën e ushtrisë. Që nga kodra urdhëroi falangën dhe “miqtë” që ta kalonin lumin dhe të rreshtoheshin në krahun e majtë, për të mbrojtur kalimin e të tjerëve. Dhe me të vërtetë, Arriani përshkruan atë moment të vështirë për maqedonasit, sepse ilirët”...kur panë se ushtria e maqedonasve filloi të kalojë lumin, u larguan nga malet, për t’i rënë praparojës që ishte shkëputur bashkë me Aleksandrin” (Arrian, Anab, I,6, 7). Falanga që kishte kaluar lumin lëshoi një britmë, sikur do kthehej përsëri, për të sulmuar.

Vetë Aleksandri, që ndodhej ende përtej lumit, i kundërsulmoi ushtarët e Glaukias, duke i detyruar të tërhiqeshin dhe dërgoi agrianët e shigjetarët te

lumi. Pas kësaj kaloi lumin dhe rreshtoi mjetet luftarake për të hedhur gurë dhe shigjeta, që do t'i mbanin larg sulmuesit ilirë; “njëkohësisht urdhëroi shigjetarët të ndaleshin në mes të lumit dhe prej andej të qëllonin. Ushtarët e Glaukias nuk guxuan t'i afroheshin vendit ku arrinin shigjetat dhe maqedonasit e kaluan lumin të sigurtë, pa humbur asnjë luftëtar gjatë tërheqjes”.

Pavarësisht nga tërheqja e rregullt dhe pa humbje, që i detyrohej disiplinës së reparteve të ushtrisë maqedonase, po aq sa edhe talentit ushtarak të Aleksandrit vetëm 21 vjeçar, kjo ishte jo vetëm një humbje në planin ushtarak, por edhe në atë politik, sepse pas largimit me turp të ushtrisë së Aleksandrit, krijoreshin mundësitë e ringjalljes së Mbretërisë së Bardhytit në një aleancë të fuqishme me mbretin Glaukias të Ilirisë.

Lajmi i disfatës ilire, i shoqëruar edhe me informatën e pasaktë për vrasjen e Aleksandrit gjatë saj, kishte nxitur një kryengritje në Tebën e pushtuar nga maqedonasit (Arrian. Anab. I, 7, 2). Por talenti i Aleksandrit nuk qëndronte vetëm në tërheqjen pa humbje nga dështimi, por edhe në kthimin e tij në fitore, kur kundërshtari nuk e shfrytëzonte atë. Dhe me të vërtetë ndodhi që ilirët jo vetëm nuk e ndoqën ushtrinë maqedonase, por as nuk morën masa për të siguruar fitoren, sepse Aleksandri nuk ishte larguar shumë. Pas tri ditësh ai u informua “...se ushtria e Klitit dhe e Glaukias ishte fushuar keq dhe as roje të rregullt për t'i ruajtur ata nuk vendosnin dhe as ledhe dhe hendeqe nuk kishin bërë...prandaj që pa u gëdhirë mirë kaloi lumin pa rënë në sy...”. Vetëm me pararojën e përbërë nga garda e tij, agrianët dhe shigjetarët, ai e goditi kampin ilir, kur ishte plotësisht në gjumë, i pasuar pastaj edhe nga maqedonasit e komanduar nga Perdika e Keno, duke krijuar panik dhe duke asgjësuar lehtësisht kundërshtarin. “Ushtarët e Aleksandrit e ndoqën armikun deri te Malet e Taulantëve; por edhe ata që shpëtuan mbetën pa armë, se i kishin hedhur në ikje e sipër. Kliti në fillim shkoi në qytetin e vet dhe pasi i vuri zjarrin, iku te Glaukia në Mbretërinë e Taulantëve”. Kështu e përmbyll Arriani (I, 6, 9-10) tregimin e tij për fushatën ilire të Aleksandrit, duke u përqëndruar në hollësitë e zhvillimeve taktike, por duke nënvleftësuar ato gjeografike.

Kjo ka qenë arsyeja që studiues të ndryshëm kanë ndeshur vështirësi së pari në përcaktimin e vendit, ku u zhvillua beteja, pra në identifikimin e qytetit Pelion. Ky qytet përmendet vetëm tri herë nga autorët antikë<sup>6</sup>. Në përshkrimin e Kurt Rufit ai del si “qytet i Dasaretisë mbi lumin Eordiak”, dhe si kryeqendra e kryengritjes antimaqedonase të drejtuar nga i biri i mbretit Bardhyl, Kliti, aleat i Glaukias. Arriani e vendoste gjithashtu Pelionin pranë lumit Eordaik, duke e

<sup>6</sup> Straboni (VII, 7, 4) përmend një toponim të ngjajshëm, Peleon, që ndodhet pas Lyhnidit, përgjatë pjesës së parë të *via Egnatia*, të njohur si rruga e Kandavisë, por që nuk është qytet, por vetëm “një vend” që ndan Ilirinë nga Maqedonia (Πυλῶνος τόπου ὀρίζοντος ἐν τῇ ὁδῷ τῇν τε Ἰλλυρίδα καὶ τῇν Μακεδονίαν).

cilësuar si “qyteti më i fortë në këtë vend”, por pa përmendur Dasaretinë<sup>7</sup>. Të dy autorët bashkohen në përshkrimin e një qyteti të rrethuar me male, ndërsa lumi Eordaik rridhte në një luginë të ngushtë, duke pasur në njerin krah malin. Rreth një gjysmë dite larg qytetit gjendej një fushë, ku gjenerali maqedonas Filota shkoi me kalorësit e tij për të grumbulluar ushqime.

Qyteti gjendej rreth një gjysmë dite larg Maleve të Taulantëve, që ishin kufiri me Mbretërinë e Glaukias. Sipas Arrianit ai duhet të ishte një qytet relativisht i madh, sepse strehonte një pjesë të mirë të ushtrisë së Kleitit dhe asaj të Glaukias. Përmendja e tretë dhe e fundit e Pelioni i takon historianit romak të kohës së Augustit, Tit Livi, i cili e konsideronte atë si qytet të rëndësishëm të krahinës ilire të Dasaretisë, me fortifikime të sigurta. Kjo përmendje i takonte ngjarjeve të vitit 199 p.es., kur duket se qyteti ishte rimëkëmbur dhe populluar pas djegies dhe braktisjes nga Kleiti më 335 p.es., sepse romakët pasi e pushtuan me sulm, morën plaçkën e luftës bashkë me skllevërit, por lanë aty një garnizon, nga që qyteti kishte një “pozitë shumë të përshtatshme për të sulmuar Maqedoninë” (Liv., XXXI, 40, 4-5). Sidoqoftë Pelioni nuk duhet të ketë qenë fare pranë kufirit, sepse ai nuk përmendet pak kohë më parë midis qyteteve të Dasaretisë të pushtuara nga mbreti ilir Skerdilajdi më 217 p. Kr., prej nga ai kishte sulmuar “...një pjesë të madhe të Maqedonisë, që është në kufi të këtyre qyteteve” (Polyb. V, 108,1).

Në këtë mënyrë ngjarjet historike, duke dhënë një lloj identikiti të qytetit, mund të ndihmojnë që të përcaktohet së pari shtrirja gjeografike e Dasaretisë dhe vendndodhja e qendrave qytetare. Qytetet dasarete përmenden nga autorët antikë kryesisht në pjesën qendrore të saj, që kufizohej me Maqedoninë dhe që korrespondon me trevat e sotme të Fushës së Korçës, rrethinave të liqenit të Ohrit, duke përfshirë edhe krahinat e Mokrës, Gorës dhe Oparit. Autorët antikë përmendin një numër të konsiderueshëm qytetesh të Dasaretisë, por pak prej tyre janë identifikuar, siç është rasti i Lyhndit në kalanë e Ohrit dhe Enkelana në lalanë e Pogradecit. Polibi përmend Antipatrean, Krysondyonën, Geruntinn dhe Kreonin<sup>8</sup>. Nga ana tjetër arkeologët kanë gërmuar vetëm një numër të vogël të qyteteve dasarete, si Kalanë e Ohrit, kalanë e Pogradecit dhe Kalanë e Symizës pranë Maliqit<sup>9</sup>.

<sup>7</sup> Εορδαϊκός ποταμός, sipas Arrian. Anab. I, 6, 9, i identifikuar zakonisht me lumin Devoll.

<sup>8</sup> Polibi (V, 108, 1-3) shkruante se në fushatën e vitit 217 p. Kr. mbreti ilir Skerdilaid “...kishte bërë për vehte qytetet e Dasaretisë: Antipatrene, Krysondyonën, Gertuntin (Αντιπάτρειαν, Χρυσονδύωνα, Γερτούντα),...”. Filipi V i Maqedonisë nuk vonoi ti përgjigjej atij sulmi dhe pushtoi sipas Polibit (V,108,8) “...Kreonin dhe Geruntin në Dasareti; Enkelanën, Kerakën, Sationën, dhe Boiusn, përqark liqenit Lyhni; Bantian në trevën e Kaloikinëve dhe Orgesin në atë të Pisantinëve (Δασσαρήτιδος Κρεώνιον καὶ Γερούντα, τῶν δὲ περὶ τὴν Λυχνιδίαν λίμνην Ἐγγελαῖνας, Κέρακα, Σατίωνα, Βοιούς, τῆς δὲ Καλοικίνων χώρας Βαντίαν, ἔτι δὲ τῶν καλουμένων Πισαντίνων Ὀρηγῆσόν.”).

<sup>9</sup> S. Anamali, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1973 në Kalanë e Pogradecit, *Iliria*, 1974, 3, ff. 469-474; P. Lera, Vendbanimi ilir në Gradishtën e Symizës, *Iliria*, 1992, ff. 177-208.



## ...MENDIMI SHKENCOR SHQIPTAR

Ne kemi mbështetur mendimin e Skënder Anamalit për ta identifikuar Pelionin në Selcën e Poshtme të Mokrës<sup>10</sup>, por ndërkohë janë shprehur edhe mendime për ta kërkuar në rrënojat e qytetit në Hijen e Korbit pranë Maliqit, apo edhe në luginën e sipërme të Devollit, Eordaikut antik, në pjesën më lindore të Dasaretisë<sup>11</sup>. I mbështetur në një vërtetim tepër të përgjithshëm të asaj lugine dhe duke ia përshtatur atë shkrimeve të Arrianit dhe Kurt Rufit kësaj krahine, arkeologu anglez Nicolas Hammond besonte ta kishte zbuluar Pelionin në kodrën me dy maja të Goricave, pranë fshatit Tren<sup>12</sup>.

Ai e pati krijuar këtë bindje duke e parë kodrën nga larg, sepse kushdo që do të vizitonte Goricat do të kuptonte se atje nuk mund të gjendej “qyteti më i fortë në këtë vend”, siç e karakterizonte Arriani (Anab. 1, 5, 5). Vërtetimi i shpateve, të cilat janë tarracuar nga punimet bujqësore, nuk ka zbuluar kërkund shenja të mureve apo banesave të qytetit, të përmendura gjithashtu nga Arriani. Edhe materialet arkeologjike të mbledhura aty, lidhen me një vendbanim fshatar të shek. III-II p. Kr., që shtrihej vetëm në kodrën më të lartë<sup>13</sup>. Pra, Pelioni nuk mund të kërkohej në as një mënyrë tek Goricat<sup>14</sup> dhe skema e ndërtuar mbi këtë bazë nga Hamondi, bie vetvetiu.

Me këtë vërejtje nuk duam të themi se i japim fund diskutimit mbi fushatën e Aleksandrit, sepse identifikimi i Pelionit është vetëm një pjesë e interpretimit të gabuar që i bën asaj Hamondi. Kryengritja e njohur ilire kundër Aleksandrit është shndërruar nga Hamondi në një inkursion kusarësh<sup>15</sup>. Për ta bërë më të besueshme këtë, ai i vesh ata si dardanë<sup>16</sup> dhe i dërgon të pushtojnë Pelionin

<sup>10</sup> N. Ceka, *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*, Tiranë, 1985, f.177.

<sup>11</sup> Shih për një parashtrim kritik të pikëpamjeve për identifikimin e Pelionit: N. Vujčić, *The City of Pelion and the Illyrian War of Alexander*, *Greek, Roman, and Byzantine Studies*, 61 (2021), ff. 496–526.

<sup>12</sup> N. G. L. Hammond, *Alexander's Campaign in Iliria*, *JHS*, 94 (1974), f. 66-87.

<sup>13</sup> P. Lera, *Pitosa antike me vula nga rrethi i Korçës*, *Iliria*, 1984, ff. 211-222.

<sup>14</sup> Në qoftë se Pelioni do të ishte në atë pjesë të fushës së Devollit, do të ishte më e arsyeshme të kërkohej në kalanë e Trajanit, pranë së cilës gjendet edhe Muri i Mokut, që mund të ishte muri i ngritur nga Aleksandri. Në fakt ky vendbanim është tërësisht prehistorik dhe nuk ka asnjë gjurmë antike. Shih Gj. Karauskaj, *Fortifikime të periudhës së parë të hekurit në rrethin e Korçës*, *Kuvendi i Studimeve Ilire*, I, f. 269.

<sup>15</sup> Hammond, *Alexander's Campaign...*, f.78; “No doubt he (Aleksandri) suspected that Cleitus and Glaucias were on the way to Western Macedonia, which lay open to ravaging and destruction: for these were the traditional tactics of the Illyrians, “*raptio vivere assueti*” (Nuk ka dyshim se Kleiti dhe Glaukia ishin vënë në rugë për në Maqedoninë Perëndimore, që kishte mbetur e pambrojtur nga grabitjet dhe shkatërrimi: sepse këto ishin taktikat tradicionale të ilirëve: “të mësuar të jetojnë duke grabitur”).

<sup>16</sup> *Cleitus... and his people were probably the Dardanians...He had seized and garrisoned Pelion as a base of operations for invading Macedonia*” (“Kleiti dhe njerëzit e tij ndoshta ishin dardanë...(Ai kishte pushtuar Pelionin, duke vënë aty një garnizon si bazë operacionale

për ta përdorur si bazë për grabitjen e Maqedonisë, duke projektuar në një kohë më të hershme versionin analistik romak për “kusarinë” ilire.

Në qoftë se do të kishte qenë me të vërtetë kështu, Arriani dhe Kurt Rufi nuk do të harronin ta vinin në dukje këtë fakt, sepse do të ishte mjaft e çuditshme që Kliti “dardan” të vendosej në një territor të huaj, për të sulmuar Maqedoninë, të cilin dardanët e vërtetë do ta sulmonin drejtpërdrejt një shekull më vonë. Gjithashtu si mund të shpjegohet që ky, “prijës dardan” pas djegies së Pelionit nuk u kthye në Dardani, por u strehua tek Glaukia, mbret i ilirëve?<sup>17</sup> Për këtë arsye, do të ishte e nevojshme të shtroheshin në fillim pyetjet: cili ishte qëllimi i fushatës, cili ishte objektivi saj dhe çfarë rezultati u arrit? Një përgjigje e drejtë e tyre do të na orientonte edhe për gjetjen e vendit ku u zhvillua fushata.

Fushata që ndërmori Aleksandri gjatë vitit 335 p. Kr. kundër tribalëve, ilirëve dhe më pas në Greqi, ishin pjesë të një plani strategjik, i cili parashikonte që gjatë zhvillimit të fushatës në Azi, të mos mbeteshin në shpinë të Mbretërisë së Maqedonisë fqinjë të pa nënshtruar plotësisht. (Arriani I, 1, 4).

Nga fqinjët që mund të rrezikonin seriozisht Maqedoninë, shteti ilir përbënte pa dyshim forcën më të madhe ushtarake dhe politike më aktive, veçanërisht në kufijtë perëndimorë të Maqedonisë<sup>18</sup>, ku ishin përfshirë toka ilire, që dikur i përkisnin këtij shteti. Në fillim duket se Aleksandri u përpoq t’i asnjëanësonte popullsitë ilire në kufijtë veriperëndimorë të Maqedonisë, por kryengritja e Klitit tregoi se ai nuk do të mënjanonte dot edhe një ndeshje tjetër vendimtare me Mbretërinë Ilire të Glaukias, që përkrahte këto popullsi<sup>19</sup>.

Për këtë arsye Kliti dhe Pelioni nuk përbënin objektivin kryesor të fushatës së Aleksandrit dhe ai i la ato në prapavijë, sapo theu forcën kryesore të ushtrisë së Glaukias. Këtu ai zbuloi qëllimin e tij të vërtetë, që ishte shtyrja e kufirit maqedon tek Malet e Taulantëve, në një vijë kërcënues për shtetin ilir. Natyrisht kjo vijë nuk mund të kalonte aspak në Grykën e Cangonjit, apo qoftë në perëndim të fushës së Korçës, siç të lë të kuptosh lokalizimi i Hamondit, sepse atëherë do mbeteshin përsëri të hapura rrugët për në Maqedoni.

Prandaj duhet të pranojmë se qëllimi përfundimtar i fushatës së Aleksandrit

---

për të mësyrë Maqedoninë”). *Po aty*, f. 79. Më pas, fjala *probably* nuk përdoret më dhe ilirët e Glaukisë quhen thjeshtë dardanë.

<sup>17</sup> Hamendësimi i N. G. L. Hammond për përkatësinë dardane të Kleitit është hedhur poshtë me argumente bindëse edhe nga N. Vujčić, Pelion..., f.502 ff.

<sup>18</sup> Shih: Islami, Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare, *Kuvendi I i Studimeve Ilire*, 1974, I, f. 89-90, veçanërisht për rivalitetin iliro - maqedon në drejtëm të Epirit.

<sup>19</sup> Ariani, Anab., 5.1 ”Kur po vazhdonte fushata kundër arianëve dhe paionëve Aleksandri mori vesh nga lajmëtarët se Kliti i biri i Bardhylit, ishte shkëputur prej tij, se me të ishte bashkuar edhe Glaukia, mbret i taulantëve”. Nga kjo kuptohet se kishim të bënim me një çlirim nga zgjedha e Maqedonisë, e vendosur mbi ilirët në kohën e Filipit II pas fitores mbi ilirët në vitin 344 p. Kr.

ishte rivendosja, apo shtyrja e kufirit më pranë qendrës së shtetit ilir, që ishte atëherë diku në shpinë të Dyrrahut dhe Apollonisë.

Me këtë vështrim të gjerë të pikësynimeve të fushatës duhej kërkuar edhe vendi i qytetit ilir Pelion, të cilin Hamondi, siç e vumë në dukje më sipër, e lokalizonin arbitrarisht në Goricat e Trenit, pranë daljes së një afluenti të lumit Devoll nga Prespa e Vogël, në Grykën e Ujkut pranë fshatit Tren. Pa përsëritur argumentin arkeologjik *sine qua non*, që i mungon këtij identifikimi, duam të theksojmë se edhe pamja fizike që krijohet për Pelionin nga përshkrimi i gjallë i Arrianit dhe Rufit ndryshon shumë nga konkretizimi i Hamondit.

Me përshkrimin e tij Arriani (I 5, 5-6) na krijon tablonë e Pelionit si “qyteti më i fortë në këtë vend”, në mes malesh të larta dhe të pyllëzuara dendur. Nga kjo kuptohet se kemi të bëjmë me një qendër të fortifikuar në një zonë malore. Dhe me të vërtetë gjatë rrjedhës së ngjarjeve rreth Pelionit nuk ndeshim asnjë përshkrim fushe, përkundrazi, veprimet luftarake zhvillohen në terren të thyer. Kështu, ilirët që i kishin dale Aleksandrit përpara qytetit, “zunë vende të përshtatshme, pyje e rrugë” (Ruf. Supi I, 12; Arrian 1,5,7). Edhe gjatë tërheqjes së Aleksandrit, Arriani dhe Rufi japin përfytyrim jo të një fushe, por të një terreni të pjerrët nga e majta në të djathtë.

Krahu i majtë i falangës maqedone, e cila kishte një hapësirë të mjaftueshme lufte për 120 veta, i sulmoi ilirët që e kërcënonin nga lartësitë dhe i detyroi “të lënë kodrat e para” (Arriani I, 6, 3). Gjithashtu kur Aleksandri sulmoi një kodër, pranë së cilës duhej të kalonte, ilirët “e lanë kodrën dhe u fshehën majtas e djathtas në male” (Arriani. I, 6, 3). Vendi i ngushtë, ku mezi kalonin katër burra të armatosur, përshkrimi i të cilit ka zotëruar skenën e tërheqjes së Aleksandrit, në fakt nuk luajti asnjë rol gjatë veprimeve luftarake. Ky vend nuk ishte vahu i lumit Eordaik, siç mendonte Hamondi<sup>20</sup>, sepse ushtria maqedone e kaloi atë pa ndeshur vështirësi nga terreni. Në përshkrimin e tyre Arriani dhe Rufi na japin mundësi të caktojmë edhe largësinë që nga lumi në Pelion dhe nga Pelioni tek Malet e Taulantëve. Hamondit, për pjesën e parë që nga Gryka e Ujkut në Gorica, i mbetet një largësi prej 1.5 km, ndërsa në pjesën e dytë ai e fut ushtrinë maqedonase nëpër grykat e Devollit deri në Gramsh e Elbasan<sup>21</sup>.

<sup>20</sup> Hammond, *Alexand. Campaign*, f.83, e lokalizon edhe këtë vend në grykën e Ujkut dhe e detyron medoemos Aleksandrin të hidhet në bregun e djathtë, kur ai mund të vazhdonte rrugën e qetë në bregun e majtë. Përveç kësaj, largësia ndërmjet dy brigjeve në këtë vend nuk i kalon të 20 m, ndërsa Rufi dhe Ariani tregojnë se shigjetarët e qëllonin armikun nga mesi i lumit, që duhet të kishte, si rrjedhim, një shtrat të gjerë sa për dy të hedhura shigjete, pra rreth 50 m.

<sup>21</sup> Po aty, shën, 34. Malet e Taulantëve nuk janë një nocion gjeografik siç mendon Hamondi (shih edhe artikullin e tij *The kingdoms of Illyria, BSA, LXI, 1966, f. 247*). Ariani dhe Kurt Rufi e japin këtë si një nocion politik, si një grup malesh që përbënin kufirin lindor të Mbretërisë Ilire të Glaukias. Në qoftë se mendojmë se një kufi i tillë i ishte imponuar shtetit ilir nga Filipi, ai mund të kalonte në malet e Polisit dhe të Kamjes.

Por Arriani (I, 6, 10) na tregon se kur u kthye për së dyti në Pelion, Aleksandri e kaloi lumin vetëm me shigjetarët dhe agrianët “pa gdhirë mirë” dhe e arriti kampin ilir, kur një pjesë e tij ishte ende në gjumë. Për këtë arsye rruga e përshkuar ka qenë të paktën rreth 20 km dhe është mbuluar nga një marshim i shpejtë, sepse Aleksandri nuk priti të mblidhej pjesa tjetër e ushtrisë. Për ndjekjen e ushtrisë ilire deri tek Malet e Taulantëve, Aleksandrit i mbetej pothuajse e tërë dita. Ai duhej të llogariste në këtë rast edhe rrugën e kthimit, sepse futej në territorin ilir, duke pasur në prapavijë Pelionin ende të pa pushtuar, që i ndërpriste vijat e furnizimit. Si rrjedhim Malet e Taulantëve nuk mund të ishin më shumë se 20 km nga Pelioni.

Edhe një e dhënë tjetër na shërben për të krijuar përfytyrimin e mikrozonës ku gjendej Pelioni. Arriani (I,5,5) e vendos kampin e parë të Aleksandrit pranë lumit Eordaik, por kur filloi rrethimin, Aleksandri e shpërngul kampin<sup>22</sup> pranë murit të Pelionit. Që nga ky çast Aleksandri dha urdhër të ndërtohej një mur, që do t'i izolonte të rrethuarit nga ndihma e jashtme dhe do të krijonte siguri edhe për kampin e tij nga ndonjë sulm prej kështjellës. Hammondi ishte i detyruar të çuditej për këtë veprim jo aq të zakonshëm në historinë e rrethimeve. Me të vërtetë në qoftë se Pelioni do të ishte në kodrat fushore të Goricave, ushtrisë rrethuese do t'i duhej të ndërtonte brenda ditës një mur 2.3 km të gjatë, duke i marrë gurët rreth 1.5 km larg, në kodrinat ku Hammondi kishte vendosur ilirët. Por ky urdhër i Aleksandërit do të ishte krejt logjik dhe do të realizohej lehtë, po ta mendojmë Pelionin si një qendër të fortifikuar ilire me disa anë të mbrojtur nga natyra, e cila lidhej me lartësitë fqinje nëpërmjet një qafe.

Mjaft fortifikime malore ilire kanë një pamje të tillë, gjë që i ndihmonte në mbrojtje, por krijonte edhe mundësinë e izolimit, po të ndërtohej nga rrethuesit një murë gjatë qafës. Në fakt këtë bllokim të mbrojtjes Aleksandri e bëri vetëm me një pjesë të ushtrisë që lë pranë Pelionit, kur u largua për të ndihmuar Filotën (Ar.I,5,10).

Tani ne mund të përmbledhim të dhënat që na ndihmojnë për të krijuar një përfytyrim të përgjithshëm gjeografik për Pelionin. Ky qytet gjendej në një zonë me male të larta, të pyllëzuara në qendër të një lugine që përshkohet nga një lumë. Rruga që vinte nga Maqedonia e kapërcente këtë lumë rreth 2-3 orë larg qytetit dhe vazhdonte midis shtratit të tij dhe lartësive, duke kaluar shpesh në vende të ngushta.

<sup>22</sup> Hamondi, *Alexand. Campaign*, f.79 dhe fig. 3, i ka zgjedhur Aleksandrit për fushim këndin e bashkimit të Ventrokut me Devollin, ku në fakt do të pengohej nga lumi për në objektin e sulmit, dhe e lë aty gjatë gjithë rrethimit, pa marrë parasysh se çfarë shkruante Arriani. Kjo sepse vetëm në këtë mënyrë mund të zbatohet skema e tij, sipas së cilës kodra të cilën e zë Aleksandri para kalimit të lumit, të ishte lartësia mbi shpellën e Grykës së Ujkut. Ndryshe do të dilte që Aleksandri nuk kishte fare nevojë që ta kalonte lumin gjatë rrugës së kthimit.

Nga shpati i malit shkëputeshin një radhë lartësish shkëmbore të ndara prej tyre nga qafa e malit dhe në njërën prej tyre ngrihej Pelioni i mbrojtur prej natyre nga disa anë, ndërsa nga ana e shpatit rrethohej me një mur. Këtë peizazh e plotëson një fushë e vogël, e cila duhet të gjendej jo tepër larg, me që Aleksandri nuk humbi shumë kohë për të tërhequr që andej Filotën e rrethuar (Arrian, I,5, 9-10). Kjo manovër e Aleksandrit tregon gjithashtu se fusha ishte në drejtim të kundërt me rrugën e tërheqjes së tij.

Po ku mund ta vendosim këtë mikrozonë? Për këtë kemi dy të dhëna gjeografike: Pelioni ishte në Dasareti (Liv. XXXI 40, 4) dhe lumi që kalonte pranë tij quhej Eordaik (Arrian I,5,5).

Nga analiza e fushatës së konsullit romak Sulpicius Galba të vitit 199 p.Kr. sonë del se Pelioni ishte diku në pjesën perëndimore të Dasaretisë, pranë rrugës që do të çonte ushtrinë konsullore për në Apolloni. Gjatë kthimit, konsulli duke ditur se konflikti romak-maqedonas do të zgjaste edhe për shumë kohë, mori masa për të siguruar rrugët që të çonin nga Maqedonia për në Ilirinë bregdetare në Maqedoni. Rruga nëpër luginën e Shkumbinit, luante në këtë mes një rol të dorës së parë<sup>23</sup>. Pikërisht në atë pjesë të kësaj luginë që i takonte Dasaretisë, ku përfshihej edhe krahina e sotme e Mokrës, mund të kërkohej edhe Pelioni. Në ngjarjet që pasuan më vonë mund ti shënojmë se lëvizjet e ushtrive romake për në Maqedoni nuk do të bëheshin më nëpër luginën e Devollit, por do të kalonin nëpër luginën e Shkumbinit. Gjithashtu, Pelioni që u kthye në një mbështetje të ushtrisë romake, nuk përmendet më, megjithëse ngjarjet edhe për tri dekada vazhduan të zhvillohen në kufijtë perëndimorë të Maqedonisë. Pra, ai ishte një pikë e rëndësishme, por jo në vijën e parë të luftës, por në prapavijë, ku kalonin furnizimet<sup>24</sup>.

Për të saktësuar kuadrin gjeografik të kërkimit të Pelionit duhet shpjeguar edhe emri i lumit Eordaik, i cili pas ngjarjes së vitit 335 p. Kr. nuk na del më asnjëherë në burimet e shkruara. Dihet se pjesa malore e Dasaretisë antike përshkohet nga dy lumenj kryesorë, Devolli dhe Shkumbini. Në formë hipoteze lumi Eordaik është identifikuar ky lumë me Devollin (Oberhummer, *PËRE*, s. V: *Eordai*), megjithëse gjatë fushatës së Sulpicit ndeshim vazhdimisht emrin Aps për Devollin. Por jo shumë kohë më pas edhe Shkumbini na del me emrin Genus. Ndonëse Eordaik nuk përdorej më si emër lumi, toponimi nuk kishte humbur krejt, sepse tek Ptolemeu (III 12, 13) ai na del si emër i krahinës ku ndodhej Skampini. Kjo lidhje nuk mund të jetë e rastit dhe duhet të mendojmë

<sup>23</sup> N. Ceka, L. Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike, *Monumentet*, 1971, 1, f.43-48.

<sup>24</sup> Le të kujtojmë faktin se Pelioni nuk përmendet midis qyteteve të Dasaretisë, Antipatrea, Krysondyona, Gertunti, të pushtuara nga mbreti ilir Skerdilaidi më 217 p. Kr., prej nga ai kishte sulmuar "...një pjesë të madhe të Maqedonisë, që është në kufi të këtyre qyteteve" (Polyb. V, 108,1).

se duke qenë në fillim emër i lashtë i lumit Shkumbin, ose i pjesës së sipërme të tij, ai i shndërrua më pas në një emër krahinor, duke i lënë vendin një emërtimi të ri të lumit.

Në qoftë se deri tani kemi qenë të saktë në interpretimin e të dhënave historike dhe gjeografike, duhet t'i kërkojmë Pelionit edhe mbështetjen arkeologjike. Edhe nga kjo pikëpamje, fusha e Korçës nuk ka ofruar deri më sot një identifikim të mundshëm, sepse vrojtimet e vazhdueshme<sup>25</sup> nuk kanë zbuluar asnjë qendër qytetare që do t'i përshtatej Pelionit të pasur skllavopronar. Numrit të madh të fortifikimeve të periudhës së parë të hekurit në këtë pellg i përgjigjet një numër i vogël qendrash qytetare, pak të zhvilluara dhe asnjëra prej tyre nuk përkon me përshkrimet mbi Pelionin. Shkaqet e këtij fenomeni qëndrojnë jashtë temës sonë, por mund të vërejmë se qendrat qytetare kryesore të Dasaretisë gjenden gjatë shek. IV-II p. Kr. rreth liqenit të Ohrit dhe në luginën e Shkumbinit.

Ndër to, qytet i vërtetë ishte Selca e Poshtme dhe pikërisht aty mund të lokalizojmë Pelionin antik. Gërmimet arkeologjike kanë provuar se ajo ekzistonte si kështjellë në mesin e shkullit IV p.e. sonë. Varret monumentale, që lidhen pa dyshim me një dinasti mbretërore ilire<sup>26</sup>, nuk mund të mos na kujtojnë faktin se Pelioni i burimeve historike ishte një rezidencë mbretërore e Klitit dhe ndoshta e paraardhësit të tij, Bardhyllit Plak, si dhe e pasardhësit, Bardhyllit të Ri.

Në shek. III-II, Selca ishte qyteti më i lulëzuar i Dasaretisë dhe qendra kryesore në rrugën që vinte nga Iliria bregdetare për në Maqedoninë perëndimore<sup>27</sup>. Kjo nga ana e saj na kujton rëndësinë që i dha konsulli Sulpici Pelionit dhe plaçkën e skllavëve që mori aty.

Pozita e qytetit antik në Selcën e Poshtme i plotëson edhe kushtet gjeografike të Pelionit. Ai ngrihet mbi bregun e lumit Shkumbin, 2 orë larg degës së tij, Dunicës, ku kalonte një rrugë tradicionale, e cila, pranë Gurit të Kamjes dhe kështjellës ilire të Kakaçit, të nxirrte në fushën e Korçës.

Kjo mund të ishte fare mirë rruga nga erdhi Aleksandri. Vetë qyteti është vendosur mbi një shkëmb, i cili shkëputet nga një faqe prej malit të Jamës

<sup>25</sup> Zh. Andrea, Rezultatet e kërkimeve informative në rrethin e Korçës, *Materiale të Sesionit Arkeologjik*, Tiranë, 1968, ff. 125-135; Gj. Karaiskaj, Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në pellgun e Korçës, *Kuvendi I i Studimeve Ilire*, 1974, I, f. 263-290; P. Lera, Petrika, Gjurmë të reja të lashtësisë në rrethin e Korçës, *Monumentet*, 1971, I, ff. 177-183; P. Lera, Vendbanimi ilir në Gradishtën e Symizës, Iliria, 1992, ff. 177-208; S. Aliu, Gj. Karaiskaj, Vendbanime të fortifikuara në pellgun e Kolonjës e në rrjedhën e sipërme të luginës së Osumit, *Monumentet*, 1984, I, f. 81-101.

<sup>26</sup> N. Ceka, "Qyteti ilir"..., f.36-56.

<sup>27</sup> Po aty, f. 57.

dhe mjaftonte një mur 200 metra i gjatë, për ta veçuar atë nga terreni përqark.


Pranë Selcës, rreth 2-3 orë larg, ndodhet fusha e Domosdovës, ku Filota mund të kishte shkuar për të marrë furnizime, ndërsa 4-5 orë rrugë të çojnë te malet e Polisit, që do të përputheshin me Malet e Taulantëve.

Pas kësaj, nuk do të ishte vështirë të vendosnim katrorët e reparteve ndërluftuese dhe do të thonim se çdo gjë përputhet me përshkrimin e Arrianit dhe Rufit, por mendojmë se kjo do të jetë e drejta e atij që do ta identifikojë Pelionin në bazë të të dhënave mbishkrimore.

### **Burime të shfrytëzuara**

1. N. Vujčić, The City of Pelion and the Illyrian War of Alexander, *Greek, Roman and Byzantine Studies*, 61 (2021).
2. Kurt Rufi Arriani, Anab. I, 5,9, Straboni (VII, 7, 4 Ἐορδαϊκός ποταμός, sipas Arrian. Anab. I, 6, 9, i identifikuar zakonisht me lumin Devoll.
3. S. Anamali, Rezultatet e gërmimeve të vitit 1973 në Kalanë e Pogradecit, *Iliria*, 1974, 3; P. Lera, Vendbanimi ilir në Gradishtën e Symizës, *Iliria*, 1992.
4. N. Ceka, *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*, Tiranë, 1985.
5. N. G. L. Hammond, Alexander's Campaign in Iliria, *JHS*, 94 (1974).
6. P. Lera, Pitosa antike me vula nga rrethi i Korçës, *Iliria*, 1984.
7. Gj. Karauskaj, *Fortifikime të periudhës së parë të hekurit në rrethin e Korçës, Kuvendi i Studimeve Ilire*, I.
8. Islami, Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare, *Kuvendi I i Studimeve Ilire*, 1974, I.
9. N. Ceka, L. Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike, *Monumentet*, 1971, 1.
10. Zh. Andrea, "Materiale të Sesionit Arkeologjik", Tiranë, 1968.






Selca - harta e fushatës së Aleksandrit 335 p. Kr.



Selca - Monedhë e Aleksandrit të Madh




Selca - Monedhë e Filipit II




Selca Pelioni





Selca - Planimetria e vendbanimit

Selca - Qytetet  
dasarete në antikitet





# TELEGRAMI I PARË I DEKRIPTUAR SHQIPTAR, I VITIT 1914

**Dr. Ulsi META**

## **Trajtesë e shkurtuar.**

*Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, shtetet në format e ndryshme të organizimit të tyre janë përpjekur të fshehin dhe mbrojnë informacionin nga kundërshtarët e tyre. Për të arritur këtë është përdorur kriptografia, e cila në vetvete ka një histori të gjatë të zhvillimit të llojeve, formave dhe metodave të saj. Kriptografia së bashku me kriptoteorinë formojnë kriptologjinë.*

*Në këtë shkrim është trajtuar puna e bërë nga studiuesi holandez Florentijn van Kampen, nga Universiteti i Radboud-it, Holandë, për dekriptimin e një telegrami të vitit 1914, në kohën e mbretit Vid në Shqipëri. Procesi i dekriptimit, zgjidhjes dhe formimit të tekstit të hapur të telegramit, është realizuar duke marrë në konsideratë faktet historike, hipotezat, analizën dhe zbërthimin kriptologjik të telegramit. Zbërthimi kriptologjik ka kaluar nëpërmjet studimit dhe përcaktimit të sistemit të shifrës; zgjidhjes së shifrës duke përdorur algoritmin e mbështetur kryesisht në statistikat gjuhësore; zhvillimin e një softueri të veçantë sulmi; përcaktimin e çelësit më të mundshëm dhe rindërtimin e tekstit të hapur (të thjeshtë).*

*Në përfundime është vënë theksi për mundësinë e thyerjes së shifrave; nevojën e përdorimit të shifrave me fortësinë e duhur për të mos u thyer dhe vijimin e studimit për gjetjen e burimeve dokumentare historike mbi këtë telegram dhe në tërësi të shifrave të shtetit shqiptar në vite.*

**Fjalët kyçe:** telegram, kriptim, dekriptim, sistem kriptimi, kriptografi, kriptoteori etj.

## RRETHANAT HISTORIKE TË KAPJES SË TELEGRAMIT

**M**ë 20-22 qershor 2022, në Amsterdam, Holandë, zhvilloi punimet Konferenca e 5-të Ndërkombëtare mbi Kriptologjinë Historike “HISTOKRIPT 2022”. Në këtë konferencë u trajtuan aspekte ndryshme të kriptologjisë historike/kriptografisë, duke përfshirë punën në disiplina të lidhura ngushtë me ato (si historia, shkenca kompjuterike, inteligjenca artificiale, gjuhësia llogaritëse, gjuhësia dhe përpunimi i imazhit etj.) që kanë lidhje me tekstet dhe kodet historike të shifruara. Gjithashtu, në temat e konferencës u përfshinë analiza e shifrave historike me ndihmën e metodave moderne të kompjuterizuara, kriptogramet historike të pazgjdhura, makinat kriptuese, historia e kriptografisë moderne (e bazuar në kompjuter), aspektet gjuhësore të kriptologjisë, ndikimi i kriptografisë në rrjedhën e historisë, mësimi dhe reklamimi i kriptologjisë në shkolla, universitete dhe për publikun.

Një nga punimet e paraqitura në Konferencën “HISTOCRYPT 2022” është edhe ai “Dekriptimi i një mesazhi sekret nga Shqipëria, 1914, i telegramit të Tomsonit”. Telegrami i kriptuar shqiptar i vitit 1914 u gjet në vitin 2009 në arkivat e dosjes së Misionit Ushtarak Holandez, të cilin deri në këtë kohë askush nuk kishte qenë në gjendje ta dekriptonte.

### Misioni Holandez në Shqipëri.

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Shqipërisë u arrit në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitet 1912-1913. Në kushtet që pushteti i qeverisë së re të përkohshme shqiptare, të krijuar më 5 korrik 1913, ishte i dobët dhe shumë i kufizuar, gjashtë Fuqitë e Mëdha vendosën që mbret i Shqipërsë të ishte Vidi, i cili e pranoi fronin shqiptar dhe arriti në Durrës më 7 mars 1914. Gjithashtu, Konferenca e Ambasadorëve kishte vendosur që rendi publik të sigurohej nga një xhandarmëri e udhëhequr nga oficerë të huaj, të cilët do të kishin komandim dhe kontroll efektiv të plotë.

Më 1 gusht 1913, qeveria holandeze mori kërkesën zyrtare nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit për të ofruar oficerë për rivendosjen e rendit publik në Shqipëri. Më 19 shtator 1913, Holanda njoftoi se pranonte kërkesën për të ngritur xhandarmërinë ndërkombëtare dhe se do të vendoste oficerë holandezë në dispozicion për një mision në Shqipëri. Misioni filloi me hyrjen e oficerëve të parë holandezë në Vlorë, më 10 nëntor 1913.

Në grupin e oficerëve holandezë bënin pjesë koloneli Willem De Veer; koloneli Lodewijk Thomson (1869-1914), 13 oficerë dhe dy nënoficerë. Kontingjenti përfshinte edhe një inspektor mjekësor, një mjek dhe një sanitar. Koloneli Lodewijk Thomson në fillim u caktua si zëvendës komandant i këtij misioni<sup>1</sup>

<sup>1</sup> D. Heaton Armstrong: “Princ Vidi, Shqipëria gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 2008, faqe 55.

dhe më pas komandant. Ai u vra në betejë më 15 qershor 1914 në Durrës gjatë një sulmi të ashpër të kryengritësve. Rrethanat e sakta rreth vdekjes së tij nuk janë sqaruar kurrë dhe kanë mbetur një çështje e hapur deri më sot. Ky mision përfundoi zyrtarisht më 27 korrik 1914, një ditë para se Austro-Hungaria t'i shpallte luftë Serbisë, ngjarje që do të shënonte fillimin e Luftës së Parë Botërore.

### **Kryengritja e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme, 1914-1915.**

Qeveria e Shqipërisë, e krijuar me 18 mars 1914, me mbretin e saj të ri Vid, e mbështetur nga oficerët holandezë, gjatë periudhës 17 maj-3 shtator 1914, u përball me një rezistencë lokale të madhe. Kryengritja e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme<sup>2</sup> kishte shkaqe të ndryshme ekonomike dhe sociale dhe u zhvillua në rrethana të veçanta, nën ndikimin e interesave dhe kontradiktave të shtresave dhe grupimeve klasore të brendshme dhe të synimeve territoriale të fuqive të huaja të mëdha dhe fqinje ndaj vendit tonë. Kjo kryengritje, krahas urrejtjes ndaj princ Vidit dhe ndaj feudalëve dhe bejlerëve, ishte e veshur edhe me parrulla fetare. Ajo ishte një nga arsyet e tërheqjes së mbretit Vid nga vendi më 3 shtator 1914, duke shënuar rënien e Principatës së Shqipërisë.

Një lojtar kyç në këtë kryengritje ishte Esad Pashë Toptani. Ai luajti një rol të dyfishtë si një njeri me lidhje të forta në kryengritje dhe si ministër i luftës në qeverinë e mbretit. Që para fillimit të kryengritjes dhe gjatë zbatimit të saj, grupi i klerikëve myslimanë të pakënaqur (si Haxhi Qamili, Arif Hiqmeti, Musa Qazimi, Mustafa Ndroqi, etj.), elemente proturq dhe esadistë si dhe vendet fqinjë, u mblodhën rreth Esad Pashës dhe e mbështetën atë. “Fillimi i Luftës së Parë Botërore në gusht 1914 dhe situata në këtë kohë në Shqipëri, ngjallën te pashai toptanas shpresat për ta shfrytëzuar kryengritjen fshatare në interes të planeve të tij, për t’u bërë sundimtar i vendit”<sup>3</sup>.

### **Telegrami.**

Telegrami, që është në qendër të punimit të studiuesi holandez Florentijn van Kampen, lidhet me arrestimin e Esad Pashës nga holandezët. Kur informacionet po shtoheshin se Esad Pasha luante një rol të dyfishtë dhe udhëzonte rebelët për të rrëzuar qeverinë, mbreti Vid urdhëroi holandezët të arrestonin Esad Pashën dhe ta dorëzonin në gjyq. Më 19 maj 1914, oficerët holandezë rrethuan shtëpinë e Esad Pashës dhe gjuajtën me top që shkatërroi një pjesë të shtëpisë së tij. Menjëherë pas kësaj, Esad Pasha u dorëzua<sup>4</sup>.

<sup>2</sup> Shih: [https://en.wikipedia.org/wiki/Peasant\\_Revolt\\_in\\_Albania](https://en.wikipedia.org/wiki/Peasant_Revolt_in_Albania) consulted on 28 December 2021.

<sup>3</sup> “Historia e Artit Ushtarak Shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1939”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 2001, faqe 245.

<sup>4</sup> D. Heaton Armstrong në librin “Princ Vidi, Shqipëria gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 2008, faqe 70-71 shkruan se majori Sluys i raportoi mbretit se: “... I bëra thirrje njerëzve të Esadit

Për të faktuar se pas kryengritjes qëndronte Esad Pasha, oficerëve holandezë u nevojiteshin prova të plota. Kështu, menjëherë pas arrestimit të Esadit, oficerët holandezë i dërguan një mesazh komandantit të tyre Tomson për ta informuar për ngjarjet aktuale. Ata dyshonin se Esad Pasha po jepte udhëzime sekrete për kryengritësit. “Komandanti Tomson, që ishte në Vlorë në kohën e rënies së Esadit, ..... pasi u informua në lidhje me arrestimin, menjëherë nxitoi në zyrën e telegrafit dhe pati fatin të kapte dhe merrte disa telegrame shifrore të koduara”<sup>5</sup>. Këto telegrame shifrore<sup>6</sup> të dërguara nga Esadi, Tomson i mori me vete për t’i kontrolluar, kur ai u kthye me nxitim te kolegët e tij oficerë dhe mbreti në Durrës dhe për t’u dhënë atyre provat se Esad Pasha ishte vërtet pas kryengritjes.

Fatkeqësisht, mbreti hezitoi të akuzonte Esad Pashën. Ai u bind nga italianët, të cilët kishin frikë se mund të zbuloheshin se ata e mbështetën Esad Pashën në fshehtësi, për ta lënë atë të shkojë. Esad Pasha iu dorëzua italianëve dhe u dërgua në Romë<sup>7</sup>.

Nisur nga sa përshkruam më sipër, evidentohen dy enigma. Së pari, rrethanat e vdekjes së kolonelit Tomson dhe së dyti, roli i Esad Pashës në kryengritjen e fshatarëve. Kur telegrami i kriptuar u rigjet në vitin 2009 nga arkivi i ushtrisë holandeze, kishte shpresa se ndoshta do të hidhej pak dritë mbi ndonjërin prej tyre.

### **Kriptoanaliza e telegramit.**

Telegrami i cituar më sipër përbën bazën për kriptoanalizën në punimin e studiusit Florentijn van Kampen, të paraqitur në Konferencën “HISTOCRYPT 2022”. Nisur nga vendi i gjetjes së telegramit, ai e ka konsideruar atë një telegram nga burime historike, të kapura nga Tomson në zyrën telegrafike në Vlorë më 19 maj 1914.

Në procesin e dekriptimit, zgjidhjes dhe formimit të tekstit të thjeshtë përkatës të telegramit janë ndjekur faktet historike, hipotezat, analiza dhe zbërthimi

---

të hidhnin armët poshtë dhe ndërsa ata ishin gati të vepronin në përputhje me urdhërin tim, zotëria i tyre doli në skenë dhe më pyeti se kush më kishte autorizuar të jepja këtë urdhër. Kur i thashë atij se e kisha dhënë urdhërin bazuar në përgjegjësinë time, u bëri thirrje njerëzve të tij të merrnin armët përsëri dhe të përgatiteshin për rezistencë. U gjuajt një e shtënë dhe gjatë shkëmbimit të zjarrit një prej burrave tanë u plagos. Pasi unë nuk doja të rrezikoja jetën e njerëzve tanë, urdhërova të hapej zjarr me top. Gjuajtja e parë bëri një vrimë në çatinë e shtëpisë dhe pas gjuajtjes së tretë, e cila shpërtheu në dhomën e gjumit të Esadit, këtij të fundit nuk i kishte ngelur veç të dorëzohesh”.

<sup>5</sup> Kujtime të oficerit Jan Fabius (1991), pjesëtar i misionit holandez.

<sup>6</sup> Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 116: “Është e paqartë nëse Fabius flet për një telegram me disa faqe (si telegrami në këtë artikull) ose që ai në mënyrë eksplicite do të thotë telegrame të shumta. Ky artikull ka të bëjë me një telegram të vetëm me katër faqe”.

<sup>7</sup> D. Heaton Armstrong: “Princ Vidi, Shqipëria gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 2008, faqe 72-76.

kriptologjik i telegramit. Gjatë analizës së telegramit original evidentohen disa fakte bazë, si:

- telegrami përbëhet nga 736 numra ndërmjet 19 dhe 119;
- 49 numra janë të ndryshëm;
- kufiri i dendurisë (frekuencës) për numër është nga 1 në 74;
- telegrami është nënshkruar në gjuhën shqipe “Nen Prefekti Krujes”;
- telegrami ka një tregues të origjinës (Kruje/Krujë) dhe destinacion (Sjak/Shijak).




Figura 1. Pamje e katër faqeve të telegramit<sup>8</sup>.

Duke qenë se ka një maksimum prej 100 numrash të ndryshëm, gjatë studimit, numrat janë renditur në një matricë 10 x 10, që përfaqëson të gjithë numrat nga 00 deri në 99<sup>9</sup> (tabela 1).

Në telegram ka disa numra me denduri (frekuencë) shumë të ulët dhe disa me denduri shumë të lartë. Disa nga këta numra mund të jenë gabime kriptimi (shifrimi) ose transmetimi, ose rezultat i gabimeve procedurale gjatë përgatitjes ose hetimit të telegramit. Për të krijuar një grup numrash që kriptojnë një alfabet duhet të shmangen gabimet. Ideja është që disa numra me denduri shumë të ulët mund të jenë një gabim. Në këtë rast, pragu është

<sup>8</sup> Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 122-123.

<sup>9</sup> Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 117: “Meqenëse 119 është i vetmi numër mbi 100 dhe meqenëse 99 nuk është përdorur, numri 119 përfaqësohet si 99”.



vendosur në 1%. Për një gjatësi teksti të koduar prej 736 numrash, do të kishim një prag prej 7. Pra, numrat me një denduri më të madhe ose të barabartë me 7 ndoshta janë numra të vlefshëm, që lidhen me një germë (shkronjë) të tekstit të thjeshtë. Këta numra janë shënuar me ngjyrë gri në tabelën 1.

|   | 0 | 1  | 2  | 3  | 4  | 5  | 6  | 7  | 8  | 9  |
|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 1 |   |    |    |    |    |    |    |    |    | 1  |
| 2 |   | 1  | 2  |    |    | 1  |    | 2  | 74 | 49 |
| 3 |   |    | 7  | 8  |    | 2  | 10 | 31 | 26 | 39 |
| 4 | 1 | 13 | 16 | 5  | 24 | 13 | 18 | 24 | 25 | 14 |
| 5 | 1 | 24 | 3  | 8  | 14 | 20 | 39 | 5  | 10 | 5  |
| 6 | 1 | 11 | 48 | 52 | 7  | 25 | 1  | 1  | 7  | 43 |
| 7 |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |
| 8 |   |    | 1  |    |    |    |    |    |    | 1  |
| 9 |   |    |    |    |    |    |    | 1  | 1  | 1  |

Tabela 1. Denduritë e numrave të telegramit (ato gri kanë një denduri  $\geq 1\%$ )<sup>10</sup>.

## PËRCAKTIMI I SISTEMIT TË KRIPTIMIT

Studimi për përcaktimin e sistemit të shifrës dhe të gjuhës së tekstit të thjeshtë ka nisur duke llogaritur Indeks in e Koincidencës (IC)<sup>11</sup>. IC, si një tipar statistikor i një teksti, është vetia që përfaqëson mundësinë se dy shkronja në një shpërndarje janë të njëjta. IC për çdo gjuhë është paksa e ndryshme (tabela 2)<sup>12</sup>. Nëse IC i tekstit të kriptuar është brenda kufirit normal të gjuhëve natyrale, ky është një tregues i fortë se sistemi i kriptimit (shifrit) të përdorur është monoalfabetik.

| Gjuha        | IC   |
|--------------|------|
| Anglisht     | 1.73 |
| Frengjisht   | 2.02 |
| Gjermanisht  | 2.05 |
| Italisht     | 1.94 |
| Portugalisht | 1.94 |
| Rusisht      | 1.76 |
| Spanjisht    | 1.94 |

Tabela 2. IC dhe gjuhët.

<sup>10</sup> Të gjitha figurat dhe tabelat janë marrë nga libri “Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology”; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 117, 120, 122, 123

<sup>11</sup> Indeksi i Koincidencës (IC) është një tregues i përdorur në kriptanalizë, i cili bën të mundur vlerësimin e shpërndarjes së përgjithshme të shkronjave në mesazhin e kriptuar për një alfabet të caktuar. Ky term është trajtuar nga kriptografi amerikan Abraham Sinkov (1966) në librin “Elementary Cryptanalysis: A Mathematical Approach”.

<sup>12</sup> William F. Friedman and Lambros D. Callimahos, 1958: “Military Cryptanalytics, part 1, volume 2”.



Nga llogaritja e bërë, rezulton se në rastin e telegramit, IC është i barabartë me 2.18. Gjithashtu, bazuar në dendurinë e shpërndarjes (treguar në tabelën 1), periudhën në të cilën është dërguar telegrami dhe krahasimi i këtij IC me ato në tabelën 2, autori ka arritur në përfundimin se për kriptimin e telegramit është përdorur një shifër me zëvendësim monoalfabetik<sup>13</sup>.

### **Përcaktimi i gjuhës së tekstit të thjeshtë.**

Nga analiza e telegramit është arritur në përfundimin se teksti i thjeshtë, është në gjuhën shqipe, për shkak të kontekstit historik, faktit të nënshkrimit në gjuhën shqipe dhe gjithashtu sepse shifra monoalfabetike e përdorur kishte nevojë për më shumë se 27 simbole, të përfaqësuara si numra, për të koduar shkronjat me denduri më të madhe se 1%.

Gjatë llogaritjes së tipareve statistikore të tekstit digjital të hapur në gjuhën shqipe është marrë në konsideratë fakti që alfabeti shqip, si një variant i alfabetit latin, ka 36 shkronja, nga të cilat nëntë përfaqësohen nga dy shkronja (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh).

### **Prodhimi i tekstit të telegramit.**

Për prodhimin (gjenerimin) dhe zgjidhjen e shifrës është përdorur algoritmi i mbështetur kryesisht në statistikat gjuhësore. Këto statistika janë nxjerrë nga një përmbledhje e disa teksteve në gjuhën shqipe. Kështu, për projektin janë shfrytëzuar shtatë libra, bazuar në disponueshmërinë, madhësinë, cilësinë dhe llojin<sup>14</sup> e tyre. Autori, në këtë studim, ka përdorur, Paketën Python gdcmdtools<sup>15</sup> për konvertim të librave të skanuar nga *archive.org*<sup>16</sup> në tekst shqip digjital për të përgatitur përmbledhjen e nevojshme. Si rezultat, janë përmbledhur 1045 faqe teksti të skanuara dhe 1.7 MB tekst digjital i papërpunuar.

### **THYERJA E SHIFRËS**

Në vitin 2009, u shfrytëzuan softuere të disponueshëm falas në internet<sup>17</sup> për të thyer shpejt shifrën me zëvendësim monoalfabetik të përdorur në këtë telegram. Megjithatë, të gjitha softet standarde të disponueshëm, nuk siguruan një zgjidhje. Nga analiza e punës së bërë, autori ka evidentuar si shkaqe faktet

<sup>13</sup> Shifra me zëvendësim monoalfabetik është një sistem zëvendësimi që përdor vetëm një alfabet shifror në një kriptogram, në mënyrë që çdo shkronjë e tekstit të thjeshtë të përfaqësohet gjithmonë nga e njëjta shifër.

<sup>14</sup> Librat janë botime të viteve 1911, 1912, 1917, 1956 dhe 1961 (katër prej të cilëve janë përkthime në shqip të Albert Camus).

<sup>15</sup> The package website: <https://github.com/tienfuc/gdcmdtools>.

<sup>16</sup> Faqja e internetit *archive.org* ruan një numër të madh të librave të skanuar, të renditur sipas gjuhës dhe sipas vitit të botimit.

<sup>17</sup> Një nga softueret e përdorur ishte dhe ai Cryptool 2; një paketë kriptografike e programueshme, me funksione të plota për kriptotanalizën dhe zbërthimin e kriptimit të shifrës.

se telegrami ishte shkruar në një dialekt të vjetër të shqipes dhe se teksti i kriptuar kishte shumë gabime.

Për të kapërcyer mangësitë e mësipërme dhe për të arritur dekriptimin (deshifrimin) e telegramit, autori zhvilloi një softuer të veçantë sulmi, të përbërë nga dy pjesë. Nëpërmjet pjesës së parë u nxorën nga teksti statistikave dhe gjuhës. Për këtë janë përdorur denduritë e kombinimeve të katër shkronjave, të ashtuquajtura denduritë e tetragramit, për të prodhuar rezultatin e tekstit. Ky rezultat është shfrytëzuar për të përcaktuar sasinë se sa vetitë statistikore të tekstit ngjajnë me vetitë statistikore të përmbledhjes së tekstit, pra nëse shpërndarjet e dendurisë së tetragrameve janë të ngjashme.

Pjesa e dytë e softurit zbaton një algoritëm të modifikuar që rritet në vlerë në vijimësi derisa arrin një zgjidhje maksimale. Nëpërmjet këtij algoritmi është synuar të gjëndet një përputhje ndërmjet numrave dhe alfabetit, që siguron një rezultat maksimal efikas si dhe shmangie të problemit të optimizimit dhe të mos arrijtes së rezultatit maksimal në sulmin ndaj shifrës. Produkti i zbatimit të softurit (programit) rezultoi me sugjerimin e tekstit të thjeshtë dhe përkatësimin ndërmjet numrave të telegramit dhe alfabetit shqip.

Megjithëse nuk u prodhua një tekst i kuptueshëm, nga ekzekutimi i softurit të sulmit u arritën disa përfundime paraprake, si:

- Hapësirat ndërmjet fjalëve ishin të koduara (ku 28 dhe 29 janë hapësira). Kjo ishte e pazakontë, por shumë e dobishme për sulme të mëtejshme, pasi mundëson dallimin në fjalë. Kriptimi i hapësirave shpjegohet me arsyetimin se hartuesi i telegramit të kriptuar mund të ishte trajnuar në ushtrinë osmane si dhe me faktin që në disa shifra osmane hapësirat janë të koduara<sup>18</sup>.

- Në tekstin e koduar (telegram) ka shumë gabime. Në formën e tij të papërpunuar, është e pamundur të arrihet një zgjidhje që ka ndonjë kuptim.

Në analizën e gabimeve të mundshme të vërejtura në telegram, autori evidenton se ato mund të kenë ndodhur gjatë kriptimit të tekstit të thjeshtë me numra, gjatë konvertimit të numrave në kodin Mors dhe gjatë konvertimit të kodit Mors në numra.

Për thyerjen e shifrës u përdorën shumë teste për të kapërcyer problemet e krijuara nga gabimet në telegram, që pengonin algoritmin të arrinte një zgjidhje. Kështu u provua ndryshimi i një numri me një numër të pasaktë në tekstin e shifruar, që nuk kishte përkatësi me një germë të gjuhës shqipe; marrja në konsideratë se numrat me ngjyrë gri (tabela 1), që kanë një denduri më të madhe ose të barabartë me 7, ndoshta janë pjesë e çelësit; lënia jashtë

<sup>18</sup> Asparouh Velkov, 2002. Les écritures secrètes del'empire Ottoman. Academie Bulgare des sciences, Sofia.

e numrave që kanë një denduri shumë të ulët; pasojat që do të vinin nga shmangia e numrave që tregojnë hapësirat midis fjalëve, të cilat mund të dëmtonin strukturën gjuhësore, pasi do të hiqeshin shkronjat e vetme në fjalë etj. Të gjitha këto teste u përdorën për të gjetur çelësin e sulmit ndaj shifrës së përdorur në telegram.

Pas testeve të ndryshme u pranua që të zbatohet rregulli i lënies jashtë tekstit të fjalëve, sekuencave numerike që fillonin dhe përfundonin me numrat 28 ose 29, që përmbanin numra me denduri të ulët. Teksti i shifruar i reduktuar, që rezultoi nga ky rregull, u ekzekutua më pas në softuerin e sulmit dhe rezultati ishte shumë më e lartë se sa ai i arritur në tekstin e pareduktuar.

### Përcaktimi i çelësit më të mundshëm.

Nga sulmi me softuerin standard me rritje të vlerave në vijimësi, duke lënë jashtë fjalët me numra me denduri të ulët, u arrit çelësi i rikuperuar (tabela 3), ku dallohen pjesë të alfabetit të gjuhës shqipe. Nga sa paraqitet në këtë tabelë, autori konkludon se hipoteza më e mundshme është se çelësi është krijuar nga një person, duke shkruar alfabetin standard të shqipes në rendin e kundërt, duke filluar nga numri më i madh dhe duke përfunduar tek ai më i vogël. Hapësirat janë shtuar në numrat më të ulët. “Meqenëse disa nga numrat kanë një denduri kaq të ulët dhe meqë telegrami përmban kaq shumë gabime, është e pamundur të vërtetohet që ky është saktësisht i njëjti çelës që ishte përdorur në vitin 1914 për të koduar telegramin”<sup>19</sup>.

|   | 1  | 2 | 3  | 4  | 5 | 6 | 7 | 8         | 9         |
|---|----|---|----|----|---|---|---|-----------|-----------|
| 2 |    |   |    |    |   |   |   | <i>sp</i> | <i>sp</i> |
| 3 |    | z | rr |    |   | v | u | nj        | t         |
| 4 | sh | q | gj | r  | s | p | o | n         | ll        |
| 5 | m  |   | l  | k  | j | i | h | b         |           |
| 6 | f  | ë | e  | dh | d |   |   | x         | a         |

*Tabela 3. Çelësi nga sulmi i softit standard me rritje të vlerave në vijimësi, duke lënë jashtë fjalë me numra me denduri të ulët.*

Nisur nga kjo, autori ka arritur në përfundimin se zgjidhja më e mundshme është ajo e treguar në tabelën 4.

<sup>19</sup> “Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology”; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 120.

|   | 1  | 2  | 3  | 4  | 5 | 6 | 7 | 8  | 9  |
|---|----|----|----|----|---|---|---|----|----|
| 2 |    |    |    |    |   |   |   | sp | sp |
| 3 | zh | z  | y  | xh | x | v | u | th | t  |
| 4 | sh | s  | rr | r  | q | p | o | nj | n  |
| 5 | m  | ll | l  | k  | j | i | h | gj | g  |
| 6 | f  | ë  | e  | dh | d | ç | c | b  | a  |

*Tabela 4. Zgjidhja përfundimtare.*

### **Rindërtimi i tekstit të thjeshtë.**

Faza e fundit e zgjidhjes së telegramit është bërë me dorë (manualisht). Gjatë rindërtimit të tekstit origjinal, autori ka bashkëpunuar me një person, njohës dhe folës i mirë i gjuhës amtare shqipe dhe që fliste rrjedhshëm edhe anglishten. Ky person arriti të dallojë se teksti ishte shkruar në një dialekt të vjetër të shqipes, në një formë që nuk është në përdorim sot.

Për të dekriptuar telegramin u përdor çelësi i rikuperuar. Nga dekriptimi duket se teksti përmban shumë gabime të llojeve të ndryshme. Lloji i parë duket se është shkaktuar nga fakti se personi që e ka kthyer tekstin origjinal në tekst shifror nuk është kujdesur aq shumë për të bërë dallimin midis germave “e” dhe “ë” ose “n” dhe “nj”. Një lloj tjetër gabimesh duket se është shkaktuar gjatë transmetimit ose marrjes nëpërmjet kodit Mors. Shumica e gabimeve janë “afër” me numrin origjinal. Meqenëse dy shifrat e secilit numër janë transmetuar veçmas (jo si grup), shpesh ka gabime të veçanta në njërin ose në të dyja shifrat.

Procesin e dekriptimit, autori e sqaron me shembullin e marrë, ku “... në faqen e parë të telegramit janë këta numra: 54, 45, 33, 63, 48, 58, 45, 56, 38, 42, 56, 38. Nëse zbatojmë çelësin e dekriptimit marrim tekstin: *kqyenjgjqithsith* që nuk është një fjalë e fjalorit shqip. Studimi i kujdesshëm tregon se ka vetëm disa gabime dhe një karakter që mungon në numrat: 54 (**45**=44) 33 63 (**48**=49) (**58**=59) (**45**=44) 56 (**38**=39) **62** 42 56 (**38**=39), kështu *kqyenjgjqithsith* del të jetë: **kryengritësit...**”<sup>20</sup>.

### **Telegrami përfundimtar i rindërtuar.**

Me çelësin e gjetur, telegrami u dekriptua dhe teksti u riparua në formën më të

<sup>20</sup> “Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology”; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 120-121.

mundshme, duke arritur rezultatin përfundimtar<sup>21</sup>, si më poshtë:

*Gjendur e ngjarjet e këtushme gjatë ngjare, ju kam diftue zotni ju.*

*Dje kryengritësit kane dërguar lajm dhe na thoshin poqe se nuk na pranoni propozimet tona do të jeni në rrezik se do te vijmë në gjithë këtyre trathorve.*

*I thashë qeverija sa të mundet do të kundërshtohet deri në fund të jetës.*

*Mustafa Pashë i diftova fjalët te gjithë me dhanë bësën me vdes ?? bej nje tradhëti ?? ?? ?? ??*

*E vumë flamurin te Turqisë këtu ka rëndësie të madhe.*

*Ka mundësi që ?? rrëzojshim ?? po mundëm jam tu ju ?? dhe disa këshillonjsve qi.*

*Çuen populli die me fjalë para ju.*

*Dhame pergjigje duke u thënë se do te vijmë vuë flamurin e turqisë.*

*Ju lutem një orë e më parë të dërgoni disa qindra njerëz, njerëz fuqishëm birbo.*

*Pashas të kam tregova me vehte punët janë njom ligësht.*

## PËRFUNDIME

Zbulimi i çelësit të kriptimit tregon rrugën dhe mjetet e përdorura për dekriptimin e telegramit. Kjo është objekt i punës së kriptanalistëve dhe kriptografëve. Thyerja e shifrave mbetet e rëndësishme për të gjetur informacionin e hapur si dhe po ashtu për të përdorur shifra që të kenë fortësinë e tyre të nevojshme për të mos u thyer.

Nisur nga teksti i telegramit vërehet se ka një thirrje për të mobilizuar “*qind burra të fortë*” për të “*vendosur flamurin turk*”. Kjo është një referencë e qartë për Kryengritjen e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme (përmendur në paragrafin 1.2). Emri “*Mustafa*” në telegram ka mundësi të ketë qenë për Mustafa Ndroqin, një nga krerët myslimanë prapa kryengritjes. Fakti që në mesazh shkruhet se “*qeveria do të kundërshtonte*” sugjeron se autori kishte dijeni të plotë mbi mendimet dhe vendimet e qeverisë. Ky fakt mbështet mundësinë që autori i telegramit të ketë qenë Esad Pasha.

Informacioni në faqen 1 të telegramit tregon se mesazhi është dërguar nga Kruja për në Shijak. Shijaku dihej se ishte një bastion i rebelëve dhe vetëm pak ditë para arrestimit të Esad Pashës, “më 17 maj 1914, mbreti mori një mesazh urgjent nga Shijaku ..., që kërkonin përforsime më të forta, pasi qyteti ishte rrethuar nga kryengritësit dhe nuk mund të mbahej në qoftë se do të

<sup>21</sup> “Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology”; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 121.

sulmohej”<sup>22</sup>.

Mbështetur në kontekstin historik të ngjarjeve të kohës së mbretit Vid dhe të veprimtarisë së Esad Pashës në këtë periudhë lind pyetja “a është Esad Pasha autori i këtij telegrami?”. Deri tani nuk ka ndonjë provë të fortë apo përmendje direkte të emrit të tij. Nënshkrimi në shqip i telegramit është me “*Nën Prefekt i Krujës*”. Mbetet për t’u studiuar dhe gjetur nga burimet historike se kush mund të ketë qenë nënprefekti i Krujës në këtë kohë. Nga ana tjetër, një hipotezë që mund të merret parasysh është fakti i kompleksitetit të personalitetit dhe synimeve të Esad Pashës. Esad Pasha, duke qenë ministër i brendshëm dhe i luftës në kabinetin e mbretit, ndoshta e konsideronte veten si nënmbret të vendit dhe “*Nën Prefekt i Krujës*” tregon për të.

Duke qenë se telegrami është shkruar në një dialekt të vjetër të gjuhës shqipe dhe meqenëse ka shumë gabime gjatë transmetimit, kriptimit ose dekriptimit, rezultati përfundimtar lë hapësirë për përmirësim, veçanërisht nëpërmjet një qasje të kombinuar kryptoanalitike dhe historike.

Në shumë dokumente historike është përmendur se kanë ekzistuar dhe janë përdorur shifra (kode shifre) në organizimet dhe format e ndryshme të qeverisjes dhe të shtetit shqiptar, duke filluar nga periudhat më të hershme të ekzistencës së kombit shqiptar. Mbetet i rëndësishëm studimi i mënyrës dhe formave të përpilimit dhe të përdorimit të këtyre shifrave dhe hartimi i një historiku të tyre.

### **Burime të shfrytëzuara**

1. D. Heaton Armstrong: “Princ Vidi, Shqipëria gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 2008, faqe 32-37, 46-47, 54-58, 65-78, 92-118.
2. “Historia e Artit Ushtarak Shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1939”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 2001, faqe 242-248.
3. Proceedings of the 5th International Conference on Historical Cryptology; 20-22 June 2022, Amsterdam, faqe 115-126.
4. Bernard J. Fischer dhe Oliver Jens Schmit “Një histori e përmbledhur e Shqipërisë”, Prishtinë 2022, faqe 123-132.

---

<sup>22</sup> D. Heaton Armstrong: “Princ Vidi, Shqipëria gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 2008, faqe 57.

